




# ANALIZA E SITUATËS

Fëmijët me aftësi  
të kufizuara në Kosovë



# ANALIZA E SITUATËS

Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë\*

24 Nëntor, 2017

Shkruar nga Paula Frederica Hunt dhe Vjollca Belegu-Caka  
me kërkesën e UNICEF KOSOVA

\*Për UNICEF: Këtu e tutje, referencat për Kosovën në këtë dokument do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999)

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

159.922.76(496.51)(047)

Analiza e situatës : Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë / shkruar nga Paula Frederica Hunt dhe Vjollca Belegu-Caka. – Prishtinë : Unicef, 2018. – 154 f. ; 30 cm.

ISBN 978-9951-601-28-3

ISBN 978-9951-601-28-3



“Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e kontributorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe UNICEF-it.”

# Falënderime

Ky raport është përgatitur nga Paula Frederica Hunt (DED – Aftësia e kufizuar, Edukimi dhe Zhvillimi – Lda.) dhe Vjollca Belegu-Caka, me mbështetjen e HandiKOS.

Ky raport është mbështetur nga programi regjional i BE dhe UNICEF ‘Mbrotja e fëmijëve nga dhuna dhe promovimi i gjithëpërfshirjes sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi’.

Mendimet e shprehura në këtë publikim janë ato të kontribuesve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikat ose pikëpamjet e BE dhe UNICEF-it. Të dhënat e përshkruara, analiza e tyre dhe gjetjet dhe rekomandimet e ndërlidhura nuk janë përfaqësuese për gjithë Kosovën dhe duhet të interpretohen me kujdes.

Ekipi dëshiron të falënderojë fëmijët dhe njerëzit e Kosovës për pjesëmarrjen e tyre të përkushtuar dhe spontane në procesin e grumbullimit të të dhënave, duke përfshirë kontributin e tyre zemërgjerë dhe të singertë gjatë Intervistave me Informatorët Kryesor dhe Diskutimet e Fokus Grupeve dhe mikpritjen e treguar ndaj hulumtuesve.

Falënderime të veçanta u drejtohen të gjithë atyre që kontribuan në grumbullimin mbarëvajtës dhe të shpejtë të të dhënave gjatë Diskutimeve të Fokus Grupeve. Ekipi dëshiron të shprehë një mirënjohje të veçantë për stafin e UNICEF-it, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ndihmoi në grumbullimin dhe analizën e të dhënave (Arta Haliti dhe Ivana Milosavljevic), Zyrën për Qeverisje të Mirë, përfaqësuesit nga organizata të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara (OPAK), dhe organizata tjera joqeveritare (OJQ) kombëtare dhe ndërkombëtare që kontribuan në finalizimin e këtij studimi. Në fund, ekipi dëshiron të shprehë mirënjohjen për të gjithë ata që kontribuan në studim dhe në vazhdimësi treguan mbështetjen dhe entuziazmin e tyre gjatë gjithë procesit.

Ky raport i dedikohet të gjithë fëmijëve në Kosovë.



# LISTA E SHKURTESAVE

UA	Udhëzimi Administrativ
TN	Teknologjia Ndhmëse
RBK	Rehabilitimi me Bazë në Komunitet
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
COD	Qendra për Orientim Social
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
QPS	Qendra për Punë Sociale
OPAK	Organizata e Personave me Aftësi të Kufizuara
ZHFH	Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme
IH/IH	Identifikimi i hershëm/Intervenimi i hershëm
KE	Komisioni Evropian
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
BE	Bashkimi Evropian
DFG	Diskutimet e Fokus Grupeve
KP	Koment i Përgjithshëm
BPV	Bruto Produkti Vendor
GIZ	Agjencia Gjermane e Zhvillimit
KNF	Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit
KNF-FR	Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit, fëmijët dhe të rinjtë
TIK	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
AGJ	Arsimi Gjithëpërfshirës
PIA	Plani i Individualizuar i Arsimit
IQ	Koeficienti i Inteligjencës
ISDY	Instituti për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim të Rinisë
NQP	Njohuri, Qëndrime dhe Praktika
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
FKAK	Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar
IKK	Intervista me Informatorët Kryesorë
KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
MICS	Anketa e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
M & V	Monitorimi dhe Vlerësimi
OJQ	Organizatë Joqeveritare
SNDPAK	Strategjia Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit

ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë
PAK	Person me Aftësi të Kufizuara
QB	Qendra Burimore
NVA	Nevoja të Veçanta Arsimore
SitAn	Analiza e Situatës
GJSH	Gjuha e Shenjave
OS	Olimpiada Speciale
PS	Punonjës Social
TiT	Trajner i trajnerëve
DU	Dizajni Universal
OKB	Kombet e Bashkuara
KDPAK (OKB)	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (Kombet e Bashkuara)
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
W3C	Konzorciumi World Wide Web
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

# FJALORTHI

## Aftësia e kufizuar e fituar

Aftësia e kufizuar që rezulton nga ndonjë shkak i jashtëm, siç është lëndimi në ndonjë aksident, sëmundja apo përdorimi i substancave të tilla si medikamentet ose drogat e paligjshme.

## Mundësimi i qasjes (qasshmëria)

Qasshmëria përshkruan shkallën në të cilën një mjedis, shërbim ose produkt mundëson qasjen e sa më shumë njerëz që është e mundur, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara.

## Kufizimet e aktivitetit

Në kuadër të KNF, si kufizime të aktiviteteve konsiderohen vështirësitë që një individ mund t'i ketë në kryerjen e aktiviteteve. Kufizimi në ushtrimin e aktivitetit mund të jenë nga një devijim i lehtë e deri tek një devijim i rëndë në aspektin e kualitetit apo kuantitetit të kryerjes së aktivitetit në mënyrën ose në masën që pritet nga njerëzit pa ndonjë problem shëndetësor.

## Vlerësimi

Proces i cili përfshin ekzaminimin, ndërveprimin dhe vëzhgimin e individëve ose grupeve me gjendje shëndetësore faktike ose potenciale, dëmtime, kufizime të aktivitetit ose kufizime të pjesëmarrjes. Vlerësimi mund të nevojitet për qëllime të ndërhyrjeve rehabilituese, ose për të vlerësuar përshtatshmërinë për mbështetje në arsim, mbrojtje sociale ose shërbime të tjera.

## Komunikimi augmentativ dhe alternativ

Metodat e komunikimit të cilat i plotësojnë ose zëvendësojnë fjalët dhe shkrimin e dorës - për shembull, shprehjet e fytyrës, simbolet, fotografitë, gjestet dhe përdorimi i shenjave.

## Aparatet ndihmëse; gjithashtu teknologjia ndihmëse

Çdo pajisje e dizajnuar, e prodhuar ose e përshtatur për të ndihmuar një person që të kryejë një detyrë të veçantë. Produktet mund të prodhohen posaçërisht ose të jenë në dispozicion në përgjithësi për personat me aftësi të kufizuara.



## Aftësia e kufizuar ose çrregullimet zhvillimore

Gjithashtu e referuar si 'aftësia e kufizuar e fëmijëve'. Një dëmtim që zakonisht për herë të parë vërehet para ose gjatë lindjes ose gjatë foshnjërisë, fëmijërisë ose adoleshencës. E përcaktuar si relative ndaj normave që janë specifike për moshën. Mund të jetë gjenetike ose e fituar, dhe zakonisht zgjatë gjatë gjithë jetës së një personi. Mund të shkaktojë vështirësi me të folurit, lëvizshmërinë, të mësuarit dhe jetesën e pavarur. Shembujt përfshijnë çrregullimet e spektrit të autizmit, paralizën cerebrale, humbjen e dëgjimit, aftësitë e kufizuara intelektuale dhe dëmtimin e shikimit.

## Aftësi e kufizuar

Në kuadër të KNF, aftësi e kufizuar është një shprehje gjithëpërfshirëse për dëmtimet, kufizimet e aktivitetit dhe kufizimet e pjesëmarrjes, duke treguar aspekte negative të ndërveprimit ndërmjet një individi (me një gjendje shëndetësore) dhe faktorëve kontekstual të atij individi (faktorëve mjedisor dhe personal).

## Organizatrat e personave me aftësi të kufizuara (OPAK)

Organizatrat ose shoqatat e themeluara për promovimin e të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara, ku shumica e anëtarëve si dhe organi udhëheqës janë persona me aftësi të kufizuara.

## Intervenimet e hershme

Përfshijnë shërbimet dhe mbështetjen që kanë për qëllim të mbështesin fëmijët e vegjël të cilët janë në rrezik të vonësës zhvillimore ose të fëmijëve të vegjël të cilët janë identifikuar të kenë vonesa zhvillimore ose aftësi të kufizuara. Këto zakonisht përqendrohen në popullatat me rrezik më të lartë të zhvillimit të problemeve, ose në familjet që përjetojnë probleme që ende nuk janë formësuar krejtësisht apo nuk kanë zënë rrënjë.

## Arsimi - gjithëpërfshirës

Arsimi i cili bazohet në të drejtën e të gjithë nxënësve për një arsimim cilësor që plotëson nevojat themelore të të nxënësve dhe pasuron jetën. Duke u përqendruar veçanërisht në grupet e rrezikuara dhe të marginalizuara, ai synon të zhvillojë potencialin e plotë të çdo individi.

## Funksionimi

Një shprehje gjithëpërfshirëse në KNF për funksionet e trupit, strukturat e trupit, aktivitetet dhe pjesëmarrjen. Ajo nënkupton aspektet pozitive të ndërveprimit ndërmjet

një individ (me një gjendje shëndetësore) dhe faktorëve kontekstual të atij individ (faktorëve mjedisor dhe personal).

## Dëmtimi

Në KNF është humbje ose anomali në strukturën e trupit ose në funksionin fiziologjik (përfshirë funksionet mendore), ku anomalia nënkupton ndryshim të konsiderueshëm nga normat statistikore të vendosura.

## Dëmtimi intelektual

Një gjendje e zhvillimit të penguar ose të paplotë të mendjes, që do të thotë se personi mund të ketë vështirësi për të kuptuar, për të mësuar dhe për të mbajtur në mend gjëra të reja dhe për të aplikuar atë mësim në situata të reja. E njohur gjithashtu si aftësia e kufizuar intelektuale, dhe më parë si retardim mendor ose hendikep mendor.

## Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së kufizuar dhe Shëndetit-(KNF)

Klasifikimi i cili siguron një gjuhë dhe kornizë të unifikuar dhe standarde për përshkrimin e shëndetit dhe gjendjeve që ndërlidhen me shëndetin. KNF është pjesë e "familjes" së klasifikimeve ndërkombëtare të zhvilluara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

## Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së kufizuar dhe Shëndetit - Versioni i Fëmijëve dhe i të Rinjve (KNF-CY)

Një version i KNF që merr parasysh karakteristikat e fëmijës në zhvillim dhe ndërveprimin e fëmijës me mjedisin që e rrethon. Pranon që funksionimi dhe aftësia e kufizuar ndër-veprojnë në mënyra të veçanta me zhvillimin e fëmijëve, për shembull ndërsa fëmijët mësojnë ose krijojnë raporte të reja.

## Shërbimet e zakonshme

Shërbimet në dispozicion të çdo anëtari të një popullsie, pavarësisht nëse ata kanë aftësi të kufizuara- për shembull: transporti publik, arsimi dhe trajnimi, shërbimet e punës dhe të punësimit, sistemet e strehimit, shëndetit dhe mbështetjes së të ardhurave.

## Modeli mjekësor

E shih aftësinë e kufizuar si një atribut i një personi, që del si rezultat i një dëmtimi apo gjendjeje shëndetësore . Prandaj, menaxhimi i aftësisë së kufizuar në rend të parë është një çështje e kujdesit profesional mjekësor, me trajtime dhe shërbime për të ndihmuar individin të përshtatet me rrethana të caktuara.

## Pjesëmarrja

Në KNF, përfshirja e një personi në një situatë jete, që përfaqëson perspektivën shoqërore të funksionimit.

## Asistenti personal

Individi i cili mbështet ose ndihmon një person me aftësi të kufizuara dhe është përgjegjës për të në mënyrë të drejtpërdrejtë.

## Personat me aftësi të kufizuara

Personat me dëmtime afatgjata fizike, mendore ose shqisore, të cilat për shkak të barrierave që ekzistojnë në shoqëri dhe në mjedis, mund të kufizojnë aftësinë e tyre që të marrin pjesë në mënyrë efektive në shoqëri dhe të gëzojnë status të barabartë me ata që nuk kanë dëmtime të tilla.

## Prevalenca

Të gjitha rastet e reja dhe të vjetra të një ngjarjeje, sëmundjeje ose aftësie të kufizuar në një popullsi dhe kohë të caktuar.

## Akomodimi i arsyeshëm

Modifikimi dhe rregullimi i domosdoshëm dhe i përshtatshëm që nuk imponon një barrë jo-proporcionale ose të panevojshme, kur është e nevojshme në një rast të veçantë, për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara gëzojnë ose ushtrojnë, në baza të barabarta me të tjerët, të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

## Rehabilitimi

Një sërë masash që ndihmojnë individët që përjetojnë ose kanë gjasa të përjetojnë aftësi të kufizuar të arrijnë dhe të mbajnë funksionim optimal në bashkëveprimin me mjedisin e tyre.

## Faktori i rrezikut

Faktori i rrezikut është atributi ose ekspozimi që ndërlidhet sipas efektit shkak-pasojë me një probabilitet të rritur ndaj një sëmundjeje apo lëndimi.

## Shkollat - gjithëpërfshirëse

Fëmijët me aftësi të kufizuara ndjekin mësimet e rregullta me bashkëmoshatarët e tyre, mësojnë kurrikulën në masën e mundshme dhe atyre u sigurohen burime dhe mbështetje shtesë në varësi të nevojës.

## Shkollat - e integruara

Shkollat që ofrojnë klasa të veçanta dhe burime shtesë për fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilat janë të bashkëngjitura me shkollat e rregullta.

## Shkollat - speciale

Shkollat që ofrojnë shërbime shumë të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe mbeten të ndara nga institucionet arsimore më të gjera; të quajtura edhe shkolla të ndara (segreguara).

## Modeli social

E sheh aftësinë e kufizuar si rezultat i një mjedisi shoqëror që nuk plotëson nevojat e individëve me dëmtime. Individët e tillë janë me aftësi të kufizuara në kuptimin e të qenit të përjashtuar nga pjesëmarrja e plotë për shkak të barrierave fizike, organizative ose të qëndrimeve (atitudave). Prandaj, menaxhimi i aftësisë së kufizuar është në rend të parë çështje e ndryshimit shoqëror që synon heqjen e barrierave të tilla.

## Dizajni universal

Dizajni i produkteve, mjediseve, programeve dhe shërbimeve për të qenë të përdorshme nga të gjithë njerëzit, në masën më të madhe të mundshme, pa nevojën e përshtatjes ose dizajnit të specializuar.

Rehabilitimi dhe trajnimi profesional

Programet e dizajnuara për të rivendosur ose zhvilluar aftësitë e personave me aftësi të kufizuara për të siguruar, mbajtur dhe avancuar në punësim të përshtatshëm - për shembull: trajnimin për punë, këshillimin për punë dhe shërbimet e punësimit.



---

# TABELA E PËRMBAJTJES

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>15</b>
<b>I. HYRJE.....</b>	<b>25</b>
<b>II. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I SITUATËS SË FËMIJËVE ME AFTËSITË KUFIZUARA NË KOSOVË.....</b>	<b>29</b>
<b>III. PROGRESI DHE SFIDAT NË REALIZIMIN E TË DREJTAVE.....</b>	<b>59</b>
<b>IV. TË GJETURAT KRYESORE DHE REKOMANDIMET.....</b>	<b>111</b>
<b>SHTOJCAT .....</b>	<b>123</b>

---



UNICEF/2011/S.Karahoda

**për çdo fëmijë, lojë**

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kjo Analizë e Situatës e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë u zhvillua nga dhjetori 2016 deri në dhjetor 2017 dhe synonte: identifikimin e shkaqeve kryesore të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve në Kosovë, veçanërisht shkeljet e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara vizavijë Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe vlerësimin e barrierave dhe mundësive për qasje dhe pjesëmarrje të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Studimi u bazua në supozimin se fëmijët me aftësi të kufizuara janë pikë së pari fëmijë, e ardhmja e Kosovës dhe të denjë për dinjitet dhe respekt në të gjithë territorin. Aftësia e kufizuar është përkufizuar sipas modelit social të aftësisë së kufizuar, si rezultat i një ndërveprimi midis dëmtimit të personit dhe pengesave mjedisore me të cilat përballen dhe që i pengon ata të kenë qasje në mundësitë e jetës në baza të barabarta me të tjerët.

I projektuar si një studim cilësor, hulumtimi përfshiu një shqyrtim të dokumenteve (*desk review*) dhe identifikimin e palëve të interesuara nëpërmjet një efekti të topit të borës. Gjatë 12 muajve të studimit, më shumë se dyzet e pesë (45) Intervista të Informuesve Kryesorë (IIK) dhe njëzet e shtatë (27) Diskutime të Fokus Grupeve (DFG) u mbajtën në 7 lokacione: Ferizaj, Gjakovë, Prizren, Mitrovica e Veriut, Prishtinë, Fushë Kosovë (Mahalla e romëve), Graçanicë (Mahalla e romëve). Në total, gjashtëdhjetë e dy (62) fëmijë me aftësi të kufizuara, pesëdhjetë e dy (52) fëmijë pa aftësi të kufizuara, pesëdhjetë e nëntë (59) prindër/kujdestarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe pesëdhjetë e tetë (58) ofrues të shërbimeve për fëmijë me aftësi të kufizuara morën pjesë në DFG-të. Vëmendje e veçantë i është kushtuar sigurimit të pjesëmarrjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë.

## Të gjeturat e analizës së situatës

Siç është dokumentuar më poshtë, **numri i personave me aftësi të kufizuara në Kosovë është i panjohur**. Ndërsa të dhënat janë grumbulluar në vitet e fundit, si në Regjistrimin e popullsisë ashtu dhe përmes mjeteve administrative, nuk ka numër të saktë që mund të mbështesë vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, sepse ka definicione të shumta të aftësisë së kufizuar që janë në përdorim nga institucionet e shumta dhe palët e interesuara.

Identifikimi i personave me aftësi të kufizuara ndjek **modelin mjekësor** dhe bazohet në një opinion mjekësor në lidhje me një dëmtim, në vend se një vlerësim holistik, që merr parasysh vlerësimin e profesionistëve të shumtë nga një sërë disiplinash/ sektorësh. Legjislacioni ekzistues që rregullon identifikimin e aftësisë së kufizuar nuk përqendrohet në fëmijët dhe pothuajse gjithmonë përdoret për të siguruar një përfitim në para. Shpesh, fëmijët me aftësi të kufizuara identifikohen vetëm kur arrijnë moshën shkollore dhe përpiqen të regjistrohen në shkollë, në të cilën kohë ndërhyrja është tashmë tepër e vonë për të pasur një ndikim të qëndrueshëm në zhvillimin e tyre. Për më tepër, **praktikat ekzistuese nuk çojnë në plane të individualizuara që janë reaguese ndaj dëmtimeve të secilit fëmijë** dhe barrierave mjedisore dhe nuk



adresojnë nevojën për shërbime të integruara dhe të vazhdueshme për fëmijën dhe familjen, për të mbështetur zhvillimin e duhur dhe qëllimet gjithëjetësore.

Legjislacioni ekzistues, edhe pse aktualisht është duke u rishikuar dhe ndryshuar, nuk është koheziv dhe nuk përfshin të gjitha aspektet (bio-psiko-sociale) të jetës së fëmijëve me aftësi të kufizuara. Nuk zbatohet në nivel lokal, buxhetet për zbatim nuk ekzistojnë ose janë të vogla dhe, më e rëndësishmja, mekanizmat ekzistues për sigurimin e zbatimit nuk janë plotësisht funksional. **Zbatimi i legjislacionit dhe ofrimi i shërbimeve pengohet nga mungesa e përkushtimit, burimeve njerëzore dhe financiare dhe mungesa e vazhdueshme e të kuptuarit të aftësisë së kufizuar nga këndvështrimi social nga profesionistët.** Pavarësisht nga ligji ekzistues kundër diskriminimit, fëmijët me aftësi të kufizuara janë të diskriminuar çdo ditë, në veçanti fëmijët që vuajnë nga faktorë të shumëfishtë disavantazhi. Aftësia e kufizuar ende kuptohet si një gjendje mjekësore dhe jo si një çështje e të drejtave të njeriut dhe profesionistët nuk janë të trajnuar për të përfshirë aftësinë e kufizuar në praktikën e tyre të përditshme. Përveç kësaj, roli profesional i punëtorëve social nuk është i përcaktuar qartë dhe as i mbështetur plotësisht.

Kosova nuk ka një Ligj për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe **ligjet ekzistuese që ofrojnë mbrojtje nuk përfshijnë qartë fëmijët dhe nuk janë përfshirëse të aftësisë së kufizuar.** Kështu, parandalimi, reagimi dhe monitorimi i abuzimit dhe neglizhimit nuk janë bërë shprehimisht të qarta ose të zbatuara. **Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë janë në një rrezik të lartë për të qenë të abuzuar dhe/ose neglizhuar** pasi fëmijët pa aftësi të kufizuara dhe **shumica e fëmijëve dhe familjeve nuk i njohin të drejtat e tyre sipas ligjit, si të mbrohen, apo se si/kujt t'i raportojnë rastet e abuzimit ose neglizhimit.** Për më tepër, mekanizmat ekzistues të mbrojtjes nuk përfshijnë në mënyrë eksplicite fëmijët me aftësi të kufizuara. **Fëmijët me aftësi të kufizuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë në rrezik jashtëzakonisht të lartë të cenueshmërisë.**

Koncepti i Arsimit Gjithëpërfshirës (AGJ), në Kosovë, kuptohet në mënyrën më të kufizuar të tij. Arsimi gjithëpërfshirës kuptohet si ofrimi i qasjes në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara (d.m.th. regjistrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat të rregullta, shpesh në klasa të bashkangjitura) dhe jo si sigurimi i kushteve për pjesëmarrjen e plotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies. Nuk ka **të kuptuar të përbashkët të arsimit gjithëpërfshirës midis palëve të interesit dhe kështu nuk ka as dakordim mbi atë se cila do të jetë rrua përpara në zhvillimin e praktikave gjithëpërfshirëse.** Zhvillimi në fëmijërinë e hershme, gatishmëria për shkollë, parashkollor dhe kopsht nuk përfshihen brenda kuptimit të gjerë të AGJ dhe nuk merren në konsideratë kur zhvillohen planet arsimore. Kurrikulat e përgatitjes së mësuesve para shërbimit dhe në shërbim nuk janë të harmonizuara dhe trajnimi i mësuesve në shërbim është ofruar nga shumë OJQ gjatë viteve, pa një plan veprimi koheziv dhe ka rezultuar me një të kuptuar të fragmentuar dhe praktika të fragmentuara të AGJ.

Sistemi i kujdesit shëndetësor në Kosovë nuk përfshin/integron aftësinë e kufizuar në të gjitha planet e tij të veprimit. **Ekzaminimet (screenings), intervenimi dhe identifikimi i hershëm i fëmijëve në rrezik vonese zhvillimore ose aftësie të kufizuar nuk ekzistojnë dhe modeli mjekësor i aftësisë së kufizuar është përfaqësuar në vazhdimësi nga profesionistët mjekësorë.** Parandalimi dhe analiza e rrezikut nuk ka përfshirë fëmijët

me aftësi të kufizuara, dhe programet shëndetësore të shkollave, edukimi i prindërve dhe intervenimet lokale janë kryer nga OJQ-të shpesh me fonde ndërkombëtare të donatorëve pa mbështetje të qeverisë, kontroll të cilësisë ose pronësi. Rehabilitimi në Kosovë ofrohet nga OJQ-të dhe vetëm për një grup shumë të vogël dhe të veçantë të fëmijëve. Shumë nga shërbimet mbështetëse që kërkohen për sigurimin e jetesës së pavarur nuk janë në dispozicion.

Puna lidhur me aftësinë e kufizuar është kryer në masë të madhe nga grupe të vogla të personave me aftësi të kufizuara që kanë një interes të përbashkët përkitazi me një dëmtim specifik. Përderisa ekziston një përpjekje e përtërirë për ta bërë aftësinë e kufizuar gjithpërfshirëse në Kosovë, kjo përpjekje nuk e pranon gjithmonë se **fëmijët kanë nevoja specifike që nuk mund të adresohen në legjislacion, politika dhe shërbime të zhvilluara për të rriturit**. Gjatë gjithë kohës, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre kanë munguar në masë të madhe nga dialogu, dhe **fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre nuk janë të informuar për të drejtat e tyre, ose mbi ato pak shërbime që janë në dispozicion për ta**.

Rekomandimet e mëposhtme janë agreguar sipas nivelit të perceptuar të urgjencës (prioritetit), si dhe nga niveli i sistemit dhe/ose institucioni përkatës që ka më shumë të ngjarë të jetë në gjendje t'i përgjigjet nevojave të identifikuar më sipër.

## REKOMANDIMET NGA ANALIZA E SITUATËS

### PËRGJEGJËSITË E NIVELIT QENDROR

#### Prioriteti 1A: Bërja e fëmijëve (me aftësi të kufizuara) një prioritet

Prioriteti më i lartë në Kosovë në lidhje me sigurimin e përmbushjes së të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara është që **Parlamenti dhe ministrat përkatës të linjës të sigurojnë që të gjithë fëmijët, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, të bëhen pjesë e dukshme/vizibile e agjendës së Kosovës për zhvillim**. Mbështetja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar është një çështje e vullnetit politik dhe duhet të ketë peshë me përfshirjen e Parlamentit (të 14 Komisionet Parlamentare) dhe Zyrën e Kryeministrit në të gjitha çështjet që lidhen me fëmijët me aftësi të kufizuara, duke filluar me miratimin e masave që adresojnë normat dhe qëndrimet sociale që ndikojnë në identifikimin dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Një hap i parë duhet të jetë **investimi në zhvillimin e kapacitetit dhe vullnetit politik të Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur** për të siguruar që të gjithë sektorët janë përfshirës të aftësisë së kufizuar dhe se e gjithë vendimmarrja është e përgjegjshme ndaj zërave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Nën udhëheqjen e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur, **mbështetja e të gjitha 14 Komisioneve Parlamentare në udhëzimin e ministrive të linjës për të zhvilluar mekanizma të qartë raportimi, detyra, role dhe përgjegjësi, për të siguruar mbulimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme** për fëmijët me aftësi të kufizuara nga ministria më përkatëse e linjës, duke përfshirë alokimin e burimeve të mjaftueshme financiare për zbatimin e legjislacionit

(duke filluar me një buxhet të dedikuar për ofrimin e shërbimeve për fëmijët, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara).

Duhet të ekzistojnë mekanizma të tillë si **krijimi i një kodi buxhetor dhe granti specifik për shërbimet sociale**, për të zbatuar legjislacionin në nivel komunal dhe për të siguruar burime shtesë financiare për ato komuna që paraqesin nivele më të larta të ofrimit të shërbimeve efikase dhe efektive për fëmijët me aftësi të kufizuara, të matur për nga numri i fëmijëve nga popullatat e cenushme (fëmijët me aftësi të kufizuara përfshirë fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian) të përfshirë plotësisht dhe që marrin pjesë me fëmijët shumicë. **Kërkimi i raporteve të rregullta nga ministritë e linjës, Zyra për Qeverisje të Mirë, si dhe Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar dhe Këshilli Kombëtar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara** mbi aktivitetet e tyre lidhur me ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe efektive për fëmijët me, duke përfshirë buxhete.

### Prioriteti 1B: Modeli shoqëror (social) i aftësisë së kufizuar

NJËKOHËSISHT me bërjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara të dukshëm/vizibil, duhet të sigurohet që **përkufizimi i aftësisë së kufizuar i përfshirë në KDKPAK** të përfshihet në të gjithë legjislacionin në nivel qendror dhe lokal që lidhet drejtpërdrejt me fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara dhe të zbatohet si **“përkufizim pune”** i përdorur nga të gjitha ministritë e linjës (dhe institucionet përkatëse komunale) gjatë përcaktimit të plotësimin të kriterëve për aftësi të kufizuar. Për të siguruar harmonizimin, e gjithë metodologjia, kriteret dhe mjetet e nevojshme për të përcaktuar plotësimin e kriterëve/ të drejtën për shërbime dhe përfitime duhet të zhvillohen në të gjitha autoritetet qendrore dhe lokale. Kjo është thelbësore për të siguruar që të drejtat e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara të njihen dhe të përmbushen në mënyrë të barabartë pavarësisht nga vendi i tyre i ekipit vlerësues që inicion procesin.

**Identifikimi, vlerësimi dhe plotësimi i kriterëve të fëmijëve duhet të konsiderohet si një qasje e integruar, holistike dhe multidisiplinare, e kryer nga një ekip mobil i ekspertëve profesionistë**, me udhëheqje të menaxhimit të rasteve nga MASHT-i, me bashkëpunim të ngushtë me MSH, MPMS, QPS-të, por sa **më herët që të jetë e mundur gjatë jetës së fëmijës** (mosha shkollore është tepër vonë) me bashkëpunim të ngushtë me metodologjitë e identifikimit të hershëm/intervenimit të hershëm (IH/IH). Ekipet duhet të trajnohen mbi parametrat KNF-FR - vlerësimi funksional - dhe të marrin në konsideratë të tre aspektet e modelit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar kur bëjnë përcaktimet e plotësimin të kriterëve, duke siguruar që rivlerësimet të kërkohen mbi baza sipas nevojës, sipas përcaktimeve të ekipit (i përshtatshëm për qëllimin) për secilin rast.

Një qasje e integruar, holistike dhe multidisiplinare e bazuar në vlerësimin funksional e bën kriterin e aftësisë së kufizuar të përhershme të papërshtatshëm dhe të panevojshëm. Zyra për Qeverisje të Mirë dhe ministritë e linjës duhet të angazhohen në një rishikim të dispozitave të përfitimeve në mjete monetare dhe të sigurojnë që **mjetet monetare ofrohen për fëmijët me aftësi të kufizuara bazuar në nevojën reale/faktike** dhe të mos u ofrohen familjeve si një mekanizëm për zbutjen e varfërisë. Të konsiderohet krijimi i një sistemi që shfrytëzon burimet financiare ekzistuese për të

ofruar shërbimet e nevojshme dhe se më pak përfitime në mjete monetare përdoren për të mbuluar shërbimet e specializuara që në përgjithësi nuk ekzistojnë në të gjitha komunitetet (d.m.th. sistemi i kuponëve/vauçerëve).

## Prioriteti 2: Legjislacion që është në përputhje me KDKPAK dhe që zbatohet

**Të sigurohet që ligjet dhe politikat të reflektojnë frymën e KDKPAK-së.** Me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, të krijohet **një sistem monitorimi** brenda çdo ministrie të linjës dhe nëpër ministri për të ndjekur zhvillimin dhe zbatimin e politikave strikte anti-diskriminuese që sigurojnë të drejtat e të gjithë fëmijëve, në të gjitha fushat e jetës, në veçanti fëmijët nga grupet më të pafavorizuara dhe fëmijët në rrezik diskriminimi për shkak të disavantazheve të shumta (p.sh. vajzat me aftësi të kufizuara, fëmijët me vonesa ose aftësi të kufizuara nga zonat e largëta rurale, fëmijët me vonesa ose aftësi të kufizuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian). Të zbatohet legjislacioni ekzistues duke ofruar trajnime në gjuhën e shenjave për punonjësit në poste publike, të cilët mund të mbështesin komunikimin adekuat ndërmjet komunitetit të të shurdhërve dhe profesionistëve. Të përfundohet procesi i zhvillimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve duke u angazhuar në konsultime të gjera me të gjitha palët e interesit, veçanërisht fëmijët dhe të rinjtë, të cilët do të jenë përfituesit kryesorë të dispozitave të përfshira në ligj dhe **të sigurohet që ligji është përfshirës i aftësisë së kufizuar dhe parashikon mekanizma për të parandaluar, monitoruar dhe për të reaguar ndaj abuzimit/neglizhimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.**

Sigurimi i burimeve adekuate financiare dhe njerëzore për Zyrën e Qeverisjes së Mirë (si Sekretariat i Këshillit Kombëtar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara) dhe Institucionit të Avokatit të Popullit, duke përfshirë mundësitë e zhvillimit të kapaciteteve të lidhura me të drejtat (dhe shkeljet e të drejtave) të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, me fokus të veçantë tek fëmijët me aftësi të kufizuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Burimet financiare dhe njerëzore janë të domosdoshme për të koordinuar zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit duke përfshirë Planin e ardhshëm Kombëtar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Bashkësia ndërkombëtare duhet të insistojë me qeverinë në nivel qendror dhe lokal në zbatimin e legjislacionit ekzistues **që është në përputhje me KDKPAK** dhe hartimin/zbatimin/monitorimin e shërbimeve cilësore si **kushte për bashkëpunim dhe mbështetje financiare**. Të gjitha agjencitë e sistemit të OKB-së, Delegacioni i BE-së dhe donatorët ndërkombëtarë duhet të avokojnë për veprime më të koordinuara duke qenë më strategjik në shpenzimet e tyre (burimet njerëzore dhe financiare) dhe duke investuar në edukimin e vendimmarrësve, duke filluar me trajnime mbi modelin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar.

Vendimmarrja duhet të informohet nga **një proces gjatësor/longitudinal i grumbullimit të të dhënave** për të përfshirë një anketë të ekonomive familjare dhe/ose regjistrim të popullsisë që do të ishin përfshirës në nivel kombëtar dhe që mund të mbledhin të dhëna në lidhje me përhapjen/prevalencën e aftësisë së kufizuar të fëmijëve (aftësia funksionale), duke filluar në moshën 0. Të dhënat e grumbulluara mbi aftësitë funksionale dhe kufizimet mund të ndihmojnë autoritetet lokale për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre. Nëse një

anketë dhe/ose regjistrim bazë/pikënisje i popullsisë, përfaqësues në nivel kombëtar, nuk është e mundur të bëhen në periudhën afatshkurtër, të merret në konsideratë realizimi i një Ankete të Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) me një modul mbi funksionimin e fëmijës në vitin 2019. Të konsiderohet krijimi i një baze qendrore të të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara, që mund të identifikojë fëmijët me aftësi të kufizuara në bazë të numrit të regjistrimit të lindjes dhe të sigurohet që të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet komunale të kenë qasje dhe përgjegjësi ndaj futjes së të dhënave të besueshme dhe të sakta për aftësinë funksionale për të siguruar që të ketë në dispozicion informata të përditësuara për vendimmarrje.

## DECENTRALIZIMI I PËRGJEGJËSISË zbatimi dhe ofrimi i shërbimeve

### Prioriteti 3: Identifikimi i shërbimeve të cilësisë së lartë

Sigurimi i shërbimeve që është i një cilësie të lartë dhe përfshirës i fëmijëve me aftësi të kufizuara kërkon burime njerëzore, si dhe krijimin ose ri-alokimin e burimeve financiare ekzistuese. Për të përcaktuar se çfarë shërbimesh ekzistojnë, duhet të zhvillohen dhe/ose të përmirësohen tre veprime që duhet të ndërmerren njëkohësisht:

- a. Angazhimi në **hartëzimin e shërbimeve ekzistuese për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre dhe identifikimi i segmenteve të praktikave të mira dhe nevojave**. Përfshirja e të gjithë projekteve aktuale dhe të planifikuara nga organizatat e OKB-së dhe organizatat tjera. Të sigurohet që përpjekje të koordinuara janë duke ndodhur në teren dhe të krijohet fotografia e plotë midis të gjitha palëve të interesuara; Praktikave të mira ekzistuese në nivel lokal, shumë prej të cilave bazohen në “faktorin njerëzor”, duhet të identifikohen, dokumentohen dhe analizohen siç duhet për replikim dhe përdorim të qëndrueshëm;
- b. Kryerja e një **vlerësimi të kapaciteteve të të gjithë profesionistëve të arsimit** (duke përfshirë profesionistët e zhvillimit gjatë fëmijërisë së hershme dhe parashkollorë) të cilët punojnë, madje edhe në mënyrë periferike me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe sigurimi i një grupi adekuat rekomandimesh për standardet minimale, duke avokuar krijimin e tyre të menjëhershëm. Kjo duhet të përfshijë vlerësimin e kapaciteteve të institucioneve për përgatitjen e mësuesve para shërbimit dhe në shërbim për arsimin gjithëpërfshirës, në përputhje me standardet e përcaktuara nga Neni 24 i KDPAK (dhe Komenti i Përgjithshëm # 4 mbi *E drejta për arsim gjithëpërfshirës*);
- c. Angazhimi në hulumtime të **Njohurive, Qëndrimeve dhe Praktikave (NQP) të fokusuara në profesionistë dhe ofrues të shërbimeve**. Përqëndrimi i vëmendjes suaj në këtë nën-grup të popullatës mund t’i ofrojë palëve të interesit një bazë të rëndësishme në lidhje me profesionistët, vizatime kategorive të ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre.

## Prioriteti 4: Ndërtimi i kapaciteteve për shërbime të cilësisë së lartë në nivel komunal/lokal

Bazuar në tre veprimet e mësipërme, avokimi tek institucionet përgjegjëse për të investuar në **zhvillimin e kapaciteteve të synuara për profesionistët për të mbështetur zhvillimin e ekipeve multidisiplinare të ekspertëve** (të përhershëm dhe mobil në nivel komunal dhe lokal) që mund të mbështesin prindërit dhe familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha aspektet e jetës, duke përfshirë: ndihmën sociale, rehabilitimin, përfshirjen në shkolla të rregullta, qasjen në shërbimet shëndetësore përfshirëse të aftësisë së kufizuar dhe sigurimin e pajisjeve të teknologjisë ndihmëse.

Investimi në **zhvillimin e kapaciteteve të profesionistëve të zhvillimit gjatë fëmijërisë së hershme dhe parashkollorë, mësuesve dhe profesionistëve të tjerë të arsimit për të punuar dhe ndihmuar në nxitjen e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës**. Të gjithë mësimitdhënësit duhet të jenë të trajnuar në mënyrë adekuate mbi zhvillimin e fëmijës dhe pedagogjinë e përqendruar te fëmijët dhe instruktimin e diferencuar që mund t'i mbështesë ata për t'i dhënë mësim të gjithë nxënësve në një klasë të rregullt. Mësimitdhënësit dhe profesionistët e arsimit duhet gjithashtu të trajnohen për të identifikuar rastet kur ata kërkojnë mbështetjen e mësuesve të tjerë ose profesionistëve të specializuar dhe ata duhet të detyrohen të përdorin mekanizma për bashkëpunim dhe kooperim ndërmjet profesionistëve.

Ofrimi i trajnimit bazik për **integrimin e aftësisë së kufizuar për të gjitha ekipet/zyrtarët e të drejtave të njeriut në nivel komunal**. Vënia në spikamë e nevojës dhe avantazheve të një qasjeje shumë sektoriale ndaj aktiviteteve që lidhen me aftësinë e kufizuar dhe përfshirjen sociale, me udhëheqje nga ekipe/zyrtarë të të Drejtave të Njeriut dhe sigurimi që ekzistojnë modelet më të mira për të punuar drejtpërdrejt me familjet dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Njëkohësisht, përmirësimi i koordinimit ndërsektorial duke **përcaktuar qartë mandatin koordinues të QPS-ve komunale** dhe forcimi i kapaciteteve të tyre përmes sigurimit të burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare. **Krijimi i mekanizmave për raportimin** e veprimeve të koordinuara që çojnë në identifikimin, vlerësimin dhe kualifikimin për shërbime të fëmijëve në situata të cenueshme (si afatshkurtra ashtu dhe afatgjata), veçanërisht fëmijët në rrezik të vonësës ose aftësisë së kufizuar, varfërisë, dhunës ose shfrytëzimit ose braktisjes dhe atyre nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. **Zgjerimi i rolit, kapaciteteve dhe përgjegjësisë të punonjësve socialë për menaxhimin e rasteve** për të siguruar që ato të arrijnë të gjithë fëmijët, duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, kudo në vend, duke përfshirë fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

## Prioriteti 5: Sigurimi i shërbimeve të cilësisë së lartë

Përshpejtimi i zhvillimit të **një sistemi të identifikimit të hershëm dhe intervenimit të hershëm (IH/IH)**, i cili respekton përkufizimin e aftësisë së kufizuar sipas modelit social, **kryhet nga ekipet e profesionistëve multidisiplinar dhe shpie në ofrimin e shërbimeve në mjedise gjithëpërfshirëse**. Shtrirja dhe zgjerimi i përpjekjeve ekzistuese për vizita në shtëpi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe programet shëndetësore të shkollave për të ekzaminuar fëmijët e moshës shkollore për kufizime të mundshme funksionale në domenet e dëgjimit, shikimit, lëvizjes, komunikimit, të mësuarit dhe sjelljes/emocioneve gjatë gjithë ciklit të jetës duke përdorur protokollet e standardizuara.



Sigurimi që fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë qasje në **zhvillimin e fëmijërisë së hershme dhe në mundësitë për gatishmëri për shkollë** dhe inicimi i kalimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga klasat e bashkangjitura dhe qendrat burimore në shkollat e rregullta; hulumtimi i dobisë së mundshme të qendrave burimore për të mbështetur tranzicionin; **qartësimi i rolit të mësuesve të arsimit të përgjithshëm**, mësuesve të arsimit special, asistentëve të mësuesve dhe të tjerëve brenda një sistemi arsimor gjithëpërfshirës në Kosovë.

Krijimi i një sistemi të kujdesit shëndetësor që është proaktiv në vend se reaktiv. Investimi në **promovimin e shëndetit dhe edukimit shëndetësor, duke përfshirë edukimin prindëror për zhvillimin e fëmijës** dhe sigurimi që ndërmerren masa preventive dhe universale si vaksinimi dhe ekzaminimet për kufizimet funksionale për të identifikuar nevojat para se të ndodhin ato dhe **inkurajimi i shtrirjes së informacionit nga mjekët e mjekësisë familjare dhe qendrat shëndetësore lokale të komunitetit**. Të gjithë profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të kenë së paku njohuri minimale në lidhje me vlerësimet funksionale sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionimit dhe modelit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, duke çuar në një të kuptuar më të mirë të rolit të tyre brenda fushëveprimit të metodologjisë multidisiplinare të identifikimit dhe vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

## Prioriteti 6: Monitorimi i shërbimeve të cilësisë së lartë

Forcimi i kapaciteteve të OJQ-ve dhe OPAK në përgjithësi, dhe në veçanti Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar, për të folur **në emër të fëmijëve me aftësi të kufizuara me një zë të vetëm** dhe pa presionet politike të elektorateve të veçanta (specifike për dëmtimin). Për shkak se fëmijët kanë nevoja dhe pika të forta që janë specifike për moshën dhe nivelin e zhvillimit të tyre, Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar duhet t'i sigurohen mundësi për të zhvilluar kapacitetin e tyre në lidhje me të drejtat e fëmijëve, përfshirë angazhimin në konsultime me fëmijët me dhe pa aftësi të kufizuara për çështjet që lidhen me ta (dhe që ata zgjedhin vetë).

**Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre duhet të jenë pjesë përbërëse e çdo procesi monitorimi dhe vlerësimi** që lidhet me zhvillimin e legjislacionit dhe zbatimin dhe/ose ofrimin e shërbimeve. Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre duhet të përfshihen në krijimin e një sistemi të monitorimit dhe vlerësimit të shërbimeve, që çon në një sistem rangimi që mund të sigurojë informacionin e nevojshëm për vendimmarrje të orientuar kah cilësia. Për më tepër, fëmijët me aftësi të kufizuara duhet **të jenë në gjendje të raportojnë, në mënyrë anonime, për rastet e abuzimit/neglizhimit, duke siguruar që raportet e tyre të merren seriozisht dhe se ndërmerren veprime mbi ankesat**. Përveç kësaj, aktivitetet për parandalimin e dhunës duhet të vazhdojnë dhe zgjerohen për të edukuar profesionistët dhe publikun e gjerë mbi të drejtën e mbrojtjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara. Sigurimi që të gjithë fëmijët dhe familjet e tyre, veçanërisht ato në komunitetet e cenushme ose të pafavorizuara (p.sh. komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian) janë të vetëdijshëm për të drejtën e tyre për mbrojtje dhe për mënyrat në të cilat ata mund të kërkojnë të drejtat e tyre. Inkurajimi i një modeli bashkëpunues pune që përfshin Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSh), MSH dhe profesionistët shëndetësor të nivelit komunal përgjegjës për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara për të siguruar që **përgjigjet në nivel lokal të bëhen sipas standardeve ndërkombëtare**. MSH duhet

të marrë përgjegjësinë për koordinimin e të gjitha aktiviteteve që lidhen me kujdesin shëndetësor, për të siguruar një qasje kohezive dhe të koordinuar për ofrimin e shërbimeve. Një sërë udhëzimesh për donatorët, OJQ-të dhe OPAK duhet të përgatiten për të siguruar që të gjitha burimet financiare dhe njerëzore të ofruara për sistemin shëndetësor të bien brenda standardeve të përcaktuara nga OBSH-ja, dhe të merren në konsideratë Udhëzimet e OBSH-së për Rehabilitimin e Bazuar në Komunitet për Personat me Aftësi të Kufizuara.

## PËRGJEGJËSIA E KOMUNITETIT

### Prioriteti 7: Asgjë për Ne, Pa Ne

Rritja e kapaciteteve të **fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, dhe fuqizimi i tyre për të kërkuar të drejtat e tyre** përmes diskutimeve publike dhe dialogut me autoritetet. Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet **angazhimit me fëmijët dhe familjet e tyre në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**. Komuniteti ndërkombëtar duhet të kushtëzojë të gjitha aktivitetet e lidhura me aftësinë e kufizuar, të financuara ose të financuara pjesërisht, që të përfshijnë aktivitete të monitorimit dhe vlerësimit që do të udhëhiqen nga fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, në bashkëpunim me OPAK të cilët mund t'i përfaqësojnë ata.

**Krijimi i ekipeve multidisiplinare që përfshijnë anëtarë të komunitetit, të cilët kanë njohuri për komunitetet në të cilat jetojnë** (p.sh. ndërmjetësit rom, udhëheqësit e komunitetit ashkali dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara) dhe që janë në gjendje të komunikojnë në mënyrë efektive dhe pa paragjykime me anëtarët e komunitetit.

Përkrahja e OPAK/OJQ-ve në sigurimin e **vetëdijes dhe edukimit në lidhje me të drejtat e fëmijëve për popullatën në përgjithësi, dhe profesionistëve të vijës së parë, në veçanti**; mbështetja e OPAK-ve në përvetësimin e shkathtësive dhe njohurive të nevojshme për t'u angazhuar në metoda të përziera, hulumtime pjesëmarrëse dhe aktivitetet e M&V, duke kontribuar kështu në komunitetin hulumtues kosovar. Të sigurohet që OPAK/OJQ-të të krijojnë një rrjet informativ që mund të ofrojë informacion, referim dhe mbështetje për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

\* \* \* \*

Kapitulli i fundit i raportit paraqet gjetjet dhe rekomandimet sipas barrierave të identifikuar dhe neneve të ndërlidhur të KDPAK, dhe shtjellon në më shumë hollësi disa nga rekomandimet e përfshira në këtë përmbledhje ekzekutive. Në të dyja rastet, pritet që kjo Analizë e Situatës, megjithëse vetëm një përshkrim i situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë në një moment të caktuar në kohë, mund të ofrojë një nxitje dhe udhërrëfyes për zhvillimin e Planeve të Veprimit.





UNICEF/2011/S.Karahoda

**për çdo fëmijë, dashuri**

# I. Hyrje

## Objektivat

Objektivi kryesor i kësaj analize të situatës është të përmbledhë, analizoj dhe dokumentoj faktet dhe vrojtimet aktuale, duke çuar në një vlerësim të jetës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë, veçanërisht në lidhje me statusin e përmbushjes së të drejtave të tyre universale sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm KDF) dhe Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (në tekstin e mëtejshëm KDPK), bazuar në të dhënat ekzistuese dhe hulumtimet cilësore shtesë të kryera në këtë studim.

## Metodologjia

Analiza e Situatës u iniciua me një shqyrtim të dokumenteve (*desk review*) në dispozicion në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë. Rishikimi i dokumenteve shërbeu për përpilimin dhe analizimin e të dhënave ekzistuese në dispozicion, me relevancë për fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Të dhënat nga rishikimi u plotësuan me të dhëna cilësore të mbledhura në mëse 45 Intervista me Informuesit Kryesor (shih listën e plotë në shtojcën 1), si dhe 27 Diskutime me Fokus Grupe të mbajtura në 7 lokacione (shih listën e plotë në shtojcën 2) gjatë një periudhe prej 9 muajve. Intervistat me Informuesit Kyç (IIK-të) u mbajtën me akterët kryesorë relevant qeveritarë të ngarkuar me monitorimin dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me OJQ-të kryesore homologe. Disa akter u identifikuan përmes një paneli ekspertësh të organizuar me qëllim që të sigurohej se Analiza e Situatës ishte përfaqësuese e situatës në terren, të tjerët u identifikuan gjatë rishikimit të dokumenteve, ndërsa të tjerët u identifikuan nga informatorë të tjerë gjatë intervistave (efekti i topit të borës). Diskutimet e Fokus Grupeve (DFG-të) u mbajtën në 7 lokacione (Ferizaj, Gjakovë, Graçanicë, Fushë Kosovë, Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë e Veriut), duke u përpjekur të ofrojnë një pamje gjeografikisht përfaqësuese të situatës. Protokollet për DFG-të u zhvilluan në bashkëpunim duke u bazuar në punën e përfunduar më parë në 6 rajone/vende të tjera (për metodologjinë dhe mjetet e plota të DFG-ve, shih shtojcën 4). Për aq sa ishte e mundur, të dhënat e grumbulluara u ndanë sipas gjinisë, moshës, njësisë administrative, llojit të aftësisë së kufizuar të raportuar dhe aranzhimeve të jetesës (p.sh. institucionit rezidencial/jo rezidencial), dhe informacionet mbi gjendjen e fëmijëve nga grupet minoritare (rom, ashkali dhe egjiptian) u mblodhën në dy sete të Diskutimeve të Fokus Grupeve të mbajtura në komunitete specifike.

Të dhënat e grumbulluara u përdorën për dy qëllime kryesore: së pari, për identifikimin e shkaqeve kryesore të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve, veçanërisht shkeljeve të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në raport me KDPAK; së dyti, për t'i vlerësuar barrierat dhe mundësitë për qasje dhe pjesëmarrje të fëmijëve me aftësi të kufizuara. U përfundua analiza përcaktuese (determinuese) dhe ajo e shkakut, shpesh paralel njëra me tjetrën. Analiza e shkakut ndoqi një procedurë 5-hapëshe: 1) Identifikimi fillestar i shkaqeve të menjëhershme, themelore dhe strukturore bazuar në rishikimet e dokumenteve dhe të dhënave; 2) Identifikimi i shkaqeve bazuar në literaturën ndërkombëtare; 3) Diskutimi fillestar i shkaqeve gjatë Intervistave me Informuesit Kyç; 4) Identifikimi i shkaqeve shtesë bazuar në intervistat dhe diskutimet e fokus grupeve; 5) Validimi përfundimtar i analizës së shkakut. Lloji i dytë, i fokusuar në identifikimin e barrierave dhe pengesave për qasje dhe pjesëmarrje.

Ky raport është hartuar në përputhje me parimet e *UNICEF*-it dhe Udhëzimet e SitAn<sup>1</sup>-it, dhe analiza që rezulton është dëshmi bazë për avokim dhe programim të politikave, duke shikuar në fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet, fëmijët me aftësi të kufizuara që aktualisht janë në sistemin arsimor dhe kur është e mundur, fëmijët me aftësi të kufizuara jashtë arsimit ose institucioneve. Në kuadër të rishikimit të gjerë të dokumenteve që u fokusua tek fëmijët me aftësi të kufizuara, vëmendje e veçantë iu kushtua identifikimit të dokumenteve që kanë të bëjnë me fëmijët e 'padukshëm', siç janë ata të moshës 0-3, vajzat dhe djemtë rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës, deri në masën që ekzistojnë dokumente të tilla.

## Kufizimet

Pjesëmarrësit në DFG-të e kryera në këtë studim përbëjnë një mostër të përshtatshme. Të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara të intervistuar dhe/ose familjet e tyre (me përjashtim të atyre në DFG-të e mundësuar nga Balkan Sunflowers dhe Ideas for Partnership Centre) marrin një lloj mbështetjeje nga HandiKOS-i. Prandaj, është e vështirë të përcaktohet se deri në cilën pikë pjesëmarrësit në DFG janë të paanshëm në raportet e tyre lidhur me ofrimin e shërbimeve (shpesh të kryera nga HandiKOS). Megjithatë, identifikimi i pjesëmarrësve në DFG përmes përdorimit të një metodologjie të ndryshme do të ishte jashtëzakonisht i vështirë, siç dëshmohet në Mitrovicën e Veriut (shih shtojcën 3 për mjetet dhe metodologjinë). Po ashtu, Balkan Sunflowers dhe Ideas for Partnership Centre, OJQ-të që mundësuan DFG-të me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe familjet nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, i identifikuan pjesëmarrësit e DFG-ve nga rrjetet e tyre vetanake të ofrimit të shërbimeve.







UNICEF/2013/G. Pirozzi

**për çdo fëmijë, lumturi**

# II. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I SITUATËS SË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOSOVË

## Konteksti i Kosovës

Kosova është një vend malor ku bujqësia, pylltaria dhe minierat janë sektorët kryesorë. Papunësia është shumë e lartë, me një normë prej 30,5% sipas Anketës për Fuqinë Punëtore për tremujorin e parë të vitit 2017<sup>2</sup>, dhe ekonomia në masë të madhe varet nga ndihmat dhe remitancat ndërkombëtare. Kosova mbetet një nga vendet më të varfra në Evropë, me një BPV prej rreth 3.393 € për kokë banori (në vitin 2016), që është rreth një e dhjeta e niveleve evropiane.<sup>3</sup> Popullsia është “e përbërë nga shqiptarë të Kosovës (92%), serbë të Kosovës 4% dhe pakica të tjera siç janë boshnjak, goran, turq, rom, ashkalinjë dhe egjiptian (4%). Flitet gjuha shqipe, serbe, boshnjake, turke dhe gjuhë të tjera. Religjionet kryesore janë islami, kisha ortodokse dhe kisha katolike romake”<sup>4</sup>. Kosova ka 38 njësi administrative dhe që nga viti 1999 në bazë të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 ka praninë e OKB-së (Misioni i Administratës së Përkohshme në Kosovë, agjencitë dhe programet e saj). Parlamenti i Kosovës ka miratuar rezolutën për pavarësinë në vitin 2008 por Serbia refuzon ta njohë Kosovën si shtet.

Në vitin 2009, Kosova miratoi një metodë të decentralizuar të qeverisjes. Megjithatë, sipas Programit për Bashkëpunim të UNICEF-it për vitet 2016-2020, “rruga për përkthimin e këtyre aktiviteteve në realitete ballafaqohet me sfida serioze politike, sociale dhe ekonomike. Gjithashtu, konteksti aktual politik tregon se ndryshimi në situatën e asistencës për zhvillim e ndërlikon mungesën në rritje të barazisë si dhe papunësinë e të rinjve në Kosovë. Përkundër këtyre sfidave, procesi i vazhdueshëm i decentralizimit ka sjellë dy ndryshime të mëdha në politika dhe në nivelin lokal. Ato përfshijnë transferimin e kompetencave të trajtimit të shërbimeve sociale dhe njerëzore, si dhe buxhetin e mirëqenies sociale. Korniza ekzistuese e politikave nuk është përkthyer mjaftueshëm në mirëqenie sociale për kosovarët. Për t’i adresuar këto sfida, është e nevojshme të identifikohen mënyrat e reja të angazhimit të akterëve për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijëve. Institucionet e Kosovës e kanë përfshirë Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës në Kushtetutën e Kosovës, e cila përbën bazën më të lartë ligjore për të drejtat e fëmijëve. Me hedhjen e këtij hapi strategjik para,

institucionet e Kosovës kanë shprehur gatishmërinë dhe vullnetin e tyre për miratimin e këtij akti ndërkombëtar, si dhe të bëjnë që sistemi i tyre legjislativ të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të njëjtin ta përkthejnë në sisteme dhe shërbime për fëmijë duke u bazuar në burimet në dispozicion”<sup>5</sup>. Procesi i decentralizimit është sfidues sepse komunave shpesh u mungojnë burimet teknike dhe financiare për të përmbushur kërkesat shtetërore. Transferimi i buxheteve nga niveli qendror në atë lokal gjithashtu është raportuar si problematik, duke ndikuar negativisht në mbrojtjen sociale dhe në përmbushjen e të drejtave të fëmijëve, pasi që institucionet lokale nuk i priorizojnë shërbimet e mbrojtjes sociale në burimet dhe të ardhurat e tyre vetanake buxhetore. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit e vitit 2015 është nënshkruar mes BE-së dhe Kosovës, duke hapur kështu rrugën për reforma drejt aderimit në BE, përfshirë këtu edhe mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të gjithë fëmijëve si një objektiv kyç i Bashkimit Evropian.

Tensionet afatëgjata ndëretnike ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës paraqesin sfida në pajtimin e këtyre komuniteteve, posaqërisht në rajonin e Mitrovicës/pjesa veriore. Infrastruktura shëndetësore dhe ajo e arsimit në Kosovën veriore, financohen nga Serbia dhe operohet me ligje të Serbisë; mbrojtja sociale (qendrat për punë sociale) aplikojnë ligjet e Serbisë dhe të Kosovës, dhe i raportojnë Serbisë dhe Kosovës, si dhe policia është pjesë e Policisë së Kosovës (që udhëheqet nga një pjesëtar i nacionalitetit serb i përzgjedhur nga komunat veriore). Bazuar në këtë, individët mund të kërkojnë shërbime nga institucionet administrative të Serbisë ose Kosovës (ose nga të dyja palët), varësisht nga ajo se ku banojnë <sup>6</sup>.

## Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë

Sipas gjetjeve të këtij raporti dhe rishikimeve tjera të dokumenteve, si dhe raporteve nga shumë akterë të intervistuar, situata e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë është përmirësuar me kalimin e kohës, sidomos në 5 vitet e fundit, megjithëse ende mbeten edhe shumë sfida që duhet adresuar. Përkundër të dhënave jo të besueshme, një analizë e situatës e përfunduar në vitin 2011<sup>7</sup> tregoi se vetëm një përqindje e vogël e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara marrin pension social prej afërsisht 103 euro në muaj, e që nga prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara të rënda konsiderohet të jetë i pamjaftueshëm për të siguruar furnizimet dhe medikamentet e nevojshme. Kurrikula jo fleksibile, mungesa e stafit profesional të trajnuar, mungesa e transportit, janë identifikuar si pengesat kryesore për përfshirje, pavarësisht rritjes së numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollën e rregullt.

Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën i vitit 2013<sup>8</sup> konfirmon përmirësimet e arritura në kornizën legjislativë në lidhje me personat me aftësi të kufizuara, si dhe në udhëzimet administrative lidhur me arsimin. Megjithatë, raporti gjithashtu raporton se ndërtesat dhe hapësirat publike mbeten të paqasshme/paarritshme për personat me aftësi të kufizuara dhe bashkëpunimi midis qeverisë dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuara duhet të përmirësohet. Raporti i Progresit i vitit 2014<sup>9</sup> sërish shpreh shqetësimin për qasjen në arsim, kujdesin shëndetësor dhe rehabilitimin, si dhe nevojën për mbështetje të vazhdueshme ndërmjet Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM) dhe Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar. Raporti i vitit 2015<sup>10</sup> raporton se, përkundër legjislativës së duhur, ofrimi i shërbimeve për personat me aftësi të



kufizuara vazhdon të jetë sfidues<sup>11</sup> dhe “të drejtat e personave me aftësi të kufizuara vazhdojnë të ngecin për shkak të shërbimeve joadekuate shëndetësore dhe atyre mbështetëse, si dhe për shkak të qasjes së dobët”<sup>12</sup>. Sërish, raportohet mungesa e zbatimit të planit të veprimit si dhe thuhet se “Largimi i padëshmuar i më shumë se 1000 anëtarëve të komunitetit të shurdhër nga skema pensionale për personat me aftësi të kufizuara është një shqetësim. Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara deri më tash nuk ka mundur të promovojë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe ka nevojë për mbështetje më të fuqishme nga Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Qeverisë, për t’ia mundësuar atij ushtrimin e rolit të tij bashkërendues në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit”<sup>13</sup>. Shqetësimet e shprehura në raportin e vitit 2016<sup>14</sup> ishin të ngjashme, por, siç është dokumentuar më poshtë, situata tani ka ndryshuar.

Gjithashtu, Raporti Vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit i vitit 2015<sup>15</sup> tregon se “Gjendja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë është shumë e rëndë. Mungesa e transportit për të ndjekur mësimin nuk është e vetmja barrierë me të cilën ata përballen. Në bazë të ankesave të hetuara gjatë viteve dhe informatave të siguruar nga përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave joqeveritare rezulton se ata përballen me vështirësi dhe barrierë të shumta në të gjitha fushat e jetës”<sup>16</sup>. Raporti përfshin barrierat që lidhen me arsimin, shëndetin dhe mbrojtjen sociale, duke filluar nga mungesa e planeve individuale arsimore, mungesa e shërbimeve dhe materialeve shëndetësore pa pagesë, përfshirë edhe teknologjinë ndihmëse, mungesat e qendrave të kujdesit ditor, si dhe mungesa e rehabilitimit dhe masave tjera të mbrojtjes sociale. Raporti Vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit i vitit 2016 tregon se “nuk ka ndonjë përparim të dukshëm”<sup>17</sup>. Sfidat dhe pengesat për përfshirje sociale vazhdojnë të ekzistojnë në aspektin e infrastrukturës që nuk mundëson qasjen në të gjitha mjediset publike pavarësisht disa përmirësimeve, punësimit, mungesës së ilaçeve të mjaftueshme esenciale, mungesës së qasjes në arsim dhe mungesa e stafit profesional etj.

Sipas të dhënave të mbledhura në intervistat me përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, mbështetja financiare e ardhshme për veprimet që lidhen me personat me aftësi të kufizuara do të kushtëzohet nga veprimi i menjëhershëm, nga qeveria e Kosovës, mbi rekomandimet e dhëna nga institucioni i Avokatit të Popullit. Prandaj, pritet që lidhja e mbështetjes financiare me zbatimin real të të drejtave ndërkombëtare të njeriut në Kosovë, do të shërbejë si nxitje drejt progresit pozitiv.

Përfaqësuesi i Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), i cili mori pjesë në DFG-të raportoi se situata e personave me aftësi të kufizuara vazhdon të mbetet një sfidë. Përkundër faktit se ekziston një kornizë ligjore për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, situata e tyre nuk është e kënaqshme. Edhe pse ligji për arsimin parauniversitar garanton arsimin gjithëpërfshirës, fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me probleme të ndryshme, duke filluar nga çështjet e të nxëniet, për shkak të mungesës së asistentëve në shkollë. Sigurimi i asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuara i mbetet familjes së fëmijës me aftësi të kufizuara, sepse shkollat nuk kanë asistentë. Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë vështirësi në qasjen në infrastrukturën shkollore, shkollat nuk kanë tualete për fëmijët me aftësi të kufizuara. Fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me problemin e qasjes në infrastrukturën rrugore. Gjithashtu, një sfidë për ta mbeten shërbimet e dobëta shëndetësore dhe sociale. IAP brenda Departamentit të tij për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Departamentit për Mbrojtje të



të Drejtave të Fëmijëve adreson ankesat e parashtruara për shkeljen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Përveç kësaj, hetimet lidhur me shkeljen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit hapen edhe sipas detyrës zyrtare (ex-officio) dhe ato trajtohen në përputhje me mandatin ligjor dhe kushtetues të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Sipas IAP-it, një nga pengesat më të mëdha për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara është mungesa e përgjithshme e njohurive për të drejtat e tyre nga vetë fëmijët, familjet e tyre dhe publiku i gjerë. Familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk e shohin IAP-in si vend ku ata mund t'i adresojnë shqetësimet e tyre, ndërsa në shumë raste ata nuk mund të japin dëshmi për shkeljen e të drejtës së tyre. Ekziston një numër shumë i vogël i familjeve që i drejtohen IAP-it, por Departamenti për Mbrojtje nga Diskriminimi në IAP ka bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile që janë të përfshira në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Një analizë e re e situatës e komisionuar nga UNICEF<sup>18</sup> në vitin 2016 ka konstatuar se fëmijët me aftësi të kufizuara janë një nga grupet më të marginalizuara në Kosovë. Mungesa e të dhënave është konsideruar të jetë pengesa kryesore në adresimin e nevojave të tyre, si dhe mungesa e përkufizimit të aftësisë së kufizuar. Është e vështirë të përcaktohet numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë, kush dhe ku janë si dhe cilat lloje të shërbimeve ofrohen dhe u nevojiten. Hulumtimi, analiza dhe raportimi mbi zbatimin janë të pamjaftueshme, dhe numri i profesionistëve të kualifikuar është po ashtu i mangët. Nuk ekziston bashkëpunim ndërministror ose ndërsektorial, apo i njëjti është i pamjaftueshëm për adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me fëmijët me aftësi të kufizuara, dhe për më tepër "mbrojtja e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk është priorizuar në ndarjen e buxhetit, që nënkupton se mungojnë burimet për zbatimin e politikave, ligjeve dhe strategjive në sektorin e shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe arsimit"<sup>20</sup>. Infrastrukturat nuk e mundësojnë qasjen, përfshirë këtu edhe disa institucione publike, dhe normat shoqërore kanë ndikim edhe tek fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

Ashtu siç edhe pritet me rastin e analizimit të jetës së fëmijëve, ndërveprimet shkollore dhe shoqërore marrin vëmendjen kryesore për të gjithë fëmijët që kanë marrë pjesë në DFG-të për këtë studim, si për fëmijët me aftësi të kufizuara ashtu edhe për fëmijët pa ndonjë aftësi të kufizuar. Në mesin e 52 fëmijëve pa aftësi të kufizuara që morën pjesë në DFG-të, 52 kanë ndjekur shkollën e rregullt në baza të rregullta, të paktën gjysma kanë ndjekur aktivitete jashtëshkollore dhe të gjithë raportuan se kishin një rreth të gjerë të familjes dhe shokëve me të cilët kanë marrë pjesë në ngjarje shoqërore. Megjithatë, gjendja e përgjithshme e 62 fëmijëve me aftësi të kufizuara (shih Aneksin 2 për më shumë informata) që morën pjesë në DFG-të për këtë studim, është mjaft e ndryshme sipas vetë raporteve të tyre. Ndonëse ëndrrat dhe aspiratat e tyre janë shumë të ngjashme me ato të fëmijëve pa aftësi të kufizuara (p.sh. lojtar futbollit/basketbollit, aktor/e, zyrtar policor, mësues, këngëtar, mjek) përvojat e tyre jetësore dhe shkollore – mjetet për t'i arritur aspiratat e tyre – janë shumë të ndryshme. Nga 62 fëmijë, 26 prej tyre janë plotësisht ose pjesërisht të varur nga kujdestari për t'u veshur, ushqyer dhe për nevojat e tualetit. Të paktën gjysma e fëmijëve nuk mund të shkojnë në shkollë vetëm dhe të paktën 12 fëmijë janë të varur nga të tjerët për nevojat e komunikimit (përfshirë 2 fëmijë që kërkojnë një përkthyes të gjuhës së shenjave).

# Përcaktimi dhe kuantifikimi i numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë

## Përkufizimi i aftësisë së kufizuar

Tradicionalisht, aftësia e kufizuar është kuptuar si gjendje mjekësore që duhet adresuar ose një cenueshmëri që mund të përmirësohet nëpërmjet veprimeve bamirëse. Që nga miratimi i **Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara** (tani e tutje si KDPAK) në vitin 2006, është duke u bërë një përpjekje që aftësitë e kufizuara të kuptohen përmes këndvështrimit të të drejtave të njeriut, ose modelit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar. Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet t'i gëzojnë plotësisht të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në baza të barabarta me fëmijët e tjerë, dhe sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF), fëmijët me aftësi të kufizuara janë “së pari fëmijë”, një e drejtë e njeriut që shtrihet tek të gjithë fëmijët.

### Çka është aftësia e kufizuar<sup>21</sup>?

Neni 1 i KDPAK-së përshkruan personat me aftësi të kufizuara si “individë me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilët në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në mënyrë të barabartë me të tjerët”<sup>22</sup>.

Megjithatë, përshkrimi i personave me aftësi të kufizuara i propozuar nga KDPAK rezulton nga progresioni kohor i mënyrës se si është kuptuar aftësia e kufizuar. Të menduarit për aftësinë e kufizuar ka evoluar në mënyrë thelbësore; tre modelet kryesore të përdorura për të konceptualizuar aftësinë e kufizuar janë:

- Modeli më i vjetër dhe më i vjetërsuar është ‘**modeli i bamirësisë**’, i cili e konceptualizon aftësinë e kufizuar si ndëshkim apo tragjedi, zakonisht me ndërhyrjen e zotit. Sipas këtij modeli, individi shihet si nevojtar dhe për keqardhje dhe mund të gjejë shpëtim vetëm nëpërmjet mëshirës, dashurisë dhe kujdesit të tjerëve.
- ‘**Modeli mjekësor**’ është ndoshta më i zakonshmi; ky model e koncepton aftësinë e kufizuar si gjendje fiziologjike të individit, një gjendje apo sëmundje që duhet trajtuar dhe shëruar me ndihmën e profesionistëve shëndetësor.
- Modeli më i fundit, ‘**modeli shoqëror**’ ka evoluar përmes të kuptuarit më të madh të barrierave që pengojnë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara. Modeli shoqëror konstaton se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimet ndërmjet individit me dëmtime specifike fizike, intelektuale, shqisore ose të shëndetit mendor dhe mjedisit rrethues shoqëror dhe kulturor. Aftësia e kufizuar kuptohet si konstrukt socio-politik, ku barrierat në qëndrime, ato mjedisore dhe institucionale që ekzistojnë qenësisht në shoqëri përjashtojnë dhe diskriminojnë në mënyrë sistematike personat me aftësi të kufizuara.

**Modeli Shoqëror** (i njohur edhe si modeli bio-psiko-social) është në përputhje me qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut, ose modelin e të drejtave të njeriut të konceptualizimit të aftësisë së kufizuar dhe është në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit të Organizatës Botërore të Shëndetit, i njohur si KNF. KNF (dhe KNF-FR) e konceptualizon nivelin e funksionimit të një personi si bashkëveprim dinamik ndërmjet kushteve të tij shëndetësore, faktorëve mjedisor dhe faktorëve personal. Ai e përcakton funksionimin dhe aftësinë e kufizuar si koncepte shumëdimensionale që lidhen me:

- Strukturat dhe funksionet trupore të njerëzve.
- Aktivitetet që njerëzit bëjnë dhe fushat jetësore në të cilat marrin pjesë.
- Faktorët në mjedisin e tyre që ndikojnë në këto përvoja.

Modeli shoqëror pranon rëndësinë e kontekstit dhe mjedisit në të mundësuarit apo të pamundësuarit individëve që të marrin pjesë në shoqëri në mënyrë efektive.

Sipas *Strategjisë Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023*<sup>23</sup> (tani e tutje si SNDPAK), personat me aftësi të kufizuara përkufizohen njëjtë si në KDPAK, përkatësisht “individë me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilët në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në mënyrë të barabartë me të tjerët”<sup>24</sup>. Megjithatë, ashtu siç është vërejtur në vendet e tjera të rajonit të Ballkanit, edhe pse përkufizimi normativ i aftësisë së kufizuar përputhet me KDPAK-në, ai nuk vihet në praktikë.

Siç raportohet nga Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar, si legjislacioni kryesor lidhur me personat me aftësi të kufizuara ashtu edhe metodologjitë përkatëse të identifikimit, vlerësimit dhe plotësimit të kriterëve/kualifikueshmërisë për qëllime të ofrimit të shërbimeve të aftësisë së kufizuar, janë nën rishikim për të adresuar kufizimet ekzistuese. Kjo krijon mundësi për identifikimin e ekspertizës ekzistuese në Kosovë, si dhe praktikat më të mira në nivel lokal, të cilat në kombinim mund të ndihmojnë për t’i adresuar disa nga pengesat. Pengesat në përmbushjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara fillojnë fillojnë me mungesën e përkufizimit të aftësisë së kufizuar (dhe kriteret e plotësimit të kriterëve) që merr në konsideratë aftësitë funksionale të secilit fëmijë në raport me mjedisin ku jetojnë. Nevoja për një përkufizim të aftësisë së kufizuar që përfshinë çdo fëmijë individualisht dhe në raport me faktorët mjedisorë dhe që çon tek shërbimet që janë të përshtatshme për qëllimin e paraparë, ende nuk njihet gjerësisht në Kosovë.

Siç përcaktohet nga 59 prindër/kujdestarë në 7 vende që morën pjesë në DFG-të për këtë studim, familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara zakonisht kanë një mesatare prej 3 fëmijësh, edhe pse në mesin e tyre vetëm një fëmijë është me aftësi të kufizuar. Dyzet e një (41) nga dyzet e tre (43) fëmijë janë diagnostikuar të kenë dëmtim (që njëjtësohet me aftësinë e kufizuar) ndërmjet moshës së lindjes e deri në moshën 13 vjeç nga një profesionist mjekësor. Shkaqet e dëmtimit janë të ndryshme, të tilla si autizmi, verbëria, paraliza cerebrale, shurdhimi, epilepsia, hidrocefalia, pengesat intelektuale, distrofia muskulore, Spina Bifida, dëmtime të ndryshme fizike dhe “*retardimi psiko-motorik*” (siç raportohet shpesh). Megjithatë, **në asnjë rast** nuk kishte tregues se faktorët mjedisorë ishin marrë në konsideratë gjatë përcaktimit të “aftësisë së kufizuar”. Siç raportohet në shumicën e komunave, shumica e fëmijëve

janë diagnostikuar në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë të kenë dëmtime/ pengesa, për shkak të mungesës së ekspertizës në nivel lokal, ose janë dërguar jashtë vendit (Shqipëri, Maqedoni, Gjermani, Turqi dhe Serbi). Një situatë e ngjashme është raportuar në Mitrovicën Veriore, ku fëmijët janë dërguar në Serbi (Beograd, Kragujevac, Nish), Rusi dhe Ukrainë për diagnostifikim.

## Kuantifikimi i aftësisë së kufizuar në Kosovë

Në bazë të rezultateve të Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave të Kosovës 2011<sup>25</sup>, në fund të muajit prill të vitit 2011 në Kosovë ishin 1,739,825 persona, të ndarë në mënyrë të barabartë në meshkuj dhe femra. Pothuajse 1/3 e popullsisë (661,586) jeton në zonat urbane. Nga 1,429,174 persona mbi moshën 10 vjeç, 8.2% janë të diplomuar (nga të cilët 3.0 janë gra), dhe 29.9% kanë një diplomë të shkollës së mesme të lartë (10.7% janë gra), 35.1% kanë një diplomë të shkollës së mesme të ulët (20.14% janë gra) dhe 17.18% kanë përfunduar vetëm shkollën fillore (9.98% janë gra). 5.7% e popullsisë mbi moshën 10 vjeç nuk kanë ndjekur arsimin formal/nuk kanë përfunduar nivel arsimimi që mundëson lexim dhe shkrim (3.06% janë gra) dhe 3.8% janë analfabetë (79.7% janë gra). Pjesa më e madhe e popullsisë kanë deklaruar që kanë përkatësi etnike/kulturore shqiptare (1,616,869), të pasuar nga boshnjakët dhe serbët si zgjedhja e dytë dhe e tretë, respektivisht. Kjo reflektohet edhe në zgjedhjen e gjuhës amtare.

Mbi 10 për qind (10.3) e popullsisë (179,648) janë nën moshën 6 vjeç, dhe mesatarisht janë 5,9 persona për familje. Në përgjithësi, në vitin 2011 ekzistonin 592,046 fëmijë nën moshën 18 vjeç, duke e bërë Kosovën një nga vendet në rajon me popullsinë më të madhe (proporcionale) nën 18 vjeç. Megjithatë, siç mund të shihet më poshtë, një përqindje shumë e vogël llogaritet si fëmijë me aftësi të kufizuara. Duke u përpjekur që t'i shmangemi mënyrës së bazuar krejtësisht në mjekësi/dëmtim, të konceptimit të aftësisë së kufizuar, Regjistrimi i vitit 2011 përdor pyetje që marrin në konsideratë aftësinë e raportuar funksionale të secilit të anketuar. Kështu, Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave në Kosovë 2011 grumbulloi të dhëna në lidhje me aftësinë e kufizuar duke shfrytëzuar një sërë pyetjesh me qëllim të kuantifikimit të numrit të personave që raportojnë *vështirësi afatgjatë*, në vend që të pyesnin për *aftësinë e kufizuar* (modeli social kundrejt modelit mjekësor të aftësisë së kufizuar).

Në bazë të Regjistrimit të vitit 2011<sup>26</sup>, numri i fëmijëve të moshës 0 deri 14 vjeç **sipas numrit të vështirësive afatgjata**<sup>27</sup>, me vetëm një vështirësi të raportuar është 2,811. Kishte 1,308 fëmijë të moshës 15-19 vjeç me një vështirësi të raportuar, dhe 1,397 të rinj të moshës 20-24 po ashtu me një vështirësi të raportuar. Numrat rriten ndërmjet moshës 55 dhe 69 dhe pastaj bien përsëri. Në të gjitha kategoritë, numri i meshkujve është më i lartë se i femrave.

NUMRI I VËSHIRËSIVE AFATGJATA						
Mosha	Asnjë	Një	Dy	Tre	Gjithsej	
Gjithsej	0-14	484,279	2,811	271	216	487,577
	15-19	173,377	1,308	141	106	174,932
	20-24	159,828	1,397	136	106	161,467
	25-29	139,372	1,658	142	96	141,268
	30-34	128,074	2,175	192	101	130,542
	35-39	121,365	3,163	256	128	124,912
	40-44	103,858	3,827	306	151	108,142
	45-49	89,551	4,876	402	159	94,988
	50-54	73,820	6,026	560	219	80,625
	55-59	57,574	6,978	714	273	65,539
	60-64	44,300	7,569	838	341	53,048
	65-69	35,130	7,559	952	415	44,056
	70-74	25,369	6,920	1,015	503	33,807
	75-79	15,601	5,197	832	514	22,144
	80+	10,593	4,702	825	658	16,778
Gjithsej	1,662,091	66,166	7,582	3,986	1,739,825	

Tabela 1 – Popullsia me banim të zakonshëm sipas numrit të vështirësive afatgjata (Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave në Kosovë 2011 – Tabela 3.3828)

Të dhënat e grumbulluara në Tabelën 2 në vijim, janë të dhënat më të përafërta ndaj atyre që mund të ishin mbledhur përmes pyetjeve më tradicionale, të tilla si “a keni aftësi të kufizuara?”. Ju lutemi, vini re se Tabela 1 (më sipër) ka vetëm numra të përgjithshëm, ndërsa tabela origjinale e ofruar në Regjistrim ofron një ndarje ndërmjet meshkujve dhe femrave.

Mosha	Shurdhim apo dëmtim i rëndë i dëgjimit"	"Verbërim apo dëmtim i rëndë i shikimit"	"Një gjendje që në mënyrë të theksuar kufizon një apo më shumë aktivitete bazike fizike, siç është ecja, ngjitja në shkallë, ngritjen apo bartjen e gjësendeve "	"Aftësi e kufizuar në të mësuar ose intelektuale"	"Aftësi e kufizuar emocionale ose psikologjike për një kohë të gjatë"	"Tjera, përfshirë çdo sëmundje për një kohë të gjatë"
0-14	355	431	1,050	684	616	865
15-19	123	155	513	348	351	418
20-24	200	127	562	315	385	398
25-29	191	135	608	318	456	522
30-34	212	146	926	334	536	708
35-39	245	220	1,312	366	738	1,178
40-44	321	299	1,644	351	780	1,497
45-49	401	488	2,181	294	725	2,068
50-54	564	732	2,587	312	693	2,915
55-59	687	946	3,211	284	667	3,430
60-64	928	1,073	3,515	340	595	3,817
65-69	1,197	1,170	3,745	368	464	3,764
70-74	1,434	1,189	3,757	451	456	3,172
75-79	1,365	1,091	3,054	403	313	2,177
80+	1,712	1,233	2,902	439	358	1,682
Gjithsej	9,935	9,435	31,567	8,133	8,133	28,611

Tabela 2 – Popullsia me banim të zakonshëm me të paktën një vështirësi afatgjatë sipas moshës (Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave në Kosovë 2011 – Tabela 3.3929)

Megjithatë, Regjistrimi i vitit 2011 grumbullon edhe të dhënat lidhur me numrin e njerëzve që raportojnë se kanë vështirësi në kryerjen e aktiviteteve të përditshme, si dhe me shkallën e vështirësisë. Kështu, tabela 2 në vijim ofron të dhëna në lidhje me **shkallën e vështirësisë në kryerjen e aktiviteteve të përditshme** – pak vështirësi, shumë vështirësi, nuk mund ta bëjë fare – të dhëna që janë shumë më të përafërta me definicionin e aftësisë së kufizuar të përfshirë në KDPAK, si dhe të dhëna që mund të shërbejnë për një qëllim më të menjëhershëm, sepse mund të përdoren për të përcaktuar se çfarë lloj shërbimesh nevojiten për t’iu përgjigjur llojeve përkatëse të vështirësive.

Siç mund të shihet në Tabelën 2 (më sipër), 880 fëmijë të moshës 0-19 vjeç janë raportuar të kenë **ca vështirësi në të mësuar, mbajtur mend apo përqendruar**, 694 fëmijë janë raportuar të kenë *ca vështirësi për t’u veshur, pastruar dhe kryer aktivitete përreth shtëpisë*, 614 fëmijë janë raportuar të kenë *ca vështirësi për të dalë jashtë shtëpisë të vetëm për të blerë ose vizituar mjekun*, 510 fëmijë janë raportuar të kenë *ca vështirësi në punë ose në biznes ose në shkollë ose kolegji* dhe 599 fëmijë janë raportuar të kenë *ca vështirësi për të marrë pjesë në aktivitete të tjera*.

Po ashtu, 520 fëmijë të moshës 0-19 vjeç janë raportuar të kenë **shumë vështirësi në të mësuar, mbajtur mend apo përqendruar**, 398 fëmijë janë raportuar të kenë *shumë vështirësi për t’u veshur, pastruar dhe kryer aktivitete përreth shtëpisë*, 614 fëmijë janë raportuar të kenë *shumë vështirësi për të dalë jashtë shtëpisë të vetëm për të blerë ose vizituar mjekun*, 510 fëmijë janë raportuar të kenë *shumë vështirësi në punë ose në biznes ose në shkollë ose kolegji* dhe 599 fëmijë janë raportuar të kenë *shumë vështirësi për të marrë pjesë në aktivitete të tjera*.

Siç pritej, numri i fëmijëve të raportuar të listuar në kategorinë **nuk mund ta bëjë fare** është shumë më i lartë se në dy kategoritë e mëparshme. Aktivitetet e listuara nuk marrin në konsideratë standardet krahasuese (*benchmarks*) zhvillimore dhe janë aktivitete që kërkohen në përgjithësi nga një i rritur, dhe thjesht të përshtatura të gjitha moshave në këtë regjistrim. Prandaj, të dhënat duhet të interpretohen me kujdes. 1,043 fëmijë të moshës 0-19 vjeç janë raportuar që *nuk mund ta bëjë fare* në kategorinë të *mësuarit, të mbajturit mend ose të përqendruarit*, 1,103 fëmijë janë raportuar që *nuk mund ta bëjë fare* në kategorinë të *pastruarit dhe të kryerit e aktiviteteve* përreth shtëpisë, 1,376 fëmijë janë raportuar që *nuk mund ta bëjë fare* në kategorinë të *dalurit jashtë shtëpisë të vetëm për të blerë ose vizituar mjekun*, 2,040 fëmijë janë raportuar që *nuk mund ta bëjë fare* në kategorinë të *angazhuarit* në punë ose në biznes ose të *shkuarit në shkollë ose kolegji* dhe 1,908 fëmijë janë raportuar si *nuk mund ta bëjë fare* në kategorinë e *marrjes pjesë në aktivitete të tjera*.



AKTIVITETE DITORE	0-4	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65-69	70-74	75-79	80+	Total
<b>PAKSA VËSHIRËSI</b>																
Të mësuarit, mbajturit në mend ose koncentimi	601	279	312	328	430	700	788	1.215	1.622	2.115	2.412	2.656	2.446	1.784	1.572	19.26
Veshja, larja ose gjindshmëria në shtëpi	460	234	262	311	413	583	711	950	1.219	1.556	1.907	2.117	2.209	1.853	1.718	16.503
Dalja vetë jashtë shtëpisë për të bler ndonjë gjë ose për vizitë te mjeku	396	218	264	327	437	664	869	1.113	1.489	1.836	2.09	2.254	2.085	1.521	1.209	16.792
Duke punuar në një punë apo biznese ose duke vijuar shkollë apo fakultetin	337	182	208	269	385	541	724	938	1.07	1.172	1.115	962	747	465	326	9.441
Pjesëmarrje në aktivitete tjera	400	199	233	285	420	618	762	945	1.189	1.405	1.405	1.228	1,050	686	496	11.381
<b>SHUMË VËSHIRËSI</b>																
Të mësuarit, mbajturit në mend ose koncentimi	346	174	185	214	258	328	400	509	594	728	933	984	1.102	895	967	8.617
Veshja, larja ose gjindshmëria në shtëpi	279	119	109	131	146	244	285	319	412	466	620	718	840	751	934	6.373
Dalja vetë jashtë shtëpisë për të bler ndonjë gjë ose për vizitë te mjeku	305	145	165	190	251	357	418	534	690	886	1.162	1.283	1.314	1.128	1.163	9.991
Duke punuar në një punë apo biznese ose duke vijuar shkollë apo fakultetin	247	171	177	228	297	465	569	750	911	1,050	1.127	1,090	1,036	693	586	9,397
Pjesëmarrje në aktivitete tjera	250	147	154	192	255	375	481	628	674	862	1,014	1,041	980	699	612	8.364
<b>NUK MUND TË BËJ FARE</b>																
Të mësuarit, mbajturit në mend ose koncentimi	712	331	340	367	394	456	478	474	611	659	850	1.095	1.286	1.294	1.583	10,930
Veshja, larja ose gjindshmëria në shtëpi	815	288	244	249	255	273	237	281	319	369	473	613	739	763	1.102	7,020
Dalja vetë jashtë shtëpisë për të bler ndonjë gjë ose për vizitë te mjeku	988	388	361	362	396	492	475	550	755	926	1.235	1.553	1,800	1.679	2.147	14.105
Duke punuar në një punë apo biznese ose duke vijuar shkollë apo fakultetin	1.396	644	646	743	925	1,280	1.461	1.846	2.544	3.266	4.066	4.772	4,722	3,909	3,900	36,120
Pjesëmarrje në aktivitete tjera	1.304	604	591	669	830	1.126	1.284	1.687	2.297	2,830	3.555	4.165	4.236	3.548	3.682	32,408

Tabela 2 – Popullsia sipas vështirësisë afatgjate në kryerjen e aktiviteteve të përditshme, sipas moshës, shkallës së vështirësisë (2011 Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave në Kosovë 2011 – Tabela 3.40)

Përkundër përpjekjeve në kuadër të Regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, të dhënat janë të pakta sa u përket personave/fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë. Shumica e sondazheve të ekonomive familjare që realizohen aktualisht në Kosovë mbledhin të dhëna rreth popullatës së rritur ose, më e shumta, rreth fëmijëve të moshës 15 vjeç e lartë, duke anashkaluar plotësisht popullatën e fëmijëve. Prandaj, është shumë e vështirë të mblidhen të dhëna me rëndësi statistikore në shkallë kombëtare. Këshilli Kombëtar i Statistikave (me përfaqësues nga të gjitha ministritë) është përgjegjës për t'i ofruar Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) një plan 5-vjeçar për mbledhjen e të dhënave, i cili deri më tani nuk ka paraparë ndonjë sondazh që do të përfshinte fëmijët. Një burim tjetër i të dhënave statistikore, PRISM (2011) vlerëson se popullata me aftësi të kufizuara (sic) është ndërmjet 150,000 dhe 180,000 ose 7% e gjithsej popullsisë. Në shumicën e rasteve, këta persona vuajnë nga varfëria, izolimi dhe stigmatizimi social. PRISM (2011) thotë që 95% e pothuajse 1,000 personave me aftësi të kufizuara që kishin intervistuar vareshin tërësisht nga dikush tjetër për aktivitetet e jetës së përditshme. Rrjedhimisht, personat me aftësi të kufizuara në Kosovë përbëjnë një prej grupeve më të rrezikuara të popullsisë<sup>30</sup>.

Shumë prej të intervistuarve për këtë analizë të situatës ishin të mendimit që fëmijët me aftësi të kufizuara janë një nga grupet më të marginalizuara të shoqërisë në Kosovë. Megjithatë, një nga kufizimet kryesore për të adresuar nevojat e tyre është mungesa e njohurive rreth asaj se sa fëmijë me aftësi të kufizuara ka në vend, ku jetojnë dhe cilat janë nevojat e tyre të veçanta<sup>31</sup>. Sipas informacioneve të marra nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, janë në dispozicion tre lloje të të dhënave për personat me aftësi të kufizuara, megjithëse dy burimet e të dhënave nuk triangulohen: së pari, meqë vlerësimi për ndihmën monetare për aftësi të kufizuara iniciohet nga qendrat komunale për punë sociale, çdo qendër komunale mban evidencë të çdo rasti që iniciohet. Së dyti, komisioni vlerësues i nivelit qendror që shqyrton rastet komunale mban evidencë për çdo rast që aprovohet se i plotëson kriteret si aftësi e kufizuar (statusi i përhershëm i aftësisë së kufizuar). Në fund, MPMS mban një regjistër të çdo personi i cili merr ndihmë monetare për aftësi të kufizuar.

Ekzistojnë informata në dispozicion nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (shih më poshtë) për numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara që marrin ndihmë sociale, por kriteret për këtë ndihmë janë jashtëzakonisht të rrepta dhe jo-domosdoshmërisht të gjithë fëmijët që plotësojnë kushtet e marrin atë. Ka shifra edhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara që vijnë shkollën, por kjo nuk përfshin fëmijët që nuk e vijnë shkollën (shih shtojcën 4).

Mbledhja e të dhënave vështirësohet edhe më tej sepse nuk ka harmonizim të mekanizmave dhe sistemeve midis ministrive. Përderisa MPMS mbledh të dhëna mbi përfitimet për aftësitë e kufizuara, por jo për specifikat e aftësive funksionale të çdo personi (ajo që çon në dhënien e përfitimit), MASHT mbledh të dhëna në bazë të "nevojave të veçanta arsimore" (jo të aftësive funksionale ose *aftësisë së kufizuar* në kuptimin tradicional) sipas një liste prej 10 llojeve të dëmtimeve: autizmi, pengesat e komunikimit dhe të folurit, Sindromi Down, çrregullimet emocionale dhe të sjelljes, pengesat në dëgjim, pengesat intelektuale, vështirësitë/çrregullimet e të mësuarit, dëmtimet e shumëfishta, dëmtimet fizike dhe pengesat me shikim. Ndërkohë që informatat mblidhen në nivel shkolle dhe mund të përdoren në të ardhmen për qëllime



financimi, ka shumë pak të ngjarë që të dhënat të jenë të besueshme ose rigorozë pasi nuk ka dokumentacion mbështetës adekuat.

Disa prej të intervistuarve për këtë studim (MASHT dhe MSh) kanë raportuar plane për harmonizimin e mbledhjes së të dhënave duke përmirësuar sistemet e grumbullimit të të dhënave për të përdorur numrat e regjistrimit civil/lindjes (një numër që i jepet secilit qytetar nga Ministria e Punëve të Brendshme), duke lehtësuar kështu triangulimin e të dhënave. Megjithatë, planet janë ende në fazat paraprake të zhvillimit. Përdorimi i përhapur, shumë-disiplinor dhe ndërministror i KNF do të krijojë kushte për grumbullimin më të besueshëm dhe më të saktë të të dhënave për vendimmarrje.

Për shkak të ndërlikimeve administrative në rajonin e Mitrovicës dhe komunave të tjera me shumicë serbe, ka pak të dhëna për fëmijët me aftësi të kufizuara. Qendra për Orientim Social (COD) ka lëshuar në vitin 2013 një raport<sup>32</sup>, sipas të cilit në Kosovë ka shumë persona me aftësi të kufizuara në gjendje të izolimit social, të privuar nga e drejta për arsimim dhe punësim të barabartë, me qasje të kufizuar në shërbimet shëndetësore, shërbimet publike dhe informacione, të privuar nga pjesëmarrja e barabartë në jetën publike dhe politike”<sup>33</sup>. Sipas raportit, personat me aftësi të kufizuara nga komuniteti serb nuk janë të evidentuar - shumica e komunave serbe nuk u përfshinë në regjistrimin e vitit 2011 të Kosovës, as në regjistrimin e Serbisë të vitit 2011. Sipas po të njëjtit raport, “megjithëse nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e saktë të personave me aftësi të kufizuara në komunën e Mitrovicës, COD-ja, përmes hulumtimit të saj, ka kuptuar që janë 432 persona me aftësi të kufizuara në komunë, kjo në bazë të të dhënave nga Qendra për Punë Sociale, Komuna e Mitrovicës dhe shoqatat e personave me aftësi të kufizuara. Numri i personave me aftësi të kufizuara sipas kategorisë së aftësisë së kufizuar: aftësi të kufizuar fizike - 58; dëmtime/pengesa në dëgjim dhe të folur - 80; të verbër dhe me shikim të dëmtuar - 107; skleroza e shumëfishtë - 29; aftësi të kufizuara intelektuale - 50; aftësi të kufizuara psikosociale - 28; fëmijët me aftësi të kufizuara - 80 (nuk ka të dhëna për llojin e aftësisë së kufizuar)”<sup>34</sup>.

Nuk ka mbledhje të standardizuar të të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara në asnjërën prej 5 komunave të përfshira në DFG, megjithëse të pasurit e të dhënave rigorozë konsiderohet si mjet thelbësor për një vendimmarrje të informuar. Përvoja e identifikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në DFG në Mitrovicën Veriore nënvizoi disa çështje me interes sa i përket identifikimit dhe përcaktimit të numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë. Siç është raportuar, ishte e vështirë të identifikoheshin fëmijët me aftësi të kufizuara, sidomos ata 15 vjeç dhe më të vjetër, sepse arsimit gjithëpërfshirës filloi në vitin shkollor 2009/2010 dhe gjenerata e regjistruar në shkollë me këtë sistem ende nuk ka arritur moshën 15-17 vjeç. Kështu, ka të ngjarë që në këtë rast, një sistem më gjithëpërfshirës do të ndihmonte në identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, por vetëm në regjistrimin parashkollor ose në shkollën fillore, kur ishte e detyrueshme që fëmijët t’i nënshtroheshin vlerësimit të “Inter resorne komisije” (Ekipit Komunal të Vlerësimit) të themeluar në vitin 2010.

## Identifikimi, vlerësimi dhe përcaktimi i kritereve të aftësisë së kufizuar në Kosovë

Grupe të ndryshme ligjesh rregullojnë atë se kush konsiderohet të ketë një aftësi të kufizuar (varësisht nga lloji i dëmtimit/pengesës) dhe nuk ka legjislacion të përgjithshëm që rregullon identifikimin, vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar. Siç mund të shihet më poshtë, legjislacioni ekzistues supozon që fillimisht dyshohet për një dëmtim të caktuar, pastaj bëhet vlerësimi, ku vlerësimi bëhet vetëm për të përcaktuar të drejtën për përfitime monetare dhe të drejta.

Identifikimi, vlerësimi dhe përcaktimi i plotësimit të kushteve të aftësisë së kufizuar në Kosovë bëhen vetëm për 3 lloje pengesash/dëmtimesh: dëmtimet në shikim, dëmtimet në dëgjim dhe dëmtimet para/tetraplegjike. Këto janë 3 llojet e vetme të dëmtimeve (dhe aftësisë së kufizuar përcjellëse) të cilat rregullohen me ligj (shih më poshtë). Sipas raporteve të dhëna nga ZQM-ja dhe OPAK-të e ndryshëm të intervistuar për këtë studim, legjislacioni ekzistues është zhvilluar si një përgjigje ndaj lobimit dhe avokimit të fuqishëm nga tri grupet më të mëdha të aftësisë së kufizuar në Kosovë, ku secili prej tyre përfaqëson grupe shumë specifike të personave me aftësi të kufizuara specifike, me theks të veçantë në nevojat e të rriturve me aftësi të kufizuara. Prandaj, përderisa mjedisi ekzistues tregon se agjenda e aftësisë së kufizuar në Kosovë është udhëhequr nga OPAK-të, tani ka përpjekje të fuqishme për të siguruar që legjislacioni të hartohet si një strategji kombëtare, të jetë më gjithëpërfshirës dhe t'u kushtojë vëmendje nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Për më tepër, legjislacioni ekziston edhe për fëmijët/personat me aftësi të kufizuara të përhershme, i cili mbulon ata me dëmtime fizike, shqisore ose mendore, megjithëse nuk ekziston ndonjë rregullore specifike për përcaktimin e identifikimit dhe vlerësimin të dëmtimit mendor. Në të gjitha rastet, një komision mjekësor është përgjegjës për përcaktimin e plotësimit të kushteve. Përveç një legjislacioni kufizues, ekziston një deficit i konsiderueshëm në numrin e profesionistëve që mund të diagnostikojnë lloje komplekse të aftësisë së kufizuar përfshirë ato të parashikuara në legjislacion, duke përfshirë autizmin<sup>35</sup>. Prandaj ka mangësi të konsiderueshme në identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Sipas drejtorit të Shërbimeve të Shëndetit Mendor të Fëmijëve dhe Adoloshentëve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, shumica e prindërve iniciojnë procedurën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar me qëllim të sigurimit të ndihmës me mjete financiare. Sigurimi i shërbimeve, madje edhe atyre që mund të ofrohen pa pagesë në sistemin shëndetësor zakonisht nuk është prioritet për prindërit. Mungesa e identifikimit të hershëm/shërbimeve të intervenimit të hershëm është një sfidë kryesore sa i përket sigurimit që prindërit të kenë njohuri për zhvillimin e fëmijës dhe të jenë në gjendje të identifikojnë sjelljet atipike dhe vonesat në arritjen e caqeve të përshtatshme. Shpesh (pothuajse çdo ditë) prindërit kërkojnë një vlerësim të spektrit të autizmit, duke mos qenë në dijeni për shumë probleme të mundshme shqisore (sensore)-përpunimit që mund të ngjajnë me autizmin, por janë, në fakt, rrjedhojë e mungesës së stimulimit të duhur. Përveç kësaj, meqë çdo proces i vlerësimit duhet të fillojë me matjen e

koeficientit të inteligjencës (IQ), statusi i *aftësisë së kufizuar* të përhershme varet shumë nga performanca, ndërsa kjo varet nga aranzhimi, atmosfera dhe kushtet e mjedisit testues dhe jo domosdoshmërisht nga performanca faktike individuale përgjatë kohës.

*Ligji Nr. 04/L-092* për Personat e Verbër<sup>36</sup>, i vitit 2012, ofron kornizën për identifikimin e personave të verbër dhe për mbrojtjen e tyre me ligj. Personat konstatohen si të verbër ose me shikim të dëmtuar nga ana e Komisionit Mediko-social i përbërë nga specialistët e të pamurit dhe profesionistët e shkencave sociale dhe OPAK-të, të cilët përcaktojnë përfitimet monetare dhe shërimin. Personat e verbër duhet të kenë të evidentuar një kujdestar të emëruar. Legjislacioni përfshin punësimin, lirin nga detyrimet fiskale, “kompensimin” mujor bazuar në pagën minimale por jo më pak se 100 euro (neni 7), asistencën personale siç konsiderohet e nevojshme, mbështetjen për banim, shërbimet shëndetësore falas ose me çmim të zvogëluar. Sa i përket arsimit, personat e verbër kanë të drejtë të shkollohen në institucione publike, si dhe për përdorimin e shkrimit brail, shkrimit relievor, shkrimit me shkronja të zmadhuara dhe teksteve në teknikën akustike dhe digjitale, si dhe pajisjeve tiflo. Ngjashëm, informatat duhet të ofrohen në mënyra të ndryshme. Rehabilitimi bëhet nëpër qendra, ndërsa personat e verbër mund të marrin pjesë në manifestime sportive dhe kulturore pa pagesë. Transporti publik është falas ose me çmim të zvogëluar, ndërsa telefonat duhet të pajisjen me softuerin adekuat. Legjislacioni hesht sa i përket nevojave specifike të fëmijëve që i përkasin kësaj kategorie. Sipas drejtorit të Shoqatës së Personave të Verbër dhe Personave me Shikim të Dëmtuar të Kosovës, legjislacioni parasheh dy lloje të kompensimit financiar: për personat që konstatohen se janë 100% të verbër, përfitimi monetar për aftësi të kufizuar është 125 euro, ndërsa 125 euro jepen si shtesë për pagesën e asistentit personal, nëse ka nevojë. Megjithatë, një person që konstatohet se është 95% i verbër, gëzon të drejtën e vetëm përfitimit monetar prej 125 eurosh për aftësinë e kufizuar.

*Ligji Nr. 05/L-067* për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë<sup>37</sup> përcakton dispozitat për personat që kanë humbur mundësinë e lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme. Personat e tillë përcaktohen si përfitues sipas legjislacionit nga ana e komitetit vlerësues (i përbërë nga MSh, MPMS dhe një anëtar i një OPAK-je përfaqësuese). Ligji parasheh mbrojtje dhe liri të shprehjes dhe qasjes në informacion. Njëjtë si me ligjin paraprak, përfituesit marrin kompensim dhe varësisht prej vlerësimit, mund të marrin një shtesë prej 50% me qëllim të parandalimit të “plagëve dekubitare” (neni 7), si dhe mund të zgjedhin të kenë një asistent personal (sërisht, varësisht prej vlerësimit). Gjithashtu, njëjtë si më lart, përfituesit lirohen nga ngarkesat fiskale, duke përfshirë ato që ndërlidhen me një automjet. Ata kanë të drejtën e arsimit në shkolla publike dhe private, si dhe të kujdesit shëndetësor pa pagesë, duke përfshirë shërbimet e kujdesit në shtëpi kur ka nevojë. Pajisjet u sigurohen po ashtu pa pagesë. Ngjashëm, energjia elektrike dhe transporti publik janë pa pagesë ose me çmim më të ulët, ndërsa sigurimi i strehimit për ta trajtohet me prioritet. Legjislacioni hesht sa u përket nevojave specifike të fëmijëve të tilla si identifikimi i hershëm dhe intervenimi i hershëm, tranzicionet përgjatë ciklit jetësor (fëmijëria e hershme, gatishmëria për shkollë, kopshti, shkolla fillore, e mesme e ulët dhe e mesme e lartë, terciare, bota e punës), aftësitë jetësore dhe shoqërore, rëndësia e lojës, e jetesës në familje, e ndërveprimeve shoqërore, mësimi të ndërmjetësuar, etj.

*Rregullorja (QRK) Nr. 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës*<sup>38</sup> përcakton rregullat dhe procedurat e shërbimeve në gjuhën e shenjave në Kosovë. Ajo zbatohet për të gjitha institucionet publike, të cilat detyrohen të ofrojnë shërbimet e përshtatshme bazuar në nevoja dhe në kërkesa. Shërbimet ofrohen nga ZQM-ja në bashkëpunim me Shoqatën Kosovare të të Shurdhërve, të cilët janë përgjegjës për ofrimin e trajnimeve për institucionet dhe personat. Instruktorët e gjuhës së shenjave duhet të trajnohen, certifikohen dhe akreditohen.

Duhet të theksohet se nuk ka ligj që specifikon masat e identifikimit dhe mbrojtjes së personave që janë të shurdhër apo me vështirësi në të dëgjuar, siç është rasti me Ligjin për të Verbrit ose Ligjin për Personat Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë. Në një vend ku legjislati merr vëmendjen kryesore në lidhje me sigurimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe duke marrë parasysh faktin se komuniteti i të shurdhërve ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, kjo është një mungesë e vëmendjes e cila raportohet se është politikisht e motivuar. Siç dëshmohet më poshtë, ekziston një rast shqetësues dhe aktualisht i pashpjeguar i rreth 1,000 njerëzve të shurdhër në Kosovë të cilëve u është hequr e drejta e tyre për të marrë asistencën sociale në bazë të aftësisë së kufizuar të përhershme, gjë që kërkon vëmendje të menjëhershme dhe një zgjidhje që merr parasysh të drejtat e të gjithë personave që janë të shurdhër, duke përfshirë edhe fëmijët. Sipas Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve, statusi i aftësisë së kufizuar të përhershme (shih më poshtë) lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e personit për të punuar. Prandaj, për shkak se personat e shurdhër konsiderohen si të aftë për t'u punësuar (edhe nëse kjo nuk përkon me realitetin në Kosovë), ata nuk kualifikohen për statusin e aftësisë së kufizuar të përhershme ose përfitimet monetare përcjellëse.

Sipas Zyrës për Qeverisje të Mirë<sup>39</sup>, Programi Kombëtar për ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave (2013-2016) është zhvilluar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të shurdhër, duke përfshirë fëmijët e shurdhër, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së tyre në të gjitha sferat e jetës, duke promovuar heqjen e pengesave të komunikimit dhe duke siguruar kështu pjesëmarrjen e plotë të personave të shurdhër në të ardhmen. Si rezultat, qeveria ka miratuar Rregulloren për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave dhe Udhëzimin Administrativ për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave (shih më poshtë) që përbëjnë dokumentet bazë që kanë mundësuar qasje në shërbimet në gjuhën e shenjave për të gjithë personat e shurdhër në vend. Përveç kësaj, personat e shurdhër janë përfitues të skemës së pensioneve të aftësisë së kufizuar sipas Ligjit Nr. 04/L-131 për Fondet e Pensioneve Shtetërore dhe numri i përfituesve mund të sigurohet nga Komisioni Vlerësues në kuadër të MPMS-së.

“Fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme të formave fizike, mendore dhe shqisore konsiderohen fëmijët nga lindja e deri në 18 vjeç me vendbanim të përhershëm në Kosovë, të cilët janë plotësisht të paaftë për kryerjen e aktiviteteve të përditshme pa ndihmën e personit tjetër”<sup>40</sup>. Aftësia e kufizuar e përhershme është një kusht i domosdoshëm që familja e fëmijës (familja biologjike ose kujdestare) të marrë mbështetje materiale në formë të të hollave. Fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme janë ata që janë të verbër dhe ata që kanë kufizime lëvizshmërie, nuk mund të kryejnë detyra të përditshme siç janë ushqimi, veshja ose higjiena personale ose “të kryejnë nevojat fiziologjike” (Neni 6).

Statusi i *aftësisë së kufizuar* të përhershme (lloji dhe niveli i ashpërsisë së dëmtimit fizik, mendor ose shqisor) përcaktohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale pas vlerësimit nga komisioni mjekësor. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, 4 profesionistë nga shkencat mjekësore (pediatri, oftalmologji, mjekësi e përgjithshme, neuropsikiatri ose psikiatri) dhe një punëtor social. Personi/familja që kërkon vlerësimin duhet të ketë një certifikatë mjekësore që vërteton dëmtimin dhe duhet të ofrojë dëshmi mjekësore. Qendra Komunale për Punë Sociale që fillon vlerësimin është përgjegjëse për vlerësimin e mjedisit social të personit që i nënshtrohet vlerësimit, si dhe nxjerr vendimin përfundimtar, retroaktiv deri datën e kërkesës për vlerësim. Koordinator i Komisionit të Vlerësimit të MPMS-së i intervistuar është shumë i vetëdijshëm për nevojën e harmonizimit të procedurës aktuale me modelin social të aftësisë së kufizuar të përkrahur nga KDPK-ja. Gjithashtu, ai konfirmoi se përfitimi rezultues monetar prej 100 eurosh është shumë modest dhe shpesh përdoret si përfitim më tepër për zbutjen e varfërisë sesa për të blerë shërbimet e nevojshme (që shpesh nuk ekzistojnë). Megjithatë, MPMS duhet të ndjekë procedurat e vendosura në udhëzimet administrative.

Megjithatë, vendimet në lidhje me statusin e “aftësisë së kufizuar të përhershme” janë, në rastin më të mirë, kontradiktore. Gjatë gjithë studimit, shumë nga profesionistët e intervistuar në qeveri dhe në shoqërinë civile si dhe pjesëmarrës të ndryshëm të DFG (profesionistë të QPS-së, Gjakovë), profesionistë të kujdesit shëndetësor (Ferizaj) dhe të tjerë përgjegjës për vlerësimin dhe/ose menaxhimin e rasteve të fëmijëve që konsiderohen të kenë një “aftësi të kufizuar të përhershme” kanë thënë që e konsiderojnë legjislacionin si diskriminues. Së pari, legjislacioni fillon me moshën 1 vjeçare, megjithëse shumë fëmijë lindin me dëmtime të rënda që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme. Së dyti, legjislacioni bën diskriminim ndaj të gjithë personave të tjerë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara që perceptohen të kenë një “nivel më të ulët” të aftësisë së kufizuar, sepse i përjashton ata nga skema e asistencës dhe nga të gjitha ndihmat në para dhe/ose shërbime. Së treti, metodologjia në përdorim për të identifikuar “aftësinë e kufizuar të përhershme” nuk merr parasysh mungesën e informatave në lidhje me aftësinë e kufizuar që është akoma normë në Kosovë, ose mungesën e shërbimeve në terren që mund të ndihmojnë familjet të identifikojnë fëmijët në rrezik të zhvillimit të vonuar ose fëmijët me aftësi të kufizuara.

Siç raportohet, kriteret për “aftësinë e kufizuar të përhershme” janë mjaft të rrepta, edhe pse të dhënat ndryshojnë në varësi të burimit dhe në varësi të vitit/tremujorit për të cilin raportohen të dhënat. Përveç kësaj, meqenëse familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara po informohen më mirë lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, ato po bëhen gjithnjë e më shumë kërkuese në lidhje jo vetëm me *diagnostikimin*, por edhe me alternativat e trajtimit dhe lehtësimin e qasjes në mjedis. Gjykimi i dhënë si rezultat i një vlerësimi të “aftësisë së kufizuar të përhershme” (po ose jo) nuk është më i mjaftueshëm.

Komisioni Mjekësor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjës për përcaktimin e llojit dhe nivelit të ashpërsisë së aftësisë së kufizuar për qëllime të skemës së ndihmës sociale. Megjithatë, raportet e tjera (OPAK Down Syndrome-Prishtinë) tregojnë se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përcakton statusin e “aftësisë së kufizuar të përhershme” bazuar në një diagnozë të certifikatës shëndetësore ose raporti mjekësor nga Qendra Shëndetësore Universitare (Spitali

Shtetëror) që lëshohet nga një ekip prej 3 mjekësh. Gjithashtu, OPAK Down Syndrome raportoi se, komisionet e vlerësimit në Ministrinë e Shëndetësisë (MSh) shpesh janë diskriminuese, sepse fëmijëve që dyshohen të kenë aftësi të kufizuara nuk u jepet përparësi mbi fëmijët e tjerë.

Për shkak se legjislacioni përqendrohet në llojin e aftësisë së kufizuar, të drejtat janë të ndryshme dhe specifike për dëmtimet e caktuara. Më tej, sipas Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit të vitit 2016, “siç është raportuar në Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit të viti 2015, personat me aftësi të kufizuara me të njëjtën diagnozë, pas rivlerësimit nga komisioni mjekësor, hiqen nga lista e përfituesve të pensioneve për personat me aftësi të kufizuara, sepse sipas vlerësimit ata nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara. Personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të ngrenë pyetje rreth saktësisë së punës së komisionit mjekësor, sepse gjatë kryerjes së rivlerësimit, komisioni mjekësor nuk i vlerëson aplikuesit sipas diagnozës së mjekëve profesionistë, por i vlerëson ata sipas perceptimit të tyre subjektiv”<sup>41</sup>.

Siç është raportuar nga pjesëmarrësit në këtë studim (Gjakovë dhe Ferizaj), nevojitet një qasje e unifikuar ndaj përkufizimit të aftësisë së kufizuar, përcaktimit të kriterëve për diagnozën, kategoritë dhe nivelin e ashpërsisë, si dhe metodologjitë dhe procedurat standarde për atë se si të sigurohet që vlerësimi I fëmijëve me aftësi të kufizuara të çojë në një orientim të dobishëm të ofrimit të shërbimeve. Sipas pjesëmarrësve në DFG, ekziston nevoja që familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara t’u ofrohen trajnime për t’i ndihmuar të kuptojnë llojin e aftësisë së kufizuar që kanë fëmijët e tyre dhe se si/ku të marrin udhëzime të mëtejshme mbi shërbimet dhe mbështetjen. Për më tepër, ekziston nevoja për udhëzime standarde për secilin ekspert të përfshirë në vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke përfshirë psikologët, punonjësit socialë, mësuesit, mjekët pediatërit, etj., në mënyrë që të ketë një mirëkuptim të përbashkët dhe shumë-dimensional mes tyre. Procedurat e vlerësimit dhe plotësimit të kriterëve/përshtatshmërisë në Mitrovicën Veriore ndjekin udhëzimet serbe. Është raportuar se disa prindër nga veriu i Mitrovicës shkojnë në Kragujevc, Kralëvë, Nish, Beograd, Novi Sad dhe qytete të tjera si për diagnostifikim ashtu dhe kujdes të nivelit tretësor.

Sa i përket vlerësimit të fëmijëve që mendohen të kenë çrregullime të spektrit të autizmit, diagnoza bazohet në një instrument intervistimi dhe vëzhgimin e sjelljes së fëmijës dhe shpesh psikiatri i fëmijëve i rekomandon ata për terapi në qendrën për fëmijët autistë. Megjithatë, ekziston një mungesë e pranuar e njohurive dhe kapaciteteve të specializuara për një diagnostifikim të hollësishëm të autizmit (madje edhe për disa kategori të tjera të aftësisë së kufizuar), shërbimeve ose trajtimeve. Sipas psikiatrit të fëmijëve nga Qendra Spitalore Universitare në Prishtinë, **“Në të vërtetë ne nuk bëjmë një diagnozë të hollësishme por më shumë një vlerësim sipërfaqësor të fëmijës. Ndonjëherë për shkak të kërkesës së prindërve dhe stigmës, mjeku bën vetëm përshkrimin e simptomave, por ata nuk e përshkruajnë diagnozën si autizëm. Ka raste kur pas terapisë fëmija bën përparim të rëndësishëm, kështu që kur ai të jetë para komisionit të vlerësimit, fëmija duket sikur nuk ka ndonjë problem, prandaj ai nuk kualifikohet për asistencën”**. Siç është konfirmuar nga përfaqësuesi i Shoqatës së Autizmit, ka raste kur pediatri nuk e di se çfarë është autizmi dhe nuk mund ta konfirmojë plotësisht diagnozën para një vëzhgimi më të gjatë të sjelljes dhe qëndrimeve të fëmijës.



Përveç procedurës së vlerësimit të lartpërmendur, secila komunë gjithashtu ka një Ekip të Vlerësimit të Arsimit përgjegjës për vlerësimin e kapaciteteve të arsimit të fëmijës dhe dhënien e udhëzimeve lidhur me mjedisin më të përshtatshëm shkollor (shkollë speciale, klasë speciale e bashkangjitur në një shkollë të rregullt ose klasë e rregullt) për secilin fëmijë individual, si dhe përmbajtjen kryesore të Planit arsimor individual të çdo fëmije (në tekstin e mëtejme: PAI). Ekipet e Vlerësimit të Arsimit kanë lindur nga nevoja<sup>42</sup>, sepse profesionistët përgjegjës në Ministrinë e Arsimit ishin të mendimit se vlerësimet ekzistuese për aftësinë e kufizuar (siç përshkruhet më sipër) nuk kanë ofruar informacion që mund të përdoret për të udhëhequr vendosjen dhe/ose PAI për çdo fëmijë me aftësi të kufizuar (shih më shumë detaje më poshtë në pjesën e arsimit). Siç mund të shihet në këtë studim, vlerësimet holistike dhe të përqendruara në fëmijët, që synojnë sigurimin adekuat të shërbimeve dhe mbrojtjen e të drejtave ende nuk bëhen në Kosovë, në asnjë sektor.

Mungesat e përpjekjeve të koordinuara dhe/ose mekanizmave që mund të lehtësojnë procesin e identifikimit, vlerësimit dhe plotësimit të kriterëve janë raportuar nga të gjitha palët e interesuara. Përderisa MASHT raporton marrëdhënie të mira pune me Ministrinë e Shëndetësisë dhe MPMS-në, asnjë veprim i koordinuar nuk ekziston midis tyre. MASHT shpesh identifikon fëmijët me nevoja të veçanta arsimore (që mund ose mund të mos kenë aftësi të kufizuar), por nuk ka mekanizëm funksional me të cilin fëmijët e identifikuar mund të referohen për shërbimet e rehabilitimit nga MSh. Përveç kësaj, disa fëmijë me aftësi të kufizuara të cilët identifikohen nga MASHT-i se kanë nevojë për pajisje të teknologjisë ndihmëse (AT) (siç janë aparatet dëgjimore, për shembull) mund të kenë qasje vetëm në AT-të nga MASHT, ndërkohë që kjo është qartë përgjegjësi e MPMS-së. Megjithatë, nuk ka mekanizma referimi për të siguruar vijueshmërinë nga identifikimi i nevojave e tek ofrimi i shërbimeve nga një ministri tjetër.

Qasja e fragmentuar ndaj aftësisë së kufizuar e theksuar më sipër rezulton në mosrespektimin e shumë të drejtave dhe i përjashton shumë fëmijë, një situatë kjo që u pranua plotësisht nga shumë palë të interesuara gjatë intervistave me informuesit kyç, por pritet që ligji i ri lidhur me aftësinë e kufizuar, i cili është në zhvillim e sipër të adresojë këto çështje. Pritet që Koncept Dokumenti<sup>43</sup> ekzistues që ka për qëllim të zëvendësojë të gjitha ligjet e mësipërme (për personat e verbër, tetra/paraplegjikë, aftësi të kufizuar të përhershme, etj.) do të jetë zhvilluar plotësisht në ligj deri në fund të vitit 2018, duke siguruar një qasje më gjithëpërfshirëse dhe shoqërisht të pranueshme ndaj aftësisë së kufizuar. Koncept Dokumenti liston shumë nga sfidat dhe pengesat për përfshirjen sociale që janë identifikuar në këtë studim por është mjaft i heshtur për çështjet specifike për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në opsionin e tij më të favorshëm për një rrugë përpara për reformat, dokumenti vazhdon të theksojë nevojën që "forcimi dhe riemërtimi i komisionit mjekësor-social është i domosdoshëm, i cili do të përqendrohet jo vetëm në aspektin mjekësor, por edhe në aspektin social të çdo shtate individualisht. Komisioni gjithashtu do të vlerësonte shkallën e aftësisë së kufizuar dhe aftësinë e mbetur të punës për personat e rritur, si dhe situatën e tyre sociale dhe mjedisore. Gjithashtu, komisioni do të vlerësonte gjendjen e fëmijëve"<sup>44</sup>. Sidoqoftë, nuk jepen sugjerime se çfarë duhet të jetë përgjegjësia e komisioneve në përcaktimin e shërbimeve mbështetëse të nevojshme për të siguruar zhvillimin e duhur të fëmijëve me aftësi të kufizuara, që nga para lindjes dhe deri në moshën e rritur të pavarur. Dokumenti nuk thekson gjetjet e këtij studimi dhe që udhëheqin

rekomandimet e mëposhtme në lidhje me vlerësimet që plotësohen nga ekipet ndërsektoriale dhe multidisiplinare të profesionistëve që përqendrohen në vështrimet holistike të fëmijës gjatë ciklit të jetës (siç propozohet nga KDPAK).

Siç shihet më lart, identifikimi i personave me aftësi të kufizuara rregullohet dhe përqendrohet ekskluzivisht në 3 grupe të dëmtimeve, ndërsa vlerësimi i aftësisë së kufizuar është i natyrës mjekësore dhe plotësimi i kriterëve/kualifikueshmëria synon sigurimin e pensioneve në mjete monetare (jo sigurimin e shërbimeve). Kufizimet në vlerësimin e aftësisë së kufizuar të përdorur në Kosovë janë diskutuar tashmë një kohë të gjatë dhe janë kuptuar në Kosovë. Të gjithë profesionistët e shëndetësisë, shumica e hartuesve të politikave të arsimit dhe shumica e donatorëve të intervistuar për këtë studim, përmendën (me thellësi të ndryshme të të kuptuarit) nevojën për një paketë identifikimi, vlerësimi dhe konstatimi të përmbushjes së kriterëve, të metodologjisë dhe mjeteve që është në linjë me KDPAK dhe në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit (KNF) dhe një qasje multidisiplinare. Disa nga profesionistët e intervistuar kanë qenë pjesë e përpjekjeve të ndryshme për të zbatuar KNF në Kosovë, disa prej të cilave kanë filluar që në vitin 2010<sup>45</sup>. Sidoqoftë, ishte e vështirë të përcaktohej me saktësi se pse, pavarësisht nga përpjekjet e ndryshme gjatë dekadës së fundit, me përfshirjen e gjerë të sektorëve të arsimit, shëndetit dhe mirëqenies sociale dhe mbështetjes financiare nga donatorë të shumtë, këto përpjekje nuk kanë sjellë rezultate konkrete. Shumë nga ata që janë intervistuar për studimin (ZQM, MSh, MPMS, OBSH etj.) shprehën gatishmërinë për të bashkuar forcat edhe një herë, dhe për të ringjallur përpjekjet për të siguruar që identifikimi, vlerësimi dhe konstatimi i përmbushjes së kriterëve të jenë shumëdisiplinare, ndërsektoriale dhe të kenë vështrim holistik të fëmijës sipas parametrave të KNF.

## Legjislacioni, Koordinimi dhe Monitorimi

Në Kosovë, sikurse në shumë vende të tjera të rajonit, fëmijët me aftësi të kufizuara nuk janë prioritet legjislativ apo politik. Shumë shpesh, fëmijët me aftësi të kufizuara shihen si pjesë e “popullatës së cenueshme” më të gjerë, për të cilën zhvillohen ligje dhe politika specifike. Sipas shumë të intervistuarve për këtë studim, përmbushja e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në mbrojtje sociale, arsim, shëndetësi etj., do të kërkonte që fëmijët me aftësi të kufizuar, të jenë të dukshëm në nivelin më të lartë të përfshirjes politike: agjenda parlamentare. Sipas Asociacionit të Komunave të Kosovës, vetëm Kuvendi i Kosovës mund të kërkojë nga ministritë, kolegjiunet, këshilli i kryetarëve të komunave dhe autoritetet komunale që të sigurojnë implementimin (dhe zbatimin) e veprimeve që mund të ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë.

### Legjislacioni kombëtar

Deri në kohën e këtij raporti, Kosova nuk ka fituar njohje të plotë ndërkombëtare, as mundësinë për të nënshkruar apo ratifikuar zyrtarisht ndonjë prej Konventave të OKB-së që përmbledhin të drejtat e njeriut. Megjithatë nuk ka autoritet për të nënshkruar/ratifikuar ndonjë traktat ndërkombëtar, Kosova ka demonstruar synimin e saj për ta

bërë këtë sa më shpejt që e lejon ligji ndërkombëtar dhe përpjekjet e saj njihen nga familja e OKB-së, BE-ja dhe të tjerët. Në vitin 2013, një raport<sup>46</sup> i porositur nga UNICEF-i tregoi se Kosova ka zhvilluar një kornizë të fortë ligjore, për të promovuar një shoqëri gjithëpërfshirëse, veçanërisht gjithëpërfshirëse për fëmijët me aftësi të kufizuara, një angazhim të demonstruar në zhvillimin e legjislacionit dhe politikave të tilla si *Plani Nacional i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2009 - 2011, Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve në Kosovës 2009-2013, Plani Strategjik për Organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Arsimin Para-universitar në Kosovë 2010-2015 dhe Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2011-16 (PSAK).*

Në vitin 2014, Studimi i UNICEF-it *për përputhshmërinë e legjislacionit ekzistues me Konventën për të Drejtat e Fëmijës* konstatoi se "korniza ligjore për fëmijët në Kosovë është kryesisht në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) është inkorporuar në kushtetutën e Kosovës në vitin 2008. Kjo kornizë është në harmoni me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe 18 instrumente të tjera të OKB-së dhe me norma evropiane siç është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Karta Sociale Evropiane, Konventa Lanzarote për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual dhe Konventa Evropiane për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe rivendosjen e kujdestarisë mbi fëmijët dhe Udhëzimet Evropiane për Drejtësinë mike ndaj Fëmijëve. Nga ana tjetër, një numër i të drejtave dhe detyrimeve të njohura nga KDF-ja, ende nuk janë pjesë e ndonjë ligji që është aktualisht në fuqi në Kosovë"<sup>47</sup>.

I gjithë legjislacioni që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut të qytetarëve të Kosovës, duke përfshirë ato më poshtë, bazohet në një grup prej tre ligjesh që përcaktojnë të gjitha të drejtat për të gjithë qytetarët: Ligji Kundër Diskriminimit<sup>48</sup>, Ligji për Barazi Gjinore<sup>49</sup> dhe Ligji për Avokatin e Popullit<sup>50</sup>. Megjithatë, siç theksohet nga disa të intervistuar, pakoja e ligjeve si e hartuar fillimisht është në kundërshtim me disa nga ligjet ekzistuese dhe direktivat që synojnë të mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe mund të krijojnë pengesa në përmbushjen e të drejtave të tyre.

## Koordinimi

### Strategjia Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023 (SNDDPAK)

Pavarësisht se nuk e ka nënshkruar apo ratifikuar KDPAK-në e OKB-së, Kosova ka pasur Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara që nga viti 2009. Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2009-2011<sup>51</sup>, paraqet "përpjekjen e parë për të harmonizuar legjislacionin e Kosovës me Deklaratën Universale të të drejtave të njeriut dhe konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut në sektorin e aftësisë së kufizuar"<sup>52</sup>, dhe identifikon disa grupe personash me aftësi të kufizuara me të drejta më të lartë të cënueshmërisë, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuara, për të cilët duhet të zhvillohen dhe zbatohen veprime specifike (të detajuara në Planin e Veprimit). Strategjia aktuale Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-

2023<sup>53</sup> (tani e tutje, SNDDPAK) është një “mekanizëm i rëndësishëm për të siguruar që parimet të cilat janë të mishëruara në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara janë inkorporuar në politikat dhe programet që ndikojnë në cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës”<sup>54</sup>. Qëllimi i saj është “të promovoj, të mbrojë dhe të siguroj gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga të gjithë personat me aftësi të kufizuara si dhe të kontribuojë në respektimin e dinjitetit të tyre të qenësishëm”<sup>55</sup>.

Dokumenti synon të ofrojë udhëzime për të gjithë sektorët qeveritarë dhe bën thirrje për veprime të cilat janë specifike, të matshme, të arritshme dhe të udhëhequra nga planet e veprimit të buxhetuara, me afate të përcaktuara qartë. Me të kërkohet që të gjitha institucionet qeveritare të punojnë në mënyrë jo-diskriminuese dhe thekson bashkëpunimin me Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe me shoqërinë civile. Për më tepër, SNDDPAK bazohet në rregulloren ekzistuese dhe gjithashtu rregullon të gjithë legjislacionin e ardhshëm në lidhje me personat me aftësi të kufizuara në Kosovë. Sipas këtij dokumenti<sup>56</sup> janë tre grupe ligjesh të dedikuara për respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Ata janë:

### Ligjet specifike

- Ligji nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuar
- Ligji nr. 03/L-022 për përkrahjen materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme.
- Ligji nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
- Ligji për Personat e Verbër

### Ligjet të cilët përmbajnë dispozita në lidhje me personat me aftësi të kufizuara

- Ligji nr. 04/L-125 për ndërtim
- Ligji nr. 03/L212 i punës;
- Ligji nr. 2004/15 për ndërtimin
- Ligji nr. 2004/3 kundër diskriminimit
- Ligji nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale
- Ligji nr. 04/L-032 për arsimin para-universitar
- Ligji nr. 04/L-075 për ndërtim

### Udhëzimet Administrative dhe Rregullorja

- Rregullore nr. 2000/66 mbi beneficionet e invalidëve të luftës të Kosovës dhe për më të afërmit e tyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë:
- Udhëzimi administrativ-nr. 07/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara
- Udhëzimi administrativ nr. 03/2010 për procedurat e aplikimit për njohjen e të drejtave në aftësim, riaftësim dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara

Ekzistojnë 5 fusha prioritare brenda SNDPAK, secila me objektivin e vet strategjik si më poshtë:

**Objektiva Strategjike 1:** Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara;

**Objektiva Strategjike 2:** Sistem funksional dhe i mirëfilltë i mirëqenies dhe sigurisë sociale si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara;

**Objektiva Strategjike 3:** Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara;

**Objektiva Strategjike 4:** Qasje e barabartë në mbrojtje ligjore si dhe ofrimi i shërbimeve në nivelin lokal për përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;

**Objektiva Strategjike 5:** Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, komunikim, pjesëmarrje si dhe në krijimin apo vendosjen e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuara”<sup>57</sup>

Sipas SNPAK, progresi është vërejtur në fusha të ndryshme të jetës së personave me aftësi të kufizuara që nga viti 2009, si rritja e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim, një trend pozitiv në sistemin arsimor drejt praktikave gjithëpërfshirëse dhe qasje e përmirësuar në shërbimet e strehimit për personat me aftësi të kufizuara. Sa i përket grumbullimit të të dhënave, SNPAK e ngre çështjen e nevojës për një angazhim më të fortë ndërmjet institucioneve përgjegjëse për të adresuar sfidat në mbledhjen e të dhënave për personat me aftësi të kufizuara duke përfshirë monitorimin e vazhdueshëm të situatës<sup>58</sup>.

Përveç asaj që u tha më lartë, Instituti për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim të Rinisë – Kosovë<sup>59</sup> identifikon dy ligje të tjera si me rëndësi parësore për personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe psikosociale:

- Ligji nr. 03/L-007 për Procedurën Jo-kontestimore
- Ligji për Shëndetin Mendor

## Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nationale për Personat me Aftësi të Kufizuara (2013-2015)

*Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015)*<sup>60</sup> (këtëj e tutje Plani i Veprimit 2013) i njeh fushat e përmirësimit që janë dakorduar nga personat me aftësi të kufizuara dhe qeveria e Kosovës në 5 fushat e përmendura më lartë në SKPAK dhe parasheh “veprimet konkrete dhe afate kohore konkrete (...) për tre vitet në vijim”<sup>61</sup>, dhe përmban “veprime dhe qëllime konkrete, tregues të matshëm, konkret, të arritshëm dhe real, institucione përgjegjëse për zbatimin e secilit aktivitet, afate kohore dhe linjat buxhetore në kuadër të çdo aktiviteti”<sup>62</sup>. Përmbledhja e mëposhtme vë në pah aktivitetet që kanë potencialin më të madh për të pasur ndikim në jetët e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Sipas Objektivit Strategjik 1, “Përmirësimi i Ofrimit të Shërbimeve Shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara”<sup>63</sup>, aktivitetet ndërlidhen me identifikimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, sigurimin që personeli shëndetësor janë të trajnuar me trajnime adekuate në mënyrë që të mund adresojnë nevojat (përfshirë shërbimet e rehabilitimit) dhe t’i informojnë personat me aftësi të kufizuara për të drejtat e tyre dhe se ofrohen furnizime të nevojshme mjekësore. Një vëmendje e posaçme i kushtohet zbulimit të hershëm, identifikimit dhe parandalimit të aftësisë së kufizuar, duke përfshirë trajnimin e stafit mjekësor, edukimin e prindërve sa i përket rëndësisë së intervenimit të hershëm, vaksinimit dhe ofrimit të furnizimeve mjekësore.

*Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës (2013-2015) – Raporti i Progresit*<sup>64</sup> (këtëj e tutje Raporti i Progresit për Planin e Veprimit 2013) thekson që Qendra për Zhvillimin e Mjekësisë Familjare ka zhvilluar një kurrikulë për arsimin e specializuar që përfshinë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, përderisa Qendra për Edukim të Vazhdueshëm Infermierik ka mbajtur tetë trajnime (në vitin 2014) për “infermierët familjarë që mbulojnë tema konkrete në lidhje me trajnimin dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor”<sup>65</sup> për personat me aftësi të kufizuara. Është hartuar manuali për vizita në shtëpi (me bashkëpunim ndërmjet MSH dhe UNICEF) dhe 50 persona nga personeli shëndetësor janë trajnuar për identifikimin e hershëm të foshnjave me vonesa në zhvillim. Janë zhvilluar udhëzimet për prindërit dhe shkalla e vaksinimit arriti në 97% (me fushata vetëdijesuese që janë në vazhdim e sipër). Janë identifikuar kufizime në zbatim: mungesa e analizës gjithëpërfshirëse të kujdesit shëndetësor, mungesa e barnave dhe materialeve shpenzuese, mungesa e trajnimit të personelit shëndetësor dhe aktivitete të pakta të identifikimit të hershëm/intervenimit të hershëm.

Objekivi Strategjik 2, “Sistem funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara”<sup>66</sup> fokusohet në ndryshimin, plotësimin apo zbatimin e legjislacionit, siç është Ligji Nr. 2003/23 për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe memorandumet ministrore. Dokumenti gjithashtu përfshin “themelimin dhe funksionimin e qendrave [funksionale] për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara”<sup>67</sup>, të përshkruara si shtatë shtëpitë me bazë në komunitet, si dhe trajnimi për ekspertët që punojnë në këto qendra. Aktivitetet e ndërlidhura me punësimin fokusohen në ndryshimin e *Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara* dhe priorizimin e mundësive për punësim për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

Sa i përket Objektivit Strategjik 2, Raporti i Progresit për Planin e Veprimit 2013 thekson që Ligji nr. 04/031 mbi Skemat Pensionale të Sponsorizuara nga Qeveria është aprovuar dhe është bërë licencimi i ofruesve të shërbimeve familjare sipas Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare<sup>68</sup>, si dhe ndryshimet e pa specifikuar në Ligjin nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Zyra e Punësimit ka raportuar progresin në punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Qendrat për Arsimin dhe Aftësimin Profesional kanë certifikuar 43 persona në vitin 2014. Më tej, shtatë prej tetë shtëpive të planifikuara me bazë në komunitet u janë përmirësuar kushtet (një tjetër është duke u ndërtuar) “dhe pas ndërtimit të saj personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe stafi do të transferohen



nga SIS në Shtime”<sup>69</sup>. Pengesat e identifikuar në zbatim janë: vështirësi në ofrimin e shërbimeve rehabilituese, vlera e ulët monetare e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara dhe zbatimi i ligjeve për punësim.

Arsimi – Objektivi Strategjik 3, “*krijimi i kushteve për gjithë-përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara*”<sup>70</sup>, është seksioni më i madh dhe më i detajuar nga seksionet në Planin e Veprimit 2013. Ai fillon me pranimin e nevojës për hulumtimin mbi personat me aftësi të kufizuara në arsim, si dhe nevojat për gjuhën e shenjave. Parasheh zhvillimin e programeve për edukim në shtëpi, mbledhjen e të dhënave në shkollat e rregullta, standardet për shkollat dhe universitetet gjithëpërfshirëse, emërimin e koordinatorëve për arsim gjithëpërfshirës në Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA-të), ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve komunale, përcaktimin e linjës së veçantë dhe formulës së financimit për fëmijët me nevoja të veçanta, emërimin, udhëzimin dhe trajnimin e ekipeve vlerësuese në shtatë komuna si dhe koordinatorët komunal, punësimin dhe trajnimin e mësimeve udhëtues dhe mësimeve mbështetës. Më tej, aktivitetet detajojnë zhvillimin dhe zbatimin e programeve të intervenimit të hershëm për fëmijët me nevoja të veçanta, si dhe bazën e të dhënave dhe fushatat vetëdijësuese, trajnimin e personelit arsimor dhe prindërve për intervenim të hershëm dhe planifikimin e themelimit të qendrave për Identifikim të Hershëm/Intervenim të Hershëm (IH/IH). Plani i Veprimit 2013 përfshin ri-organizimin dhe plotësimin me staf, sipas nevojës, të qendrave burimore për mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta dhe krijimin e një rrjeti të qendrave burimore me mbulim kombëtar, si dhe punësimin e instruktorëve të gjuhës së shenjave dhe asistentëve në klasë për fëmijët e shurdhër. Qendrat burimore parashihen të kenë ekipe vlerësuese, si dhe të ofrojnë shërbime të reja (të pa specifikuar) nga profesionistët e trajnuar. Qendrat burimore gjithashtu kanë për detyrë monitorimin e *integritit* të fëmijëve me aftësi të kufizuara, mbështetjen e krijimit të forumeve të mësimeve të arsimit gjithëpërfshirës, si dhe mësimin (trajnimin) e fëmijëve me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëllojshme. Praktika profesionale e studentëve universitar duhet të zhvillohet në qendrat burimore dhe shkollat të cilat i vijnë fëmijët me aftësi të kufizuara. Plani i Veprimit 2013 parasheh trajnimin e mësimeve në programet e aftësimin dhe riaftësimin dhe shtimin e lëndëve të ndërlidhura me arsimin gjithëpërfshirës dhe hapjen e një programi për mësime të arsimit gjithëpërfshirës në universitet, duke siguruar trajnimin pa shpërburje nga puna të të gjithë mësimeve. Vetëdijësimi dhe shpërndarja e materialeve që promovojnë arsimin gjithëpërfshirës përmbyllin planin.

Raportimi mbi Objektivin Strategjik 3<sup>71</sup> përfshin hulumtimin mbi zhvillimin në fëmijërinë e hershme, trajnimin dhe vendosjen e 3 interpretuesve të gjuhës së shenjave në shkollat e rregullta, si dhe “miratimin dhe zbatimin e indeksit për gjithëpërfshirje në shkollat e fillore dhe të mesme të ulëta, si dhe 8 institucione parashkollore”<sup>72</sup>. Një sistem nacional për mbledhjen e të dhënave arsimore përfshin të dhëna mbi fëmijët me aftësi të kufizuara dhe standardet shkollore miqësore për fëmijë të zbatuara. Në nivel komunal, 25 komuna kanë emëruar zyrtarë për arsimin gjithëpërfshirës, 13 kanë themeluar ekipe vlerësuese dhe janë mbajtur 4 punëtori mbi ngritjen e kapaciteteve me zyrtarët komunal. Ekipe vlerësuese në qendrat burimore janë funksionale dhe kanë ndjekur 4 punëtori trajnuese (një nga të cilat mbi gjuhën e shenjave). Një nga qendrat burimore ka pranuar donacion prej 100 mijë Euro me pajisje për dëgjim dhe

pajisje tjera nga Universiteti i Anatólisë (Turqi). Siç edhe është pritur, një ngarkesë e madhe në lidhje me arsimin gjithëpërfshirës bie mbi Qendrat Burimore që kanë akredituar 20 programe trajnuese dhe kanë ofruar mundësi për praktikë. Disa inspektorë dhe drejtorë të shkollave kanë ndjekur trajnime mbi monitorimin e planeve të individualizuara arsimore dhe gjithsej 3100 mësime dhe edukatorë janë trajnuar për arsimin gjithëpërfshirës. Formula e financimit është duke u shtjelluar me një grup punues. Shtatë edukatorë dhe shtatë asistentë janë punësuar (me sa duket për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara – lokacioni i paspecifikuar). Së fundi, fushatat vetëdijësuese janë në vazhdim e sipër. Sfidat e identifikuar në zbatim janë: mungesa e rishikimeve në programet për arsim në shtëpi, rezidencial dhe trajtues; standardet për arsimin tretësor; punësimi i mësimeve udhëtues dhe asistentëve, zhvillimi dhe zbatimi i programeve dhe/ose themelimi i qendrave për identifikimin e hershëm/intervenimin e hershëm.

Objektivi Strategjik (4) “krijimi i infrastrukturës ligjore për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara”<sup>73</sup> i dedikohet aktiviteteve të ndërlidhura me legjisllacionin, disa nga të cilat janë përmendur më lartë. Përveç kësaj, parashihet hartimi i *Ligjit për Paraplegjikët dhe Tetraplegjikët*, ndryshimi i *Ligjit kundër Diskriminimit*, *Ligjit për Transportin Rrugor*, nxjerrja e akteve të ndryshme ligjore dhe nën-ligjore dhe udhëzimeve administrative. Gjithashtu përfshin të siguarit që ekziston personel i specializuar në shërbimet dhe objektet korrektuese dhe sprovuese dhe trajnimi i nëpunësve të ndryshëm civil mbi të drejtat dhe nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara, si dhe ofrimi i shërbimeve në gjuhën e shenjave dhe dokumenteve në gjuhën Braille, sipas nevojës.

Në kuadër të Objektivit Strategjik 4, raportohet progres<sup>74</sup> në ndryshimet legjisllative, siç është drafti mbi Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji, aprovimi i Projektligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Projektligjit për Barazi Gjinore dhe Projektligjit për Avokatin e Popullit. Është aprovuar U.A. 12/2014, si dhe Draft U.A. 18/2013 mbi Planin e Personalizuar Arsimor dhe Rregulloren nr. 02/2013 mbi Komisionet Mjekësore – Sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara. Gjithashtu janë aprovuar UA 07/2012 mbi Vlerësimin Profesional të Fëmijëve me Nevojat e Veçanta, UA 15/2012 për Përkujdesje në Fëmijëri të Hershme dhe Arsim dhe UA 23/2013 për Qendrat Burimore. Zyrtarët korrektues janë trajnuar për të drejtat e njeriut, me theks në personat me aftësi të kufizuara dhe 20 interpretues të gjuhës së shenjave janë trajnuar për interpretim ligjor. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale tani ofrohen në Brajl (Braille). Pengesat e identifikuar në zbatim janë: miratimi i projektligjeve, mungesa e trajnimeve për zyrtarët sprovues dhe zyrtarët policorë dhe shërbimet e gjuhës së shenjave në kuadër të fushave të gjyqësorit dhe sigurisë.

Objektivi Strategjik 5, “krijimi i kushteve të barabarta për qasje, komunikim, pjesëmarrje, si dhe krijimin e një sistemi të unifikuar të të dhënave mbi personat me aftësi të kufizuara”<sup>75</sup>, prapë përfshinë aktivitetet hulumtuese në lidhje me qasjen dhe fushatat vetëdijësuese. Ai parasheh ndërtimin e rampave, tualeteve të qasshme në ndërtesat publike, meremetimin e shkollave dhe universiteteve, ofrimin e pajisjeve të teknologjisë ndihmëse në shkolla si dhe transportimin, gjuhën e shenjave Brajl dhe komunikimin tjetër alternativ për fëmijët me aftësi të kufizuara, infrastrukturën e vendeve publike dhe automjetet e përshtatshme publike. Në Objektivin Strategjik

5 përmenden aktivitetet sportive dhe kulturore për personat me aftësi të kufizuara, si dhe përfshirja e të rinjve me aftësi të kufizuara në aktivitetet që synojnë të rinjtë, bashkëpunimin e gjerë, dhe si më lartë, zhvillimin e softuerit, respektimin e standardit informativ W3C, trajnimin e zyrtarëve të informimit, përdorimin e lexuesve dhe shkruesve të ekraneve dhe trajnimin e personave me aftësi të kufizuara mbi përdorimin e TIK dhe TN.

Në fund, Raporti i Progresit për Planin e Veprimit 2013 vë në pah se në fushën e Objektivit Strategjik 5, tetë institucione i janë nënshtruar intervenimeve infrastrukturore (edhe pse shtatë nuk janë adekuate për personat me lloje të ndryshme të dëmtimeve), është bërë një vlerësim i qasjes në shëndetin publik (vetëm 25% mundësojnë qasjen), 12 përfaqësues të OPAK janë trajnuar (.....) , dy klasa janë pajisur me harduer dhe softuer të TIK dhe tre persona janë pajisur me softuerin që konverton tekstin në zë. Pasaportat, letërnjoftimet dhe patentë shoferi tani jepen pa pagesë për personat me aftësi të kufizuara dhe komisioni paralimpik ka marrë pjesë në trajnime për zhvillimin e kapaciteteve dhe mundësive për bashkëpunim. Sfidat e identifikuara janë: mungesa e njohurive në lidhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara në nivel lokal, mungesa e infrastrukturës së qasshme dhe përshtatshmëria e transportit publik.

Siç shihet më lartë, Plani i Veprimit 2013 është mjaft gjithëpërfshirës dhe ambicioz (veçanërisht duke pasur parasysh buxhetet e ndara) dhe përfshinë fëmijët. Përderisa ky studim përkrahë perspektivën që situata e fëmijëve duhet të konsiderohet përgjatë ciklit të jetës, gjithashtu merr parasysh që veprimet duhet të fillojnë sa më herët gjatë jetës që të jetë e mundur. Plani i Veprimit 2013 ka parasysh fëmijët dhe të rinjtë. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve në adresimin e disa veprimeve më relevante dhe të domosdoshme në Kosovë aktualisht, disa të tjera janë lënë anash. Për ta thënë më qartë, vetëm një numër i kufizuar i personave me aftësi të kufizuara merret parasysh në dokument. Plani i Veprimit 2013 nuk bënë përjashtime dhe flet për personat me aftësi të kufizuara në terma të përgjithshëm, dhe vetëm përmend në mënyrë specifike aktivitetet, veprimet, legjislacionin dhe nevojat për qasje të personave me dëmtime shqisore apo fizike. Nuk ka pika të veçanta për personat me dëmtime intelektuale, personat me aftësi të kufizuara mentale, personat me aftësi të kufizuara të lehta, apo fëmijët me aftësi të kufizuara në të nxëniet (për të përmendur vetëm disa) të cilët, si tërësi, ka të ngjarë të përbëjnë numrin më të madh nga numri i përgjithshëm i personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, për dallim nga ata me aftësi të kufizuara fizike dhe shqisore. Lënia jashtë e veprimeve të ndërlidhura me një spektër të gjerë të aftësisë së kufizuar në legjislacionin dhe Planin e Veprimit 2013 pranohet njësoj nga qeveria dhe shoqëria civile dhe reflekton mungesën aktuale të angazhimit nga një grup i gjerë i personave me aftësi të kufizuara të Kosovës, në kuadër të aktivizmit politik.

Plani i Veprimit gjithashtu parasheh mekanizmat e monitorimit, raportimit dhe zbatimit që diskutohen në seksionin më poshtë.

## Zbatimi dhe monitorimi

Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara është një komision ndër-ministor me përfaqësim nga qeveria dhe shoqëria civile. Këshilli Kombëtar takohet dy herë në vit për të vlerësuar zbatimin e Strategjisë Nationale dhe Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara por në vitin 2016 është takuar vetëm një herë për të miratuar draft Raportin e BE-së për Vendin. Këshilli përbëhet nga: Zëvendës Kryeministri (kryesues), i bashkë-kryesuar nga Shefi i Forumit për Aftësi të Kufizuara në Kosovë (bashkë-kryesues), Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë, OPAK-të dhe përfaqësimi nga ministri të ndryshme të linjës (d.m.th. Ministria pa Portofol, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) dhe përfaqësimi nga gjashtë OJQ që janë të dedikuara ndaj çështjeve të aftësisë së kufizuar (HandiKOS, Handicap Kosova, Shoqata e Personave të Shurdhër, Shoqata e Autizmit, Shoqata e Personave të Verbër në Kosovë, dhe Shoqata e Down Syndrome).

Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar i OPAK-ve, është një organizatë ombrellë e krijuar kohët e fundit, me përfaqësim nga 8 OJQ-të më të mëdha në Kosovë, e cila shihet nga shumica e aktorëve të intervistuar për këtë studim si mekanizëm përmes të cilit mund të adresohen shumë nga sfidat. Me statusin e vëzhguesit në Forumin Evropian të Aftësisë së Kufizuar, Forumi e sheh agjendën e tij si të intervenimit dhe jo si mjet politik (si Këshilli Kombëtar). Qëllimi kryesor i Forumit është të sigurohet se diskutimet e koncept dokumentit të hartuar (aktualisht në diskutim publik) për një ligj gjithëpërfshirës për aftësitë e kufizuara të përfundohen me sukses (edhe pse koncept dokumenti është iniciuar para krijimit zyrtar të Forumit, OJQ-të e përfshira në Forum janë ato që zhvilluan koncept dokumentin). Pritet që koncept dokumenti shumë shpejt do t'i hapë rrugë një projektligji dhe një ligji të ri deri në fund të vitit 2018. Forumi thuhet se njihet nga qeveria si organizata që përfaqëson të gjithë personat me aftësi të kufizuara, një përgjegjësi e madhe duke e pasur parasysh që përbëhet nga shtatë organizata me misione dhe interesa shumë specifike (grupe të personave me dëmtime specifike).

Ka mungesë të hulumtimeve dhe analizave të dokumentuara të situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në mënyrë që të vlerësohet se ku qëndron Kosova në zbatimin e ligjeve që përfshijnë dispozitat e ndërlydhura me fëmijët me aftësi të kufizuara (Konferenca KOMF mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara, 3 dhjetor 2015). Po ashtu, nuk ekziston ndonjë bashkëpunim i ngushtë ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Financave, si partnerët kryesor për avancimin e çështjeve të ndërlydhura me fëmijët me aftësi të kufizuara, (Konferenca për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, 3 dhjetor 2015).

Plani i Veprimit 2013 përfshin tetë aktivitete të ndërlydhura me mekanizmat e monitorimit, raportimit dhe zbatimit. Aktivitetet fokusohen në bashkëpunimin ndërmjet qeverisë dhe OPAK-ve, raportimin vjetor mbi progresin, pjesëmarrjen e paspecifikuar aktive të personave me aftësi të kufizuara në vendimmarrje në nivel komunal, mbledhjen dhe shpërndarjen e informacioneve, analizën e strukturave komunale vizaviqë zbatimit

të Planit të Veprimit 2013, hartimin e planeve lokale të veprimit dhe informimin e autoriteteve lokale për obligimet e tyre.

Megjithatë, dhe sipas vrojtimeve nga akterë të ndryshëm të intervistuar për studimin, duke përfshirë Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, zbatimi i Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit në nivel komunal është duke ndodhur në baza ad-hoc dhe rezultatet e monitorimit kanë qenë jo efektive në zgjerimin e mbulimit apo prodhimin e ndryshimit pozitiv. Kështu, në kohën e këtij raporti, vetëm 14 nga 38 komunat kanë Strategji dhe Plane Komunale të Veprimit për personat me aftësi të kufizuara. Ato janë: Drenasi, Hani i Elezit, Ferizaji, Fushë Kosova, Gjilani, Kamenica, Lipjani, Parteshi, Podujeva, Prizreni, Skenderaj, Suhareka, Vitia dhe Vushtrria. Edhe pse Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit janë në fuqi që nga viti 2013 (dhe kanë skaduar në vitin 2016), më pak se një e treta e të gjitha komunave në Kosovë janë duke respektuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, siç parashihet në legjislacion.

Të intervistuarit kanë sugjeruar disa arsye përkitazi me mungesën e zbatimit të programeve dhe aktiviteteve që kanë pasur për synim përmbushjen e disa nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, që me gjasë ndërlidhen me mungesën e planeve komunale të veprimit për personat me aftësi të kufizuara.

Së pari, mungesa e veprimeve e ndërlidhur me përpjekjet e *decentralizimit* ishte arsyeja e cituar më së shpeshti për mungesën e zbatimit të tyre dhe direktivave tjera legjislative: 1) mungesa e burimeve financiare që do të duhej të ishin ofruar për autoritetet komunale së bashku me përgjegjësitë për qeverisje; dhe, 2) mungesa e mekanizmave transparent të llogaridhënies që sigurojnë se ekziston koordinimi ndërmjet niveleve qendrore dhe komunale dhe që është plotësisht funksional.

Së dyti, është dakorduar që strategjitë dhe planet komunale të veprimit janë të dëshirueshme, por nuk janë kusht për ofrimin e shërbimeve. Në këtë mënyrë, dy arsye tjera për mungesën e zbatimit citohen shpesh: 1) mungesa e vullnetit politik për të caktuar fëmijët me aftësi të kufizuara si prioritet politik, që i bënë fëmijët me aftësi të kufizuara të padukshëm; 2) mungesa e alokimit të buxhetit qendror/granteve enkas për shërbimet sociale që do t'iu ofronin komunave alokimet e nevojshme financiare për inicimin e ofrimit të shërbimeve sociale. Megjithatë, siç mund të shihet më poshtë, alokimet financiare nuk janë kufizimet kryesore ndaj zbatimit, pasi që sektorët e arsimit dhe shëndetësisë të dy përfshijnë grantet qendrore dhe këta dy sektorë akoma paraqesin sfida të konsiderueshme.







UNICEF/2013/G. Pirozzi

**për çdo fëmijë, shpresë**

# III.

## PROGRESI DHE SFIDAT NË REALIZIMIN E TË DREJTAVE

Progresi dhe sfidat e vërejtura gjatë këtij studimi janë paraqitur më poshtë sipas neneve përkatëse të KDPAK. Një citat nga KDPAK jepet në fillim të çdo seksioni për të përshkruar të gjeturat në kuadër të nenit përkatës të KDPAK. Megjithatë, duhet të theksohet që shumë nga të gjeturat janë ndër-sektoriale dhe nuk “përshtaten” saktësisht brenda një të drejte specifike. Ato janë relevante në të gjithë nenet e shumta (p.sh. shkeljet e të drejtës për qasje – neni 9 i KDPAK – kufizimi i të drejtës për pjesëmarrje në jetën politike dhe publike – neni 29 i KDPAK – dhe kufizimi i të drejtës për pjesëmarrje në jetën kulturore dhe aktivitetet argëtuese dhe sportive – neni 30 i KDPAK).

### Të drejtat dhe obligimet ndër-sektoriale

#### Obligimet e përgjithshme

**1. Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe nxisin realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pa diskriminim të çfarëdo lloji për shkak të aftësisë së kufizuar. Për këtë qëllim, Shtetet Palë marrin përsipër (...) të ndërmarrin apo të nxisin punën kërkimore dhe zhvillimin e mallrave, shërbimeve, pajisjeve dhe objekteve të dizajnuara në mënyrë universale, sipas përcaktimit të nenit 2 të kësaj Konvente, që kërkon adaptimet më minimale të mundshme dhe me koston më të ulët për të plotësuar nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara, për të nxitur disponueshmërinë dhe përdorimin e tyre, si dhe për të nxitur përdorimin e dizajnit universal në përpilimin e standardeve dhe udhëzimeve; (g) të ndërmarrin apo të nxisin kërkimin dhe zhvillimin, si dhe të promovojnë disponueshmërinë dhe përdorimin e teknologjive të reja, duke përfshirë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, mjetet ndihmëse lëvizëse, pajisjet e teknologjive asistuese të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, duke iu dhënë përparësi teknologjive me kosto të përballeshme; (h) t’u sigurojnë personave me aftësi të kufizuara qasje në informatat lidhur me mjetet ndihmëse lëvizëse, pajisjet, dhe teknologjitë asistuese, përfshirë teknologjitë e reja, si dhe forma të tjera të asistencës, shërbimeve dhe faciliteteve mbështetëse; (i) të përmirësojnë trajnimin e profesionistëve dhe stafit që punon me personat me aftësi të kufizuara lidhur me të drejtat që njeh kjo Konventë, me qëllim që asistenca dhe shërbimet e garantuara nga këto të drejta të ofrohen më mirë. (...) me synimin për të arritur në mënyrë progresive në realizimin e plotë të këtyre të drejtave, pa paragjykim ndaj atyre detyrimeve të paraqitura në këtë Konventë, të cilat sipas ligjeve ndërkombëtare janë për zbatim të**

menjëhershëm. (...)Shtetet Palë duhet të konsultohen në mënyrë aktive me personat me aftësi të kufizuar, përfshirë këtu edhe fëmijët me aftësi të kufizuar për të siguruar përfshirjen e tyre nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese. (...) – Neni 4 i KDPAK

KDPAK është e qartë sa i përket procedurave normative, por gjithashtu sa i përket mënyrave në të cilat KDPAK mendohet të zbatohet. Përderisa KDPAK pret “*realizimin e plotë të këtyre të drejtave në mënyrë progresive*”, ofrimi i shërbimeve pritet të shoqërojë edhe rishikimet e legjislacionit. Në përgjithësi, në Kosovë ka pasur përpjekje për të siguruar që legjislacioni i hartuar pas vitit 2008 të jetë në përputhje me frymën e KDPAK. Megjithatë, zbatimi është jashtëzakonisht i vështirë dhe megjithëse të intervistuarit shpesh tregojnë që decentralizimi ka qenë pengesa kryesore për zbatim, analiza e mëposhtme përshkruan barrierat dhe pengesat ku jo të gjitha janë të ndërlidhura me procesin e *decentralizimit*.

## E drejta për barazi dhe mos-diskriminim

**Shtetet Palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtat pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji; (...)ndalojnë çdo lloj diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar dhe u garantojnë personave me aftësi të kufizuar mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në çdo rrethanë; (...) ndërmarrin të gjitha hapat e duhura për tu siguruar se është ofruar akomodim i arsyeshëm; (...) masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur de facto barazinë e personave me aftësi të kufizuar nuk do të konsiderohen diskriminim – Neni 5 i KDPAK**

Ligji nr. 05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>76</sup> përmend në mënyrë specifike se “Mosdhënia e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar, në përputhje me nevojat e tyre specifike konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, përveçse kur është një barrë e paarsyeshme për personin që është i detyruar ta ofrojë dhe kjo nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, duke marrë në konsideratë për këtë qëllim faktorë të tillë si përdorimi i burimeve të disponueshme publike, pjesëmarrjen në jetën sociale dhe publike dhe garantimin e qasjes në vendin e punës dhe kushte të përshtatshme pune” në nenin 4, nën llojet e trajtimit të pabarabartë. Neni 19 përmend përsëri akomodimin e arsyeshëm të personave me aftësi të kufizuara në lidhje me punësimin. Megjithatë, i gjithë ligji është miqësor për aftësinë e kufizuar dhe mund të përdoret për të argumentuar në favor të praktikave jo diskriminuese për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara. Përveç kësaj, Qeveria e Kosovës në vitin 2017, ka miratuar një rregullore<sup>77</sup> që siguron mbrojtjen nga diskriminimi në të gjitha ministritë dhe komunat, për të siguruar zbatimin e plotë të Ligjit nr. 05/L-21 për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Diskriminimi përjetohet në ofrimin e shërbimeve, në të cilat familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara kanë qasje. Përderisa familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara nuk paguajnë para nga xhepi për shërbimet që i marrin në institucionet publike, në shumicën e rasteve shërbimet e specializuara në institucionet publike janë të pakta dhe nuk janë në dispozicion në tërë komunat. Në shumicën e rasteve mungojnë barnat në klinika, madje nganjëherë edhe ato në listën esenciale. Prandaj, shumica e familjeve obligohen që të kërkojnë shërbime të specializuara në klinika private, të cilat janë jashtëzakonisht

të kushtueshme për familjet, ku shumica prej tyre kanë standard shumë të ulët të jetesës dhe kushte të dobëta. Profesionistët e kujdesit shëndetësor që kanë marrë pjesë në këtë studim kanë raportuar që përfitimi monetar që marrin familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme është pothuajse **“hiq”** në krahasim me shpenzimet që i kanë shumica e familjeve për të siguruar shërbimet për të cilat kanë nevojë fëmijët (kur shërbimet e përmendura janë në dispozicion, gjë që është e rrallë). Natyra diskriminuese e kriterëve të cilat kërkojnë që fëmijët me aftësi të kufizuara të identifikohen si me më shumë se 85% me dëmtim, i lë shumë fëmijë me aftësi të kufizuara të rënda dhe nivele të larta të nevojave për shërbim jashtë skemës së asistencës: **“Ne jo vetëm që po shkelim të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, por po shkelim me të dyja këmbët të drejtat e tyre njerëzore”** (mjek, rajoni i Ferizajt).

Ndihma juridike falas në Kosovë rregullohet me Ligjin për Ndhmë Juridike Falas në Kosovë<sup>78</sup>, në mënyrë që të krijohet një sistem funksional për ndihmë juridike falas në procedurat civile, penale, kundërvajtëse dhe administrative, nëpërmjet të cilave sigurohet një qasje efikase në drejtësi për qytetarët që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare. E njëjta ofrohet në tërë territorin e Kosovës nëpërmjet pesë zyrave rajonale në këto lloje të rasteve: informacionet dhe këshillat juridike në lidhje me procedurat ligjore, hartimin e dokumentacionit dhe e gjithë asistencë tjetër teknike që ka të bëjë me kompletimin e përfaqësimit të rasteve të procedurave civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse. Gratë, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe personat tjerë të pafavorizuar apo të përjashtuar kanë qenë fokusi i ndihmës juridike.

Ndihma juridike falas është gjithashtu në dispozicion për të siguruar mbrojtjen juridike të personave që marrin asistencë sociale dhe personave të papunë, edhe pse ky shërbim nuk është i njohur mjaft mirë tek qytetarët e marginalizuar, siç edhe është ripërsëritur nga përfaqësuesit e zyrave për ndihmë juridike në Prizren dhe në Prishtinë gjatë DFG. Siç është raportuar, shërbimet mund të ofrohen edhe për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të cilëve iu është mohuar asistencë sociale dhe gjithashtu në të siguruarit që fëmijët mbesin me familjet e tyre: **“kohëve të fundit ka shumë raste kur Komisioni për Mirëqenie Sociale në Ministri refuzon familjet nga të gjitha skemat tjera të asistencës sociale, nëse tashmë përfitojnë nga ndonjë skemë. Për shembull, është një familje me 7-8 anëtarë që jetojnë në kushte shumë të dobëta dhe pos kësaj kanë një fëmijë me aftësi të kufizuara, që përfiton nga skema e asistencës sociale, por është privuar nga përfitimi nga skema për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, gjë që është shumë diskriminuese. Këto familje madje nuk kanë as qasje në informacionet themelore për të drejtat e tyre në bazë të kornizës ekzistuese ligjore dhe asaj se si t’i qasen institucionit dhe mekanizmit të duhur për ndihmë”** (avokat, Prizren). Siç është raportuar, në Kosovë nuk ka avokatë të specializuar për të drejtat e fëmijëve dhe as nuk ka trajnim specifik për këtë fushë. Gjithashtu, nuk ka avokatë të specializuar në lidhje me aftësitë e kufizuara por, siç përmendet nga profesionistët tjerë, ligji për “aftësinë e kufizuar të përhershme” është shumë diskriminues.

## E drejta për vetëdijesim

Shtetet Palë marrin përsipër të ndërmarrin masa të menjëhershme, efektive dhe të përshtatshme: (a) për të rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë, duke përfshirë punën me familjet, lidhur me personat me aftësi të kufizuara, me qëllim nxitjen e respektit



për të drejtat dhe dinjitetin e personave me aftësi të kufizuara; (b) Për të luftuar stereotipat, paragjykimet dhe praktikat e dëmshme (...); (c) për të nxitur rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me aftësitë dhe kontributin e personave me aftësi të kufizuara; 2. Masat për këtë qëllim përfshijnë: (a) Ndërmarrjen e nismave dhe fushatave efektive për ndërgjegjësimin e publikut (...); (b) nxitja e mendësisë së respektit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, duke përfshirë të gjithë fëmijët që në moshë të hershme; (c) të inkurajojë të gjithë organet e mediave për të portretizuar personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të tillë që të jetë konsistente me këtë Konventë; (d) të promovoj programet e trajnimit për rritjen e ndërgjegjësimit (...). – Neni 8 i KDPAK

Stigmatizimi, paragjykimi (dhe diskriminimi) i fëmijëve me aftësi të kufizuara është në masë të madhe i pranishëm në shumicën e komuniteteve në Kosovë. Shembulli më mbizotërues dhe ilustrativ është ai i “fëmijëve me autizëm”. Siç sugjerohet më lartë (shih seksionin mbi vlerësimin e statusit të aftësisë së kufizuara të përhershme) dhe më poshtë (shih seksionin për arsimin), procedurat e vlerësimit të fëmijëve që mendohet të jenë brenda spektrit të fëmijëve me çrregullimin e autizimit mungojnë, janë joprofesionale dhe diksriminuese për shkak të mungesës së trajnimit profesional të personelit. Fëmijët shpesh përshkruhen, flitet për ata dhe rekomandohen për vlerësim si “djalë autist” apo “vajzë autiste” madje edhe para se të jetë filluar diagnostifikimi mjekësor, gjë që mund të ndikojë tek disa profesionist që të mendojë për fëmijën në një mënyrë të caktuar dhe të ndikohen nga paragjykimet në vlerësimin e rastit të fëmijës. Madje edhe në rastet kur diagnostifikimi është jo-konkluziv apo është jo i plotë, stigma e ndërlidhur me autizmin është aq mbizotëruese sa që në të gjitha rastet e mbledhjes së të dhënave në këtë studim (si DFG-të ashtu dhe IIK-të), të gjithë profesionistët iu referuan fëmijëve që mendohen të jenë në spektrin e autizmit si “fëmijë autistë” pa i konsideruar së pari të drejtat e tyre si fëmijë, madje edhe në rastet kur i përshkruanin fëmijët të cilëve nuk u ishte përcaktuar diagnoza. Në anën tjetër, shumica e profesionistëve u ankuan që prindërit nuk ishin edhe shumë të gatshëm që të vlerësojnë fëmijët e tyre qoftë për përfitimet monetare apo për vendosjen në arsim, pa e njohur që hezitimi i prindërve vjen pjesërisht për shkak të mungesës së ekspertizës profesionale të demonstruar dhe të raportuar.

Mësimdhënësit e arsimit special në rajonin e Gjakovës kanë raportuar për përpjekjet e bëra në vitin 2002 për identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, me qëllim që të sigurojnë që kanë qasje në arsim dhe gjatë kësaj është konstatuar që shumë prindër po i fshihnin fëmijët e tyre: ***“Ka pasur raste kur as fqinjët më të afërm nuk ishin të vetëdijshëm që kishte fëmijë me aftësi të kufizuara në shtëpinë tjetër”***.

Në vitin 2013, situata është akoma e vështirë dhe familjet vazhdojnë të raportojnë stigma dhe diskriminim: “Grupi i nënave raportuan që për disa raste stigma brenda komuniteteve të tyre lokale ishte aq e fuqishme sa që ata hezitonin t’i qasen qendrave lokale shëndetësore për këshillë dhe mbështetje. Shumica e nënave raportuan se aftësia e kufizuara e fëmijës ishte identifikuar vonë dhe askush nuk e pati mundësinë që të përfitojë nga një program për stimulim të hershëm deri kur ata patën qasje në qendrën e HandiKOSit. Megjithatë, për disa kjo nënkuptoi që ndihma e parë që ata e morën ishte tek në moshën gjashtë apo shtatë vjeçare të fëmijës”<sup>79</sup>. “Njërës nga nënat me fëmijë me Sindromin Down i kishte thënë punëtori shëndetësor në vitet

e hershme të fëmijës që, fëmija nuk kishte gjasa të mbijetojë. Nëna raportoi që ajo ndihej jo e mirëseardhur në qendrën lokale shëndetësore. Kjo i shtoi ndjenjës së saj të izolimit dhe ndjenjës se fëmija nuk ekzistonte në sytë e autoriteteve”<sup>80</sup>.

Shumë pjesëmarrës në DFG (Gjakovë) raportuan se akoma ekzistojnë raste kur fëmijët me aftësi të kufizuara stigmatizohen, ngacmohen dhe përqeshen nga fëmijët tjerë, drejtorët e shkollave refuzojnë që t’i akomodojnë (siç raportohet në Ferizaj), si dhe siç është rasti me disa familje që hezitojnë të identifikojnë fëmijën e tyre me aftësi të kufizuar për shkak të stigmës dhe frikës së diskriminimit. Përpyekjet e përbashkëta nga institucionet parashkollore dhe klasat e veçanta/të rregullta kanë ndihmuar në largimin e stigmës dhe edukimin e familjeve të fëmijëve me dhe pa aftësi të kufizuara: **“prania e fëmijëve me aftësi të kufizuara në ngjarje dhe aktivitete të ndryshme ndihmon në vetëdijesimin e tërë shoqërisë”** (drejtor i institucionit parashkollor në Ferizaj).

Siç raportohet nga përfaqësuesi i DKA në Prishtinë në DFG, përpjekjet për ngritjen e vetëdijesimit duhet të synojnë tërë popullsinë e Kosovës. **“Kemi probleme me prindërit e fëmijëve që nuk kanë aftësi të kufizuara të cilët akoma nuk e kuptojnë dhe pranojnë faktin që fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejta për arsim gjithëpërfshirës”**.

## E drejta për qasje

**Me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar, ashtu si gjithë të tjerë të kenë qasje në ambientet fizike, transport, informata dhe komunikim, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në objekte dhe shërbime të tjera të disponueshme apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane edhe në ato rurale. – Neni 9 i KDPAK**

Ligji nr. 2004/15 mbi Ndërtimin<sup>81</sup> përmend aftësinë e kufizuar vetëm njëherë dhe nuk i referohet asnjëherë dizjanit universal apo rregulloreve gjithëpërfshirëse të aftësisë së kufizuar dhe neni 12 përcakton që “kushtet teknike për përdorimin e objekteve ndërtimore nga personat me aftësi të kufizuara” duhet të përcaktohen me Udhëzim Administrativ. Megjithatë, hartimi dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ 33/2007<sup>82</sup> që rregullon kërkesat teknike të qasjes në ndërtesat publike dhe infrastrukturën publike, si rrugët dhe semaforat, dhe përcakton rregullat sa i përket madhësisë së ndërtesës dhe planifikimit të dhomave, hyrjeve, rampave, etj., mori 3 vite për t’u zhvilluar dhe aprovuar. Gjithashtu rregullohen aspektet arkitekturore, elektrike, hidraulike, inxhinierike dhe janë kusht që duhet plotësuar me rastin e marrjes së lejes së ndërtimit.

Megjithatë, sipas një sondazhi të kryer në Prishtinë dhe Prizren, “gjendja reale është se udhëzimi administrativ mbetet në letër dhe komunat nuk ndjekin procedurën për zbatimin e këtyre kërkesave teknike”<sup>83</sup>. Hulumtimi sugjeron që kur bëhen përpjekje për të bërë ndryshime, ato mbeten të kufizuara vetëm në nivelin sa për t’u dukur, ndërsa inspektimet e vendeve të ndërtimit nuk e bëjnë zbatimin e Udhëzimit Administrativ. Tualetet publike ose transporti publik që mund të akomodojnë një person me aftësi të kufizuara janë të rralla ose jo-ekzistente dhe trotualet janë njësoj në gjendje të



keqe dhe, që nga viti 2015 nuk ka ekzistuar asnjë transport i përshtatshëm publik në Kosovë. Siç është raportuar, Qendra e Mjekësisë Familjare në Ferizaj nuk është e qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara (me përjashtim të një platforme të pjerrët (rampe) në hyrje) pavarësisht se është një ndërtesë e ndërtuar rishtazi.

Në Prishtinë, janë marrë masa nga Zyra e Kryetarit të Komunës për të korrigjuar disa nga çështjet me rrugët publike dhe trotuaret. Sipas përfaqësuesit të Drejtorisë Komunale të Investimeve Kapitale që ka marrë pjesë në DFG, që nga viti 2013, komuna ka filluar të bëjë ndarjen e buxhetit për përmirësimin e qasjes në infrastrukturë për personat me aftësi të kufizuara si p.sh. ngritjen e platformave të pjerrëta, përshtatjen e dritave të trafikut për personat e verbër, ashensorë, etj. Ata janë duke rikonstruktuar rrugën e gjatë dhe sipas planit të dizajnit, rreth 200 metra trotuar me një shtresë jo të rrëshqitshme do të përshtatet për personat e verbër në Rrugën Garibaldi, në Prishtinë dhe ata do të vazhdojnë me këtë në pjesë të tjera të qytetit në të ardhmen: **“Ne jemi larg vendeve të tjera në këtë drejtim, por disa iniciativa janë ndërmarrë nga komuna për të përmirësuar qasjen për personat me aftësi të kufizuara”**.

Megjithatë, qasshmëria shkon përtej ndërtimit të rrugëve dhe ndërtesave. Është e nevojshme të sigurohet që çështjet e lëvizshmërisë të diskutohen dhe adresohen, përveç udhëzimeve të Dizajnit Universal, Gjuhës së shenjave dhe shenjave të Braille, sinjaleve zanore, sipërfaqeve të prekshme etj. Ndërsa zbatimi i udhëzimeve teknike është i rëndësishëm, trajtimi i çështjeve të qasshmërisë fillon me edukimin e ligjvënësve, stafit teknik dhe inspektorëve për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Siç shihet më poshtë, e drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim shpesh shkelet për shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate dhe përfshirja sociale bëhet e vështirë.

Drejtori i QPS-së në rajonin e Gjakovës raportoi se **“një person me aftësi të kufizuara i vetëm nuk mund të bëjë asnjë punë në qytetin tonë, pasi që ata nuk mund të lëvizin lirshëm në komunë për shkak të mungesës së infrastrukturës së duhur”**. Pjesëmarrësit e DFG-së u pajtuan që iniciativa për ta bërë mjedisin miqësor ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara është modeste. **“Ka disa platforma të pjerrëta të ndërtuara në qytet, por ka mungesë të qasjes në shumicën e institucioneve, as tualete, apo terrene të sigurta të lojës. Situata është edhe më e keqe në zonat rurale”**.

Përfaqësuesi i Drejtorisë Komunale të Prishtinës për investime kapitale përmendi se drejtorja ka ndërmarrë disa iniciativa për të kontribuar në qasjen në infrastrukturë për personat që përdorin karroca, si dhe për personat e verbër dhe të shurdhër, por përpjekjet nuk janë të kënaqshme. Megjithatë, çdo ministri duhet të planifikojë nevojat për qasje në infrastrukturë. Thuhet se ndërhyrjet që ata bëjnë janë kryesisht të përqendruara në hyrjen e ndërtesave të vjetra, sepse është e vështirë të përshtatet brendësia. Megjithatë, në ndërtesat e reja, qasja për personat me aftësi të kufizuara është planifikuar në fazën e dizajnit të projektit. Po ashtu thuhet se po punohet në disa rrugë në qytet edhe pse ky raport ishte shumë i kontestuar nga përfaqësuesit e OPAK në të njëjtin DFG.

HandiKOS dhe GIZ janë partnerë në projekte të fokusuara në përmirësimin e qasjes në qytetin e Prishtinës, por fatkeqësisht, çështjet në lidhje me qasjen kryesisht kuptohen

në mënyrën më të kufizuar: qasja kuptohet si ndryshime infrastrukturore të bëra për të adresuar nevojat e perceptuara të personave që përdorin karroca. Raportohet se AT është siguruar nga donatorët në baza ad-hoc dhe MSH dhe MPMS kanë punuar me HandiKOSin në sigurimin e mirëmbajtjes së karrocave dhe patericave. Syzet dhe mjetet e dëgjimit, në të kaluarën, ishin dhuruar nga disa donatorë të SHBA, por ato projekte tani kanë përfunduar. Sipas intervistave me stafin e Ministrisë së Shëndetësisë, teknologjia ndihmëse nuk është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e asnjë ministrie, gjë që e bën llogaridhënien pothuajse të pamundur.

## E drejta për njohje të barabartë para ligjit

**Shtetet Palë riafirmojnë që personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e njohjes kudo si persona para ligjit (...) gëzojnë kapacitet ligjor në baza të barabarta me të tjerët në të gjitha aspektet e jetës (...) do të marrin masat e duhura për të siguruar qasje nga personat me aftësi të kufizuara për mbështetjen që ata mund të kërkojnë në ushtrimin e zotësisë së tyre ligjore (...) sigurojnë mbrojtje të përshtatshme dhe efektive për të parandaluar abuzimet në përputhje me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Masat e tilla mbrojtëse do të sigurojnë që masat të cilat kanë të bëjnë me ushtrimin e zotësisë ligjore respektojnë të drejtat, vullnetin dhe preferencat e personit, nuk kanë konflikt të interesit dhe ndikim të padrejtë, janë proporcionale dhe të përshtatura për rrethanat e personit, aplikohen për kohën më të shkurtër të mundshme dhe i nënshtrohen shqyrtimit të rregullt nga një autoritet kompetent, i pavarur dhe i paanshëm, ose organ gjyqësor. Masat mbrojtëse duhet të jenë proporcionale me shkallën në të cilën masat e tilla prekin të drejtat dhe interesat e personit (...) Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme dhe efektive për të siguruar të drejtën e barabartë të personave me aftësi të kufizuara për të zotëruar ose trashëguar pronën, (...). - KDPK Neni 12.**

Në Kosovë, Ligji Nr. 03/L-007 mbi Procedurën Jokontestimore rregullon zotësinë ligjore të personave me aftësi të kufizuara (të rriturve), me kujdestarinë e plotë dhe të pjesshme ose vendosjen në një institucion. Vendimi merret nga një gjyqtar dhe mbështetet nga 3 ekspertë mjekësor, dhe personi ka të drejtë të dëgjohet dhe/ose të ankohet në vendimin e marrë. Kujdestari i caktuar mund të jetë një anëtar i familjes ose një profesionist nga Qendrat për Punë Sociale<sup>84</sup>. Sipas raporteve nga Instituti për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim të Rinisë (ISDY) dhe të tjerë, Ligji Nr. 03/007 mbi Procedurën Jokontestimore nuk është përfshirë në listën e ligjeve që duhet rishikuar ose ndryshuar të Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023. Megjithatë, duhet të jetë i përfshirë, pasi e drejta për zotësinë ligjore ndikon në shumë të drejta të tjera.

Të gjithë 43 prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara që morën pjesë në 5 DFG gjatë këtij studimi raportuan se edhe pse nuk kanë dijeni për të gjitha të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, ata e dinë se të drejtat e tyre ekzistuese nuk janë duke u mbrojtur dhe ligjet nuk po zbatohen në mënyra jo diskriminuese. Në Gjakovë, Ferizaj dhe Prishtinë, prindërit kanë raportuar se kujdesi esencial dhe shërbimet nuk janë adekuate, të drejtat e fëmijëve të tyre nuk respektohen dhe ligjet ekzistuese nuk zbatohen. Në komunën e Prishtinës, prindërit në zonat urbane dhe ato rurale raportojnë se kanë marrëdhënie të këqija me punonjësit socialë dhe mungesë të

informatave apo mbështetjes. Disa familje raportuan hapur se kanë pak besim se shteti do të kujdeset për fëmijët e tyre nëse lind nevoja. Ashtu siç u shpreh një baba në Ferizaj: **“I lutem Perëndisë që djali im të mos jetojë pasi të vdes unë, pasi nuk do të ketë askush që të kujdeset për të”.**

Përderisa prindërit në veri të Mitrovicës raportuan të kenë nevojë për njohuri mbi ligjet ekzistuese, prindërit në Gjakovë dhe Prishtinë kanë pritshmëri (dhe aspirata) shumë të ulëta për fëmijët e tyre pasi raportojnë se nuk janë në gjendje t’i përmbushin nevojat e tyre më themelore. Të gjithë shprehën shumë dashuri për fëmijët e tyre, si dhe vullnetin dhe dëshirën për të vazhduar të ofrojnë atë që është e nevojshme për aq sa është e mundshme brenda mundësive të tyre, por ata janë qartazi të dëshpëruar për shkak të mungesës së mbështetjes qeveritare.

## E drejta për standard adekuat të jetesës dhe mbrojtje sociale

**Shtetet Palë e njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për një standard adekuat të jetesës për vete dhe familjet e tyre, duke përfshirë ushqimin adekuat, veshmbathjen dhe strehimin, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës, prandaj do të ndërmarrin hapat e duhur për të mbrojtur dhe promovuar realizimin e kësaj të drejte pa diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar. 2. Shtetet Palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për mbrojtje sociale dhe gëzimin e kësaj të drejte pa diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar dhe do të marrin masat e duhura për të mbrojtur dhe promovuar realizimin e kësaj të drejte, duke përfshirë masat: a) Për të siguruar qasje të barabartë të personave me aftësi të kufizuara në shërbimet e ujit të pastër dhe për të siguruar qasje në shërbime të përshtatshme dhe të përballeshme, pajisje dhe asistencë tjetër për nevojat në lidhje me aftësinë e kufizuar; (b) Për të siguruar qasje për personat me aftësi të kufizuara, në veçanti gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar me aftësi të kufizuara, në programet e mbrojtjes sociale dhe programet për zvogëlimin e varfërisë; (c) Për të siguruar qasje për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre që jetojnë në situata të varfërisë në ndihmë nga Shteti me shpenzimet e lidhura me aftësinë e kufizuar, duke përfshirë trajnimin adekuat, këshillimin, ndihmën financiare dhe kujdesin për pushim; (d) Për të siguruar qasje për personat me aftësi të kufizuara në programet e strehimit publik; (e) Për të siguruar qasje të barabartë për personat me aftësi të kufizuara në përfitimet e pensionit dhe programeve. - KDPAK Neni 28**

Në Kosovë, Qendrat për Punë Sociale mbajnë peshën kryesore të përgjegjësisë në lidhje me identifikimin e personave që kanë nevojë për mbrojtje sociale, qoftë të përhershme apo të përkohshme, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara. Puna Sociale është një profesion relativisht i ri në Kosovë, edhe pse një profesion i ngjashëm ka ekzistuar gjatë periudhës së sistemit Jugosllav, edhe pse me një profil të punës shumë të ndryshëm. Sipas informatave të grumbulluara në intervistat me informantët kyç dhe diskutimet me fokus grupe, në Kosovë ekzistojnë rreth 2,600 familje që marrin një lloj përfitimi social, duke përfshirë mbështetjen e punës sociale, me rreth 1,700 në komunën e Prishtinës, ku Qendra për Punë Sociale ka ekzistuar që nga viti 1999. Punonjësit socialë janë përgjegjës për 46 lloje të ndryshme të klientëve, nga të cilët fëmijët me aftësi të kufizuara janë vetëm një prej tyre. Disa nga shërbimet që ata duhet të japin përfshijnë mbështetjen e adoptimit, strehimit familjar, hetimi i rasteve të dhunës në familje, shërbimet për fëmijët në situatë rruge , etj.

Duke u fokusuar në punën sociale të përqendruar tek fëmijët me aftësi të kufizuara, është e rëndësishme të theksohet se përderisa profili i punës i një punonjësi social përfshinë një pjesë të mirë të informimit dhe referimit në shërbime, mungesa e burimeve financiare për të udhëtuar nëpër komuna dhe për të kryer vizitat në shtëpi, të kombinuara me mungesën e kapaciteteve teknike për identifikimin dhe referimin e fëmijëve në rrezik të aftësisë së kufizuar ose vonesave në zhvillim, janë theksuar si sfiduese. Megjithatë, përkundër faktit që Qendrat për Punë Sociale nuk kanë kushtet e nevojshme për të përmbushur pritjet e tyre, QPS (dhe punonjësit socialë personalisht) janë të ngarkuar me përgjegjësi të mbrojtësit që ndikon shumë në jetën e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Siç raportohet nga Komisioni i Vlerësimit në MPMS i cili është përgjegjës për përcaktimin e të drejtës për t'u kualifikuar në statusin e "Aftësisë së kufizuar të Përhershme», vetëm fëmijët të cilët janë konstatuar të kenë një dëmtim mjekësor dhe kanë paraqitur një aplikacion në QPS, mund të dalin para Komisionit. Përveç kësaj, Punonjësi Social që inicion një rast në nivel komunal është gjithashtu përgjegjës për kompletimin e pjesës psiko-sociale të vlerësimit bio-psiko-social që aktualisht është paraparë në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, edhe pse nuk ka dëshmi të mbledhura për këtë studim se çfarë përfshin ky proces.

Punonjësit socialë duhet të jenë në gjendje të identifikojnë fëmijët që kanë nevojë për vlerësim të mëtejshëm ose përcjellje për trajtim mjekësor, të sigurojnë/ofrojnë referimin në shërbimet e duhura, të mbajnë lidhjet me shkollat dhe komunitetet, të rivlerësojnë rastet ekzistuese, të bashkëpunojnë me MPMS, MSH, MASHT dhe të tjerët sipas nevojës, dhe të këshillojnë familjet kur/nëse një vendim është kontestuar. Përveç kësaj, siç raportohet nga QPS në Prishtinë, puna e PS nuk përfundon me konstatimin e përmbushjes së kriterëve. Edhe në rastet kur fëmijët nuk konstatohen se përmbushin kriteret për ndihmë në para, fëmijët dhe familjet ende do të kenë nevoja që duhet të plotësohen dhe kërkohet përcjellja e tyre. Ngritja e kapaciteteve të stafit, duke përfshirë strategjitë e komunikimit për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, janë më se të nevojshme brenda komunës.

*Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare i vitit 2005<sup>85</sup>* rregullon ofrimin e shërbimeve për personat dhe familjet në nevojë për mbështetje dhe personat në nevojë janë, ndër të tjera, "fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët me sjellje antisociale, (...) sëmundje fizike ose aftësi të kufizuara (...), aftësi të kufizuara mendore" – (Neni 1-1.3). Kjo përcakton sjelljen dhe përgjegjësitë e Qendrave Komunale për Punë Sociale, duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë e secilit në përcaktimin se kush ka nevojë dhe të drejtë të përfitoj nga asistenca. Interesi më i mirë i fëmijës rregullon të gjitha përcaktimet lidhur me fëmijët dhe familjet e tyre. Familjet dhe fëmijët që kanë nevojë për përkrahje duhet të regjistrohen në nivel komunal, të vizitohen periodikisht nga një Punonjës Social dhe, kur është e nevojshme, Qendra për Punë Sociale mund të veprojnë si kujdestar i një fëmije. Ndryshimi i ligjit në vitin 2012<sup>86</sup> përfshin licensimin e OJQ-ve që mund të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Në përgjithësi, ndryshimet janë kryesisht administrative, edhe pse ekziston një shtesë e dispozitave për "fëmijët me sjellje asociale".

Përderisa pjesa më e madhe e punës në lidhje me mbrojtjen sociale bie mbi Qendrat e Punës Sociale<sup>87</sup>, duhet thënë se mungesa e burimeve njerëzore të cilët janë në gjendje të adresojnë siç duhet gjendjen e vështirë të fëmijëve me aftësi të kufizuara

është raportuar si një sfidë kryesore që nga miratimi i ligjit. Në vitin 2013, një raport i UNICEF-it tregoi "(...) mungesa të konsiderueshme të personelit të trajnuar dhe mungesa e trajnimit në fushën e aftësisë së kufizuar. Përveç promovimit të strehimit të duhur familjar për një numër të vogël fëmijësh me aftësi të kufizuara, përshtypja është se pak ishte duke u bërë për të ndihmuar fëmijët me aftësi të kufizuara. Me pesëdhjetë e katër kategori të ndryshme të personave që ndihmohen nga Qendra e Punës Sociale, nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë prioritet të ulët. Megjithatë, Qendra për Punë Sociale është në procesin e krijimit të një ekipi të ri psikologësh, të cilët mund të jenë në gjendje të ndihmojnë familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara. Për më tepër, me kërkesat e reja për akreditim, plani është që të gjithë Punonjësit Social të Komunitetit të ri-licencohen gjatë pesë viteve të ardhshme"<sup>88</sup>. Po ashtu, raporti për vitin 2014<sup>89</sup> tregoi "një mungesë të madhe në disponueshmërinë e stafit të punës sociale, për arritjen e një shërbimi cilësor. Të gjitha fushat e punës ishin nën presion, por në veçanti, mbrojtja e fëmijëve, drejtësia për të mitur dhe rastet e dhunës familjare/gjinore"<sup>90</sup>. Përderisa përgjegjësia financiare bie brenda komunave, Drejtorët e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nuk mund ta kuptojnë ose vlerësojnë plotësisht rolin e punonjësve socialë brenda sistemit, gjë që çon në pakësimin e burimeve në shumë komuna. Burimet njerëzore, financiare dhe materiale janë të pakta dhe raporti i njëjtë tregoi se natyra dhe shtrirja e kualifikimeve të punonjësve socialë ishte e papërcaktuar. "Përveç punës së QPS-ve, një numër i OJQ-ve ofrojnë shërbime specifike për punë sociale, kryesisht në fushën e punës me fëmijët dhe familjet. Këto shërbime lidhen me zhvillimin e politikës dhe praktikës, dhe disa ndërhyrjeve të veçanta të punës sociale, veçanërisht përkujdesja rezidenciale për fëmijët. OJQ-të gjithashtu përfshihen në trajnimin e stafit të tyre dhe stafit të përfshirë në zhvillimet e praktikës. Shumë nga OJQ-të që aktualisht veprojnë në Kosovë janë të informuara nga përvoja individuale dhe kolektive e punës sociale në vende të tjera në Evropë. Rrjedhimisht stafi i OJQ-ve ka një vizion për punën sociale që ndryshon nga ai që mbahet brenda komunave dhe brenda ministrive përkatëse"<sup>91</sup>. Prindërit gjithashtu kanë pikëpamje të ndryshme se çfarë duhet të jetë roli i një punonjësi social, në krahasim me përvojat e tyre: "**Punonjësit socialë janë shumë të pasjellshëm nëse/ kur ata vijnë për monitorimin e Fëmijëve me aftësi të kufizuara që janë në skemën e ndihmës sociale, ata më detyruan të tërheqë zvarrë mbesën time nga karroca e saj për t'i bindur se nuk mund të qëndrojnë në këmbë të saja**" (gjyshja/kujdestare, Prizren).

*Ligji nr. 4/L131 për Skemat Pensionale të Financuara nga shteti*<sup>92</sup> rregullon pensionet e ndryshme, duke përfshirë pensionet për "aftësi të kufizuar të përhershme" dhe "paaftësi për punë". Siç tregon titulli, i pari i paguhet personave që konsiderohen se kanë aftësi të kufizuara të përhershme sipas "vendimit të organit përkatës të Ministrisë" dhe i dyti "personave që pësojnë lëndime në punë ose marrin sëmundje profesionale gjatë marrëdhënies së punës, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë ligj dhe invalidët e punës "(Neni 3). Përderisa pensioni për "aftësi të kufizuara të përhershme" i paguhet një qytetari midis moshës 18 dhe 65 vjeç (duke përjashtuar kështu fëmijët), "pensioni i paaftësisë për punë" duhet t'u paguhet qytetarëve nën moshën gjashtëdhjetë e pesë vjeç të cilët kanë qenë marrës të një pensioni të paaftësisë për punë sipas një ligji më të vjetër. Kështu, duke qenë i lidhur me punën, kjo përjashton gjithashtu fëmijët (ose familjet e tyre) nga skema e pensioneve.

*Ligji Nr. 2003/15 mbi Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë*<sup>93</sup> rregullon asistencën sociale në formën e një pagese financiare për familjet në rrezik. Në kohën e zhvillimit



të ligjit, pagesat ishin deri në 75 euro ose aq të vogla sa 35 euro në muaj për familje. Familjet që plotësojnë kriteret për asistencë sociale mund të përfshijnë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe e konsiderojnë një kujdestar të një personi me paaftësi të përhershme si të papunësueshëm (kështu që llogaritet si një person i varur i cili i plotëson kriteret). Megjithatë, një person me paaftësi që merr një pension invalidor nuk llogaritet si anëtar i varur i familjes për qëllim të llogaritjes së shumës së parave për t'u paguar (ndërsa një person me paaftësi për shkak të lëndimit të luftës - invalid i luftës - llogaritet si një person i varur). Pas vendimit të MPMS-së për të rritur përfitimet e asistencës sociale për 25% nga nëntori 2015, siç raportohet, pagesat e asistencës sociale mund të jenë nga 50 euro deri në 150 euro në muaj për familje, si më janar 2017.

Sipas Ligjit Nr. 03/L-022 për *Përkrahje Materiale për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme*<sup>94</sup>, që synon mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, përkrahja materiale ofrohet për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, për t'u mundësuar atyre "të jetojnë një jetë më normale në kushte që garantojnë dinjitetin e tyre dhe bëjnë jetën e tyre më të lehtë" (Neni 3). Një kompensim në para i jepet prindërve biologjik ose kujdestarit të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme (procedurat e identifikimit dhe vlerësimit më lart). Në vitin 2010, ligji u plotësua<sup>95</sup> me udhëzime se si të ri-dorëzohet një kërkesë. Në vitin 2014, një Udhëzim Administrativ<sup>96</sup> u miratua për të sqaruar rregullat për ri-aplikim, si dhe për identifikimin dhe eliminimin e mashtrimit.

*Ligji nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 mbi Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë*<sup>97</sup>, përpunon rregulloret e ligjit origjinal, përcakton përgjegjësitë brenda menaxherëve komunal të rasteve dhe shtrin mbulimin për familjet me fëmijë të vegjël (nën 5 vjeç) ose fëmijë jetim nën moshën 15 vjeç. Megjithatë, ndryshimet dhe plotësimet nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme situatën e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara.

Përkundër ligjeve të lartpërmendura, masat e mbrojtjes sociale të përshkruara në Strategjinë Nacionale për Personat me Aftësi të Kufizuara (SNPAK) nuk marrin në konsideratë nënkategoritë e ndryshme të popullsisë së personave me aftësi të kufizuara. Së pari, nuk merren në konsideratë nevojat e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara që shpesh jetojnë nën vijën e varfërisë për shkak të shpenzimeve të ndryshme (d.m.th shërbimet e specializuara mjekësore, teknologjia ndihmëse, kujdesi për fëmijët jo ambulantë, humbja e të ardhurave) që nuk mund të tejkalohet pavarësisht nga statusi i punësimit të prindërve<sup>98</sup>. E dyta, nuk merr në konsideratë dhe popullatën e moshuar të personave me aftësi të kufizuara, të cilët për shkak të moshës së tyre dhe mungesës së arsimimit dhe trajnimit përkatës, nuk janë në gjendje t'i bashkëngjiten fuqisë punëtore. E treta, duke vendosur barrën e masave të mbrojtjes sociale mbi punësueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, objektivi strategjik i SNPAK nuk arrin të njohë përgjegjësinë e qeverisë ndaj një prej popullsisë më të cënueshme të saj: fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët aktualisht nuk janë duke u përgatitur të hyjnë në një fuqi punëtore relevante, tani ose në të ardhmen e afërt.

Ndihma specifike prej €100 në muaj për familjet e fëmijëve të moshës 0-18 vjeç me aftësi të kufizuara të përhershme u prezantua në vitin 2009. Megjithatë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka pasur vështirësi për të financuar këtë skemë,<sup>99</sup> pasi



që duket se kriteri i përzgjedhjes është shumë i rreptë: “Fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme fizike, mendore dhe shqisore” janë ata “të cilët janë tërësisht të paaftë për të kryer aktivitete të jetës së përditshme pa kujdesin e personit tjetër”.<sup>100</sup> Ndërkohë, sapo fëmija të mbushë 18 vjeç, pagesa zvogëlohet në € 65, përfitimi standard për të rriturit.<sup>101</sup>




Figura 1: Familjet që marrin përfitime për fëmijët me nevoja të veçanta, 2014-2015, sipas tremujorit

Sipas HandiKOS, në vitin 2013, “Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka mbështetur 2,985 familje të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme (mosha 1-18 vjeç) me skemën e asistencës sociale prej 100 euro në muaj dhe 17,000 persona me aftësi të kufizuara (18-65 vjeç) përmes skemës së pensionit prej 60 euro në muaj”<sup>102</sup>. Megjithatë, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të intervistuar në të njëjtin vit, raportuan se edhe pse ata ishin “mirënjohës për programin e ndihmës në para të ofruar nga qeveria, ata gjithashtu shprehën frustrimin se një ndihmë e tillë ofrohej vetëm në rastet e ‘aftësisë së kufizuar të përhershme’. Një nënë theksoi se duhej të prisnin dy vjet për të marrë një karrocë që do t’i mundësonte të dërgonte vajzën e saj në shkollën e rregullt. Çfarëdo mbështetje që ata kanë marrë nga institucionet në aspektin e ndihmës sociale është konsideruar si joadekuate”<sup>103</sup>.

Numri i familjeve që marrin përfitime ka rënë në vitet e fundit. Në fund të vitit 2015, vetëm 2.528 familje përmbushnin kriteret. Ndërmjet tremujorit të tretë dhe katërt të vitit 2015, numri i familjeve ra për 217: vetëm në Prishtinë ra nga 280 në 95.<sup>104</sup> 2,528 familjet do të thotë më pak se gjysma e 6,172 fëmijëve të regjistruar me nevoja të veçanta në sistemin arsimor në fillim të vitit shkollor 2015-16.<sup>105</sup> Në vitin 2014, sipas OJQ-së PEMA<sup>106</sup>, vetëm 2,898 fëmijë kanë përfituar nga kjo asistencë financiare në tërë Kosovën. Megjithatë, sipas të njëjtit burim, “janë rreth 20,000 fëmijë me aftësi të kufizuara në Kosovë që vuajnë nga përjashtimi social dhe/ose neglizhimi në jetën e tyre të përditshme, duke i shtyrë ata më tej në marginalizim social, ekonomik dhe politik. Këta fëmijë kanë nevojë për përkrahje dhe kujdes të specializuar për t’i ndihmuar të arrijnë potencialin e tyre dhe të zhvillojnë jetë më të përmbushura”<sup>107</sup>.

Sipas të dhënave të grumbulluara në DFG-të të organizuara për këtë studim, 39 prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara (nga 59) raportuan se marrin ndihmë në

para sipas dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-022. Dhe, ndërkohë që asistencë në para konsiderohet kryesisht joadekuate duke marrë parasysh shërbimet e nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, kjo është një çështje debati ndërmjet të gjithë prindërve të intervistuar. Ndërsa, nga njëra anë, shuma prej 100 euro, siç thuhet, nuk është e mjaftueshme për të mbuluar nevojat e fëmijëve, nga ana tjetër, është e nevojshme për të kompensuar shpenzimet në familjet tashmë të mbingarkuara nga kushtet e këqija, pasi shumica e familjeve raportuan se jetojnë në kushte të vështira ekonomike. Në Prishtinë, disa familje raportojnë se mbijetojnë nga bamirësia e anëtarëve të familjes që jetojnë jashtë vendit, ndërsa në Mitrovicën e Veriut, 7 nga 9 nënat që morën pjesë në DFG-të ishin të pa-punësuar dhe një tjetër kërkoi ndryshim në turnin/ndërrimin e saj të punës në mënyrë që të mund të jetë në shtëpi kur fëmija i saj është në shtëpi. Gjashtë (6) familje në Ferizaj ishin këmbëngulëse në raportimin se nuk marrin asistencë në para, sepse edhe pse fëmijët e tyre kanë një aftësi të kufizuar, ajo nuk konsiderohet si “e përhershme”. Një prind kujdestar raportoi se merrte 250 euro ndihmë në para për fëmijën me aftësi të kufizuara për të cilin ishte kujdestar.

Në Prizren, një gjyshe (që kujdeset për 4 nipërit e saj) ka përmendur se përkundër kushteve të saj shumë të këqija ajo u përpoq të dërgonte mbesën e saj për trajtim gjithandej në vend, pasi ajo as që mund ta marr me mend se do të ishte në gjendje ta dërgonte jashtë vendit pa ndonjë mbështetje institucionale. Para se mbesa e saj të mbushte 18 vjet, familja merrte 100 euro si përfitim në të holla nga skema e ndihmës sociale, **“e cila nuk është e mjaftueshme as për të paguar për pelenat e saj”**. Tani që vajza ka mbushur 18 vjet, ajo është transferuar në një skemë tjetër pensionale që siguron një pension mujor prej 75 eurosh. **“Çfarë lloj ligji është ky? Kjo është kundër çdo të drejte të njeriut pasi mezi mund t’ia dilnim me 100 Euro ... tani çfarë mund të bëjmë me 75 Euro?”** Gjyshja më tej përmendi se ata janë të privuar nga përfitimi nga skema të tjera të asistencës sociale edhe pse ata mund të kualifikoheshin për shkak të kushteve të vështira në të cilat jetojnë. Vajza ishte operuar 14 herë në spitalet shtetërore, por pa ndonjë rezultat. Ajo përmendi më tej për kohërat e vështira që kishin kur ajo duhej ta dërgonte mbesën e saj (me autobus) në Pejë për një operacion pasi që ajo nuk mund të përballonte një transport më të rehatshëm. Ajo më tej deklaroi se ajo mund të bënte çdo gjë për ta trajtuar atë, por ata kanë humbur besimin se shëndeti i saj mund të përmirësohet. **“I lutem zotit për këtë fëmijë sa herë që vë atë në shtrat dhe kam frikë se çfarë do të ndodhë me të kur unë të vdes”**.

Mospërputhje të mëtejshme konstatohen nëse krahasohen rajonet/rrethet që janë me shumicë serbe me pjesët e tjera të vendit, ose kur krahasohen përfitimet sipas llojeve të dëmtimeve. Për shembull, në veri të Mitrovicës, të gjithë prindërit që morën pjesë në DFG-të raportuan se merrnin ndihmë prej 100 euro për fëmijët me aftësi të kufizuara nga qeveria e Kosovës, por gjithashtu merrnin 65 euro nga qeveria serbe, pavarësisht se sa i vështirë dhe i dhimbshëm mund të jetë procesi. Siç raportoi një nënë: **“U deshën dy vjet që fëmija im të bindte Panelin e Vlerësimit Shëndetësor që të kualifikohej për skemën e ndihmës në para, me arsyetimin se aftësia e kufizuar e fëmijës së saj nuk ishte e mjaftueshme për të përfituar nga skema”**. Në veri të Mitrovicës, siç raportohet, ndihma në para jepet po ashtu edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda dhe për nivele të tjera të aftësisë së kufizuar në varësi të situatës. Asistencë ndryshon ndërmjet 40 dhe 120 euro në muaj, edhe pse fëmijët e verbër mund të marrin një bursë prej 250 euro në muaj. Nëse ndjekin shkollën, përfitimet në para mund të paguhet deri në moshën 26 vjeçare. Sipas përfaqësuesit të Qendrës

për Punë Sociale në veri të Mitrovicës, i cili ka marrë pjesë në DFG-të, përveç një përfitimi në të holla për një fëmijë me aftësi të kufizuara të rënda nga qeveria serbe, familja gjithashtu merr një pagesë për fëmijë prej 70 euro në muaj (që u jepet të gjithë fëmijëve deri në moshën 18 vjeçare) dhe fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet mund të përfitojnë edhe nga pagesat në të holla të ofruara nga institucionet e Kosovës siç janë përfitimet në të holla të paguara familjeve me fëmijë me paftësi të përhershme.

Në anën tjetër, në Prishtinë, prindi i një fëmije me aftësi të kufizuara të shumëfishta njoftoi se ai kishte hequr dorë nga aplikimi për 100 euro ndihmë dhe në vend të kësaj po aplikonte për 250 euro që ofrohet nëse një fëmijë është i verbër. Sipas raportit të tij, QPS nuk ishte e kënaqur me vendimin e tij dhe ishte jo bashkëpunuese deri në atë pikë sa kërcënoi këtë baba me padi në gjykatë nëse ai këmbëngulte. **“Ai donte të më padiste në gjykatë për “mashttrim” sepse kërkova të heq dorë nga ndihma prej 100 euro që vajza ime merrte nga skema e asistencës për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe të aplikoj për asistencën tjetër për personat e verbër, sepse ishte më e dobishme për vajzën time. Punonjësi social shkoi aq larg, sa që ai donte të më kërkonte nëpërmjet gjykatës, të ktheja të gjitha paratë që vajza ime kishte marrë deri më tani para se të aplikonim për skemën e re të asistencës. Më është dashur të përfshija njerëz të tjerë për t’ia shpjeguar atij situatën dhe të drejtën tonë për të bërë zgjedhjen më të mirë që është e ligjshme për rastin e vajzës sime dhe ai ndaloi këtë ide të pakuptimtë “(baba, Prishtinë).**

Në fund, përfaqësuesi ligjor për HandiKOS raportoi se gjatë viteve të fundit, personave u është ndaluar të kërkojnë përfitime nga dy ose më shumë skema të asistencës, e cila është gjithashtu diskriminuese. Për shembull, njerëzve të verbër nuk u lejohej (nga Ligji për Personat e Verbër) të përfitojnë nga burime të tjera shtetërore, nëse ata tashmë përfitojnë nga kjo skemë e asistencës. Megjithatë, ka persona të verbër që kanë punuar para se të bëhen të verbër, ishin kontribuues tatimorë dhe pensional dhe duhet të jenë në gjendje të kërkojnë të drejtat e tyre. Në Gjakovë, një nënë deklaroi se fëmija i saj merr ndihmë vetëm për shkak të verbërisë së tij edhe pse ai ka aftësi të kufizuara të shumëfishta/komplekse.

Siç mund të shihet më lartë dhe konfirmuar nga shumë akterët e intervistuar për këtë studim, ofrimi i shërbimeve bëhet pothuajse ekskluzivisht nga OJQ-të siç janë HandiKOS, Caritas dhe disa të tjera. Familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara, shoqëria civile dhe zyrtarët qeveritarë të gjithë konsiderojnë OJQ-të si pikat kryesore të referimit për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, pavarësisht faktit se ato veprojnë me buxhete shumë të vogla, afatshkurtra, dhe të bazuara në projekte. Të gjithë të intervistuarit deklarojnë se OJQ-të janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, pavarësisht se kjo është përgjegjësi e qeverisjes lokale<sup>108</sup> – për të siguruar mbrojtjen sociale të të gjithë qytetarëve të saj.

Hulumtimet e mëparshme të kryera në Mitrovicën e Veriut raportojnë <sup>109</sup> rrethana të ngjashme. Përderisa ekziston një mungesë e dukshme e shërbimeve sociale sidomos kur është fjala për fëmijët, Qendra për Rehabilitimin Bazë e financuar nga një OJQ, ofron shërbime për rreth 60 fëmijë. Interpretimi i gjuhës së shenjave ofrohet përmes Shoqatës Ndër-Komunale të të Shurdhërve dhe me Vështirësi në Dëgjim, por nuk ekzistojnë shërbimet mbështetëse të jetesës, transportimit të fëmijëve me aftësi

të kufizuara dhe të asistentit personal. Po ashtu, Rrjeti i Vëzhguesve të të Drejtave gjithashtu raporton se rreth 40% e të gjithë të anketuarve janë duke përdorur shërbime institucionale. Prej tyre, 85% e të anketuarve janë plotësisht ose pjesërisht të kënaqur me shërbimet, por shumica e prindërve kanë raportuar se “ kanë hasur në vështirësi ose pamundësi për të realizuar të gjitha format e mbështetjes së parashikuar (...), si dhe vështirësi në ofrimin e shërbimeve të cilat tashmë janë krijuar në atë zonë, por për të cilat ka kapacitete të pamjaftueshme “.

Profesionistët mjekësorë, punonjësit social, mësuesit dhe zyrtarët e shkollave, si dhe ndarja e informatave në mënyrë jo-formale midis prindërve dhe familjeve shpesh i referojnë fëmijët me aftësi të kufizuara në njërin nga OJQ-të më të afërta për fëmijët që kanë nevojë për shërbime, pavarësisht nga nevoja/fuqia e identifikuar e fëmijës, me disa përjashtime: fëmijët me dëmtime shikimi zakonisht referohen në Shoqatën e të Verbërve të Kosovës ose shkollën speciale për të verbrit në Pejë, ndërsa fëmijët që janë të shurdhër apo kanë vështirësi në dëgjim referohen në Shoqatën e të Shurdhërve të Kosovës ose shkollën speciale për të shurdhërit në Prizren. Fëmijët që perceptohen të kenë një dëmtim fizik, ose një aftësi të kufizuar komplekse ose të rëndë, zakonisht referohen në HandiKOS që shpesh duhet t’i referojë tutje diku tjetër, për shkak të mungesës së kapacitetit teknik dhe burimeve për të ofruar shërbime shumë të specializuara për fëmijët me dëmtime komplekse dhe shpesh me nevoja komplekse. Fëmijët të cilët identifikohen të kenë një dëmtim intelektual në lidhje me Sindromën Down, zakonisht referohen në Down Syndrome Kosova, ndërsa shumica e fëmijëve me një dëmtim intelektual kompleks zakonisht referohen në Qendrën për Shëndetin Mendor të Fëmijëve dhe Adolehentëve në Spitalin Universitar. Shumica e shërbimeve ofrohen ad-hoc, pa një vlerësim të duhur apo plan përcjellës për intervenim.

### Theksi mbi fëmijët rom dhe ashkali me aftësi të kufizuara

Nëntë (9) fëmijë ashkali (5 vajza dhe 4 djem) dhe 6 fëmijë rom (3 vajza dhe 3 djem) me aftësi të kufizuara morën pjesë në DFG-të në 2 komunitete romë dhe ashkali. Nuk pati pjesëmarrës nga komuniteti egjiptian. Nga 15 fëmijët, 12 fëmijë vijnë nga zonat urbane dhe 3 nga zonat rurale. Fëmijët ishin të grupmoshave të ndryshme. Fëmija më i vogël ishte 3 vjeç dhe më i madhi ishte 14 vjeç. Vetëm dy fëmijë të komunitetit ashkali mund të merrnin pjesë në mënyrë të pavarur, sepse ata ose kishin vështirësi në të folur ose ishin tepër të turpshëm për të komunikuar. Për fëmijët e tjerë u mblodhën informatat nga prindërit e tyre që i shoqëruan ata në DFG. 2 nga fëmijët rom nuk mund të komunikonin vetë dhe informacioni u mor nëpërmjet kujdestarëve. Fëmijët kishin lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar, disa të rënda dhe komplekse. Fëmijët vijnë nga familje të mëdha, zakonisht me 3 deri në 9 fëmijë. 9 fëmijët ashkali morën pjesë në DFG-të me kujdestarët e tyre, të cilat që të gjitha ishin nëna dhe të gjitha e flisnin rrjedhshëm gjuhën shqipe. 7 kujdestarë morën pjesë në DFG-të me fëmijët rom. Tri ishin nëna, një baba, një gjyshe dhe dy vëllezër e motra. Ata që mund të komunikonin flisnin gjuhën romë, me shumë pak përdorim të gjuhës serbe.

Të gjithë fëmijët vijnë nga familje shumë të varfra. Në të dy komunitetet, nënat ishin të papuna (dhe shumica e nënave nuk mund të lexonin ose të shkruanin) dhe baballarët punonin kohë pas kohe me të ardhura jo të rregullta, kryesisht

duke bërë punë fizike. Nënata nga komuniteti ashkali raportuan se ndonjëherë i ndihmojnë burrat e tyre të mbledhin shishe dhe kanaçe nga kontejnerët e plehrave. Familjet e komunitetit ashkali kanë raportuar se kanë të instaluar sistemin e furnizimit me ujë dhe kanalizim në shtëpi, por jo furnizim të rregullt me ujë, ndërsa familjet romë kanë raportuar se nuk kanë furnizim me ujë dhe nuk kanë kanalizim. Ndërsa shumica e familjeve të komunitetit ashkali jetojnë në asistencë sociale minimale, fëmijët romë raportuan se ndonjëherë nuk kanë ushqim të mjaftueshëm për të ngrënë. Një nga kujdestarët (gjyshja) raportoi se askush nuk po mbështet komunitetin romë, duke përfshirë edhe ata që jetojnë në varfëri të skajshme. Ata përpiqen të mbështesin njëri-tjetrin brenda komunitetit, por kjo nuk është e mjaftueshme pasi të gjithë përpiqen të mbijetojnë për vete. Ajo më tej kërkoi nga udhëheqësit e DFG të përcjellin mesazhin tek autoritetet që duhet të dërgojnë të paktën disa paketa urgjente me ushqim dhe higjienë bazike për ata që jetojnë në varfëri të skajshme.

Shumica e prindërve, si të fëmijëve ashkali ashtu dhe atyre romë, raportuan se asnjëherë nuk janë vizituar nga asnjë punonjës social, as nuk e dinë se ku është Qendra për Punë Sociale, përveç atyre prindërve që kanë marrë përfitime për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe kanë vizita periodike për rivlerësim. Vetëm dy familje marrin përfitim në para të lidhur me aftësinë e kufizuar (verbëri), një në komunitetin ashkali dhe një në komunitetin romë. Një nënë e komunitetit ashkali raportoi se ajo aplikoi dy herë për këtë skemë dhe u refuzua pa ndonjë justifikim. Megjithatë, shumica e kujdestarëve nuk ishin në dijeni të skemës së përfitimit për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme dhe nuk kishin dijeni se si të aplikonin ose si të përgatisin dokumentacionin. Kur u pyetën për të drejtat e tyre më gjerësisht dhe ato të fëmijëve, prindërit raportuan se nuk dinin se cilat janë të drejtat e tyre. Disa prindër romë marrin ndihmë sociale në lidhje me papunësinë dhe ndihmat për fëmijë, edhe pse nuk ishte e qartë se nga cilat institucione e pranojnë atë, por nuk ishin plotësisht të informuar për të gjitha mundësitë e mbështetjes materiale brenda institucioneve të Kosovës, veçanërisht në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara. Një nga kujdestarët romë që është me aftësi të kufizuara dhe një baba i vetëm, raportoi se ai është përgjegjës për 7 anëtarë në familjen e tyre, asnjëri prej tyre i punësuar dhe pa ujë ose kanalizim në shtëpinë e tyre.

7 nga 9 fëmijët e komunitetit ashkali në DFG janë krejtësisht të varur nga nënat e tyre për nevojat themelore siç janë ngrënia dhe përdorimi i tualetit. Situata familjare e fëmijëve romë ishte dukshëm ndryshe nga ajo e atyre ashkali, pasi 2 nga 6 familjet ishin shtëpi me prindër të vetëm. Në një rast, dy fëmijë jetojnë me prindër të ndarë. Në rastin tjetër, kujdestari është një baba (i shurdhër) që kujdeset për tre djem, 2 prej të cilëve kanë aftësi të kufizuara. Një fëmijë ka një dëmtim intelektual dhe tjetri një dëmtim fizik për shkak të djegieve në trup që kishte pësuar duke u përpjekur që të ngrohë veten pranë një zjarri. Nëna thuhet se braktisi familjen për shkak të sëmundjes dhe babai është i detyruar t'i lërë fëmijët vetëm në shtëpi kur ai ka punë. Mungesa e mbikëqyrjes së të rriturve mund të jetë gjithashtu shkak për një fëmijë tjetër që ka humbur një sy në një aksident me gërshërë. Një fëmijë me Sindromën Down ka lindur nga prindërit e shurdhër dhe ajo shpenzon shumicën e kohës me gjyshërit e saj.

## E drejta për masat e mbrojtjes së fëmijëve

Pjesa më poshtë përfshin të Drejtën e Lirisë nga Shfrytëzimi, Dhuna dhe Abuzimi - Neni 16, E drejta për jetesë të pavarur dhe përfshirje në komunitet - Neni 19 dhe e drejta për respektimin e shtëpisë dhe familjes - neni 23.

**Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura legislative, administrative, sociale, arsimore dhe masa të tjera për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara, brenda dhe jashtë shtëpisë, nga të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, përfshirë aspektet e tyre gjinore. (...) parandalojnë të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, duke siguruar, ndër të tjera, forma të përshtatshme të asistencës së ndjeshme ndaj gjinisë dhe moshës, si mbështetjen për personat me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre dhe kujdestarëve, duke përfshirë përmes ofrimit të informacionit dhe edukimit se si duhet shmangur, njohur dhe raportuar rastet e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit. Shtetet Palë do të sigurojnë që shërbimet e mbrojtjes janë të ndjeshme ndaj moshës, gjinisë dhe aftësisë së kufizuar. (...) promovojnë rimëkëmbjen fizike, kognitive dhe psikologjike, rehabilitimin dhe riintegrimin social të personave me aftësi të kufizuara, të cilët bëhen viktimat të çdo forme të shfrytëzimit, dhunës apo abuzimit, duke përfshirë përmes sigurimit të shërbimeve mbrojtëse. Ky shërim dhe ri-integrim duhet të ndodh në një mjedis që nxit shëndetin, mirëqenien, vetë-respektin, dinjitetin dhe autonominë e personit dhe merr parasysh nevojat specifike të gjinisë dhe moshës. 5. (...) vendosja e legjislacionit dhe politikave efektive, duke përfshirë legjislacionin dhe politikat e fokusuar për gratë dhe fëmijët, për të siguruar që rastet e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit ndaj personave me aftësi të kufizuara të identifikohen, hetohen dhe, kur është e përshtatshme, të ndiqen penalisht. - KDPAK Neni 16**

**Shtetet Palë në këtë Konventë njohin të drejtën e barabartë të të gjithë personave me aftësi të kufizuara për të jetuar në komunitet, me zgjedhje të barabarta me të tjerët dhe do të marrin masat e duhura dhe efektive për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht këtë të drejtë dhe përfshirjen e pjesëmarrjen e tyre të plotë në komunitet, përfshirë dhe duke u siguruar që: (a) Personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësinë për të zgjedhur vendbanimin e tyre, ku dhe me kë do të jetojnë, njësoj si të tjerët dhe të mos jenë të detyruar të jetojnë në një mënyrë të veçantë jetese; (b) Personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në një gamë të gjerë shërbimesh mbështetëse në shtëpi, shërbimesh rezidenciale dhe shërbimesh në komunitetet dhe të parandalojnë izolimin dhe veçimin e tyre nga komuniteti; (c) Shërbimet dhe objektet komunitare për popullatën në përgjithësi të jenë të disponueshme në baza të barabarta për personat me aftësi të kufizuara dhe t’ju përgjigjen nevojave të tyre. – DPAK Neni 19**

**Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për eliminimin e diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuar në lidhje me të gjitha çështjet lidhur me martesën, familjen, të qenit prindër dhe lidhjet, njësoj si gjithë të tjerët për të siguruar (...) Personat me aftësi të kufizuar, duke përfshirë fëmijët, ruajnë fertilitetin/(të drejtën për riprodhim) njësoj si gjithë të tjerët. (...)Shtetet Palë do të garantojnë që fëmijët me aftësi të kufizuar të gëzojnë të drejta të barabarta lidhur me jetën familjare. Me qëllim realizimin e këtyre të drejtave dhe për parandaluar fshehjen, braktisjen, neglizhimin**



dhe izolimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, Shtetet Palë do të garantojnë sigurimin e informacionit, shërbimeve dhe mbështetjes së hershme dhe të gjithanshme për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre. 4. Shtetet Palë do të garantojnë që fëmija të mos ndahet nga prindërit e tij/ saj kundër dëshirës së tij/saj, përveç atyre rasteve kur autoritetet kompetente sipas shqyrtimit gjyqësor përcaktojnë, në përputhje me ligjet dhe procedurat përkatëse, që një ndarje e tillë është e domosdoshme për interesin më të mirë të fëmijës. Në asnjë rast nuk do të ndahet një fëmijë nga prindërit për shkak të aftësisë së kufizuar të fëmijës apo aftësisë së kufizuar të njërit apo të dy prindërve. 5. Shtetet Palë, në rastet kur familja e afërt nuk është në gjendje të kujdeset për fëmijën me aftësi të kufizuara, do të bëjnë çdo përpjekje për të siguruar kujdes alternativ brenda familjes së zgjeruar, dhe në rast se një përpjekje e tillë dështon, brenda komunitetit në një ambient familjar. – DPAK Neni 23

Sipas *Indeksit për Mbrojtjen e Fëmijëve për Kosovën*<sup>110</sup>, rezultati “indeksi i cënueshmërisë së fëmijëve” për Kosovën<sup>111</sup> është 0,56 nga maksimumi 1,0. Ky rezultat e vendos Kosovën në pozitën e dytë midis 9 vendeve të rajonit, më poshtë se Serbia, por më lart se të gjitha vendet e tjera: Gjeorgjia (0,49), Bosnja dhe Hercegovina (0,47), Rumania (0,47), Bullgaria (0,40), Shqipëria (0,34), Moldavia (0,34) ose Armenia (0,26)<sup>112</sup>. Sa i përket rezultateve të mbrojtjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara, Kosova renditet e teta (e dyta nga fundi) nga të gjitha 9 vendet<sup>113</sup> në *Indeksin për Mbrojtjen e Fëmijëve*<sup>114</sup>. Rezultati më i lartë i Kosovës mbi aftësinë e kufizuar shfaqet në fushën e ligjit dhe politikës (0.688) ndërsa të gjitha fushat e tjera tregojnë rezultate dukshëm të ulëta. Megjithatë Kosova rezultoi në renditur relativisht lart kur është fjala për ligje dhe veprime politike për aftësinë e kufizuar (0.688), shërbimet (0.375), kapaciteti (0,100) dhe llogaridhënia e saj (0,167) janë në renditje dukshëm më të ulët. Mekanizmat e koordinimit, si ligji dhe politika, tregojnë për dispozitat e forta ligjore dhe rregullative të Kosovës (0.667)<sup>115</sup>.

Përderisa Kosova akoma nuk ka një Ligj për Mbrojtjen e Fëmijëve (shih më poshtë), sigurimi i të drejtave të fëmijëve në Kosovë, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe drejta për mbrojtjen e fëmijëve, janë të përkrahura në Strategjinë dhe Planin Nacional të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2009-2013<sup>116</sup>. Strategjia Kombëtare bazohet në parimet kryesore të KDF (mosdiskriminimi, pjesëmarrja e fëmijëve, potenciali i plotë i fëmijës dhe interesi më i mirë i fëmijës) dhe duhet të jetë e zbatueshme për të gjithë fëmijët, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara. Përderisa në vitin 2009 ishte progresiv, duke marrë parasysh që KDPAK u zhvillua rishtazi, dokumenti është disi i kufizuar në fushëveprim meqë parashikon që legjislacioni përkatës të garantojë të drejtat e “fëmijëve me aftësi të kufizuara ose të pjeshëm mendore apo fizike nga mosha 0 deri në 18 vjeç”<sup>117</sup>. Më tutje, përderisa parashikon nevojën për adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me arsimin, kujdesin shëndetësor, mirëqenien sociale dhe drejtësinë për të mitur për të gjithë fëmijët, dokumenti nuk adreson disa nga çështjet me prioritet të mbrojtjes së fëmijëve në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara, siç janë: liria nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi, jetesa e pavarur dhe e drejta për të jetuar në familje.

Llogaridhënia është një çështje që është trajtuar në mënyra të ndryshme, duke përfshirë diskutimet dhe veprimet që lidhen me natyrën ndër-sektoriale të mbrojtjes së fëmijëve dhe nevojën për veprime shumë sektoriale dhe veprime nga shumë

agjensione<sup>118&119</sup> që synojnë të sigurojnë mbrojtjen e të gjithë fëmijëve, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, që kanë çuar në krijimin e planeve dhe protokolleve përkatëse. Njëri ndër ta është *Protokolli i Punës: Bashkëpunimi Ndërsektorial në Rastet e Mbrojtjes së Fëmijëve*<sup>120</sup> që synon të "standardizojë, unifikojë dhe koordinojë punën e të gjitha agjencioneve që punojnë ose duhet të punojnë së bashku për të mbrojtur fëmijët"<sup>121</sup>. Meqenëse protokollin është krijuar mbi parimin e mbrojtjes për të gjithë fëmijët në rrezik, dhe vlerësimi i rrezikut përfshin cenueshmëri të ndryshme, Protokolli është gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara pavarësisht nga lloji i dëmtimit që ata mund të kenë.

Sipas Raportit Vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit të vitit 2015, ligji për mbrojtjen e fëmijëve është në hartim që nga viti 2013 dhe "duhet të pasohet me hartim dhe miratim më të shpejtë të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të drejtat e fëmijës për vitet 2016-2020. Procesi i hartimit të këtyre dokumenteve filloi pas vlerësimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijës (2009-2013), i përfunduar nga Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara (UNICEF) në pjesën e parë të 2015"<sup>122</sup>. Në të vërtetë, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve është i nevojshëm dhe ka qenë në hartim e sipër për disa kohë. Megjithatë, do të duhet të ri-dorëzohet nga Qeveria për rishikim, por në kohën e shkrimit të këtij raporti (drafti i parë) Kuvendi i Kosovës është shpërbërë (më 11 maj 2017) për shkak të shpalljes së zgjedhjeve të përgjithshme dhe ende nuk është konstituuar Kuvendi i ri. Të gjitha projektligjet që janë në proces të rishikimit në kohën e shpërbërjes konsiderohen si të papërfunduara nga legjislatura e ardhshme.

Në DFG-të e Mitrovicës së Veriut, në diskutime u theksuan shqetësimet lidhur me dhunën në familje. Punonjësit socialë raportuan se fëmijët me aftësi të kufizuara shpesh krijojnë një stres të shtuar për familjet e cenuara dhe çështja e divorcit midis prindërve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara nuk është trajtuar fare. Një punonjëse sociale, e cila është gjithashtu nënë e një fëmije me aftësi të kufizuara, tha: ***"Kam një fëmijë me aftësi të kufizuara dhe e kam dërguar gjithandej për trajtim. Në këtë rrugëtim, kam takuar shumë gra me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe pothuajse çdo e dyta nga to ishte e divorcuar si pasojë e mungesës së mbështetjes nga burrat e tyre dhe si pasojë e dhunës në shtëpi. Sipas mendimit tim, rreth 70% e martesave janë shpërbërë për shkak të aftësisë së kufizuar të një fëmije. Në shumicën e rasteve burrat heqin dorë nga përgjegjësitë e tyre"***

Siç raportohet nga ofruesit e shërbimeve në rajonin e Gjakovës, nuk ka programe sistematike të vizitave në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara. Profesionistët e QPS-së janë të detyruar të vizitojnë familjet që marrin ndihmë sociale një herë në 6 muaj, por nuk ekziston ofrimi i shërbimit në shtëpi. HandiKOS ofron disa shërbime të bazuara në shtëpi, të cilat gjatë periudhës raportuese janë duke u mbështetur nga Save the Children, por mbështetja nuk është e qëndrueshme. Përveç nëse institucionalizohet, ky lloj i mbështetjes nuk është i qëndrueshëm pasi që prioritetet e OJQ-ve dhe burimet financiare dhe njerëzore ka gjasa të ndryshojnë.

Ndryshe nga vendet e tjera në Ballkan, në institucione rezidenciale në Kosovë ka shumë pak njerëz (përfshirë fëmijët). Siç raportohet nga MPMS dhe SOS Fshati i Fëmijëve në Prishtinë, SOS Fshati i Fëmijëve është i vetmi program i akredituar në Kosovë për t'u kujdesur për fëmijët e braktisur nga familjet e tyre, si dhe për mbështetjen e familjeve

që janë në rrezik të braktisjes. Në kohën e intervistës dhe vizitës në vend, nga 13 fëmijë nën moshën 3 vjeç, vetëm një ishte fëmijë me aftësi të kufizuara. Në shtëpitë e kujdesit të bazuar në familje, ku ofrohet kujdes për fëmijët e moshës mbi 4 vjeç, nga rreth 40 fëmijë, 6 janë fëmijë me aftësi të kufizuara. Të gjithë fëmijët ndjekin shkollën rregullisht dhe vetëm një herë kanë pasur rastin e një fëmije që përkohësisht është “përrjashtuar” nga shkolla për shkak të vështirësive akademike. SOS Fshati i Fëmijëve punëson profesionistë të kualifikuar, si psikologë, pedagogë, punonjës socialë dhe të tjerë për të mbështetur fëmijët në kujdesin e tyre dhe familjet që marrin pjesë në shërbimet këshilluese.

Drejtori i Institutit Special në Shtime tha se nuk ka fëmijë me aftësi të kufizuara të vendosur në institutin e tyre, por ai e di se ekziston një qendër e përditshme e kujdesit ku janë vendosur rreth 10 fëmijë me **“vonesa të rënda mendore”**. Sipas njohurive të tij, sa i përket institucioneve në komunë, nuk ka staf të specializuar për ofrimin e shërbimeve dhe as nuk dinë të merren me fëmijët me aftësi të kufizuara. **“Mendoj se duhet të ketë një Kornizë Kombëtare për të siguruar udhëzime, obligime, përgjegjësi dhe llogaridhënie të qartë për mënyrën e trajtimit të këtyre kategorive të fëmijëve, pasi gjërat nuk do të funksionojnë për aq kohë sa këtë e lëmë vetëm në duart e OJQ-ve. Nuk ka staf të mjaftueshëm dhe të specializuar në institucionet tona për t’u marrë me fëmijët me kategori të ndryshme të aftësisë së kufizuar. Ekziston nevoja për ngritje sistematike të kapaciteteve. Edhe në Institutin tim ka mungesë të personelit adekuat, sepse punësimi është bërë pa ndonjë kriter profesional dhe çështja është që këta njerëz nuk mund të shkarkohen deri në pensionimin e tyre. Konsideroj se njerëzit me aftësi të kufizuara janë kategoritë më të diskriminuara, ndonëse ka pasur pak progres krahasuar me kohën e mëparshme, por nevojitet ende shumë punë. Përgjegjësia duhet të fillojë së pari nga familja, të mos fshehen rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe anëtarët e tjerë të familjes. Ka raste që janë fshehur nga shoqëria madje për 25 vjet, dhe rasti është identifikuar vetëm pas vdekjes së njërit prej prindërve dhe prindi tjetër që është i moshuar dhe nuk mund të kujdeset për fëmijën e tij, kërkon ndihmë nga Qendra për Punë Sociale, e cila pastaj i adreson këto raste në Institutin tonë”**.

Megjithëse Ligji i Mbrojtjes së Fëmijëve, i përmendur më lart, mbetet në formë të draftit, masat për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe masat e kujdesit alternativ, shfaqen në mënyrë të dukshme në Nenet 10 dhe 11 (respektivisht) të *Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare*<sup>123</sup>. Megjithëse jo specifike për fëmijët me aftësi të kufizuara, mirëqenia e fëmijës duhet të konsiderohet e para në kontekstin familjar. Masat mbrojtëse ndaj largimit të një fëmije nga familja janë shprehur në mënyrë të qartë, njësoj si procedurat që duhet të ndiqen në rast se dyshohet që mbrojtja është e nevojshme, si dhe detyrat e raportimit nga profesionistë të ndryshëm të kujdesit shëndetësor. Neni 11 rregullon vendosjen alternative për një fëmijë, në rastet kur dihet se familja biologjike nuk mund të kujdeset për fëmijën ose fëmija braktiset. Përsëri, edhe pse jo specifik për fëmijët me aftësi të kufizuara në veçanti, as nuk përjashton fëmijët me aftësi të kufizuara.

Sipas regjistrimit të vitit 2011<sup>124</sup>, më poshtë është dhënë numri i personave të raportuar në institucione rezidenciale:

LLOJI I INSTITUCIONIT REZIDENCIAL		MOSHA																	
		0-4	5-9	10-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65-69	70-74	75-79	80+	Gjithsej
Gjithsej	Rezidenca për studentët	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Spital, senatorium, qendër e rimëkëmbjes	4	13	14	9	5	6	6	9	8	8	8	6	4	0	0	0	0	100
	Objektet për personat me aftësi të kufizuara, institucione psikiatrike	0	0	2w	8	11	5	10	18	22	30	23	21	27	11	2	1	0	191
	Shtëpi të pleqve	0	0	0	0	0	0	1	1	1	1	5	4	8	16	38	25	24	124
	Shtëpi të pleqve, jetimore	29	9	12	9	0	0	0	1	0	1	2	0	0	0	0	0	0	63
	Kazerma ushtarake dhe policore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Burgjet dhe qendrat korrektuese	0	0	2	36	102	169	163	113	76	62	38	27	15	10	6	3	0	822
	Manastiret	0	0	0	0	4	13	12	4	18	13	17	3	7	4	4	0	1	100
	Konvikti i punonjësve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Kampe të refugjatëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Tjetër	2	3	0	1	2	2	2	1	2	0	1	1	2	0	2	1	1	23

Tab. 3.52 - Popullata e zakonshme në institucione rezidenciale sipas moshës, gjinisë dhe llojit të institucionit rezidencial

LLOJI I INSTITUCIONEVE REZIDENCIALE		MOSHA																		
		1-15	16-25	26-35	36-45	46-55	56-65	66-75	76-85	85+	1-15	16-25	26-35	36-45	46-55	56-65	66-75	76-85	85+	Gjithsej
Gjithsej	Hotel	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Rezidenca për studentët	0	0		0	0	0	0	0	92	1208	25	3	0	0	0	0	3	1,331	
	Spital, sanatorium, qendër e rimëkëmbjes	33	14	14	19	18	11	2	2	1	145	150	166	120	130	139	148	68	14	1,194
	Objekte për personat me aftësi të kufizuara, institucione psikiatrike	2	20	15	47	43	51	8	1	0	9	17	0	0	0	1	0	0	0	214
	Shtëpi të pleqve	0	0	1	3	5	14	57	36	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	122
	Shtëpi fëmijësh, jetimore	38	6	0	1	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	48
	Kazerma ushtarake dhe policore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Burgjet dhe qendrat korrektuese	4	167	332	175	89	38	15	2	0	0	127	114	48	23	5	1	0	1	1,141
	Manastiret	0	4	25	21	29	10	7	0	1	3	65	3	0	0	0	0	0	0	168
	Konvikt i punonjësve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Kampe të refugjatëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
Tjerë	4	3	4	1	0	1	0	1	0	6	11	9	4	1	0	0	0	9	54	
Gjithsej	81	214	392	268	187	126	89	42	8	255	1,578	317	175	154	145	149	68	27	4,275	

Tab. 3.55 - Institucionet rezidenciale sipas numrit të personave në institucione rezidenciale, gjina e personave në institucionet rezidenciale dhe lloji i institucioneve rezidenciale.

Fëmijët me aftësi të kufizuara pa përkujdesje prindërore, rrallëherë adoptohen në Kosovë dhe gjasat janë se do të vendosen në strehim familjar. Strehuesit familjar pranojnë gjithsej 250 € për t'u kujdesur për fëmijët me aftësi të kufizuara<sup>125126</sup>. Në vitin 2013, KOMF raportoi<sup>127</sup> se "mbrojtja e fëmijëve të braktisur me aftësi të kufizuara mbetet një sfidë. Aktualisht, në strehim familjar janë nëntë (9) fëmijë të braktisur me aftësi të kufizuara, ndërsa në institucionet rezidenciale janë gjashtë (6) fëmijë të braktisur me aftësi të kufizuara. Vendosja e fëmijëve në institucionet rezidenciale të fëmijëve (për një kohë të gjatë privon të drejtën e fëmijës për t'u rritur në familje dhe paraqet shkelje të të drejtave të fëmijës. Vështirësi janë paraqitur edhe në gjetjen e familjeve adoptuese për fëmijët e braktisur me aftësi të kufizuara. Kryesisht, janë realizuar adoptime/birësime ndërkombëtare të fëmijëve të braktisur me aftësi të kufizuara"<sup>128</sup>.

Sipas të dhënave të grumbulluara nga OJQ-ja lokale OFAP (ish OJQ-ja italiane "Amici dei Bambini") dhe Cooperazione Italiana allo Sviluppo<sup>129</sup>, kishte një mesatare prej 54 fëmijëve të braktisur në vit në Kosovë, midis viteve 2009-2013. Braktisja e fëmijëve shpesh ndodh që në lindje dhe fëmijët mund të braktisen edhe përkohësisht ose përgjithmonë nga familja për një sërë arsyesh. Në vitin 2015, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ofroi një shifër të përgjithshme prej 1,279 fëmijëve nën kujdestari në vitin 2015, të vendosur në kujdes alternativ, shumica e tyre në kujdes farefisnor formal (familja e ngushtë), në strehim familjar dhe në institucione rezidenciale të banimit për fëmijë<sup>130</sup>. Megjithatë, shpesh fëmija nuk vendoset në strehim familjar, por vendoset në strehimore rezidenciale, ndonëse kjo nuk është në përputhje me ligjin<sup>131</sup>. Qendrat për Punë Sociale në nivel komunal janë përgjegjëse për rekrutimin e strehuesve familjar, planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, ndërsa miratimi përfundimtar i familjeve strehuese është i centralizuar. Standardet e shërbimit janë krijuar si "garanci për uniformitetin e të drejtave të fëmijëve në mesin e komunave të ndryshme"<sup>132</sup>.

OJQ OFAP, ka funksionuar në Kosovë që nga viti 1999 me një ekip mbështetës psiko-social që ofron shërbime për fëmijët dhe familjet. Në janar të vitit 2017, kishte gjithsej 68 fëmijë të vendosur në 28 familje strehuese aktive në Kosovë. Prej tyre, 9 janë fëmijë me aftësi të kufizuara që marrin përfitim në para nga MPMS, edhe pse numri i fëmijëve të *paidentifikuar* me aftësi të kufizuara në përkujdesje alternative familjare është ndoshta shumë më i lartë. Përderisa udhëzimi administrativ i MPMS-së përcakton që secila komunë duhet të ketë 3 familje strehuese aktive, në kohën e intervistës, 14 nga 38 komunat nuk kishin familje strehuese dhe shumica e të tjerave kishin përmbushur vetëm pjesërisht objektivin. Sfidat kryesore e raportuar është zbatimi në nivel komunal për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe angazhimit të QPS-ve në rekrutimin e familjeve të reja të mundshme strehuese.

Strehimi familjar po zhvillohet edhe në veri të Mitrovicës për të siguruar që fëmijët nga rajoni, të cilët në mënyrë të përkohshme apo të përhershme janë pa përkujdes prindëror, të mos largohen nga komunitetet e tyre. Aktualisht, 8 familje janë duke u trajnuar. Është planifikuar që ata të paguhen rreth 200 euro në muaj, për fëmijë, dhe t'u jepen fonde shtesë për shpenzime të tjera. Familjet strehuese që marrin fëmijë me aftësi të kufizuara do të pranojnë një shumë shtesë nga MPMS-ja e Serbisë. Në kohën e finalizimit të këtij raporti, skema financiare nuk ishte ende në fuqi.

Ligji i Punës Nr. 03/L-212 specifikon se njëri nga prindërit (ose kujdestari) i fëmijës me aftësi të kufizuara të përhershme, ka të drejtë që të punojë me gjysmë orari të punës derisa fëmija t'i mbushë dy (2) vjeç, si një tranzicion në mes të pushimit të lehonisë dhe punës me orar të plotë (Neni 52)<sup>133</sup>.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF - është një organizatë ombrellë me 22 OJQ anëtare që avokojnë për të drejtat e fëmijës, përmes ngritjes së vetëdijes dhe rishikimit të legjislacionit. Përderisa fokusi i tyre janë fëmijët në përgjithësi, disa nga aktivitetet e tyre përqendrohen te fëmijët me aftësi të kufizuara. Sipas zëdhënësit të tyre, mungesa e të dhënave ndikon në masë të madhe në jetën e fëmijëve, sepse vendimmarrja bëhet në bazë të supozimit, e jo në fakte. Përveç kësaj, mungesa e një granti specifik (nga buxheti qendror në atë komunal), që siguron se komunat kanë fonde të mjaftueshme për të justifikuar prioritizimin e nevojave të fëmijëve brenda planeve të tyre të veprimit, u theksua si arsyeja kryesore për të cilën ofrimi i shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara është joadekuat dhe i lihet shoqërisë civile si përgjegjësi. Sipas KOMF dhe Institutit GAP<sup>134</sup>, përderisa komunave u sigurohet financim i dedikuar për arsimim (13% ose grant i përgjithshëm komunal) dhe shëndet dhe mirëqenie (9% ose grant i përgjithshëm komunal), shumica e të cilët shpenzohet në mëditje dhe paga, nuk ka financime të destinuara për shërbimet sociale.

## E drejta për arsim (gjithëpërfshirës)<sup>135</sup>

Shtetet Palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsim. Me qëllim realizimin e kësaj të drejte pa diskriminim dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, Shtetet Palë do të garantojnë një sistem arsimor gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe arsimin gjatë gjithë jetës me synim: (a) Zhvillimin e plotë të potencialit njerëzor dhe ndjenjës së dinjitetit dhe vetëvlerësimit, fuqizimin e respektit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe diversitetit njerëzor; (b) Zhvillimin e personalitetit, talenteve dhe krijimtarisë të personave me aftësi të kufizuara, si edhe të aftësive të tyre mendore dhe fizike, në potencialin e tyre të plotë; (c) Mundësimin personave me aftësi të kufizuara që të marrin pjesë në mënyrë efektive në një shoqëri të lirë. 2. Gjatë realizimit të kësaj të drejte, Shtetet Palë do të garantojnë që: (a) Personat me aftësi të kufizuara të mos jenë të përjashtuar nga sistemi arsimor për shkak të aftësisë së kufizuara dhe që fëmijët me aftësi të kufizuara të mos jenë të përjashtuar nga arsimimi pa pagesë dhe i detyruar fillor, ose arsimit të mesëm, për shkak të aftësisë së kufizuara; (b) Personat me aftësi të kufizuara mund të kenë qasje në arsimin fillor gjithëpërfshirës, cilësor dhe pa pagesë dhe arsimin e mesëm njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë në komunitetet ku ata jetojnë; (c) Sigurohet akomodimi i arsyeshëm i kërkesave individuale; (d) Personat me aftësi të kufizuara marrin mbështetjen e kërkuar, brenda sistemit të arsimit të përgjithshëm për të mundësuar arsimimin e duhur të tyre; (e) Sigurohen masa mbështetëse efikase dhe të individualizuara në ambiente që rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror, në përputhje me qëllimin për përfshirjen e tyre të plotë. 3. Shtetet Palë do të bëjnë të mundur që personat me aftësi të kufizuara të krijojnë aftësi për zhvillim shoqëror dhe jetësor për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në arsim dhe si pjesëtarë të komunitetit. Për këtë



qëllim Shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura, duke përfshirë: (a) Të mësuarit e Braille, shkrimeve alternative, mënyrave augmentative/njohëse dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, aftësive të orientimit dhe lëvizshmërisë dhe mbështetjes dhe kujdesit nga moshatarët; (b) Të mësuarit e gjuhës së shenjave dhe nxitjen e identitetit lingistik të personave që nuk dëgjojnë; (c) të sigurohen që arsimimi i individëve, dhe në veçanti fëmijëve, të cilët janë të verbër, të shurdhër, apo të shurdhër dhe të verbër, në të njëjtën kohë të jepet në gjuhën, mënyrat dhe mjetet e komunikimit më të përshtatshme për individin dhe në ambiente të cilat rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror të tij/saj. 4. Me qëllim që të garantohet realizimi i kësaj të drejte, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për punësimin e mësuesëve, duke përfshirë mësuesit me aftësi të kufizuara, të cilët janë të kualifikuar në gjuhën e shenjave dhe/apo Braille, dhe të trajnojnë profesionistët dhe stafin që punon në të gjitha nivelet arsimore. Trajnime të tilla duhet të përfshijnë ndërgjegjësimin në lidhje me aftësinë e kufizuara dhe përdorimin e mënyrave të duhura augmentative/njohëse dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, teknikave edukuese dhe materialeve për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara. 5. Shtetet Palë do të garantojnë që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në arsimin e lartë, trajnime profesionale, arsim për të rritur dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës pa diskriminim dhe në baza të barabarta me të tjerët. Për këtë qëllim, Shtetet Palë do të garantojnë ofrimin e akomodimit të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara. – DPAK Neni 24

## Progresi drejt Arsimit Gjithëpërfshirës

***“Procesi i përgjithshëm i arsimit gjithëpërfshirës është një proces i dhimbshëm për të gjithë, duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, prindërit dhe mësuesit e tyre”***  
– përfaqësues i DKA - Gjakovë)

MASHT ka qenë e përkushtuar drejt arsimit gjithëpërfshirës që nga fillimi i viteve 1990. Ky angazhim është dokumentuar dhe diskursi ka evoluar me kalimin e kohës, nga qasja në arsimim për fëmijët me aftësi të kufizuara (shpesh në shkolla speciale) deri në krijimin e shkollave gjithëpërfshirëse, në një vizion më të gjerë dhe më gjithëpërfshirës, i cili merr parasysh ndryshimet sistematike që kërkojnë përfshirjen e komuniteteve, koordinimin ndër-sektorial dhe monitorimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të zbatimit. Janë krijuar standardet për fëmijërinë e hershme dhe për shkollat mike për fëmijët, dhe janë ndërmarrë përpjekje për zhvillim profesional, duke përfshirë ato që lidhen me asistentët e gjuhës së shenjave dhe inspektorët dhe hartimin dhe monitorimin e Planit të Individualizuar të Arsimit, megjithëse zbatimi vazhdon të jetë sfidues.

Përgjatë 2 dekadave të fundit dhe përkundër përpjekjeve të shumta, përgjegjësia për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara ka rënë mbi profesionistët e specializuar, fillimisht mbi ata që punojnë në shkolla të veçanta dhe më pastaj mbi ata që punojnë në Qendra Burimore. Në praktikë, dhe siç është dokumentuar më poshtë, arsimit gjithëpërfshirës është ende shumë i fokusuar në integrimin e nën-grupeve të fëmijëve (p.sh. fëmijët me aftësi të kufizuara dhe/ose nxenesit me nevoja të veçanta arsimore) në disa shkolla gjithëpërfshirëse dhe ende matet me numrin e fëmijëve me aftësi të

kufizuara që ndjekin shkollën. Përgjegjësia për zbatimin e Arsimit Gjithpërfshirës është ende shumë e fokusuar në personelin arsimor, përvoja e të cilit ka qenë në kuadër të arsimit special dhe në ofrimin e shërbimeve mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara të integruar në gjithpërfshirje, që është në kundërshtim me etiken gjithpërfshirëse. Të intervistuarit pranuan sfidat e përjetuara nga Shkollat Speciale/Qendrat Burimore në mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara të rënda, megjithëse “qendrat burimore kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve të shkollave të zakonshme për arsimin gjithpërfshirës nëpërmjet shërbimeve të ofruara nga mësimdhënësit udhëtues dhe përmes programeve të trajnimit ku në vitin 2014 MASHT-i ka licencuar 16 programe trajnimi”<sup>136</sup>. Sipas vëzhguesve të ndryshëm, fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me një sërë sfidash në shkollë, duke përfshirë infrastrukturën joadekuate, mungesën e asistentëve personalë, mungesën e mbështetjes nga shumë mësues dhe shpesh mungesën e planeve të arsimit individual.<sup>137</sup>

Numri i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe/ose fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta në Kosovë nuk dihet. Megjithatë, ka shumë gjasa që është shumë më i vogël se përqindja prej 5,25% e studentëve me NVA në popullsinë e përgjithshme të shkollave në disa prej vendeve fqinje në Evropë<sup>138</sup>. Sipas UNICEF-it, “më pak se 20 për qind e fëmijëve po ndjekin programet e arsimit të fëmijërisë së hershme në Kosovë” dhe “në Kosovë, më pak se 1 në 5 fëmijë janë nga ana zhvillimore në rrugë të duhur sa i përket çështjes së shkrim-leximit dhe njehësimit”<sup>139</sup>.

Regjistrimi i përgjithshëm në vitin akademik 2015/2016, shkollat publike, private dhe speciale			
	Gjithsej	Meshkuj	Femra
parashkollor/para-fillor (SNKAO)	26924	13988	12936
Filllore dhe e mesme e ulet (SNKA 1 dhe 2)	261107	134842	126265
E mesme e lartë (SNKA 3)	86376	45366	41010
Gjithsej	374407	194196	180211

Viti akademik	2005/2006	2006/2007	2007/2008	2008/2009	2009/2010	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014	2014/2015	2015/2016	2016/2017
Numri i fëmijëve në shkolla speciale	396	420	384	387	421	450	454	453	463	445	357	271
Burimi: Statistikat e arsimit (MASHT)												

Përveç kësaj, statistikat zyrtare nga viti 2015-16 sugjerojnë se më shumë se 94 përqind e fëmijëve të regjistruar me nevoja të veçanta, ndjekin orët mësimore rregullisht, por vajzat me aftësi të kufizuara kanë më pak gjasa sesa djemtë me aftësi të kufizuara që të ndjekin shkollën (shih më poshtë).<sup>140</sup>




Figura 2: Proporcioni i djemve dhe vajzave me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollimin obligativ dhe pas-obligativ.

Sipas DKA, në Ferizaj, nga mbi 20,000 nxënës vetëm 184 janë fëmijë me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollën, 33 në klasa të arsimit special dhe 151 në klasa të rregullta. Megjithatë, cilësia e arsimit raportohet se dallon nga vendi në vend dhe mes shkollave në varësi të materialeve dhe burimeve njerëzore në dispozicion. Po ashtu, të dhënat e siguruar nga një përfaqësues i DKA-së në Prishtinë tregojnë se në komunë ka më shumë se 60 institucione, me mbi 50,000 nxënës, nga të cilët 400 janë identifikuar si fëmijë me nevoja të veçanta.

Dizajnimi i një aplikacioni të bazuar në internet për një Sistem më të fortë të Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA), filloi në vitin 2009 (projekt i përbashkët me Bankën Botërore) dhe përfundoi në 2012-2013, si pjesë e një përpjekjeje për të adresuar mungesën e të dhënave për vendim-marrje. Tani, SMIA mbledh të dhëna për shkollat (publike dhe private të licencuara), personelin dhe fëmijët duke u bazuar në të dhënat e klasës, por nuk lejon një mbledhje të detajuar të të dhënave si: vitin e lindjes, gjininë, etninë, aftësinë e kufizuar, konstelacionin e familjes, distancën nga shtëpia në shkollë, ndihmën sociale etj., të cilat janë lloje të informatave që MASHT-i i konsideron të rëndësishme për vendimmarrje. SMIA gjithashtu përfshin llojet e *aftësive të kufizuara* të përfaqësuara në secilën Qendër Burimore, bazuar në listën e 10 llojeve të dëmtimeve: autizëm, dëmtime gjuhësore dhe të komunikimit, Sindromi Down, çrregullimet emocionale dhe të sjelljes, dëmtimet e dëgjimit, dëmtimet intelektuale, vështirësi/çrregullime në të mësuar, dëmtime të shumëfishta, dëmtime fizike dhe dëmtimi në të pamur. Megjithatë, të dhënat mbi *aftësinë e kufizuar, dëmtimin ose nevojat e arsimit special* nuk grumbullohen në shkolla të rregullta për shkak të mungesës së besueshmërisë.

## Vlerësimet pedagogjike

Meqenëse procedurat e përmbushjes së kritereve të aftësisë së kufizuar nuk e mbështesin vendimmarrjen në arsim, MASHT-i ka hartuar një *Udhëzues për Ekipet Vlerësuese Profesionale për të vlerësuar Nevojat Arsimore të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta në Komunë*<sup>141</sup> dhe aktualisht ka themeluar 16 ekipe komunale për vlerësime pedagogjike, edhe pse raportet ndryshojnë përkitazi me atë se deri në çfarë mase të gjitha ekipet janë plotësisht funksionale. Ekipet mund të përfshijnë një varg profesionistësh varësisht nga nevoja dhe disponueshmëria, dhe dokumentacioni është i rregulluar. Një metodologji e re e vlerësimit që është reaguese ndaj aftësisë funksionale të secilit fëmijë (sipas KNF-FR) është planifikuar, por procesi ende nuk është finalizuar. Ndërkohë që ekziston një udhëzim administrativ për të rregulluar vlerësimet, nuk ekziston ndonjë obligim për prindërit ose shkollat që të sigurojnë realizimin e një vlerësimi pedagogjik. Kështu, shumë shpesh, fëmijët me aftësi të kufizuara vendosen në klasa të rregullta pa ndonjë plan mësimor ose mbështetje arsimimi.

Sipas MASHT-it dhe stafit të ekipit vlerësues në komunën e Prishtinës, procesi i një vlerësimi pedagogjik mund të iniciohet nga prindërit ose nga shkolla ku fëmija është i regjistruar. Por raportet ndryshojnë në masë të madhe kur është fjala për procesin dhe rezultatin e vlerësimeve dhe shumica e atyre që morën pjesë në këtë studim kanë raportuar se përgjithësisht, fëmijët e shurdhër dhe fëmijët me shikim të dëmtuar referohen në dy shkollat speciale që specializohen në këto dëmtime të veçanta, për vlerësim të mëtejshëm pedagogjik. Ekipi i vlerësimit në komunën e Prishtinës raportoi se zakonisht marrin kërkesa për vlerësimin e fëmijëve që perceptohen të kenë një dëmtim intelektual ose paaftësi të rëndë në të mësuar. Në vitin shkollor 2016/2017, nga rreth 400 fëmijë me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollat e rregullta, vetëm 24 fëmijë u vlerësuan nga ekipi në komunën e Prishtinës. Prej 24 fëmijëve të vlerësuar, janë bërë 16 rekomandime për të ndjekur shkollën e rregullt, megjithëse me një asistent personal. Siç raportohet nga prindërit në DFG-të, pothuajse në të gjitha rastet, asistentët personalë, ndonëse janë një rekomandim nga ekipet e vlerësimit dhe shpesh një kërkesë e shkollës që kushtëzon regjistrimin, duhet të paguhen nga prindërit.

Për më tepër, siç është raportuar, jo të gjithë pjesëtarët e ekipit në të gjitha ekipet komunale pedagogjike kanë trajnim të mjaftueshëm dhe/ose relevant, gjë që i bënë rezultatet e vlerësimeve pedagogjike shumë të ndryshueshme në varësi të zonës gjeografike dhe ndoshta jo tërësisht të besueshme. Siç është raportuar gjatë intervistave dhe DFG-ve, pjesëtarët e ekipit vlerësues nuk paguhen për punën vlerësuese të bërë, punë të cilën ata e konsiderojnë si **“shumë komplekse dhe detyrë me shumë përgjegjësi”** (përfaqësuesi i DKA). Siç është raportuar nga udhëheqësi i Ekipit Komunal për Vlerësim Pedagogjik në Prishtinë, rolet dhe përgjegjësitë e ekipit përfundojnë me përfundimin e raportit të vlerësimit dhe dërgimit të tij tek prindi, përveç nëse është i nevojshëm një rivlerësim në një kohë të mëvonshme. Të gjitha veprimet tjera që mund të ndodhin pasi të jetë përmbyllur procedura e vlerësimit (diskutimet sa i përket vendosjes, zhvillimin e PIA, monitorimin apo krahasimin me pikëreferim, ri-vlerësimet, etj.) janë përgjegjësi e dikujt tjetër, me gjasë prindit, drejtorëve të shkollave, mësimdhënësve dhe të tjerëve.

Gjatë 5 DFG-ve me ofruesit e shërbimeve për këtë studim, mësimdhënësit patën shqetësime të ndryshme në lidhje me ekipet komunale vlerësuese. Ata raportuan që ekziston vetëm një ekip komunal vlerësues për tërë komunën e Prishtinës, e cila ka një dendësi të lartë të popullsisë. Pjesëtarët e ekipit vlerësues angazhohen në detyrat e tjera ditore (mësimdhënie, ambulanca, apo menaxhment të shkollës, etj.), nuk e shohin anëtarësimin në ekip si pjesë të detyrave të tyre kryesore profesionale dhe prandaj ankohen që nuk paguhen për punën e tyre. Përveç kësaj, mjekët e specializuar marrin pjesë në ekipet vlerësuese vetëm herë pas here. Sipas pjesëmarrësve në DFG, vetëm 50% e komunave në Kosovë kanë themeluar Ekipet Komunale Vlerësuese. Ka raste kur pjesëtarët e ekipit vlerësues nganjëherë nuk raportojnë diagnozat reale të fëmijëve, gjë që ndikon në përfshirjen e tyre të mëtejshme në shkollë dhe zhvillimin e planeve të tyre individuale. Shumë fëmijë me aftësi të kufizuara aplikojnë për regjistrim në shkollë, ku në mesin e tyre edhe fëmijë të verbër dhe kjo është një sfidë për ekipet vlerësuese. Në fund, pjesëtarët e ekipit komunal vlerësues pohojnë që nuk kanë standarde të harmonizuara për identifikimin e llojeve dhe kategorive të aftësive të kufizuara. Ata gjithashtu kanë nevojë për trajnime mbi materialet mësimore për planin individual për fëmijët me nevojë të veçanta arsimore.

## Mjediset dhe udhëzimet

Psikologu që ka marrë pjesë në DFG-të në rajonin e Prizrenit, i cili ka qenë anëtar i ekipit komunal vlerësues, beson që koncepti i klasave të bashkangjitura (klasat e veçanta brenda shkollave të rregullta) kontribuon në ndarjen dhe stigmatizimin e mëtejshëm ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara, që paraqesin një pengesë për integrimin real. Sipas këtij profesionisti (dhe të tjerëve në rajon), në mënyrë që gjithëpërfshirja sociale të ketë sukses, fëmijët me aftësi të kufizuara duhet t'i ekspozohen të njëjtit mjedis, sjellje dhe qëndrime si të gjithë fëmijët tjerë në grupmoshën e tyre, me mbështetjen e mësimdhënësve të përgatitur mirë (mësimdhënësit e arsimit special dhe të rregullt), të udhëzuar me PIA. Koncepti i klasave të bashkangjitura në Kosovë, si në pjesë të madhe të rajonit, shihet si hap i nevojshëm i ndërmjetëm ndërmjet shkollave speciale (ndarja/segregimi) dhe shkollave të rregullta (gjithëpërfshirja). Megjithatë, në realitet, klasat e bashkangjitura veprojnë në masë të madhe si mjedise të segreguara/ndara, përkundër se janë në të njëjtën hapësirë gjeografike si shkolla e rregullt. 2 mësimdhënësit e arsimit special që punojnë në klasa të bashkangjitura në Ferizaj raportojnë se kanë 25 nxënës me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara në 2 klasa, nga moshë 7 deri në 22 vjeç. Ata raportuan që, edhe pse klasat tani quhen *klasa burimore*, praktika e tyre akoma nuk përkon me terminologjinë. Megjithatë, sipas vëzhgimeve të tyre profesionale, disa fëmijë me aftësi të kufizuara do të mund të transferoheshin nga klasat e tyre në klasa të rregullta, përveç 2 fëmijëve me aftësi të kufizuara të rënda. Nuk ka pasur ndonjë shpjegim se pse kjo nuk ka ndodhur akoma.

Siç është raportuar në DFG-të, në komunën e Vushtrrisë, të gjitha klasat ekzistuese të bashkangjitura janë transformuar gjithashtu në *klasa burimore*. Për momentin, ata kanë 13 nxënës me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara dhe të moshave më të rritura, të cilët **“nuk mund t'i ndjekin klasat e rregullta”** (përfaqësues i DKA). Nxënësit janë të moshave nga 19 vjeç dhe më të moshuar, të cilët nuk mund të shkojnë në një shkollë speciale pasi që prindërit e tyre kanë refuzuar regjistrimin e tyre. Ata kanë

aftësi të kufizuara të rënda dhe mbështeten nga psikologu i shkollës, një mësimitdhënës mbështetës dhe një teknik. Siç është raportuar, është duke u ndërtuar një qendër për kujdes ditor, të cilën **“këta fëmijë mund ta ndjekin në të ardhmen”** (përfaqësues i DKA). Gjithashtu, siç është raportuar nga i njëjti person, në komunë janë 5 fëmijë me aftësi të kufizuara në klasat e rregullta, por nuk ka personel profesional për të punuar me ta. Megjithatë, të gjithë mësimitdhënësit e rregullt kanë ndjekur trajnime mbi planifikimin individual për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ky raport është i kundërt me atë të ofruar nga përfaqësuesi nga OJQ-ja Down Syndrome Kosova, e cila raportoi se ajo personalisht njeh një fëmijë me Sindromin Down që ndjek një klasë të rregullt, pa PIA.

Sipas *Raportit mbi Funksonimin e Qendrave Burimore në Kosovë*<sup>142</sup>, Qendrat Burimore në Kosovë rregullohen me Ligjin për Arsimin Para-Universitar (2011) dhe Udhëzimin Administrativ nr. 23/2013, dhe funksionojnë drejtpërdrejtë nën mbikëqyrjen e MASHT-it. Ato kanë dy funksione kryesore: 1) “shkollë speciale për nxënësit me aftësi të kufizuara të rënda dhe aftësi të kufizuara të shumëfishta dhe ofrojnë akomodim në konvikte për ata që kanë nevojë”; 2) “ofrojnë mbështetje për shkollat e rregullta në mësimin e nxënësve me NVA”<sup>143</sup>. 5 qendrat ekzistuese burimore secila kanë specializim në lidhje me një dëmtim: një me specializim në dëmtim në të pamur, një me specializim në dëmtim në dëgjim dhe tri me specializim në dëmtim intelektual/vonesë në zhvillim. 5 QB-të kanë mbështetur mbi 80 shkolla në vitin shkollor 2015-2016, me mbi 200 nxënës që marrin mbështetje nga mësimitdhënësit udhëtues, të cilët vizitojnë shkollat mesatarisht 3-5 herë në javë. Gjatë vizitave në shkollë, mësimitdhënësit udhëtues supozohet të kryejnë detyra të shumëllojshme në lidhje me: PIA-të, ofrimin e materialeve, konsultimeve me personelin e shkollës, trajnimet, identifikimin e nxënësve dhe vlerësimin pedagogjik, mbështetjen e mësimitdhënësve dhe mbështetjen e nxënësve. Përveç kësaj, gjysma e mësimitdhënësve udhëtues që kanë marrë pjesë në vlerësim kanë bërë vizita familjare për të identifikuar rastet për vlerësim dhe mbështetjen dhe këshillimin e prindërve.

Sipas drejtorit të QB në Prishtinë, QB ka gjithsej 38 të punësuar, nga të cilët 4 janë mësimitdhënës udhëtues. 4 mësimitdhënësit udhëtues mbështesin 108 fëmijë me aftësi të kufizuara në 28 shkolla, në 13 komuna (përreth Prishtinës), por nuk mbështesin apo punojnë bashkërisht me mësimitdhënësit e rregullt, të cilët kanë fëmijë me aftësi të kufizuara në klasat e tyre, për shkak të: mungesës së trajnimit të mësimitdhënësve, mungesës së vullnetit nga mësimitdhënësit dhe administratorët e shkollave për krijimin e kushteve për gjithpërfshirje dhe mungesës së zbatimit të legjislacionit nga ana e autoriteteve komunale dhe MASHT-i. QB në rajonin e Prizrenit – Nëna Terezë – është institucioni i vetëm për fëmijët që kanë dëmtime në dëgjim. Qendra aktualisht ka 81 fëmijë, të moshave 3 deri në 18 vjeç, në institucione parashkollore, shkolla fillore dhe të mesme, si dhe 3 programe të aftësimin profesional. QB funksionon si një shkollë me konvikt, me 51 punonjës, nga të cilët 2 janë defektologë dhe 29 janë mësues lëndorë, ndërsa niveli parashkollor përfshin fëmijë me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara (por jo të shurdhër apo me vështirësi në dëgjim) nga komuna. Sipas raportimeve të pjesëmarrësve në DFG dhe pjesëtarëve të intervistuar të Shoqatës së të Shurdhërve të Kosovës, QB vazhdon të veprojë si shkollë speciale me një konvikt, përderisa raportet e shtrirjes së saj dhe mbështetjes së fëmijëve të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në shkollat e rregullta (siç është e pritshme nga një QB) ndryshojnë. Sipas Shoqatës



së të Shurdhërve të Kosovës, përkundër legjislacionit që pohon që gjuha e shenjave supozohet të jetë gjuhë e instruksionit për nxënësit e shurdhër, realiteti është shumë më ndryshe. Në shumicën e rasteve, mësimdhënësit nuk përdorin gjuhën e shenjave, pavarësisht mjedisit, përfshirë në QB. Sipas raporteve, është një instruktor i gjuhës së shenjave në personelin që supozohet të ofrojë trajnim për mësimdhënësit, por nuk ka vullnet nga ana e mësimdhënësve që ta mësojnë atë dhe nuk ka udhëzim administrativ që e kërkon atë. Në këtë mënyrë, sipas anketës së mësimdhënësve, më pak se 1% e të gjithë instruksionit bëhet në gjuhën e shenjave. Sipas të intervistuarve, nuk është befasuese që 66% e të anketuarve të shurdhër janë analfabet pasi të kenë ndjekur shkollën. Programet për përgatitjen e mësimdhënësve nuk përfshijnë informacione mbi të shurdhërit apo gjuhën e shenjave dhe shoqata tash është duke punuar me Universitetin e Prizrenit për të përfshirë gjuhën e shenjave në programin e tyre.

Fëmijët me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollat e rregullta shpesh regjistrohen pa u identifikuar si të tillë, pa një vlerësim paraprak ose një plan të individualizuar arsimor, sepse regjistrimi nuk varet në të dhe prindërit shpesh nuk duan (ose nuk dinë se si) të fillojnë procesin. QPS mund të identifikojë fëmijët për vlerësim, dhe prindërit ose mësuesit mund të kërkojnë një vlerësim. Sidoqoftë, prindërit mund të (dhe e bëjnë) regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollën që ata zgjedhin dhe nuk duhet t'i binden kërkesës së mësuesve për vlerësim. Kjo është identifikuar nga shumë ofrues të shërbimeve si një sfidë dhe një pengesë për përfshirjen. Përveç kësaj, ka shumë fëmijë me vështirësi akademike dhe sociale në klasa të rregullta, pa mbështetje adekuate.

Siç është raportuar në Gjakovë, situata e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta është shumë problematike, pjesërisht sepse ekipi i vlerësimit që merr vendime në lidhje me edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk përfshin profesionistët të cilët duhet të zbatojnë ato vendime. Ndërsa ekipi i vlerësimit përcakton objektivat e mësimit që udhëheqin planin individual të edukimit të secilit fëmijë, shumë mësues të klasës ngurrojnë të pranojnë fëmijët me aftësi të kufizuara në klasat e tyre, madje edhe në rastet kur ka një mësimdhënës mbështetës të caktuar për një fëmijë të caktuar. Siç është raportuar gjatë një DFG: ***“Nëse unë flas këtu me kolegun përderisa ju e zhvilloni Diskutimin e Fokus Grupit, a do t’ju pengoja apo shpërqendroja? Kështu është puna në një klasë ku ka mësues mbështetës në të njëjtën klasë ku unë jap mësim. Është e vështirë për një mësues të rregullt të ketë një mësues tjetër në klasë”*** – mësues veteran, 20 vjet përvojë në klasë, diplomë pasuniversitare, në Gjakovë.

Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre kanë raportuar se shpesh ata ndjekin klasat e rregullta, por nuk marrin mbështetjen individuale që kërkojnë (dhe që ju takon) që të marrin pjesë në procesin e të mësuarit. Siç është raportuar nga një kujdestare në komunën e Prishtinës, motra e të cilës po ndjek shkollën e rregullt në klasën e 5-të, mësuesi i motrës së saj nuk po përpiket ta përfshijë atë në procesin e të mësuarit edhe pse ka vetëm 4 fëmijë në klasë: ***“Në parim, ajo është një mësuese e mirë për fëmijët e tjerë, por puna është se ajo nuk di se si të merret me motrën time. Ajo e mban atë mënjanë dhe të vetmuar në klasë, të ndarë nga fëmijët e tjerë duke mos e përfshirë atë në aktivitetet e klasës. Ajo gjithashtu ka kërkuar nga ne, anëtarët e familjes, të ulemi me motrën tonë në klasë. Ajo nuk mërzhitet nëse motra ime nuk shkon fare në shkollë dhe as nuk mban evidencë kur ajo mungon”***.

Prindërit siç është rasti me nënën e një vajze me aftësi të kufizuara në veri të Mitrovicës shprehën zhgënjimin e tyre me arsimin. Siç është përmendur, ajo ka blerë materialet e të mësuarit për vajzën e saj që po ndjek shkollën e zakonshme, por askush nuk po punon me të në mënyrë individuale. Ajo tha se është shumë e zhgënjyer se si trajtohet vajza e saj në shkollë, sikur të gjithë përpiqen të jenë të mirë me të dhe të ndiejnë keqardhje, pa u përpjekur të mbështesin vërtetë përfshirjen e saj: ***“Jam ngopur më me këtë dhe kjo po më bën të çmendem, nuk është vetëm fëmija im që ka nevojë për psikiatër, por edhe unë kam nevojë për mbështetje psikologjike, dhe jam lodhur nga sjellja e rreme dhe jo përkrahja profesionale për fëmijën tim”. Ajo më tej përmendi se “ka gjithmonë OJQ që përfitojnë nga fëmijët tanë me aftësi të kufizuara, të cilët vetëm i ftojnë fëmijët tanë në disa evente, por në të vërtetë nuk bëjnë asgjë, përveçse përfundojnë duke bërë disa fotografi me fëmijët tanë dhe më pas duke u larguar”.***

Në Gjakovë, Ferizaj dhe në komuna të tjera, mësuesit e rregullt kanë raportuar se nuk kanë trajnim në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara. Mësimdhënësit të cilët kanë raportuar se kanë marrë ndonjë trajnim përkatës janë ata të cilët zakonisht kanë punuar në klasa/shkolla të arsimit special. Megjithatë, mësuesit mbështetës ( të arsimit special) në shumicën e komunave raportojnë se kanë marrë trajnime të gjera në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara gjatë viteve. Save the Children ka qenë i angazhuar në trajnimin e mësimdhënësve për gjithëpërfshirje, dhe deri në fund të vitit 2017 do të ketë siguruar mbështetje për 8 institucione parashkollore dhe 18 shkolla fillore/të mesme të ulëta për përdorimin e Indeksit për Gjithëpërfshirje. Po kështu, UNICEF-i ka mbështetur në vitin 2016 zhvillimin dhe modelimin e programit të trajnimit të mësimdhënësve në arsimin gjithëpërfshirës (AGJ) bazuar në modulet e ToT (Trajnimit të mësimdhënësve) për programin e trajnimit të mësimdhënësve në shërbim në AGJ me theks tek fëmijët me aftësi të kufizuara, në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit/Institutin për Kërkime dhe Zhvillim të Arsimit, për të siguruar një bazë për trajnimin e mësuesve në AGJ, që mbështetet në një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut<sup>144</sup>. Megjithatë, mësuesit raportuan se edhe pse ka një kurs universitar mbi arsimin gjithëpërfshirës, mësuesit nuk janë fizikisht ose psikologjikisht të gatshëm të punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara. Edhe në rastet kur mësuesit e rregullt janë të aftë dhe janë përgjegjës për shkrimin dhe zbatimin e planeve të edukimit individual ***“institucioni nuk ka pedagog, as psikolog që mund të ofrojë mbështetje të mëtijshme për këtë kategori fëmijësh”*** (drejtori institucioni parashkollor, Ferizaj). Po ashtu, të intervistuarit nga MASHT-i dhe organizatat e ndryshme të donatorëve konfirmuan se gjatë viteve janë siguruar shumë mundësi trajnimi, por ka pasur shumë vështirësi në motivimin dhe sigurimin e një ndryshimi në praktikë në fushën e arsimit.

## Perceptimet e prindërve dhe fëmijëve për sistemin arsimor

Perceptimet lidhur me ofrimin e shërbimeve të arsimit ndryshojnë në mënyrë drastike ndërmjet prindërve dhe zyrtarëve të arsimit. Sipas raportimeve të prindërve/kujdestarëve të mbledhura në 7 DFG, nga 62 fëmijë me aftësi të kufizuara, dyzet e një (41) fëmijë me aftësi të kufizuara ndjekin shkollën e zakonshme, edhe pse siç raportohet nga kujdestarët vetëm pak prej tyre kanë një PIA dhe siç raportohet nga kujdestarët, vetëm disa mësues bëjnë përpjekje për t'i zbatuar ato. Nga ata që janë në shkollën e zakonshme, dy (2) fëmijë kanë një mësues mbështetës dhe një

(1) ka një asistent privat. Të dy fëmijët me sindromën Down që ndjekin shkollën e zakonshme në Gjakovë, nuk kanë mësues mbështetës, ose PIA. Një nënë thotë: **“ajo ndjek shkollën e rregullt në klasën e 9-të, nuk ka një mësues mbështetës dhe nuk ka një plan individual. Kemi kërkuar mësimdhënës nga komuna, por nuk ka pasur asnjë përgjigje deri më tani”**. Në të dyja rastet, prindërit duan t’i dërgojnë fëmijët në **“shkollën speciale Përparimi”** (QB në Prishtinë) për trajnim profesional pas moshës 17 vjeç, në mënyrë që ata të fitojnë aftësi për punësim dhe në të ardhmen të bëhen të pavarur.

Dymbëdhjetë (12) nga 59 prindër shkojnë çdo ditë në shkollë me fëmijët e tyre. Prindërit, fëmijët e të cilëve vijojnë shkollat gjithpërfshirëse janë të lumtur që fëmijët e tyre ndjekin shkollën e rregullt dhe kalojnë kohë me fëmijët e tjerë. Ata raportojnë se përparimi në mësim është shumë i ngadalshëm, por fëmijët e tyre janë të lumtur të jenë mes shokëve të klasës që i mbështetin ata në klasë: **“Djali im kurrë nuk mund të arrijë rezultatet e mësimi dhe rezultatet si fëmijët e tjerë në klasën e tij, por ky ishte vendimi i ekipit të vlerësimit dhe mjekut, që ai duhet të merret pjesë në shkollën e rregullt dhe përkrahim këtë vendim”** (nënë, Prizren). Të njëjtët 59 prindër raportojnë se kanë dy (2) fëmijë me aftësi të kufizuara në shkollë speciale, dy (2) që vijojnë një klasë të bashkëngjitur, dymbëdhjetë (12) nuk vijojnë fare, dy (2) që nuk kanë vijuar kurrë.

Një prind nga Ferizaj raportoi se fëmija i saj kishte ndjekur shkollën e zakonshme për pesë vjet, por tani është regjistruar në një klasë të bashkëngjitur. Siç thuhet, arsyeja është se mësuesi deklaroi se ajo nuk mund ta trajtojë më atë dhe se motra e fëmijës po tallet nga shokët e klasës në shkollën e rregullt. Një tjetër prind, fëmija i të cilit nuk është më në shkollë (Prishtinë), raportoi se fëmija i tij ndoqi fillimisht një klasë të bashkëngjitur, e cila ishte 15 km nga fshati i saj. Transporti ishte organizuar nga shkolla dhe fëmija ishte shumë i lumtur atje. Pas procesit të ri të arsimit gjithpërfshirës, menaxhmenti i shkollës rekomandoi që fëmija të regjistrohej në një shkollë të rregullt, vetëm 3 km larg shtëpisë së saj. Por, pasi që komuna nuk ka ofruar transport, ajo nuk ka qenë në gjendje të vijojë mësimin që tashmë 2 vjet. Babai përmendi se komuna i ofroi atij 20 euro në muaj për shpenzimet e transportit (për ta transportuar vajzën e tij në shkollë), por ai nuk mund të përballojë këtë sepse ai duhet të punojë (për të mbajtur familjen e tij shtatë-anëtarëshe) dhe nuk ka asnjë tjetër person që mund ta transportojë vajzën e tij në shkollë.

Gjithashtu në komunën e Prishtinës, e vetmja nënë kujdestare që kishte marrë pjesë në DFG-të raportoi se fëmija i saj i birësuar ndoqi shkollën e zakonshme deri 2 vjet më parë, kur ata u zhvendosën në një shtëpi tjetër që është shumë më larg shkollës. Pasi që nuk ka transportim të ofruar nga komuna, familja u përpoq ta regjistronte fëmijën në shkollën e zakonshme më afër shtëpisë së tyre të re, por menaxhmenti i shkollës nuk e pranoi regjistrimin e saj, duke deklaruar se nuk kishte vend për të. Ajo ka qëndruar në shtëpi dhe nuk ka ndjekur shkollën qysh atëherë. Një tjetër prind në Prishtinë raportoi se ajo regjistroi vajzën e saj në shkollën e zakonshme në lagjen e tyre për një periudhë të shkurtër, por pastaj mësuesja iu ankua prindit se ajo nuk mund të kujdeset për vajzën dhe t’i mësojë fëmijët e tjerë në të njëjtën kohë, përpos nëse ndonjë familjar qëndron me fëmijën në klasë. Meqenëse nëna nuk mund ta përballonte këtë (ajo kishte një fëmijë tjetër më të ri për t’u kujdesur), ata u detyruan të tërhiqnin vajzën nga shkolla. Ajo nuk ka vijuar mësimin që atëherë.

Dy prindër në Prishtinë kanë pasur përvoja të ndryshme edhe pse kanë raportuar vështirësi me transportin. Megjithatë, ata konfirmuan se të dy djemtë janë shumë mirë të integruar në shkollën e rregullt dhe janë ndër nxënësit më të mirë në klasë. Ata më tej kanë raportuar se janë të lumtur me mësuesit dhe mënyrën se si i trajtojnë fëmijët e tyre. Drejtori i shkollës ka qenë shumë mbështetës duke përshtatur një klasë në katin e parë, dhe tualetin sipas nevojave të fëmijëve. Në Gjakovë, një tjetër prind kishte një raport të ngjashëm: **“Gjithkush në shkollë përpiqet ta ndihmojë atë ... miqtë dhe mësuesit ... drejtori ka lëvizur klasën e tij nga kati i dytë në të parin në mënyrë që djali im të mund të merrte pjesë në të.”** (baba, Gjakovë).

## Cilësia e arsimit

Në përgjithësi, prindërit nuk janë të kënaqur me përparimin e fëmijëve të tyre në shkollë dhe shqetësohen se çfarë do të ndodhë kur ata të përfundojnë arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, pasi që fëmijët e tyre nuk kanë mësuar as gjërat më themelore. Në të gjitha pesë lokacionet e DFG-së, kishte marrëveshje unanime se shkolla nuk i plotëson nevojat më elementare të mësimit për fëmijët e tyre dhe shumë prindër kanë raportuar se fëmijët nuk pëlqejnë të shkojnë në shkollë.

Ndërsa prindërit dhe fëmijët identifikojnë mungesën e kapacitetit teknik të mësuesve si një pengesë kryesore, sipas rishikimit të literaturës dhe konfirmuar nga të intervistuarit për këtë studim, shumë trajnime të përqendruara tek fëmijët me nevoja të veçanta arsimore ose arsim gjithëpërfshirës janë ofruar për një shumëllojshmëri të profesionistëve të arsimit. Donatorët e shumtë kanë bashkëpunuar me MASHT-in që nga viti 2008, por përpjekjet për koordinimin e përpjekjeve nuk kanë qenë efektive duke krijuar një mungesë të qasjes kohezive për trajnim, veçanërisht në lidhje me trajnimin në shërbim. Mësimdhënësit dhe administratorët e shkollave identifikojnë mungesën e edukimit dhe mbështetjes së prindërve dhe një sistem të ngathët si pengesa për arsim cilësor, megjithëse çdo ofruer shërbimi i intervistuar dhe pjesëmarrës në DFG-së përmendën mungesën e trajnimeve adekuate si një pengesë për mësimin cilësor.

Pothuajse të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara që morën pjesë në DFG përmendën që kanë marrë mbështetje edukative nga Save the Children, HandiKOS, Caritas apo OJQ të tjera. Në disa raste, fëmijët raportojnë se mësimi i tyre i vetëm bëhet në qendrat e drejtuara nga OJQ-të, ndërsa OJQ-të raportojnë të jenë përfshirë në mbështetjen e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në ndonjë kapacitet apo tjetër, nganjëherë duke punuar drejtpërdrejt me MASHT-in dhe në raste të tjera duke punuar drejtpërdrejt me fëmijët dhe familjet e tyre. Tutorimi, mbështetja në klasë, udhëzimi i drejtpërdrejtë, këshillimi, janë disa nga shërbimet e mbështetjes arsimore që HandiKOS u ofron fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha komunat e paraqitura në këtë studim (me mbështetje financiare pjesërisht nga Save the Children) edhe pse modalitetet ndryshojnë, nga shërbimet me bazë në shtëpi, mbështetja e të mësuarit në qendrën HandiKOS, e deri tek punësimi i një mësuesi mbështetës i cili ofron mbështetje në mënyra të ndryshme.

Cilësia e arsimit është gjithashtu e lidhur drejtpërdrejt me financimin. Siç mund të shihet më sipër, pjesa më e madhe e burimeve njerëzore dhe financiare që janë alokuar ose janë në përdorim, qoftë edhe në mënyrë periferike për fëmijët me aftësi të kufizuara është e përqendruar në mjedise të ndara (segreguara) dhe vepron si pengesë aktive në përfshirjen e plotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara brenda mjediseve kryesore. Një shembull për qëllim ilustrues në këtë studim është rasti i Vushtrisë si një rast i qëlluar: Jo vetëm që burimet njerëzore janë shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në mes të një dhome burimore që funksionon si klasë speciale (13 nxënës me 3 profesionistë) dhe klasa të rregullta (5 nxënës dhe asnjë profesionist), por transporti ilustron edhe ngarkesën që mjediset e ndara (segreguara) paraqesin për burimet e mangëta komunale. Siç raportohet, komuna ka ndarë një buxhet prej 10,000 Euro për transportin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë. Varësisht nga distanca, ata paguajnë mes 200 dhe 400 euro në vit për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, për të siguruar transportin e fëmijëve që ndjekin shkollën e rregullt. Megjithatë, komuna ofron një mini-autobus për transportin e fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollën speciale.

## Mundësia e qasjes (Qasshmëria)

Qasshmëria e shkollave (si modifikimi i shkollave ekzistuese ashtu dhe ndërtimi i atyre të reja) ka qenë përgjegjësi e MASHT-it që nga viti 2004. Normat dhe udhëzimet janë publikuar, në përputhje me Udhëzimet Administrative ekzistuese (Kushtet Teknike të Ndërtesave të Ndërtuara për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara Nr. 07/2007). Udhëzimet ekzistuese<sup>145</sup> u zhvilluan në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe përfshijnë normat e Bashkimit Evropian në lidhje me pjerrinat (rampat), madhësinë e derës, tualetet e qasshme dhe kërkesat e tjera për mundësimin e qasjes. Megjithatë, akomodimi për personat me dëmtime shqisore nuk parashikohet në asnjë nga dokumentet. Derisa departamenti i MASHT-it përgjegjës për qasshmërinë është jashtëzakonisht krenar për udhëzimet e reja dhe për punën e planifikuar ndërtimore, ata gjithashtu janë mjaft të vetëdijshëm për kufizimet dhe sfidat e punës së tyre të përditshme. Ekipi prej 7 personave (2 arkitektë dhe 5 inxhinierë) përgjegjës për qasshmërinë, të gjithë janë autodidakt për çështjet e qasshmërisë dhe nuk kanë pasur asnjëherë arsimim ose trajnime specifike rreth aftësisë së kufizuar, kërkesave të KDPK-së ose dizajnit universal. Është e rëndësishme të theksohet se MASHT-i është përgjegjës vetëm për ndërtimin e shkollave speciale. Të gjitha shkollat e tjera (ndërtimi i atyre të reja dhe modifikimi) janë përgjegjësi e komunave.

### Theksi mbi fëmijët rom dhe ashkali me aftësi të kufizuara

Nga 7 fëmijë ashkali të moshës shkolllore me aftësi të kufizuara që morën pjesë në DFG, vetëm një fëmijë, një vajzë 11 vjeç me një dëmtim të lehtë fizik vijonte shkollën. Ajo vijon shkollën e rregullt në klasën e 4-të, por raportoi se nuk i pëlqen mësuesi ose të shkojë në shkollë, sepse ajo ulet vetëm në klasë, nuk ka miq, dhe nxënësit e tjerë e ngasin dhe ngacmojnë atë: “**Ulem vetëm në klasë ..... Unë vetë doja të ulesha vetëm**”. Nëna e saj raportoi: “**Po, fëmijët e tjerë në shkollë tallen me të, e quajnë invalid**”. Dy fëmijët e vegjël (të dy 3 vjeç) nuk vijonin mësim parashkollor/çerdhe. Fëmijët e tjerë deri në moshën 5 vjeç vijnë

në çerdhe tek Ideas for Partnership (OJQ). Një nga vajzat, e cila është e verbër, është e interesuar të shkojë në shkollë, por, siç është raportuar nga nëna e saj, nuk është regjistruar kurrë sepse shkolla për të verbrit është shumë larg prej aty. Megjithatë, ajo ka mësuar pak Braille tek Qendra e Ideas for Partnership. Ajo ndonjëherë shkon vetëm jashtë në oborr dhe në tualet, por jo më tej. Asaj nuk i pëlqen muzika fare. Një vajzë tjetër, 10 vjeçe, që ishte regjistruar në një shkollë të rregullt, thuhet se iu desh të ndërpres vijimin sepse ishte **“shumë nervoze dhe mund të bëhet agresive”**. Kujdestarët ashkali nuk ishin të vetëdijshëm për të drejtat e fëmijëve të tyre në arsimin gjithëpërfshirës dhe asnjëherë nuk iu qasën askujt për t’i informuar ata rreth mundësive të shkollimit në shkollën e rregullt. Ata gjithashtu kanë shumë pak njohuri për të drejtat e fëmijëve të tyre dhe për shërbimet e ofruara falas që mund të marrin për fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara.

Tre (3) nga 6 fëmijë rom me aftësi të kufizuara që morën pjesë në DFG vijonin shkollën e rregullt, në gjuhën serbe, por një nga fëmijët, një vajzë me Sindromën Down vijon vetëm një orë në ditë. Gjyshja e saj raportoi se ajo nuk po mësonte asgjë në shkollë: **“Dikur kishte një shkollë për fëmijë të tillë, por jo më ... dhe tani në shkollën e rregullt ata nuk mësojnë asgjë ..... nuk mësojnë as edhe një shkronjë të vetme të alfabetit dhe ajo është 11 vjeç”**.

2 fëmijët e vegjël, 3 dhe 4 vjeç, nuk ishin regjistruar në asnjë shkollë parashkollore/çerdhe. Një nga fëmijët, një djalë 10 vjeç, nuk vijonte shkollën dhe ai kurrë nuk ishte regjistruar në shkollë. Vëllai i tij u përgjigj në këtë mënyrë kur u pyet se përse nuk shkon në shkollë: **“Ai shkakton telashe në klasë...nuk mund ta përdor tualetin i vetëm dhe është shumë nervoz”**. Ai gjithashtu përmendi se babai i tyre nuk është i interesuar të lejojë që bijtë e tij të shkojnë në shkollë, pasi nuk mund të kujdeset për ta dhe t’i përgatisë për shkollë, prandaj preferon që ata të qëndrojnë në shtëpi. Ata fëmijë që shkojnë në shkollë gjithashtu vijojnë në qendrën mësimore Ballkan Sunflowers (OJQ). Qendra e të mësuarit ofron libra shkollorë dhe mbështet fëmijët në aktivitetet e të mësuarit. Duhet të theksohet se edhe pse fëmijët rom vijojnë shkolla të rregullta në gjuhën serbe në Graçanicë, ata mezi që komunikonin në gjuhën serbe në DFG dhe punëtori i komunitetit duhej të përkthente nga gjuha serbe në atë rome dhe anasjelltas.

## E drejta për shëndet dhe rehabilitim

### E drejta për Shëndet

Shtetet Palë njohin faktin që personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën të gëzojnë standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit pa diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Shtetet Palë do të marrin masat e nevojshme për të siguruar qasjen e personave me aftësi të kufizuara ndaj shërbimeve shëndetësore që janë të ndjeshme ndaj gjinisë, përfshirë rehabilitimin lidhur me shëndetin. Në veçanti, Shtetet Palë do të: (a) garantojnë personave me aftësi të kufizuara të njëjtën gamë, cilësi dhe standarde të shërbimeve shëndetësore pa pagesë ose të përballueshme siç iu sigurohet personave të tjerë, duke përfshirë programe dhe shërbime në fushën e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe programe të shëndetit publik; (b) garantojnë



**ato shërbime shëndetësore që u nevojiten personave me aftësi të kufizuara, për shkak të aftësisë së tyre të kufizuara, duke përfshirë edhe identifikimin e hershëm dhe intervenimin sipas rastit, si dhe shërbime të hartuara për të minimizuar dhe parandaluar aftësi të kufizuara të mëtejshme, duke përfshirë fëmijët dhe personat e moshuar; (c) garantojnë këto shërbime shëndetësore sa më pranë të jetë e mundur komuniteteve të këtyre personave, përfshirë zonat rurale; (d) t'u kërkojë profesionistëve të kujdesit shëndetësor të ofrojnë kujdes të së njëjtës cilësi për personat me aftësi të kufizuara si për të tjerët (...) (e) të ndalojë diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara në ofrimin e sigurimeve shëndetësore (...) – KDPAK Neni 25**

Sipas UNICEF-it, Kosova është ndër vendet me renditjen më të ulët në rajon sa i përket shëndetit të nënës dhe fëmijës<sup>146</sup>. Bazuar në Anketën e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë<sup>147</sup>, shkalla e vdekshmërisë së foshnjave<sup>1</sup> është vlerësuar të jetë 12 për 1000 lindje të gjalla, ndërsa shkalla e vdekshmërisë nën pesë vjeç<sup>1</sup> është 15 për 1000 lindje të gjalla. Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave në mesin e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian është tre herë më e lartë, vlerësohet 41 për 1000 lindje të gjalla, ndërsa shkalla e vdekshmërisë nën pesë vjeç është 49 për 1,000 lindje të gjalla (probabiliteti i vdekjes ndërmjet lindjes dhe moshës pesë vjeç). Përveç kësaj, sipas të dhënave të raportuara nga institucionet shëndetësore<sup>148</sup>, përqindja e vdekshmërisë perinatale (lindjet e frytit të vdekur dhe vdekjet e hershme neonatale) ka shënuar trend rënës, e vlerësuar në 12/1000 lindje në vitin 2015. Në vitin 2013, mortaliteti perinatal u vlerësua në 16.2/1000 lindje, ndërsa në vitin 2000 shkalla e vdekshmërisë perinatale u vlerësua në 29.1/1000 lindje (MSH 2016).

Psikologët në Qendrat e Mjekësisë Familjare duhet të jenë në gjendje të marrin një rol proaktiv që mund të ndihmojë në parandalimin e kushteve që çojnë në kufizim të aftësive. Çelësi i parandalimit është edukimi i prindërve për zhvillimin e fëmijës si dhe zhvillimi i një sistemi të kontrollit (skriningut) që mund të ndjekë zhvillimin e fëmijës përtej vaksinimit.

Sipas intervistave me Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), të gjitha shërbimet shëndetësore primare, sekondare dhe terciare në Kosovë janë pa pagesë për të gjithë fëmijët. Ofrimi i shërbimeve jashtë institucioneve publike lejohet dhe rregullohet me udhëzim administrativ kur pacienti ka rekomandim nga një ekip zyrtar shëndetësor (3 persona), si dhe kujdesi urgjent që mund të merret në klinikat private i paguar nga MSH. Ekziston një listë kombëtare e shërbimeve/ilaçeve esenciale, por për fat të keq, prindërit duhet të blejnë ilaçet që sipas ligjit do të duhej të jenë pa pagesë. Të gjithë të sapolindurit marrin një kartë vaksinimi që u lejon atyre të vaksinohen falas, por të gjitha rehabilitimet në spitalet rajonale janë shumë bazike dhe gati jo-ekzistente në nivel lokal.

Në një studim të porositur nga UNICEF-i në vitin 2013, nënat raportuan se sistemi shëndetësor nuk mban kontakte me fëmijët pas vitit të parë të lindjes dhe shërbimet shëndetësore dhe trajtimi mjekësor, veçanërisht trajtimi i specializuar, janë shumë të shtrenjta. Sipas intervistave të kryera me profesionistë të Divizionit të Shëndetit të Nënës, Fëmijës dhe të Shëndetit Riprodhues në MSH, shërbimet e specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara bëhen me referimin e fëmijëve tek specialistë të caktuar. Trajtimi, aftësimi dhe rehabilitimi nuk ekzistojnë në të gjitha specializimet (si paraliza

cerebrale, autizmi, etj.) pavarësisht përparimeve në identifikim, edhe pse infermierët që bëjnë vizita mjekësore në shtëpi kanë për qëllim të identifikojnë dhe referojnë fëmijët më të vegjël se 36 muajsh që janë në rrezik për aftësi të kufizuara ose vonesë.

Megjithëse përpjekjet për vizitat në shtëpi filluan në vitin 2007, ato janë zgjeruar vetëm në shtatë komuna (Prizren, Gjakovë, Dragash, Fushë Kosovë, Gjilan, Ferizaj dhe jug të Mitrovicës) në fund të vitit 2016 (me 9 të tjera në fund të qershorit 2017), me mbështetjen e UNICEF-it që nga viti 2013. Në kontekstin e përmirësimit të shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve në rrezik dhe familjeve më të cenuara, është ofruar trajnimi për të siguruar që infermierët që kryejnë vizita në shtëpi janë në gjendje të identifikojnë fëmijët në rrezik të vonesave të zhvillimit dhe/ose aftësive të kufizuara. Përveç ofrimit të një pakete shërbimesh të integruara sociale për mbi 7000 nëna dhe fëmijë, 5 qendra dhe 9 qendra të edukimit të hershëm të fëmijërisë në zonat rurale lehtësojnë zbulimin e hershëm dhe identifikimin e fëmijëve në rrezik të zhvillimit të aftësisë së kufizuar ose vonesës në zhvillim<sup>149</sup>.

Sipas të intervistuarve, infermierët duhet të kryejnë si vizitat neonatale ashtu dhe ato postnatale në shtëpi dhe të ofrojnë këshillim për familjet, të ndjekin zhvillimin e fëmijës dhe të identifikojnë vonesat. Nëse identifikohet një fëmijë me aftësi të kufizuara, numri i vizitave do të rritet sipas nevojës dhe infermieri/ja është përgjegjës për raportimin e gjendjes së familjes dhe fëmijës tek QPS, Qendra për kujdesin shëndetësor familjar, specialistët sipas nevojës dhe të tjerët. Infermierët nuk janë të detyruar të mbledhin të dhëna për fëmijët me aftësi të kufizuara edhe pse të dhënat ndahen, jo zyrtarisht, me qendrat e zhvillimit shëndetësor në komunë. Deri më tani, shërbimet janë në masë të madhe të varura nga *“vullneti i mirë”* i autoriteteve komunale dhe financimi i donatorëve, megjithëse të gjitha shërbimet duhet të mbështeten nga buxhetet komunale në të ardhmen e afërt.

Qendra e Mjekësisë Familjare në Prishtinë është përgjegjëse për koordinimin e vizitave në shtëpi dhe trajnimin e infermierëve që kryejnë vizita në shtëpi. Profesionistët e intervistuar raportojnë se shumica e shërbimeve të kërkuara për foshnjat (që lidhen me një dëmtim ose aftësi të kufizuar) ofrohen, aq sa është e mundur, pa shkaktuar një ndarje të foshnjës nga familja. Gjithsej, janë trajnuar 150 infermierë, në 7 komuna, ku përpjekje të mëdha janë bërë në bashkëpunimin ndër-departmental në nivelin komunal. Në vitin 2016, u realizuan gjithsej 6,334 vizita të fëmijëve nga 0 deri në 3 vjeç, grave shtatzëna dhe komuniteteve RAE (rom, ashkali, egjiptian) nga 200 profesionistë (infermierë, PS, mësues të çerdheve etj.). Vizitat në shtëpi mbikëqyren nga një profesionist i emëruar nga drejtorët e qendrës kryesore të mjekësisë familjare në nivel komunal, i cili është përgjegjës për të raportuar çdo tre muaj para një grupi punues ndër-departmental, i cili është gjithashtu përgjegjës për grumbullimin e të dhënave. Infermierët kosovar që kryejnë vizita në shtëpi dhe profesionistët e tjerë me mbështetjen e UNICEF-it janë trajnuar nga profesionistët e Institutit të Shëndetit Publik të Shqipërisë, nga shtatori deri në dhjetor të vitit 2016. Materialet e trajnimit përfshijnë një modul mësimor mbi aftësitë e kufizuara, që prezanton aftësinë e kufizuar nga perspektiva e aftësisë së kufizuar dhe vonesës në zhvillimin e fëmijëve si një fenomen social.

Pavarësisht përpjekjeve të mëdha për të krijuar një rrjet të infermierëve që kryejnë vizita në shtëpi në Kosovë, që mund të ndihmojnë në identifikimin e fëmijëve të vegjël

në rrezik, nga 6.334 vizita të kryera në vitin 2016, nuk ka të dhëna të disponueshme që mund të tregojnë identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, edhe pse disa fëmijë u identifikuan se kishin vonesa në zhvillim. Të intervistuarit për këtë studim ishin të pasigurt lidhur me kapacitetin teknik të infermierëve që kryejnë vizita për të identifikuar si duhet fëmijët në rrezik, por theksonin se çdo rast i dyshimtë i aftësisë së kufizuar ose vonesës në zhvillim i komunikohet një mjeku në qendrën shëndetësore komunale, i cili gjithashtu duhet të bëjë një vizitë në shtëpi.

Por, vizitat në shtëpi si të vetme nuk do të jenë të mjaftueshme për të adresuar të gjitha nevojat që lidhen me identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vonesa në zhvillim. Përderisa ekziston nevoja për zgjerimin e rrjetit të infermiereve që kryejnë vizita në shtëpi dhe institucionalizimin e rolit të tyre profesional, ekziston edhe nevoja për të zgjeruar kapacitetin e të gjithë rrjetit shëndetësor në identifikimin e dëmtimeve që mund të çojnë në kushte të aftësisë së kufizuar. Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2010-2014 përmend nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, por nuk hyn në detaje. Përderisa fëmijët me aftësi të kufizuara do të përfitojnë në mënyrë të qartë nga dispozitat e gjera të Strategjisë në fushat e kujdesit prenatal dhe antenatal, ushqimit të përmirësuar dhe kujdesit, duhet të ketë më shumë fokus në "Strategjinë për nevojat specifike të fëmijëve me aftësi të kufizuara"<sup>150</sup>, duke përfshirë identifikimin e hershëm dhe intervenimin e hershëm si thelbësor për parandalimin e vonesave dhe aftësisë së kufizuar.

Në Gjakovë dhe Ferizaj, secila komunë ka një QPS përgjegjëse për identifikimin paraprak të fëmijës/personit me aftësi të kufizuar që aplikon për ndihmë financiare. Lista me dokumentacionin e nevojshëm i prezantohet Panelit Vlerësues të Shëndetit në MPMS që është përgjegjëse për vlerësimin, rezultati i të cilit pastaj i komunikohet MPMS-së, subjekti përgjegjës për disbursimin prej 100 euro/muaj për familje që fiton të drejtën. Qendrat e Mjekësisë Familjare gjithashtu bashkëpunojnë me shkollat dhe me të miturit në Ferizaj, ku ka një neuropsikiatër që është në gjendje të punojë me të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar dhe të gjithë fëmijët e moshës nga 1 deri në 18 vjeç dhe të cilët zakonisht përfshihen në vlerësimin fillestar dhe në përshkrimin e *trajtimit*. Puna në mënyra multidisiplinare është ende shumë e re dhe disi problematike për shkak të dallimeve në trajnimin e profesionistëve të shëndetësisë: disa janë në gjendje të marrin pjesë në vlerësime komplekse dhe shumëdimensionale, ndërsa të tjerët barazojnë aftësinë e kufizuar me një numër IQ-je. Ky variacion në kapacitetin profesional ndikon edhe në atë se cili person fiton të drejtën për një pension të aftësisë së kufizuar.

Raportohet se shumica e fëmijëve me aftësi të kufizuara që jetojnë në veri të Mitrovicës kanë qasje në shërbimet shëndetësore dhe rehabilitim në Qendrën e Shëndetit Publik në Zveçan. Medikamentet që janë në dispozicion mund të merren pa pagesë me recetën e mjekut, por fëmijët me nevoja më komplekse shkojnë në Beograd ose në qytete të tjera në Serbi ose jashtë vendit për trajtim. Nuk ka shërbime shëndetësore në shtëpi.

Save the Children raporton se identifikimi i hershëm në komunën e Prishtinës, në përgjithësi kryhet në njësinë neonatale të Qendrës Klinike Universitare për foshnjat deri në 28 ditë. Megjithatë, kjo nuk është e mundur në zonat rurale dhe nuk ndihmon

në identifikimin e aftësive të kufizuara që nuk janë të dukshme menjëherë pas lindjes. OPAK Down Syndrome raportoi se diagnoza e Sindromës Down deri në 3 ose 4 vjet më parë konsiderohej një diagnozë e re. Megjithatë, përgjithësisht, identifikimi i hershëm thuhet se është problematik, siç tregohet nga një studim që arriti në përfundimin se nuk ekziston një mekanizëm i integruar i identifikimit të hershëm në Kosovë. Ekzistojnë institucione të ndryshme që kanë ekipet e tyre të ndryshme të vlerësimit për qëllimet e tyre, por nuk ekziston një strategji e integruar e përbashkët në bazë të së cilës do të kryhet vlerësimi ose identifikimi i hershëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në Prishtinë, tre prindër deklaruan se besonin që fëmijët e tyre nuk do të mbeteshin me aftësi të kufizuara nëse do të identifikoheshin dëmtimet më herët dhe nëse shërbimet shëndetësore adekuate do të siguroheshin në kohën kur u paraqitën shenjat e para. Gjendja e aftësisë së kufizuar të tyre është përkeqësuar edhe më tej, sepse nuk ka pasur trajtim urgjent të fëmijëve të tyre nga personeli mjekësor dhe ka pasur mungesë të ekspertizës për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të aftësisë së kufizuar.

Të gjithë ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, të intervistuar për këtë studim, si dhe ata që morën pjesë në DFG ishin të bindur në raportimin se shërbimet e kujdesit shëndetësor janë falas në spitalet shtetërore dhe klinikat lokale të shëndetit. Prindërit/kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara pajtohen me këtë vlerësim, por gjithashtu raportojnë se edhe pse të gjithë fëmijët duhet të shkojnë në spitalet shtetërore për kujdes mjekësor, nuk ka shërbime të specializuara në dispozicion. Më tej, prindërit raportojnë se cilësia e shërbimeve shëndetësore është më e keqe në klinikat publike sesa në klinikat private, me pritje shumë më të gjata, që raportohet të jenë me orë të tëra dhe kostot e trajtimeve të specializuara janë shumë të larta.

Puna me profesionistët, ngritja e vetëdijes dhe njohurive mbi aftësinë e kufizuar u përmend gjithashtu nga OPAK-të në DFG. Për shembull, OPAK Down Syndrome punon me mjekët mbi mënyrën se si të komunikojnë me prindërit, si të shpjegojnë diagnozën e fëmijës së tyre, sidomos nënave, pasi është shumë e vështirë që të pranojnë se fëmija i tyre ka sindromën Down. Ka shumë raste kur pediatri ua ka komunikuar diagnozën prindërve në një mënyrë të pasjellshme/indiferente, shpesh duke dhënë informacione ç'orientuese si p.sh duke u thënë prindërve se fëmija i tyre nuk do të jetojë më gjatë se moshë 12 vjeç.

Sipas fëmijëve me aftësi të kufizuara që morën pjesë në DFG për këtë studim, kujdesi shëndetësor ndaj tyre varion në varësi të rajonit. Përderisa fëmijët në Gjakovë raportuan se shkonin tek mjeku për kontrolle të rregullta shëndetësore dhe shërbime më të specializuara, fëmijët në Ferizaj raportuan se nuk merrnin ndonjë kujdes shëndetësor, as për trajtime të rregullta (si gripi) e as për kujdes të specializuar. Një fëmijë në rajonin e Prishtinës tha se **“mjeku më i afërt është 4 kilometra larg shtëpisë sonë ..... rruga është shumë e keqe .... ne shkojmë tek mjeku privat .... në ambulancë (të shtetit) pranojnë vetëm emergjencë”**, ndërsa dy fëmijë të shurdhër nga Prizreni, të cilët shkojnë në shkollë speciale, kanë raportuar se kanë kontrolle të rregullta mjekësore në shkollën speciale dhe nëse ka çështje më serioze për t'u adresuar, atëherë ata referohen për në spital dhe përkthyesi i shoqëron ata.

Duke konfirmuar deklaratat e prindërve, fëmijët me aftësi të kufizuara raportuan raste të udhëtimit në distanca të largëta, ndonjëherë jashtë vendit, për të kërkuar shërbime të specializuara që lidhen me dëmtimet e tyre. Në Gjakovë, dy (2) fëmijë përmendën intervenimet më serioze, si operacionet që janë ndërmarrë në Prishtinë dhe Shqipëri. Po kështu, në Prishtinë, tre fëmijë (të verbër) kanë përdorur shërbime shëndetësore jashtë vendit, për diagnostikim ose trajtim (Shqipëri, Maqedoni dhe Rusi) dhe pothuajse të gjitha shpenzimet janë mbuluar privatisht. Vetëm një fëmijë raportoi se ka marr mbështetje financiare nga Ministria e Shëndetësisë për një operacion në Maqedoni, në një spital të specializuar privat.

Në Gjakovë dhe Ferizaj, shumica e prindërve që morën pjesë në DFG raportuan se i merrnin fëmijët e tyre në klinika private për vizita në lidhje me aftësitë e kufizuara, pavarësisht se të gjitha kontrollet mjekësore private paguhën nga xhepi, shpesh në një nga qytetet më të mëdha, ndonjëherë edhe jashtë vendit. Pesë (5) prindër i dërgojnë fëmijët në klinika private të cilat ata mezi mund t'i përballojnë: **“Djali im ka nevojë për shumë terapi mjekësore. Mbështetja financiare prej 100 eurosh pothuajse është hiq”** (nënë, Gjakovë). Dy (2) prindër thuhet se kanë aplikuar për mbështetjen e MSH për të dërguar fëmijët e tyre për trajtim jashtë vendit dhe kanë pritur me muaj për një përgjigje.

Prindërit nga zonat rurale në rajonin e Prishtinës raportojnë se u duhet të shkojnë në Prishtinë (qytet) ose jashtë vendit për shërbimet shëndetësore. Shpesh, ata marrin shërbime private, dhe paguajnë gjithashtu për të gjitha ilaçet: **“Duhet të udhëtoja të paktën 5-7 km deri në qendrën më të afërt shëndetësore dhe zakonisht duhet të prisja në një radhë të gjatë për kontroll mjekësor. Kishte raste kur më duhej të kthehesha në shtëpi pa qenë në gjendje të kryeja ndonjë ekzaminim mjekësor të fëmijës tim, sepse lodhej pas një udhëtimi të gjatë dhe duke pritur në radhë, dhe pasi askush nuk kishte konsideratë për ne”** (nënë, Prishtinë). Për më tepër, prindërit në zonat rurale raportuan se kanë ndërprerë dërgimin e fëmijëve të tyre për shërbime të specializuara (psikolog, psikiatër, logoped etj.), sepse nuk mund t'i përballojnë ato.

Në Prizren, prindërit u ankuan si për shpenzimet ashtu dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor. Të gjithë prindërit raportuan se, në shumicën e rasteve, fëmijët shkojnë në spitalin shtetëror dhe në klinikat publike, sepse nuk mund të përballojnë asgjë tjetër, ndonëse rezultatet nuk janë inkurajuese. Dy prindër raportojnë se fëmijët e tyre kanë pasur intervenime kirurgjike të shumëfishta, të cilat nuk kanë dhënë rezultate të dukshme dhe një nënë beson se aftësia e kufizuar e fëmijës së saj është për shkak të mungesës së njohurisë së mjekut kur fëmija ka lindur: **“Unë besoj se truri i saj është dëmtuar për shkak të ushqyerjes së dobët me gji pasi mjekët gjithmonë insistonin për këtë edhe pse ajo ishte shumë e dobët për t'u ushqyer vetë me gji. Që atëherë, truri i vajzës nuk ishte zhvilluar mirë dhe pastaj filloi të kishte probleme edhe me sytë”**.

Në Mitrovicën Veriore, të gjithë prindërit i dërgojnë fëmijët në institucionet publike shëndetësore. Ato kanë medikamente esenciale në dispozicion, por duhet të shkojnë në Beograd për medikamente më specifike, shpesh me një çmim më të lartë, sepse ato nuk janë në dispozicion në nivel lokal. Për trajtime të specializuara ata shkojnë në klinika private në qytete të mëdha, shpesh jashtë Kosovës. .

Përkundër raporteve sikurse ato të përmendura më lartë dhe që tregojnë se jo vetëm kosto, por edhe cilësia e kujdesit shëndetësor janë të diskutueshme në Kosovë, Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara (SKPAK) parasheh që themelimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore do të ndryshojë vështirësitë ekzistuese të përjetuara nga personat me aftësi të kufizuara në qasjen në kujdes shëndetësor; prandaj, e vetmja dispozitë në SKPAK është parashikimi se ndryshimi në mënyrat në të cilat financohet kujdesi shëndetësor do të përmirësojë dispozitat e përgjithshme shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara. Por, në sistemin shëndetësor, fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk u sigurohen gjithmonë ilaçe falas dhe pajisje të tjera për të ndihmuar në përmirësimin e shëndetit të tyre, për të përmirësuar mobilitetin e tyre dhe për t'u ofruar atyre një jetë dinjitoze.<sup>151</sup>

## Theksi mbi fëmijët rom dhe ashkali me aftësi të kufizuara

Vetëm 4 prindër nga 9 prindërit e komunitetit ashkali mund të tregonin për dëmtimet ose aftësinë e kufizuar të fëmijëve të tyre. Ata treguan se shumica e fëmijëve të tyre kanë lindur të shëndetshëm dhe se problemet janë shfaqur menjëherë pas lindjes së tyre. Si shkaqe të aftësisë së kufizuar, prindërit përmendën lindjen e parakohshme, ethet dhe vështirësitë gjatë lindjes së fëmijës. **“Ajo lindi para kohe dhe më pas u mbajt në inkubator për 2 muaj dhe aty i'u dëmtua të pamurit”** (nëna e një vajze të verbër). Nga të 6 prindërit, vetëm një nga prindërit e komunitetit rom mund të tregonte dëmtimin ose aftësinë e kufizuar, një tumor në tru që çoi në verbëri.

Të tjerët mbanin në mend kur identifikuan ose panë vështirësitë, por nuk mund të thoshin diagnozën.

Prindërit ashkali raportuan se shumica e fëmijëve ishin pjesërisht të imunizuar. Ata morën imunizim fillestar kur u lindën në spital (të gjithë fëmijët ishin të lindur në spitale), por që nga atëherë nuk u vizituan më kurrë nga punonjësit shëndetësorë për vaksinim të mëtejshëm dhe nuk i dërguan fëmijë për imunizim të mëtejshëm. Sipas prindërve, një fëmijë nuk është imunizuar asnjëherë. Në DFG-në e komunitetit rom, vetëm një kujdestar, që kishte dy vëllezër me dëmtime fizike, deklaroi se nuk ishin vaksinuar fare pasi nuk frekuentonin rregullisht shkollën, ku bëhej zakonisht vaksinimi.

Prindërit i dërgojnë fëmijët e tyre në Prishtinë dhe Beograd për trajtim të specializuar, por shumica e tyre nuk mund të përballojnë shumën për trajtime të rregullta. Në komunën e tyre, ata marrin pjesë në shërbimet shëndetësore falas për nevojat themelore, me përjashtim të barnave, për të cilat u duhet të paguajnë. Ata gjithashtu raportuan se duhet të presin në radhë të gjata së bashku me pacientë të tjerë dhe që nuk ka përparësi për fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara. Vetë fëmijët rom nuk raportuan të kenë vizituar shërbimet shëndetësore. Disa prindër deklaruan se ata duhej të dërgonin fëmijët e tyre në Beograd për trajtim të specializuar (kirurgji) por se është shumë i shtrenjtë për ta dhe që shpesh nuk mund ta përballojnë atë.

Për aq sa ata kanë njohuri, në komunën e tyre nuk ka shërbime të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara. Një nga prindërit që ka dy fëmijë me aftësi të kufizuara tha se ajo nuk mund të përballonte financiarisht të dërgonte një nga vajzat e saja tek mjeku, edhe pse vajza ka vështirësi serioze në të folur.



## E drejta për Aftësim (habilitim) dhe Rehabilitim

Shtetet Palë do të ndërmarrin masat e duhura, duke përdorur edhe mbështetjen e moshatarëve, për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuara të arrijnë dhe të ruajnë pavarësinë e tyre maksimale, aftësinë e plotë fizike, mendore, shoqërore dhe profesionale, dhe për të siguruar përfshirjen dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në të gjitha aspektet e jetës. Për këtë qëllim, Shtetet Palë do të organizojnë, fuqizojnë dhe zgjerojnë shërbimet aftësuese dhe rehabilituese gjithëpërfshirëse, veçanërisht në fushat e shëndetit, punësimit, edukimit dhe shërbimeve sociale, në mënyrë të tillë që këto shërbime dhe programe: (a) Të fillojnë në fazën më të hershme të mundshme dhe të jenë të bazuara në vlerësimet multidisiplinare të nevojave dhe fuqive individuale; (b) Të mbështesin pjesëmarrjen dhe përfshirjen në komunitet dhe në të gjitha aspektet e shoqërisë dhe të sigurohen që ato janë mbi baza vullnetare të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara sa më pranë komuniteteve të tyre të jetë e mundur, duke përfshirë zonat rurale. 2. Shtetet Palë do të inkurajojnë organizimin e trajnimeve të nivelit fillestar dhe të vazhdueshëm për profesionistët dhe stafin që punon në shërbimet aftësuese dhe rehabilituese. 3. Shtetet Palë do të inkurajojnë disponueshmërinë, njohuritë dhe përdorimin e pajisjeve dhe teknologjive asistuese të projektuara për personat me aftësi të kufizuara, duke qenë se ato lidhen me aftësimin dhe rehabilitimin. - KDPK Neni 26

Siç është raportuar nga kujdestarët, në komunat e përfshira në këtë studim, shërbimet e vizitave në shtëpi nuk ofrohen as nga QPS-të, as nga profesionistët e kujdesit shëndetësor. Në Gjakovë, disa vizita shtëpiake bëhen nga HandiKOS, ndërsa në Prizren vizitat në shtëpi bëhen nga HandiKOS dhe PEMA. Një analizë e kryer nga KOMF në vitin 2014<sup>152</sup> tregoi se shërbimet psikosociale dhe rehabilituese për fëmijët me aftësi të kufizuara janë ofruar në vetëm 4 qendra të kujdesit ditor në Kosovë (Pejë, Ferizaj, Gjilan dhe Prizren). Në vitin 2014, qendrat e kujdesit ditor ishin një kombinim i bashkëpunimit qeveritar dhe joqeveritar dhe buxhetet komunale pritej t'i përfshinin ato sapo të përfundonin projektet fillestare.

Në Kosovë, fëmijët me aftësi të kufizuara ballafaqohen me barrierat e mungesës së qendrave të kujdesit ditor ku mund të trajtohen, ndihmohen ose mbështeten për integrim të barabartë në shoqëri. Asnjë komunë nuk ofron një mbështetje të tillë, e cila ekskluzivisht ofrohet nga OJQ-të, dhe si e tillë nuk është e qëndrueshme.<sup>153</sup> PEMA, një OJQ e themeluar në dhjetor të 2013-së, deri në vitin 2015 krijoi katër qendra të kujdesit ditor, të cilat thuhet se ishin "shembuj të praktikave më të mira dhe që krijuan mekanizma të fortë referimi me institucionet e tjera". Megjithatë, financimi i projektit nga Bashkimi Evropian përfundoi në vitin 2015.<sup>154</sup>

Thuhet se qendrat tani po bëjnë përpjekje të mëdha për të mbijetuar pa buxhet.<sup>155</sup> Trajtimi i kësaj gjendje kërkon që strukturat qeveritare të sigurojnë mbështetje materiale dhe buxhetore për qendra të tilla.<sup>156</sup>

Siç raportohet nga Drejtori i QPS-së në rajonin e Gjakovës, në rajonin e tij nuk ekzistojnë qendra të kujdesit ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara që mund të ofrojnë shërbime rehabilitimi, pavarësisht se komuna ka bërë një plan që u refuzua nga qeveria qendrore. Ai i konsideron qendrat e kujdesit ditor si shumë të rëndësishme për komunën, sepse aktualisht, në momentin që një fëmijë identifikohet se është me

aftësi të kufizuar, ata duhet t'i referohen një OJQ-je për shërbime, të cilët shpesh janë ato që kanë identifikuar fëmijën dhe e kanë identifikuar atë për kontroll.

Siç raportohet, QPS-ja e Gjakovës nuk ka kapacitetin për të ndërmarrë aktivitete në terren apo për të bërë identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në komunë; QPS-ja punon vetëm me familjet dhe fëmijët që kërkojnë ndihmë nga ta. **“Komuna nuk ka përcaktuar ndonjë buxhet për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, ata vetëm paguajnë pagat e personelit dhe për shpenzimet e tjera operationale të QPS-së”**.

Sidoqoftë, OJQ-ja PEMA raporton se ka hapur qendra të kujdesit ditor në katër komuna, duke ofruar shërbime për rreth 350 fëmijë me aftësi të kufizuara mbi moshën 6 vjeç. Shumica e shërbimeve fokusohen në mbështetjen psiko-sociale, terapinë e të folurit dhe gjuhës, në mbështetjen familjare dhe në shëndetin e familjes. Në fund të vitit 2016, përgjegjësia për qendrat e kujdesit ditor ishte e supozuar të bartej tek autoritetet komunale.

Të gjithë të anketuarit në këtë studim me njohuri rreth ofrimit të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara përmendën (me thellësi të ndryshme të njohurive) HandiKOSin si një nga ofruesit më të vjetër të shërbimit në Kosovë. Fillet e saj datojnë që nga viti 1983, edhe pse trajektorja e tyre ka ndryshuar me kalimin e kohës. Fokusi i organizatës është në personat me lëvizshmëri të kufizuar, si në ofrimin e teknologjisë qasëse/ndihmëse ashtu edhe në mbështetje ligjore.

Megjithatë, HandiKOS gjithashtu merret me identifikimin dhe intervenimin e hershëm për shkak të rrjetit të gjerë të organizatave partnere dhe personelit të përfshirë. Sipas drejtorit të tyre, HandiKOS ka qenë aktiv në terren për 16 vite dhe, ndërkohë që kanë zhvilluar ndërhyrje dhe aktivitete për të trajtuar nevojat aktuale, këto aktivitete duhet të kishin kaluar në duar tjera tani, pasi shumë nga rolet dhe përgjegjësitë e tyre i përkasin institucioneve qeveritare dhe profesionistëve të shëndetësisë/rehabilitimit. Aktualisht, HandiKOS ka 58 punonjës me orar të plotë, në të gjithë vendin, dhe më shumë se 25 vullnetarë që punojnë kryesisht në baza ad-hoc, sipas-nevojës. Ata gjithashtu kanë 20 makina/furgone, disa prej të cilave janë përshtatur për personat me lëvizshmëri të kufizuar. Personeli punon si në qendër ashtu edhe në baza shëtitëse (ambulate). Financimi i HandiKOS është një përzierje e fondeve të donatorëve dhe tenderit të ofrimit të shërbimeve nga komunat. Siç është përkthyer, HandiKOS e gjen veten në një pozitë shumë të vështirë pasi që aplikon për financim qeveritar për të ofruar shërbimet, ndërsa avokon për një ndryshim në ofrimin e shërbimeve nga ai mbi baza të OJQ-ve në institucionalizim qeveritar.

Siç raportohet nga prindërit (59 raste në 7 lokacione) gjatë DFG-së, raportohet se shumica e fëmijëve marrin shërbimet nga HandiKOS, në qendrat e tyre ose në shtëpi, me përjashtim të fëmijëve në veri të Mitrovicës dhe në komunitetet rom dhe ashkali. Shërbimet ndryshojnë sipas vendndodhjes dhe kërkesave të fëmijës, por ato fokusohen në socializimin, mbështetjen bazë të arsimit, rehabilitimin fizik dhe mbështetjen psikologjike. Prindërit në DFG-në në Gjakovë raportuan se **«Ne kemi kërkuar nga komuna të na mbështesë përmes HandiKOS-it në ofrimin e personelit mjekësor më të specializuar në vetëm disa ditë të caktuara, kështu që ne mund t'i sjellim fëmijët tanë për kontrole mjekësore, por ata nuk bënë asgjë në lidhje me këtë kërkesë»** (baba, Gjakovë). Fëmijët e verbër dhe ata me të pamur të dobësuar të intervistuar për këtë studim (gjatë vizitës me Shoqatën e Personave të Verbër) gjithashtu raportuan se

nuk pranojnë shërbime nga HandiKOS, sepse nuk ka bashkëpunim reciprok ndërmjet HandiKOS dhe Shoqatës së të Verbërve të Kosovës. Në përgjithësi, situata e fëmijëve që janë të verbër dhe/ose me të pamur të dobësuar është përshkruar si e ndryshme nga ajo e fëmijëve tjerë, sepse ata marrin një përfitim më të lartë në të holla (250 euro/muaj) dhe përveç disa kontrolleve të përgjithshme mjekësore dhe trajtimeve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, nuk ka shërbime tjera të specializuara të disponueshme. Për ndërhyrje dhe kontrolle të tjera mjekësore më të specializuara, prindërit e tyre duhet t'i dërgojnë fëmijët jashtë vendit. Shumica e fëmijëve që janë të verbër dhe/ose ata me të pamur të dobësuar shkojnë në shkollën për të verbrit në Pejë për të mësuar Braille dhe orientimin/lëvizshmërinë.

Komunat e Gjakovës, Ferizajt dhe Prizrenit kanë të drejtën të kontraktojnë OJQ-të për ofrimin e shërbimeve të veçanta, ndërsa QPS-të mund të identifikojnë vetëm llojin e shërbimit që fëmija ka nevojë të marrë, por nuk mund të ofrojë shërbimin pasi nuk kanë as kapacitete as buxhet. Profesionistët në QPS janë të vetëdijshëm për sfidat me të cilat ballafaqohen OJQ-të dhe besojnë se pa OJQ-të që ofrojnë shërbime rehabilitimi **“tani jemi lënë në baltë të thellë”** (PS Ferizaj). Siç është raportuar si nga profesionistët ashtu dhe nga një prind në Ferizaj, mungesa e koordinimit dhe pronësisë nga zyrtarët e qeverive kombëtare dhe lokale ka pasur një ndikim të madh për jetën e fëmijëve. Për shembull, siç është raportuar nga një prind, është një vajzë 8-vjeçare e shurdhër që ka pasur një implant koklear në moshën 3 vjeçare, por pa asnjë shërbim apo përditësim të softuerit apo harduerit. Aktualisht është në moshën 8 vjeçare dhe ka probleme me aparatit e saj të dëgjimit, nëna njoftoi se ato kanë vizituar disa herë mjekët si në klinikat publike ashtu dhe ato private, por nuk kanë qenë në gjendje të gjejnë këdo që mund të ofrojë një shërbim të tillë të specializuar dhe që familja nuk mund të paguajë për riprogramimin e aparatit të dëgjimit. Siç raportohet nga ekipi hulumtues i përfshirë në DFG “vajza nuk dëgjon dhe nuk mund të flasë, si dhe duket mjaft e irrituar dhe agresive kur dikush i afrohet asaj. Ajo nuk mund të përqendrohej në asnjë diskutim dhe luante me lodra gjatë gjithë kohës, duke bërë zhurmë të madhe. As ajo e as nëna e saj nuk përdorin ndonjë gjuhë të shenjave”.

QPS-ja bashkëpunon me Save the Children dhe institucionet arsimore, ndërsa HandiKOS ofron disa shërbime të rehabilitimit fizik (125 fëmijë në Gjakovë, 30 fëmijë me aftësi të kufizuara të rënda në Ferizaj, 30 fëmijë në Prizren), si në shtëpi ashtu edhe në objektet e tyre, edhe pse OJQ-ja është e mbingarkuar me kërkesa, duke operuar me një buxhet të vogël dhe ballafaqohen me mungesën e ekspertizës për të punuar me fëmijët me dëmtime që kalojnë përtej ekspertizës së tyre me dëmtimet fizike.

Përveç shërbimeve të rehabilitimit, shumica e OJQ-ve në terren (Gjakovë dhe Ferizaj) janë kryesisht përgjegjëse për të gjitha kontaktet dhe identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve në rrezik të zhvillimit të vonshëm, ndërkohë që Save the Children ofron mbështetje psikologjike dhe ndërgjegjësim publik. Caritas identifikon fëmijët me aftësi të kufizuara (7 fëmijë me aftësi të kufizuara të moshave 7 deri në 22 vjeç në Gjakovë) brenda komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian në rajonin e Gjakovës dhe ndërmjetëson me HandiKOSin për ofrimin e shërbimeve. Në Prizren, Caritas ka zhvilluar një projekt për 9 vjet, që siguron identifikimin e hershëm dhe mbështetjen për gatishmëri për shkollë për fëmijët prej moshës 0 deri në 6 vjeç (aktualisht 50 fëmijë). Në Ferizaj, përpjekjet në lidhje me identifikimin e hershëm kanë qenë një përpjekje e përbashkët e QPS/HandiKOS.

Pothuajse gjithkush dhe çdo organizatë bëjnë gjëra të shumëfishta: mbështetje në edukim dhe identifikim të hershëm, identifikimi i hershëm dhe ndërgjegjësimi i publikut, shërbimet shëndetësore dhe identifikimi i hershëm, etj.

Asociacioni i Kosovës për të verbrit dhe personat me të pamur të pjesëshëm ka avokuar për të drejtat e personave me të shikim të dobësuar) në Kosovë që nga viti 1947. Sot organizata është e angazhuar si në avokimin e të drejtave të personave me të meta në shikim ashtu edhe ofrim të shërbimeve, si ofruer i licencuar i shërbimeve të Braille, orientim dhe lëvizshmërisë, dhe Teknologjisë Informative për të Verbrit. Shoqata fokusohet në integrimin social dhe punësimin dhe ishte përgjegjëse kryesore për përparimet legjislative në vitet e fundit. Për sa i përket aftësisë së tyre për grumbullimin e të dhënave, shoqata raporton se u shërben rreth 500 fëmijëve me shikim të dobësuar, nga të cilët 127 përfitojnë në të holla (95% deri në 100% të verbër). Shoqata, sikurse HandiKOS më lart, funksionon me një kombinim të pagesave të anëtarësisë të shoqatës, fondeve të donatorëve dhe tenderit të qeverisë për shërbimet që ofrohen për personat me shikim të dobësuar.

### Theksi mbi fëmijët rom dhe ashkali me aftësi të kufizuara

Në grupin ashkali, shërbimet e vetme që u ofrohen fëmijëve janë nga OJQ-ja Ideas for Partnership, që ofron disa ilaçe dhe terapi fizike. Ata nuk janë në dijeni për shërbimet që HandiKOS mund të ofrojë, përveç dy prindërve që raportuan se nga HENDIKOS kanë pranuar ndihmë në formë të karrocave speciale, si dhe terapisë fizike për një kohë të shkurtër. Me përjashtim të mbështetjes së qendrave të mësimin në komunitet që u ofrohen fëmijëve të komunitetit rom, asnjë nga fëmijët me aftësi të kufizuara nuk merr ndonjë shërbim dhe as nuk dinë se si të kenë qasje në shërbimet e një OJQ-je.

## Asgjë Për Ne, Pa Ne

Paragrafi më poshtë përfshin të drejtën për pjesëmarrje në jetën politike dhe publike - Neni 29 - dhe të drejtën për pjesëmarrje në jetën kulturore, rekreative, argëtuese dhe sportive - Neni 30, të KDPAK.

**Shtetet Palë do t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullsisë dhe do të marrin përsipër:(a) T'u garantojnë personave me aftësi të kufizuar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, duke përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësitë kufizuar për të votuar dhe për tu zgjedhur (...) (b) garantimin e një ambienti, në të cilin personat me aftësi të kufizuar mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në dirigjimin e çështjeve publike, pa diskriminim dhe njësoj si të tjerët dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në çështjet publike, duke përfshirë: (i) Pjesëmarrjen në organizatat joqeveritare dhe shoqatat që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend dhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike;**

(ii) Krijimin apo pjesëmarrjen në organizata të personave me aftësi të kufizuar për të përfaqësuar personat me aftësi të kufizuar në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale. -KDKAK Neni 29

Shtetet Palë njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të marrë pjesë njësoj si gjithë të tjerët në jetën kulturore të vendit dhe do të marrin të gjitha masat e duhura për të garantuar që personat me aftësi të kufizuar:

(a) Gëzojnë qasje në materialet kulturore në të gjitha formatet e qasshme;(b) Gëzojnë qasje në programet televizive, filmat, teatrot, dhe aktivitete të tjera kulturore, në formate të qasshme; (c) Gëzojnë qasje në institucionet apo shërbimet kulturore, si p.sh: teatrot, muzeumet, kinematë, bibliotekat dhe shërbimet për turistët dhe për sa është e mundur gëzojnë qasje në monumentet dhe qendrat me rëndësi për kulturën kombëtare (...) t’u japin mundësinë personave me aftësi të kufizuara për të zhvilluar dhe shfrytëzuar potencialin e tyre krijues, artistik dhe intelektual, jo vetëm për të mirën e tyre, por edhe për pasurimin e shoqërisë.

(...) ndërmarrja e të gjithë hapave të duhur, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, për të siguruar që ligjet që mbrojnë të drejtat e pronësisë intelektuale nuk përbëjnë një pengesë të paarsyeshme ose diskriminuese për personat me aftësi të kufizuara, që të kenë qasje në materialet kulturore. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë, në baza të barabarta me të tjerët, në njohjen dhe mbështetjen e identitetit të tyre kulturor dhe gjuhësor, duke përfshirë gjuhët e shenjave dhe kulturën e komunitetit të të shurdhërve. Me synimin për t’u mundësuar personave me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në aktivitete rekreative, të kohës së lirë dhe sportive, shtetet palë marrin masat e duhura: (a) Për të inkurajuar dhe nxitur pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në aktivitetet sportive gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet;(b) Për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar të kenë mundësinë të organizojnë, zhvillojnë dhe marrin pjesë në aktivitete sportive specifike dhe argëtuese për aftësinë e kufizuar dhe për këtë qëllim, të inkurajojnë ofrimin e instruksioneve, trajnimit dhe burimeve të duhura, njësoj si gjithë të tjerët;(c) Për të siguruar qasjen e personave me aftësi të kufizuar në terrenet sportive, argëtuese dhe turistike;

(d) Për të siguruar qasjen e barabartë të fëmijëve me për të marrë pjesë në lojra, argëtime, aktivitete sportive dhe të kohës së lirë, duke përfshirë edhe aktivitetet që zhvillohen në sistemin shkollor;(e) Për të siguruar qasjen e personave me aftësi të kufizuar në shërbimet argëtuese, turistike, sportive dhe të kohës së lirë. - KDKAK Neni 30

Në vitin 2013, një raport i UNICEF mbi jetën e fëmijëve me aftësi të kufizuara, tregoi se “OPAK-të tentojnë të përqendrohen pothuajse ekskluzivisht në nevojat e anëtareve të tyre, shpesh deri në pikën e kritikimit të shoqatave të tyre partnere. Pas 20 vjetësh mbështetje ndërkombëtare qeveritare, do të ishte me vend të shpresonim se komuniteti i OPAK do të ishte zhvilluar më tutje. Në praktikë, duket sikur ata nuk bashkëpunojnë dhe vetëm disa janë të gatshëm të bashkëpunojnë me qeverinë. Por komuniteti i OPAK aktualisht po ballafaqohet me një realitet të ri, fokusi i financuesve po zhvendoset në toka të reja, paratë po harxhohen, OPAK-të e reja po garojnë për burimet e pakta që janë në dispozicion. Ekziston një nevojë e vërtetë për një aktivitet vizionimi dhe ripozicionimi me komunitetin e OPAK. OPAK duhet të ndryshojnë mentalitetin e tyre. Nuk duhet të jetë befasues fakti që problemet e mungesës së transparencës, nevojës për demokratizim dhe decentralizim, probleme këto të

mirënjohura në komunitetin jo me aftësi të kufizuara në Kosovë, do të prekin po ashtu edhe komunitetin e OPAK<sup>157</sup>. Megjithatë, komuniteti i personave me aftësi të kufizuara në Kosovë është duke u organizuar dhe përkushtohet për të punuar në partneritet. Në dhjetor të vitit 2016, nëntë OPAK nënshkruan *Deklaratën mbi Forcimin e Forumit*<sup>158</sup>, “që unifikon lëvizjen e aftësisë së kufizuar në Kosovë”. Qëllimi i Deklaratës është të riafirmojë angazhimin e tyre në përmirësimin e “koordinimit të punës së tyre në një mënyrë që do t’u mundësojë atyre të bëhen më reprezentativë dhe më efektiv në promovimin e të drejtave shoqërore dhe njerëzore të personave me aftësi të kufizuara dhe mundësive të barabarta”

Sipas Raportit të PERSON për Kosovën mbi Kapacitetet Ligjore<sup>159</sup>, edhe pse organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të themeluara nga personat me aftësi të kufizuara dhe anëtarët e familjeve të tyre ekzistojnë në Kosovë, qasja e tyre ndaj çështjeve të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara mbetet e fragmentuar dhe ndikohet shumë nga interesat e ngushtë të disa komuniteteve me aftësi të kufizuara, të cilat këto organizata përfaqësojnë. Përveç kësaj, për shkak të mungesës së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, shumica e OSHC-ve ekzistuese janë mbingarkuar me nevojën për të ofruar shërbime për komunitetin, duke i lënë kështu shumë pak mundësi për të vepruar si avokatë për të drejtat e tyre. Mungesa e një zëri të unifikuar që vjen nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre e bën këtë komunitet të cenueshëm kur është fjala për avancimin e interesave të tyre në politikën, ligjet dhe shërbimet, për të cilat përfituesit përfundimtarë janë personat me aftësi të kufizuara”.

Siç është përmendur në dy DFG-të të ndara, palët e interesuara nga sektorë të ndryshëm zakonisht nuk kanë mundësi që të diskutojnë gjërat me interes të përbashkët. DFG-të e zhvilluara për këtë studim, shpesh janë përdorur nga pjesëmarrësit për të shkëmbyer ide dhe për të mësuar rreth punës së njëri-tjetrit. Përfaqësuesit e komunave në DFG-të u befasuan shpesh nga angazhimi i OPAK dhe OJQ-ve në kuadër të jetës së fëmijëve me aftësi të kufizuara, ndërsa OPAK dhe OJQ-të panë DFG-të si mundësi për të bërë që zërat e tyre të ndëgjohen nga zyrtarët qeveritarë.

Në Kosovë, pjesëmarrja në jetën shoqërore për fëmijët me aftësi të kufizuara është jashtëzakonisht e kufizuar. Ndërsa infrastruktura padyshim kufizon lëvizjet e tyre në shtëpi, në shkollë, në komunitetet e tyre dhe në qasjen në institucione publike, qëndrimet e shoqërisë duket të jenë një barrierë shumë më e madhe. Siç shihet më lart, qëndrimet diskriminuese dhe ngacmimi janë mbizotërues në mjediset shkollore. Nëse marrim parasysh se pjesa më e madhe e jetës së fëmijës kalohet në shkollë, nuk është çudi që fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre e raportojnë jetën shkollore si shumë të vështirë.

Kur u pyetën për shtrirjen e jetës së tyre sociale dhe kulturore, fëmijët me aftësi të kufizuara që morën pjesë në DFG-të kishin përgjigje të ndryshme. Dy (2) djem përmendën se nuk marrin pjesë në asnjë ngjarje jashtë familjes së tyre: “Unë nuk dal ... qëndroj (në shtëpi) ... nuk bashkohem me familjen time kur dalin” (djaloshi 15 vjeçar); “Unë nuk dal të ecë ... Qëndroj në shtëpi me vëllain tim” (djaloshi 7 vjeçar). Të tjerët u përgjigjën pozitivisht, duke treguar se dalin me familjen dhe shokët, si dhe marrin pjesë në aktivitetet e komunitetit: “Shkoj në pallatin e kulturës për të parë shfaqje ...



dhe shkoj në ahengjet familjare” ( vajza 11 vjeçare). Siç është vërejtur nga personeli i HandiKOS dhe nga disa prindër, fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda dhe më të dukshme (intelektuale/fizike/shqisore) nuk duket të jenë të përfshirë në aktivitetet e komunitetit apo në ndonjë jetë kulturore përveç jetës familjare, kushërinjve të afërt ose vëllezërve apo motrave, ose vetëm me disa shokë nga lagja e tyre. Ata nuk ndjehen të sigurt për t’u ndarë nga nënat e tyre ose për të shkuar larg shtëpive të tyre dhe larg zonës së shkollës. Disa prej tyre nuk janë fare komunikues, janë të ndrojtur dhe nuk mund ta shprehin veten pa mbështetjen e nënës së tyre.

Siç raportohet nga 59 prindër të cilët kanë marrë pjesë në DFG-të dhe siç konfirmohet prej shumë fëmijëve, më shumë se gjysma e fëmijëve janë të paktën pjesërisht të varur nga një prind/kujdestar për të kryer disa aktivitete themelore të jetës (të ushqyerit, higjienën, të veshurit, vajtja në shkollë, etj.). Njëmbëdhjetë (11) fëmijë nga 43 prej tyre, janë krejtësisht të varur, ndërsa vetëm 2 prej tyre thuhet se janë në gjendje të jetojnë në mënyrë të pavarur. Nga 43 të anketuar, 31 ishin nëna, të cilat të gjitha raportuan se ishin kujdestarët kryesor të fëmijës.

Të gjithë 59 prindërit raportuan se fëmijët e tyre kalojnë pjesën më të madhe të kohës me familjet e tyre më të ngushta (në zonat urbane) si nëna/babai dhe motrat e vëllezërit, ndonëse familjet në zonat rurale raportuan se fëmijët e tyre gjithashtu kalojnë kohë me anëtarët e familjes më të gjerë (hallat/axhallarët, kushërinjtë, gjyshet, etj.). Fëmijët në zonat rurale raportuan gjithashtu se kanë një rreth më të gjerë të pjesëmarrjes në jetën shoqërore sesa fëmijët në zonat urbane, pasi fqinjët dhe anëtarët e familjes duket se janë më mirëkuptues lidhur me aftësitë e kufizuara të tyre. Fëmijët kur nuk janë në shkollë, ata kalojnë kohën në shtëpi, duke shikuar televizor, duke lexuar, duke dëgjuar muzikë dhe duke luajtur me vëllezërit e motrat. Nga të gjithë prindërit (59), 6 nga ta në 5 vendndodhje kanë raportuar se fëmijët e tyre nuk kanë asnjë shok, por vetëm 3 nga prindërit raportuan se fëmija i tyre është i mbyllur në shtëpi dhe rrallë herë del jashtë shtëpisë.

Nga 62 fëmijët me aftësi të kufizuara që morën pjesë në DFG, nëntë (9) nga ta raportuan se nuk kishin asnjë shok, ndërkohë që shumica e fëmijëve raportuan se shokët e tyre janë anëtarët e familjes së tyre të afërt, si vëllezërit e motrat apo kushërinjtë. Fëmijët me aftësi të rënda të kufizuara që vijojnë shkollën, kanë vetëm shokë nga shkolla, dhe pothuajse të gjithë fëmijët kanë raportuar se luajnë vetëm në shtëpi. Një vajzë 15 vjeçare, e cila duhej të braktiste shkollën, tha: **“Mërzitem, bëhem emocionale kur e shoh shkollën ... .. Mërzitem në shtëpi ... Jam mësuar me aktivitete (në shkollë). Unë nuk kam shoqëri, kaloj kohë vetëm me familjen time në shtëpi ... largimi nga shkolla më ka bërë të ndihem e mërzitur... Jam ndarë nga shoqet e mia”**. Dy fëmijë, të moshës 8 vjeç dhe 14 vjeç, të verbër, raportojnë se nuk kanë asnjë shok të ngushtë dhe se nuk ndihen plotësisht të pranuar nga shokët tjerë në shkollë, ndërsa një vajzë tjetër në Prizren, e cila është e shurdhër, ka raportuar se ka shumë shokë, por shumica e tyre i përkasin komunitetit të shurdhër. Një vajzë tjetër, gjithashtu e shurdhër dhe që vijon mësimet në të njëjtën shkollë speciale, raportoi se ajo ka shumë shokë në mesin e njerëzve të shurdhër, por që nuk ka shokë që nuk janë të shurdhër. Ajo konsideron se rrjeti shoqëror është burim shumë i rëndësishëm për mbajtjen e njerëzve që janë të shurdhër të lidhur me njerëzit e tjerë dhe që është kureshtarë të njohë njerëz të tjerë që nuk janë të shurdhër.

Ndryshe nga rasti me personat që janë të verbër dhe personat që janë para/tetraplegjikë, nuk ka ndonjë ligj që rregullon identifikimin e personave që janë të shurdhër ose që kanë vështirësi në dëgjim dhe që nuk ka legjislacion tjetër që rregullon ofrimin e shërbimeve, përveç gjuhës së shenjave. Kosova që nga viti 2013, ka pasur një *program kombëtar për ofrimin e shërbimeve për gjuhën e shenjave për personat e shurdhër në Republikën e Kosovës (2013-2016)*<sup>160</sup>, me qëllim të “krijimit të një shoqërie gjithëpërfshirëse e cila do të rrisë pjesëmarrjen e komunitetit të shurdhër në të gjitha fushat e jetës në Republikën e Kosovës”<sup>161</sup>. Programi kombëtar e përshkruan si ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave (interpretimin) ashtu dhe arsimin në gjuhën e shenjave (shih seksionin e arsimit më sipër), dhe përfshin dispozita për përgatitjet institucionale lidhur me ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave, qasjen në arsim për personat e shurdhër, programe trajnimi dhe fushata ndërgjegjësimi.

Gjatë gjithë 7 DFG-ve me prindërit/kujdestarët, ka pasur raportime të shumta të rasteve të stigmës, diskriminimit dhe ngacmimit nga të dy palët, fëmijët dhe të rriturit, disa prej të cilëve, nga vetë mësuesit e fëmijëve dhe mjekët kujdestarë. Në Gjakovë një nënë raportoi se **“Ishte vështirë në shkollë ... djali im ngacmohej në shkollë dhe qante. Mësuesi i tij e veçonte nga nxënësit e tjerë në klasë, dhe nuk e lejonte që të ulej me të tjerët .... Ai madje është rrahur nga mësuesi për shkak të mos disiplinës në klasë ”** (nëna nga Gjakova). Në Ferizaj, dy (2) prindër raportuan se fëmija i tyre është tallur dhe përqeshur në shkollë dhe që **“nuk dëshiron të shkojë më”,** ndërsa një tjetër prind ka raportuar se **“në shkollë fëmijët e tjerë e shtyjnë atë, nuk duan të ulen me të dhe e quajnë budalla”,** gjë që e bëri fëmijën shumë të palumtur dhe të mërzitur. Një nënë tha: **“shkolla në qytet e ka refuzuar djalin tim, nuk donin ta pranonin .... ishte katastrofë ... ata thanë se nuk donin një fëmijë të sëmurë ... prindërit dhe mësuesit u rebeluan... nuk e lejonin të regjistrohej në shkollë”.**

Në Mitrovicën Veriore, prindërit treguan disa raste kur fëmijët e tyre ishin viktimat të përqeshjeve, ngacmimeve, talljeve dhe madje rrahjeve nga fëmijët e tjerë, qoftë në shkollë ose jashtë shkollës, në parqe apo në vende të tjera publike. Kjo zakonisht ndodh prapa shpinës së prindërve: **“Shikoje atë, ajo vajzë ecën si plakë”** (nëna e një vajze me dëmtime fizike). **“Fëmijët e tjerë përpiqen ta rrahin djalin tim, qoftë në shkollë, jashtë apo në park, për shkak të “sjelljes së tij të çuditshme”. Askush nuk ndjen keqardhje për djalin tim. A duhet t’ia shkruaj në ballë se ai është një “fëmijë me aftësi të kufizuara?”** (Nënë, Mitrovicë Veriore). **“Kunati im më sugjeroi disa herë që unë të heq qafe djalin tim duke e dërguar atë në jetimore. Çfarë mund të them më shumë”** (Nënë, Mitrovicë Veriore).

Në Mitrovicën Veriore, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara folën lirshëm për nevojat e tyre për mbështetje dhe këshillim psikologjik. Nënata, të cilat shpesh janë ato që shpenzojnë më shumë kohë me fëmijët e tyre, ndjejnë mbingarkesë. Siç është dokumentuar në shumë shkrime<sup>162</sup>, prindërit shpesh hezitojnë të dalin në publik me fëmijët e tyre, pjesërisht për shkak të infrastrukturës së keqe dhe pjesërisht sepse turprohen të shihen në rrugë me fëmijën e tyre dhe kanë grupe sociale shumë të kufizuara. Megjithatë, nënat janë anëtares të familjes që përkushtohen dhe angazhohen më së shumti për adresimin e nevojave të tyre, duke përfshirë këtu shëndetin, arsimin, shoqërimin dhe pjesëmarrjen në evente kulturore kur një gjë e tillë është e

mundur. Siç dokumentohet gjerësisht, të qenit prind i një fëmije me aftësi të kufizuara shpesh shkakton stres të shtuar në një martesë, që rrjedhimisht shkakton grindje mes prindërve. Dy kujdestare në DFG konfirmuan se ato ishin të divorcuara, pjesërisht për shkak të tensionit në marrëdhëniet e tyre martesore dhe si rrjedhojë tani janë nëna vetëushqyese që kujdesen në rrethana shumë të vështira për fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara.

Shumë prej fëmijëve me aftësi të kufizuara që morën pjesë në DFG-të raportuan raste të talljes dhe ngacmimit. Ndërsa, një vajzë tha se fëmijët e tjerë e ngacmojnë atë në shkollë - **“Vajzat në klasë më ngacmojnë mua .... Ato më pengojnë gjatë mësimet...”**, fëmijë të tjerë me aftësi të kufizuara thanë se askush nuk i ngacmon ata në shkollë dhe nxënësit në klasë u ndihmojnë atyre. Në Ferizaj, disa fëmijë me aftësi të kufizuara të dukshme janë bërë objekt i talljeve dhe ngacmimeve nga shokët e tjerë të klasës dhe një fëmijë ka thënë se dëshiron ta lërë shkollën për shkak të sjelljes së fëmijëve të tjerë dhe shokëve të klasës. Në Prishtinë, situata është e përzier. Dy fëmijë kanë treguar se ata mendojnë se janë pranuar shumë mirë dhe gjithashtu marrin ndihmë në shkollë nga fëmijët e tjerë: **“Shokët dhe shoqet e mia janë shumë të vëmendshme, të sjellshme ndaj meje dhe ata kujdesen për mua”** (djalë, 12 vjeçar); dhe, **“Shokët e klasës sillen mirë me mua .... më ndihmojnë.... më ndihmojnë të mbaj çantën dhe gjithashtu më ndihmojnë lidhur me mësimet”** (djalë, 10 vjeçar). Megjithatë, kishte edhe raporte negative: një vajzë tregoi se ajo ngacmohet në mënyrë verbale dhe jo-verbale nga shokët/shoqet e saj të klasës: **“ata mi morën fletoret e mia dhe mi hodhën në tokë”**, ndërsa një vajzë tjetër tha **“Epo, pas një kohe mësohesh me talljet.... sapo të mësohesh me talljet, i përballon shumë lehtë, ata që nuk mësohen e kanë shumë të vështirë t’i përballojnë”**.

Në Prizren, dy fëmijë treguan se ngacmohen në shkollë dhe njëra vajzë ulet vetëm në bankën e saj. Stafi i HandiKOS raportoi se **“Ka raste të dhunës fizike... gjithashtu edhe të dhunës psikologjike... për shembull prindërit nuk i lejojnë fëmijët e tyre (të shurdhër) të dalin jashtë... ata i sjellin fëmijët e tyre në shkollë, por kur shohin se ne përdorim gjuhën e shenjave ata tërheqin fëmijët e tyre nga shkolla sepse nuk duan që fëmija i tyre të përdorë gjuhën e shenjave...”** Një vajzë 10 vjeçare tha: **“Ka fëmijë që tallen me mua ... ata më thonë që unë eci si plakë... ata janë fëmijë të rritur”**. Një kujdestare e re (motër) foli rreth ngacmimit të fëmijëve të tjerë ndaj motrës së saj: **“Ata e godasin dhe e shtyjnë atë... i shkulin flokët... kam qenë dëshmitare e këtyre rasteve dhe u kam thënë atyre se po t’i shoh duke e shtyrë motrën time do t’i tregoj mësuësit”**. Njëra nga vajzat pjesëmarrëse në DFG raportoi se si sillen me të shokët/shoqet në shkollë: **“Kam disa probleme me shokët dhe shoqet e mia... ato më përjashtojnë nga disa gjëra ... për shembull i shoh duke folur diçka, shkoj tek ato dhe i pyes se për çfarë po flasim dhe ato nuk thonë asgjë...”**

Kosova është anëtare e Olimpiadës Speciale dhe që nga viti 2007 është themeluar Olimpiada Speciale e Kosovës. Kjo organizatë ka rreth 200 atletë nga sporte dhe komuna të ndryshme të Kosovës, mes të cilëve ka fëmijë nga mosha 5 vjeç. Në 3 vitet e fundit OS Kosova ka filluar të organizojë aktivitete gjithëpërfshirëse ku fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët pa aftësi të kufizuara luajnë së bashku, 1 ditë në javë, prej 1 deri 2 orë për seancë. Sipas drejtorit të programit, aktivitetet gjithëpërfshirëse janë jashtëzakonisht të rëndësishme sepse ato ndihmojnë në rritjen e besimit të

fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe ndryshojnë perceptimet negative të fëmijëve pa aftësi të kufizuara në lidhje me moshatarët e tyre me aftësi të kufizuara.

## Theksi mbi fëmijët me aftësi të kufizuara të komunitetit rom dhe ashkali

Në komunitetet rom dhe ashkali është raportuar se fëmijët e kalojnë pjesën më të madhe të kohës në shtëpi, me vëllezërit, motrat apo prindërit e tyre dhe ndonjëherë lihen krejtësisht të vetëm. Ata nuk raportuan ndonjë aktivitet sportiv apo argëtues. Fëmijët e komunitetit rom treguan se ata shikojnë televizion dhe janë të lumtur që shikojnë në qendrën e të mësuarit në komunitetin e tyre ku kalojnë kohë me fëmijët e tjerë rom. Fëmijët me aftësi të kufizuara në komunitetin ashkali kryesisht janë të izoluar, madje edhe brenda familjes së tyre të gjerë. Siç raportohet, ata nuk marrin pjesë në ngjarjet familjare: ***“Ata nuk janë të mirëpritur në ceremonitë dhe ngjarjet e familjes së gjerë, prandaj i mbajmë në shtëpi”***. Ka edhe raste kur njerëzit tallen më fëmijët në mënyrë të hapur. Një nënë u shpreh mbi reagimet e komunitetit të tyre: ***“Ata e pështyjnë... e ofendojnë në mënyra të ndryshme... unë e fus atë brenda në shtëpi... çfarë mund të bëj tjetër”***. Brenda komunitetit rom, shumica e fëmijëve nuk kanë shokë apo shoqe të ngushta. Ata/ato shpesh mbahen të izoluar brenda komunitetit rom. Nganjëherë ata janë pre e talljeve dhe rrahen nga fëmijët e tjerë. ***“Fëmijët e tjerë, madje edhe fëmijët rom nuk luajnë me të.... ata e rrahin atë dhe ajo bëhet agresive dhe pastaj fillon të godasë fëmijët e tjerë.... (gjyshja).***

***“Ka shumë padrejtësi ndaj neve.... dhe do të ketë për shekuj me radhë përderisa mbetemi të marginalizuar, të harruar dhe të anashkaluar. Askush nuk na do neve... Ne mezi mbijetojmë, por unë nuk heq dorë, pasi unë duhet të kujdesem për djalin tim të shurdhër dhe fëmijët e tij. Unë dhe burri im çdo ditë shkojmë nga një vend në tjetrin duke kërkuar dhe kontrolluar kontejnerët e mbeturinave prej nga marrim shumicën e rrobave apo gjërave të tjera për të jetuar, dhe unë nuk jam aspak e turpëruar për këtë”*** (Një gjyshe, lidhur me situatën e fëmijëve të komunitetit rom).



UNICEF/2017/L.Morina

**për çdo fëmijë, përkujdesje**



# IV. TË GJETURAT KRYESORE DHE REKOMANDIMET

Duke marrë parasysh gjetjet e mësipërme, rekomandimet nga kjo Analizë e Situatës supozojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara janë para së gjithash fëmijë, e ardhmja e Kosovës, të denjë për dinjitet dhe respekt në të gjithë territorin.

## Identifikimi dhe kuantifikimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë

**Gjetje:** Numri i personave me aftësi të kufizuara në Kosovë nuk është i ditur. Edhe pse janë grumbulluar të dhëna në vitet e fundit, si në Regjistrim ashtu dhe përmes mjeteve administrative, nuk ka numër të saktë që mund të mbështesin vendimmarrjen e bazuar në të dhëna. Identifikimi i personave me aftësi të kufizuara ndjek modelin mjekësor (sipas llojit të dëmtimit), nuk fokusohet tek fëmijët dhe përdoret pothuajse gjithmonë për të ofruar një përfitim në para.

REK 1 – Është e domosdoshme që fëmijët me aftësi të kufizuara të bëhen pjesë e dukshme e agjendës së Kosovës për zhvillim. Për të siguruar identifikimin e duhur të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë, rekomandohet që përkufizimi i aftësisë së kufizuar i përfshirë në KDPAK, të përfshihet në të gjithë legjislacionin në nivel qendror dhe lokal që lidhet drejtpërdrejt me fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara (veçanërisht në mirëqenien sociale, arsimin, shëndetin dhe sektorët e punësimit) dhe të zbatohet si “përkufizim pune” i përdorur nga të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet komunale gjatë përcaktimit të përmbushjes së kriterëve të aftësisë së kufizuar.

Institucioni/organizata përgjegjëse: Parlamenti dhe ministritë përkatëse të linjës.

REK 2 - Avokimi me Këshillin Kombëtar të Statistikave për përfshirjen e një ankete dhe/ose regjistrimi të familjeve, përfaqësuese në nivel kombëtar, që mund të mbledhë të dhëna në lidhje me përhapjen e aftësisë së kufizuar të fëmijëve, duke filluar nga mosha 0, në një bazë të qëndrueshme (çdo 5 vjet) me qëllim që: 1) të mblidhen të dhëna afatgjata lidhur me aftësinë e kufizuar të fëmijëve në Kosovë; 2) të mblidhen të dhëna mbi kufizimet funksionale në Kosovë që mund t'i ndihmojnë më mirë autoritetet lokale në ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre. Nëse një studim dhe/ose regjistrim i familjeve, përfaqësues në nivel kombëtar, nuk është i mundur në periudhën afatshkurtër, merrni parasysh që të zhvilloni një Anketë të Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) me një modul mbi funksionimin e fëmijës në 2019.



Institucioni/organizata përgjegjëse: Parlamenti, Këshilli Kombëtar i Statistikave, ministritë e linjës, donatorët ndërkombëtar, Agjencia Kosovare e Statistikave (ASK)

REK 3 – Të konsiderohet themelimi i një baze qendrore të të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara, që mund t'i identifikojë fëmijët me aftësi të kufizuar sipas numrit të regjistruar të lindjes dhe të sigurojë që të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet komunale të kenë qasje dhe përgjegjësi ndaj të dhënave të besueshme dhe futjes së saktë të të dhënave për të siguruar që është në dispozicion një informacion i përditësuar për vendimmarrje.

Institucioni/organizata përgjegjëse: ASK-ja dhe ministritë e linjës

## Identifikimi, vlerësimi dhe përcaktimi i përmbushjes së kriterëve

**Gjetje:** Identifikimi, vlerësimi dhe përcaktimi i përmbushjes së kriterit të kufizuar është me natyrë mjekësore dhe i bazuar në një opinion mjekësor sa i përket një dëmtimi, më tepër se sa një vlerësim holistik. Fëmijët me aftësi të kufizuara shpesh identifikohen vetëm kur arrijnë moshën shkollore, kurse ndërhyrja tashmë është tepër vonë për të pasur një ndikim të qëndrueshëm në zhvillimin e tyre. Për më tepër, praktikat ekzistuese nuk çojnë në plane të individualizuara që i përgjigjen pengesave të çdo fëmije dhe barrierave mjedisore dhe nuk adresojnë nevojën për shërbime të integruara dhe të vazhdueshme për fëmijën dhe familjen, për të mbështetur zhvillimin e duhur dhe qëllimet gjatë gjithë jetës.

REK 4 – Për të siguruar harmonizimin, duhet që metodologjitë, kriteret dhe mjetet e nevojshme për të përcaktuar të drejtën për shërbime dhe përfitime, sipas modelit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar të përcaktuar në KDPAK, të zhvillohen në të gjitha autoritetet qendrore dhe lokale. Kjo është qenësore për të siguruar që të drejtat e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara njihen dhe përmbushen në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga vendi i ekipit vlerësues që fillon procesin.

Institucioni/organizata përgjegjëse: Parlamenti dhe ZQM-ja

REK 5 - Identifikimi, vlerësimi dhe përmbushja e kriterëve duhet të konsiderohet si një qasje e integruar, holistike dhe multidisiplinare, e drejtuar nga një ekip i lëvizshëm i ekspertëve profesionistë, me udhëheqës të menaxhimit të rasteve nga MASHT-i (në bashkëpunim të ngushtë me MSH-në, MPMS-në, QPS-në), mirëpo sa më herët që të jetë e mundur gjatë jetës së fëmijës. Ekipet duhet të trajnohen mbi parametrat KNF-FR dhe të marrin parasysh të tre aspektet e modelit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, gjatë kryerjes së përcaktimeve të përmbushjes së kriterëve, duke siguruar që rivlerësimet kërkohen sipas nevojës, sipas përcaktimeve të ekipit (i përshtatshëm për qëllimin) për çdo rast veç e veç.

Institucioni/organizata përgjegjëse: ZQM-ja, MASHT-i, MSH-ja, MPMS-ja dhe QPS-ja

REK 6 - Ndryshimi i kriterëve të aftësisë së kufizuar të përhershme për të siguruar se u ofrohet mbështetje të gjithë fëmijëve që kanë nevojë për të, pavarësisht nga koeficienti i inteligjencës (IQ) ose dëmtimi. Nevojitet një qasje multidisiplinare, duke filluar sa më herët që të jetë e mundur (mosha shkollë është tepër vonë) në bashkëpunim të ngushtë me metodologjitë e identifikimit të hershëm/intervenimit të hershëm (IH/IH) (shih më poshtë). Njëkohësisht, rishikimi i dispozitave për përfitime në të holla për të siguruar që të hollat i ofrohen fëmijëve me aftësi të kufizuara bazuar në nevojën faktike dhe nuk iu ofrohen familjeve si një mekanizëm për zbutjen e varfërisë. Të konsiderohet themelimi i një sistemi, që shfrytëzon burimet financiare ekzistuese për të ofruar shërbimet e nevojshme dhe sa më pak përfitime në të holla të përdoren për të mbuluar shërbimet e specializuara që nuk ekzistojnë përgjithësisht në të gjitha komunitetet (d.m.th. Sistemi i vauçerëve).

Institucioni/organizata përgjegjëse: ZQM-ja, MASHT-i, MSH-ja, MPMS-ja, MF-ja

## Legjislacioni, Koordinimi dhe Monitorimi

**Gjetje: Legjislacioni ekzistues, edhe pse është duke u rishikuar dhe ndryshuar, nuk është koheziv dhe nuk përfshin të gjitha aspektet (bio-psiko-sociale) të jetës së fëmijëve me aftësi të kufizuara. Legjislacioni ekzistues nuk zbatohet në nivel lokal, buxhetet për zbatim nuk ekzistojnë ose janë të vogla dhe mekanizmat ekzistues për zbatimin në praktikë nuk funksionojnë plotësisht.**

REK 7 - Mbështetja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara është një çështje e vullnetit politik dhe ka nevojë për një qasje shumë të ngjashme me atë të marrë në drejtim të çështjeve gjinore dhe çështjeve të pakicave. Prandaj, është e rekomandueshme që të bëhet një përpjekje për t'u angazhuar me Kuvendin (të gjitha 14 Komisionet e Kuvendit) dhe nivelin më të lartë të Zyrës së Kryeministrit për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, siç është përshkruar në KDPAK, veçanërisht normat dhe qëndrimet shoqërore që ndikojnë në identifikimin dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Institucioni/organizata përgjegjëse: Parlamenti dhe qeveria (zyra e kryeministrit), BE-ja, UNICEF-i, Institucioni i Avokatit të Popullit, OPAK-të dhe OSHC-të.

REK 8 - Ngritja e angazhimit dhe kapacitetit mbi aftësinë e kufizuar sipas modelit social. Investimi në zhvillimin e kapacitetit (dhe vullnetit politik) të Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur, për të siguruar që të gjithë sektorët janë gjithëpërfshirës ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe e gjithë vendimmarrja është përgjegjëse ndaj zërave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Institucioni/organizata përgjegjëse: Parlamenti dhe qeveria, BE-ja, UNICEF-i, Institucioni i Avokatit të Popullit, OPAK-ët dhe OSHC-të

REK 9 - Nën udhëheqjen e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur, mbështetja e të gjitha 14 Komisioneve Parlamentare në udhëheqjen e ministrive të linjës për të zhvilluar mekanizma të qartë raportimi, detyra, role dhe përgjegjësi, për të siguruar mbulimin e të gjitha shërbimeve të

nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara nga ministria më përkatëse e linjës, duke përfshirë ndarjen e burimeve të mjaftueshme financiare për zbatimin e legjislacionit (duke filluar me një buxhet të dedikuar për ofrimin e shërbimeve për fëmijët, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara). Të kërkohen raporte të rregullta nga ministritë e linjës, Zyra për Qeverisje të Mirë, si dhe Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar dhe Këshillit Nacional për Persona me Aftësi të Kufizuara, mbi aktivitetet e tyre në lidhje me ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe efektive për fëmijët, duke përfshirë buxhetet.

Institucioni/organizata përgjegjëse: Parlamenti, ZQM-ja, ministritë e linjës, FKAK-ja, BE-ja, UNICEF-i

REK 10 - Rishqyrtimi dhe analizimi i legjislacionit përkatës përmes këndvështrimit të modelit shoqëror të aftësisë së kufizuar. Të rishikohen, sipas nevojës, të gjitha pjesët e kornizës legjislative për të siguruar që ligjet, ndryshimi(et) i mëvonshëm dhe udhëzimet administrative shoqëruese janë në përputhje dhe respektojnë angazhimet e qarta dhe të nënkuptuara ndërkombëtare të Kosovës.

Institucioni/organizata përgjegjëse: ministritë e linjës

REK 11 - Bashkësia ndërkombëtare duhet të insistojë në zbatimin e legjislacionit ekzistues që është në përputhje me KDPAK-në dhe hartimin/zbatimin/monitorimin e shërbimeve cilësore, si kushte për bashkëpunim dhe mbështetje financiare me qeverinë qendrore dhe lokale. Të gjitha agjencitë e sistemit të OKB-së, Delegacioni i BE-së dhe donatorët ndërkombëtarë duhet të avokojnë për veprime më të koordinuara, duke qenë më strategjike në shpenzimet e tyre (burimet njerëzore dhe financiare) dhe duke investuar në edukimin e vendimmarrësve, duke filluar me trajnime mbi modelin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar.

Institucioni/organizata përgjegjëse: organizatat ndërkombëtare

REK 12 – Një angazhim në hartëzimin e shërbimeve ekzistuese për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre dhe identifikimi i segmenteve të praktikave të mira dhe nevojave. Përfshirja e të gjithë projekteve aktuale dhe të planifikuara nga organizatat e OKB-së dhe organizatat tjera. Të sigurohet që përpjekjet e koordinuara janë duke ndodhur në teren dhe të krijohet fotografia e plotë midis të gjitha palëve të interesuara. Avokimi me institucionet përgjegjëse për të mbështetur zhvillimin e ekipeve multidisiplinare të ekspertëve (të përhershme dhe mobile) që mund të mbështesin prindërit dhe familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha aspektet e jetës, duke përfshirë: ndihmën sociale, rehabilitimin, përfshirjen në shkolla të rregullta, qasjen në shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse për personat me aftësi të kufizuara dhe sigurimin e pajisjeve ndihmëse teknologjike. Praktikrat e mira ekzistuese në nivel lokal, shumë prej të cilave bazohen në “faktorin njerëzor”, duhet të identifikohen, dokumentohen dhe analizohen siç duhet për replikim dhe përdorim të qëndrueshëm.

Institucioni/organizata përgjegjëse: ZQM-ja, FKAK-ja dhe ministritë e linjës

## Të drejtat dhe obligimet ndër-sektoriale

**Gjetje:** Zbatimi i legjislacionit dhe ofrimi i shërbimeve është penguar nga mungesa e angazhimit, burimet njerëzore dhe financiare dhe mungesa e vazhdueshme e të kuptuarit të aftësisë së kufizuar nga këndvështrimi social nga profesionistët. Pavarësisht nga ligji ekzistues kundër diskriminimit, fëmijët me aftësi të kufizuara janë të diskriminuar çdo ditë, në veçanti, fëmijët që vuajnë nga faktorët e disavantazheve të shumëfishtë. Aftësia e kufizuar ende kuptohet si një gjendje mjekësore dhe jo si një çështje e të drejtave të njeriut dhe profesionistët nuk janë të trajnuar për të përfshirë aftësinë e kufizuar në praktikat e tyre të përditshme. Përveç kësaj, roli profesional i punëtorëve social nuk është i përcaktuar qartë, as plotësisht i mbështetur.

REK 13 – Të themelohet një sistemi monitorimi brenda çdo ministrie të linjës dhe përgjatë ministrive për të ndjekur zhvillimin dhe zbatimin e politikave strikte anti-diskriminuese që sigurojnë të drejtat e të gjithë fëmijëve në të gjitha fushat e jetës, në veçanti fëmijët nga grupet më të pafavorizuara dhe fëmijët me rrezik diskriminimi për shkak të disavantazheve të shumta (p.sh. vajzat me aftësi të kufizuara, fëmijët me vonesa ose aftësi të kufizuara nga zonat e largëta rurale, fëmijët me vonesa ose aftësi të kufizuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian).

Institucioni/organizata përgjegjëse: ZQM-ja dhe ministritë e linjës

REK 14 - Përkundër decentralizimit, duhet të ekzistojnë mekanizma të tillë si krijimi i një kodi buxhetor dhe një granti specifik për shërbimet sociale, për të zbatuar legjislacionin në nivel komunal dhe për të siguruar burime shtesë financiare për ato komuna që paraqesin nivele më të larta të ofrimit të shërbimeve efikase dhe efektive për fëmijët me aftësi të kufizuara, të matur me numrin e fëmijëve nga popullatat e cenueshme (fëmijët me aftësi të kufizuara përfshirë fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian) të përfshirë plotësisht dhe që marrin pjesë me fëmijët shumicë.

Institucioni/organizata përgjegjëse: parlamenti, ministritë e linjës, komunat dhe Asociacioni i komunave

REK 15 - Të ofrohen trajnime bazë për integrimin e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha ekipet/zyrtarët e të Drejtave të Njeriut në nivel komunal. Të theksohet nevoja dhe përparësitë e një qasjeje shumë sektoriale në aktivitetet që lidhen me aftësinë e kufizuar dhe përfshirjen sociale<sup>163</sup>, të drejtuar nga ekipe/zyrtarë të të Drejtave të Njeriut dhe të sigurohet se janë themeluar modelet më të mira për të punuar drejtpërdrejt me familjet dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Institucioni/organizata përgjegjëse: Zyra për Qeverisje të Mirë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, komunat dhe Asociacioni i komunave të Kosovës

REK 16 - Të rriten kapacitetet e profesionistëve përgjegjës brenda secilës ministri të linjës lidhur me qasshmërinë dhe Dizajnin Universal. Të sigurohet që disa profesionistë brenda secilës ministri përkatëse të linjës të kenë një të kuptuar të gjerë të akomodimit të arsyeshëm kundrejt akomodimit të individualizuar dhe që burimet financiare dhe njerëzore të jenë në dispozicion për të zbatuar dhe monitoruar Dizajnin Universal me kosto efektive, Teknologjinë Ndihmëse (TN) dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) që janë të kushtueshme për t'u shtuar pas faktit të kryer.

Institucioni/organizata përgjegjëse: Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Financave, ZQM-ja, organizatat ndërkombëtare, OPAK-të dhe OShC-të vendore dhe ndërkombëtare.

REK 17 - Angazhimi në hulumtime mbi Njohuritë, Qëndrimet dhe Praktikrat (NQP) të fokusuara në profesionistë dhe ofrues të shërbimeve (në vend se me popullatën e përgjithshme, vetë fëmijët me aftësi të kufizuara ose familjet e tyre - ky informacion ekziston tashmë). Përqendrimi i vëmendjes në këtë nën-grup të popullsisë, mund t'i ofrojë palëve të interesuara një bazë/pikënisje të rëndësishme në lidhje me profesionistët kundrejt kategorive të ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre. Ky informacion, i mbledhur bazuar në një metodologji rigoroze të hulumtimit dhe dokumentuar siç duhet, mund të çojë në avokim të fokusuar dhe në ngritjen enkas të përshtatur të kapaciteteve të profesionistëve bazuar në nevoja.

Institucioni/organizata përgjegjëse: ZQM-ja, ASK-ja, organizatat vendore dhe ndërkombëtare

REK 18 - Përmirësimi i koordinimit ndër-sektorial duke përcaktuar qartë mandatin e koordinimit të QPS-ve komunale dhe forcimi i kapaciteteve të tyre përmes sigurimit të burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare. Themelimi i mekanizmave për veprime të koordinuara të raportimit që çojnë në identifikimin, vlerësimin dhe përmbushjen e kriterëve për shërbime të fëmijëve në situata të cënueshme (si afatshkurtër ashtu dhe afatgjatë), veçanërisht fëmijët me rrezik për vonesë ose aftësi të kufizuara, varfëri, dhunë ose shfrytëzim, ose braktisje, dhe nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Institucioni/organizata përgjegjëse: MPMS-ja, MSH-ja dhe MASHT-i, ZQM-ja

REK 19 - Të zgjerohet roli, kapacitetet dhe përgjegjësitë e punonjësve socialë për menaxhimin e rasteve, për të siguruar që ato të arrijnë tek të gjithë fëmijët, duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, kudo në vend, duke përfshirë fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Punonjësit socialë duhet të pajisen me resurse, që të angazhohen në aktivitete në terren, që çojnë në ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara brenda familjeve të tyre, duke përfshirë aftësinë për të koordinuar ofrimin e forumeve dhe hapësirave adekuate për të gjithë fëmijët që ata të shprehin veten e tyre.

Institucioni/organizata përgjegjëse: MPMS dhe MSH, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Komunitat, drejtoritë komunale të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

REK 20 - Mbështetja e të gjitha ministrive përgjegjëse për të futur licencimin e shërbimeve dhe për të krijuar një mekanizëm të monitorimit dhe vlerësimit të shërbimeve; të sigurohet vazhdimësia e shërbimeve, duke çuar në një sistem të rangimit që mund t'u sigurojë fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre informacionin e nevojshëm për vendimmarrje të orientuar në cilësi;

Institucioni/organizata përgjegjëse: të gjitha ministrinë e linjës dhe donatorët ndërkombëtarë

## E drejta për mbrojtje të fëmijëve

**Gjetje:** Kosova nuk e ka Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe ligjet ekzistuese që ofrojnë mbrojtje nuk përfshijnë qartë fëmijët. Kështu, parandalimi, reagimi dhe monitorimi i abuzimit dhe neglizhencës nuk janë bërë shprehimisht të qarta ose të zbatueshme. Fëmijët me aftësi të kufizuara janë në rrezik të lartë të abuzimit dhe/ose neglizhimit dhe shumica e fëmijëve dhe familjeve nuk i njohin të drejtat e tyre sipas ligjit, si të mbrohen, apo si t'i raportojnë rastet e abuzimit apo neglizhimit. Për më tepër, mekanizmat ekzistues të mbrojtjes nuk përfshijnë në mënyrë eksplicite fëmijët me aftësi të kufizuara. Fëmijët me aftësi të kufizuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë në rrezik jashtëzakonisht të lartë të cenueshmërisë.

REK 21 - Të sigurohet që ligjet dhe politikat të pasqyrojnë frymën e KDPAK dhe që ekzistojnë mekanizma për parandalimin, monitorimin dhe përgjigjen ndaj abuzimit/neglizhimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në të gjitha nivelet dhe nga të gjitha palët e interesit; të përfundohet procesi i zhvillimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve duke u angazhuar në konsultime të gjera me të gjitha palët e interesit, veçanërisht fëmijët dhe të rinjtë, të cilët do të jenë përfituesit kryesorë të dispozitave të përfshira në ligj.

Institucioni/organizata përgjegjëse: MPMS, ZQM, ZL-ZKM (Zyra Ligjore e Kryeministrit), UNICEF, KOMF, Institucioni i Avokatit të Popullit

REK 22 - Sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për Zyrën për Qeverisje të Mirë (si Sekretariati i Këshillit Kombëtar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara) dhe për Institucionin e Avokatit të Popullit, përfshirë mundësitë e zhvillimit të kapaciteteve në lidhje me të drejtat (dhe shkeljet e të drejtave) të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, me fokus të veçantë tek fëmijët me aftësi të kufizuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Institucioni/organizata përgjegjëse: Parlamenti dhe donatorët ndërkombëtarë

REK 23 - Krijimi i një sistemi me anë të të cilit fëmijët me aftësi të kufizuara mund të raportojnë, në mënyrë anonime, rastet e abuzimit/neglizhimit, për të siguruar që raportet e fëmijëve të merren seriozisht dhe ankesat të përcillen me veprime.

Institucioni/organizata përgjegjëse: MPMS

REK 24 - Të vazhdohen dhe të zgjerohen aktivitetet e parandalimit të dhunës dhe të edukohen profesionistët dhe publiku i gjerë mbi të drejtën e mbrojtjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara. Të sigurohet që të gjithë fëmijët dhe familjet e tyre, veçanërisht ato në komunitetet e cenueshme ose të pafavorizuara (p.sh. komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian) janë të vetëdijshëm për të drejtën e tyre për mbrojtje dhe për mënyrat në të cilat ata mund të kërkojnë të drejtat e tyre.

Institucioni/organizata përgjegjëse: MPMS, ZQM, OPAK-të - OSHC-të



## E drejta për arsim gjithëpërfshirës

**Gjetje:** Koncepti i arsimit gjithëpërfshirës (AGJ) në Kosovë është kuptuar në mënyrën e tij më të kufizuar: ofrimi i qasjes në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara. Nuk ka të kuptuar të përbashkët të AGJ dhe asnjë marrëveshje për një rrugë përpara në zhvillimin e praktikave gjithëpërfshirëse. Zhvillimi gjatë fëmijërisë së hershme, gatishmëria për shkollë, parashkollori dhe kopshti nuk përfshihen në kuptimin e gjerë të AGJ dhe nuk merren në konsideratë kur zhvillohen planet arsimore. Trajnimi i mësuesve në shërbim është siguruar nga shumë OJQ gjatë viteve, pa një plan veprimi koheziv dhe ka rezultuar me një të kuptuar (dhe praktika) të fragmentuar/(a) të AGJ.

REK 25 - Fillimi i dialogut kombëtar për promovimin e arsimit gjithëpërfshirës që është në përputhje me Komentin e përgjithshëm të KDPAK në nenin 24: Të sigurohet që fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë qasje në mundësi të zhvillimit gjatë fëmijërisë së hershme dhe në gatishmërinë për shkollë dhe të iniciohet kalimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara nga klasa dhe qendra burimore të bashkangjitura në shkolla të rregullta; hulumtimi i dobisë së mundshme të qendrave burimore për të mbështetur kalimin; të qartësohet roli i mësuesve të arsimit të përgjithshëm, mësuesve të arsimit special, asistentëve dhe të tjerëve brenda një sistemi arsimor gjithëpërfshirës në Kosovë.

Institucioni/organizata përgjegjëse: MASHT

REK 26 - MASHT-i duhet të marrë përgjegjësinë për koordinimin e të gjitha aktiviteteve lidhur me përgatitjen e mësuesve (në-shërbim dhe para-shërbimit), burimet shkollore dhe mbështetjen komunale nga palët e interesit, për të siguruar një qasje kohezive dhe të koordinuar për përgatitjen e mësuesve. Një sërë udhëzimesh për donatorët, OJQ-të dhe OPAK-ët duhet të përgatiten për të siguruar që të gjitha burimet financiare dhe njerëzore të ofruara në sistemin arsimor janë brenda standardeve të përcaktuara në nenin 24 të KDPAK-së (dhe Komentin e Përgjithshëm # 4 mbi të Drejtën për Arsimin Gjithëpërfshirës);

Institucioni/organizata përgjegjëse: MASHT-i

REK 27 - Sigurimi i një forumi për zyrtarët e arsimit (duke përfshirë zhvillimin gjatë fëmijërisë së hershme dhe profesionistët parashkollorë) dhe prindërit/familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të dialoguar mbi atë se çka duhet të nënkuptojë një sistem arsimor gjithëpërfshirës. Kurdo që të jetë e mundur, dialogu duhet të bëhet drejtpërdrejt me prindërit dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, në vend se me përfaqësuesit; përdorimi i strukturave ekzistuese si Bordet e Shkollës, Këshillin e Mësimdhënësve dhe Këshillin e Nxënësve për të krijuar mjedise shkollore që janë gjithëpërfshirëse për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga karakteristikat e tyre individuale.

Institucioni/organizata përgjegjëse: MASHT-i dhe donatorët ndërkombëtar

REK 28 – Të kryhet një vlerësim i kapaciteteve të të gjithë profesionistëve (duke përfshirë profesionistë të zhvillimit gjatë fëmijërisë së hershme dhe parashkollorë) të cilët punojnë, madje edhe në mënyrë periferike me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të ofrohet një grup adekuat rekomandimesh për standardet minimale duke avokuar

për krijimin e menjëhershëm të tij<sup>164</sup>. Kjo duhet të përfshijë vlerësimin e kapaciteteve të institucioneve për përgatitjen e mësimeve (dhe mbështetjes sipas nevojës) për të siguruar përgatitjen e mësimeve para-shërbimit dhe në-shërbim për arsimin gjithëpërfshirës, në përputhje me standardet e përcaktuara nga Neni 24 i KDPAK (dhe Komenti i Përgjithshëm # 4 mbi të Drejtën për Arsim Gjithëpërfshirës);

Institucioni/organizata përgjegjëse: MASHT-i

REK 29 – Investimi në zhvillimin e kapaciteteve të zhvillimit gjatë fëmijërisë së hershme dhe profesionistëve parashkollorë, mësuesve dhe profesionistëve të tjerë të arsimit, për të punuar dhe ndihmuar në nxitjen e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës. Të gjithë mësuesit duhet të jenë të trajnuar në mënyrë adekuate mbi zhvillimin e fëmijës dhe pedagogjinë e përqendruar te fëmijët dhe mësime të diferencuara, që mund t'i mbështesin ata për t'i mësuar të gjithë nxënësit në një klasë të rregullt. Mësuesit dhe profesionistët e arsimit duhet gjithashtu të trajnohen për të identifikuar rastet kur ata kërkojnë mbështetjen e mësimeve të tjerë ose profesionistëve të specializuar dhe duhet të detyrohen të shfrytëzojnë mekanizma për bashkëpunim dhe kooperim ndërmjet profesionistëve.

Institucioni/organizata përgjegjëse: MASHT-i

## E drejta për Shëndet dhe Rehabilitim

**Gjetje: Sistemi i kujdesit shëndetësor në Kosovë nuk përfshin integrimin e aftësisë së kufizuar në të gjithë planet e tij të veprimit. Ekzaminimet, identifikimi dhe intervenimi i hershëm tek fëmijët në rrezik të vonësës ose aftësisë së kufizuar nuk ekzistojnë dhe modeli mjekësor i aftësisë së kufizuar është përqafuar në vazhdimësi nga profesionistët mjekësorë. Parandalimi dhe analiza e rrezikut nuk ka përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe programet shëndetësore në shkolla, edukimi i prindërve dhe ndërhyrjet lokale janë kryer nga OJQ-të ose me fondet ndërkombëtare të donatorëve.**

REK 30 – Krijimi i një sistemi të kujdesit shëndetësor që është proaktiv në vend se reaktiv. Investimi në promovimin shëndetësor dhe edukimin shëndetësor, duke përfshirë edukimin prindëror për zhvillimin e fëmijës dhe sigurimi që ndërmerren masat preventive dhe universale si vaksinimi dhe kontrollet për kufizimet funksionale me qëllim të identifikimit të nevojave para se të ndodhin ato dhe inkurajimi i shtrirjes së informacionit nga mjekët e mjekësisë familjare dhe qendrat shëndetësore lokale të komunitetit. Të gjithë profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të kenë së paku njohuri minimale në lidhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Funksionimit dhe modelin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, duke çuar në një të kuptuar më të mirë të rolit të tyre brenda fushëveprimit të metodologjisë multidisiplinare të identifikimit dhe vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Institucioni/organizata përgjegjëse: MSH-ja

REK 31 – Nxitja e një modeli bashkëpunues që përfshin Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSh), MSH-në dhe profesionistët shëndetësor në nivel komunal që janë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, për

të siguruar që përgjigjet në nivel lokal të bëhen sipas standardeve ndërkombëtare. MSH-ja duhet të marrë përgjegjësinë për koordinimin e të gjitha aktiviteteve që lidhen me kujdesin shëndetësor, për të siguruar një qasje kohezive dhe të koordinuar për ofrimin e shërbimeve. Duhet të përgatiten një sërë udhëzimesh për donatorët, OJQ-të dhe OPAK-ët për të siguruar që të gjitha burimet financiare dhe njerëzore të ofruara për sistemin shëndetësor bien brenda standardeve të përcaktuara nga OBSH-ja, dhe marrin në konsideratë Udhëzimet e OSHB-së për Rehabilitim me Bazë në Komunitet për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Institucioni/organizata përgjegjëse: OBSH-ja dhe MSH-ja

REK 32 - Krijimi i ekipeve multidisiplinare që përfshijnë anëtarë të komunitetit të cilët kanë njohuri për komunitetet në të cilat jetojnë (p.sh. ndërmjetësit rom, udhëheqësit e komunitetit ashkali dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara) dhe që janë në gjendje të komunikojnë në mënyrë efektive dhe pa paragjykime me anëtarët e komunitetit. Zbatimi i legjislacionit ekzistues duke ofruar trajnime në Gjuhën e Shenjave për punonjësit në zyra publike, të cilët mund të mbështesin komunikimin adekuat ndërmjet komunitetit të shurdhër dhe profesionistëve të shëndetësisë.

Institucioni/organizata përgjegjëse: MSH-ja, autoritetet lokale dhe udhëheqësit e komunitetit

REK 33 – Përshpejtimi i zhvillimit të një sistemi të identifikimit të hershëm dhe intervenimit të hershëm (IH/IH), i cili respekton përkufizimin e aftësisë së kufizuar sipas modelit social, kryhet nga ekipet e profesionistëve multidisiplinar dhe çon në ofrimin e shërbimeve në mjedise gjithëpërfshirëse. Shtrirja dhe zgjerimi i përpjekjeve ekzistuese për vizita në shtëpi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe programet shëndetësore të shkollave për të ekzaminuar fëmijët e moshës shkollore për kufizime të mundshme funksionale në domenet e dëgjimit, shikimit, lëvizjes, komunikimit, të mësuarit dhe sjelljes/emocioneve gjatë gjithë ciklit të jetës duke përdorur protokollat e standardizuara.

Institucioni/organizata përgjegjëse: MSH-ja, MPMS-ja dhe MASHT-i

## Asgjë për Ne, Pa Ne

**Gjetje:** Puna lidhur me aftësinë e kufizuar është kryer kryesisht nga grupe të vogla të personave me aftësi të kufizuara, që kanë një interes të përbashkët për një dëmtim specifik. Përderisa ekziston një përpjekje e ripërtërirë për ta bërë aftësinë e kufizuar gjithëpërfshirëse në Kosovë, kjo përpjekje nuk e pranon gjithmonë se fëmijët kanë nevoja specifike që nuk mund të trajtohen në legjislacion, politika dhe shërbime të zhvilluara për të rriturit. Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre kanë munguar gjithandej në masë të madhe në dialog, dhe fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre nuk janë të informuar për të drejtat e tyre, ose për ato pak shërbime që janë në dispozicion të tyre.

REK 34 - Forcimi i kapaciteteve të OJQ-ve dhe OPAK-ve në përgjithësi, dhe Forumit të Personave me Aftësi të Kufizuara në veçanti, për të folur në emër të fëmijëve

me aftësi të kufizuara. Derisa Forumi i Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë përbëhet nga 7 OJQ/OPAK, të cilët kanë shumë njohuri dhe janë të aftë përkitazi me personat me dëmtime specifike, është më se e domosdoshme që të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara të mbrohen nga një organizatë që flet në emër të fëmijëve me vetëm një zë. Për shkak se fëmijët kanë nevoja dhe forca që janë specifike për moshën dhe nivelin e zhvillimit të tyre, Forumit të Personave me Aftësi të Kufizuara duhet ofruar mundësi për të zhvilluar kapacitetet e tyre në lidhje me të drejtat e fëmijëve, përfshirë angazhimin në konsultime me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe ata pa aftësi të kufizuara për çështjet që lidhen me ta (dhe që ata zgjedhin vetë).

Institucioni/organizata përgjegjëse: BE-ja dhe UNICEF-i, FKAK-u

REK 34 - Rritja e kapaciteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, dhe fuqizimi i tyre për të kërkuar të drejtat e tyre përmes diskutimeve publike dhe dialogut me autoritetet. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet angazhimit me fëmijët dhe familjet e tyre në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, kushtëzimi i të gjitha aktiviteteve të lidhura me aftësinë e kufizuar të financuara (ose pjesërisht të financuara) nga komuniteti ndërkombëtar që të përfshijnë aktivitete të monitorimit dhe vlerësimit që do të udhëhiqen nga fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, në bashkëpunim me OPAK-ët të cilët mund t'i përfaqësojnë ata.

Institucioni/organizata përgjegjëse: ZQM-ja dhe FKAK-u, OPAK-ët

REK 35 - Përkrahja e OPAK/OJQ-ve në sigurimin e vetëdijesimit dhe edukimit në lidhje me të drejtat e fëmijëve për popullatën në përgjithësi<sup>165</sup>, dhe në veçanti profesionistëve të vijës së parë; mbështetja e OPAK-ve në përvetësimin e shkathtësive dhe njohurive të nevojshme për t'u angazhuar në metoda të kombinuara, hulumtime pjesëmarrëse dhe aktivitete të M&V, duke kontribuar kështu në komunitetin hulumtues kosovar. Të sigurohet që OPAK/OJQ-të të krijojnë një rrjet informativ që mund të ofrojë informacion, referim dhe mbështetje për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

Institucioni/organizata përgjegjëse: ZQM-ja, FKAK-u dhe donatorët ndërkombëtar

REK 36 – Të sigurohet që fëmijët me aftësi të kufizuara të përfshihen në të gjitha planet e veprimit të reagimit humanitar, siç është Reduktimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë.

Institucioni/organizmi përgjegjës: ZQM-ja, ministritë e linjës



UNICEF/2011/S.Karahoda

**për çdo fëmijë, fëmijëri**



# SHTOJCA

## Shtojca 1 - Lista e IIK-ve

Emri	Institucioni	Pozita e personit brenda Organizatës
Dr. Brandão Có, MD, MPH	UNICEF	Përfaqësuesi i vendit
James Mugaju	UNICEF	Zëvendës Përfaqësues
Afrim Ibrahim, i	UNICEF	Zyrtar për Mbrojtjen e Fëmijëve
Feride Dashi	UNICEF	Zyrtare për Mbrojtjen e Fëmijëve
Kozeta Imami	UNICEF	Zyrtare e Arsimit
Agron Gashi	UNICEF	Zyrtar i Shëndetit dhe Ushqimit
Dren Rexha	UNICEF	Specialist i Mbrojtjes Sociale
Arjeta Gjokolli	UNICEF	Zyrtare për menaxhimin e të dhënave
Sergio Tomsa	UNICEF	Specialist për komunikim dhe informim
Florije Kryeziu	UNICEF	Zyrtare e Mbrojtjes Sociale
Jeton Siqeca	UNICEF	Zyrtar i Laboratorit të Inovacionit
Abit Hajredini	ZQM	Udhëheqësi i ZQM
Armenda Berani	ZQM	Zyrtare e Lartë për Personat me Aftësi të Kufizuara
Lulavere Behluli	MASHT	Drejtoreshë e Departamentit për Arsim me nevoja të Veçanta
Fadile Dyla	MASHT	Drejtoreshë e Departamentit për Infrastrukturën e Ndërtesave Arsimore
Enver Mekolli	MASHT	Zyrtar i SMIA
Gazmend Tahiraj	KAPIE	Koordinator i projektit
Merita Vuthaj	MSH	Drejtoreshë e Departamentit të Mbrojtjes së Nënës dhe Fëmijës
Muse Shigjeqi	MSH	Zyrtar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
Albana Morina	Qendra e Mjekësisë Familjare	Ushtruese e detyrës së udhëheqëses së kujdesit parësor shëndetësor
Ibush Fazliu	MPMS	Komisioni i Vlerësimit (shëndetësor) i MPMS
Qazim Gashi	MPMS	Shef i Divizionit për Aftësinë e Kufizuar dhe Personat e Moshuar
Salvador Elmazi Hysnije Maliqi,	Ministria e Financave	Drejtor i Departamentit të Buxhetit Analiste e buxhetit
Xheladin Hoxha	Kuvendi i Kosovës	Drejtor i Drejtorisë për Standardizim, Përafrim dhe Harmonizim Ligjor
Fehmi Hyseni,	Kuvendi i Kosovës	Drejtor i Drejtorisë për Mbështetje të Komisioneve Parlamentare
Vebi Mujku	Qendra për Punë Sociale (Prishtinë)	Drejtor
Sazan Ibrahim	Asociacioni i Komunave	Drejtor Ekzekutiv
Donjeta Kelmendi	KOMF	Drejtoreshë Ekzekutive
Bujar Kadriu	Forumi i OPAK në Kosovë	Kryetar i Forumit



Alketa Lasku	Terre des Hommes	Zëvendës Përfaqësuese e Vendit
Afrim Maliqi	HandiKOS	Drejtor
Ahmet Kryeziu	Save the Children	Drejtor
Sami Uka	OBSH	
Ilir Begolli	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik	Drejtor i partnerit për mjekësi sociale
Flora Kelmendi	Banka Boterore	Zyrtare e Lartë e Operacioneve në përmirësimin e Arsimit të Bankës Botërore
Edis Agani Visar Bivolaku	ZNKEK PSBE	Task Menaxhere në Zyrën e BE-së në Prishtinë Njësia Sociale Task Menaxher në zyrën e PSBE në Prishtinë
Hilmi Jashari	Avokati i Popullit	Avokat i Popullit
Igballe Rrahmani	Zyrtar Ligjor për të Drejtat e Fëmijës	Institucioni i Avokatit të Popullit
Ivana Milosavljevic	Mitrovica e Veriut Zyra zonale UNICEF	PO UNICEF
Ibadete Krasniqi	Amici de Bambini Kosovo	Drejtor Ekzekutiv
Gani Lluga	ASTRA Agjencia për hulumtime të të drejtave të fëmijëve	Drejtor
Ramadan Gashi	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	Drejtor
Igballe Potera	Qendra Burimore "Përparimi" Prishtinë	Drejtor
Drita Cenaj	Shkolla fillore "Ismail Qemali" Prishtinë	Drejtoreshë
Arben Vitia	Komuna e Prishtinës (Kolegjiumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale)	Kryesues i Kolegjiumit të Shoqatës së Kosovës për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Rozafa Ukimeraj-Çuni	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Sekretare e Përhershme
Liridona Preniqi	Komuna e Prishtinës	Udhëheqëse e Komisionit Komunal të Vlerësimit (pedagogjik) (Prishtina),
Rukije Gashi	Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës	Drejtoreshë Ekzekutive
Nebi Cakaj	Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës	Kryetar i Shoqatës së të Shurdhërve të Kosovës
Andreë Russell Nora Sahatciu	UNDP/UNKT	Kordinator i OKB-së për zhvillim Kordinatore e UNKT
Oliver Mains Mimoza Jupa	Zyra Amerikane	Zyrtar Politik Këshilltare për të Drejtat e Njeriut
Matteo Corradini	Ambasada Italiane	Zëvendës i Misionit
Sebahate Beqiri	OPAK Down Syndrome	Drejtoreshë Ekzekutive e OPAK Down Syndrome
Brigitte Koller Rezarta Jashari	GiZ	Zyrtare Kombëtare e Projektit Të drejtat sociale për grupet e cënueshme
Drita Dushi	Atletët e Olimpiadës Speciale	Drejtoreshë Ekzekutive
Ilir Begolli	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)	Drejtor i Institutit të Shëndetit Publik
Mimoza Shahini	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	Udhëheqëse e Departamentit të Psikiatrisë së Fëmijëve
Hilary Adams	HandiKOS	Konsulente
Ariana Shala	SOS	Përfaqësuese e SOS (mbrojtja e fëmijëve)

## Shtojca 2 – Orari dhe vendndodhja e DFG-ve

Janë kryer gjithsej 27 DFG në 7 lokacione:

1. Ferizaj
2. Gjakovë
3. Prizren
4. Mitrovica e Veriut
5. Prishtinë
6. Fushë Kosovë (Mahalla e Romëve)
7. Graçanicë (Mahalla e Romëve)

Në Ferizaj, Gjakovë, Prizren, u mbajtën katër (4) Diskutime të Fokus Grupeve: një (1) me fëmijë me aftësi të kufizuara, një (1) me fëmijë pa aftësi të kufizuara, një (1) me prindin/kujdestarin e fëmijëve me aftësi të kufizuara; një (1) me ofruesit e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në Prishtinë u mbajtën gjashtë (6) Diskutime të Fokus Grupeve: një (2) me fëmijë me aftësi të kufizuara, një (1) me fëmijë pa aftësi të kufizuara, një (1) me prindin/kujdestarin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe një (2) me ofruesit e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në Mitrovicëne Veriut u mbajtën katër (4) Diskutime të Fokus Grupeve: një (1) me fëmijë me aftësi të kufizuara, një (1) me fëmijë pa aftësi të kufizuara, një (1) me prindin/kujdestarin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe një (1) me ofruesit e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në Fushë Kosovë dhe Graçanicë u mbajtën dy (2) Diskutime të Fokus Grupeve: një (1) me fëmijët pa aftësi të kufizuara, një (1) me prindin/kujdestarin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Gjithsej, në të gjitha DFG-të, numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve, sipas llojit, është si në vijim:

62 fëmijë me aftësi të kufizuara  
 52 fëmijë pa aftësi të kufizuara  
 59 prindër/kujdestarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara  
 58 ofrues të shërbimeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara

### Fëmijët me aftësi të kufizuara në DFG-të:

Gjithsej 62 fëmijë (36 femra, 26 meshkuj) me aftësi të kufizuara morën pjesë.

Sipas grupmoshave:

Nën 6 vjeç: 6 fëmijë  
 6-10 vjeç: 19 fëmijë  
 11-14 vjeç: 28 fëmijë  
 15-17 vjeç: 8 fëmijë  
 18 vjeç: 1 fëmijë

Sipas përkatësisë etnike:

shqiptarë: 38 fëmijë

serbë: 8 fëmijë

rom dhe ashkali: 16 fëmijë

Sipas lokacionit:

Rural: 25 fëmijë

Urban: 37 fëmijë

### **Fëmijët pa aftësi të kufizuara në DFG-të:**

Gjithsej 52 fëmijë (36 femra, 16 meshkuj) pa aftësi të kufizuara morën pjesë.

Sipas grupmoshave:

Nën 6 vjeç: 0 fëmijë

6-10 vjeç: 10 fëmijë

11-14 vjeç: 34 fëmijë

15-17 vjeç: 7 fëmijë

18 vjeç: 1 fëmijë

Sipas lokacionit:

Rural: 13 fëmijë

Urban: 39 fëmijë

### **Prindërit/Kujdestarët e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara në DFG-të:**

Gjithsej 59 prindër/ kujdestarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara morën pjesë.

Nëna: 42

Etër: 10

Kujdestarë të tjerë: 7

Sipas lokacionit:

Rural: 20

Urban: 39

### **Ofruesit e Shërbimeve në DFG-të:**

Gjithsej 58 ofrues të shërbimeve morën pjesë.

Sipas domenit të shërbimeve:

Arsimi: 22

Shëndeti: 8

Mbrojtja e Fëmijëve: 8

OJQ (OPAK dhe OJQ të tjera): 16

Të tjerë (infrastruktura, sektori privat etj): 4

## Shtojca 3 -Mjetet dhe metodologjia e DFG-ve

Kriteret e përzgjedhjes për pjesëmarrësit në DFG-të për Analizën e Situatës të fëmijëve me aftësi të kufizuara

### 1. Fëmijët me aftësi të kufizuara

Në dobi të një diskutimi produktiv, ju lutemi përpiquni ta kufizoni madhësinë e një grupi në një maksimum prej 10. Megjithatë, ju lutemi mos i përjashtoni kujdestarët/prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë shprehur gatishmërinë për të marrë pjesë në diskutim.

Përbërja e grupit duhet të përzgjedhet sipas moshës, gjinisë, rajonit, zonës urbane/rurale, llojit të aftësisë së kufizuar – kriteri më i rëndësishëm është që fëmijët të mos i përkasin TË GJITHË të njëjtës shkollë, OJQ, grupi sportiv etj.

### 2. Fëmijët pa aftësi të kufizuara

Në dobi të një diskutimi produktiv, madhësia e një grupi duhet të kufizohet në një maksimum prej 10. Megjithatë, ju lutemi mos i përjashtoni fëmijët që kanë shprehur gatishmërinë për të marrë pjesë në diskutim.

Përbërja e grupit duhet të përzgjedhet sipas moshës, gjinisë, rajonit, zonës urbane/rurale, llojit të aftësisë së kufizuar – kriteri më i rëndësishëm është që fëmijët të mos i përkasin TË GJITHË të njëjtës shkollë, OJQ, grupi sportiv etj.

### 3. Prindërit/kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Në dobi të një diskutimi produktiv, madhësia e një grupi duhet të kufizohet në një maksimum prej 10. Megjithatë, ju lutemi mos i përjashtoni kujdestarët/prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë shprehur gatishmërinë për të marrë pjesë në diskutim.

Përbërja e grupit duhet të përzgjedhet sipas moshës, gjinisë, rajonit, zonës urbane/rurale, etj.

### 4. Ofruesit e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara

Në dobi të një diskutimi produktiv, madhësia e një grupi duhet të kufizohet në një maksimum prej 10. Megjithatë, ju lutemi mos i përjashtoni kujdestarët/prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë shprehur gatishmërinë për të marrë pjesë në diskutim.

Përbërja e grupit duhet të përzgjedhet sipas moshës, gjinisë, rajonit, zonës urbane /rurale, institucionit shëndetësor, institucionit arsimor, institucionit përkatës të qeverisjes lokale, OPAK, OJQ-ve, RBK, strehimit familjar, punonjësit social, psikologut, pedagogut, etj.)

Kriteri më i rëndësishëm është që pjesëmarrësit të punojnë drejtpërdrejt me fëmijët me aftësi të kufizuara ose me familjet e tyre. Këta duhet të jenë profesionistë që kanë një të kuptuar të asaj se si funksionon sistemi, jo vetëm vetë (si individë), por aftësia e sistemit në të cilin ata punojnë për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre.

## 1: Diskutimet e Fokus Grupeve me Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

### Udhëzime për Koordinatorët e DFG-së

- Në dobi të një diskutimi produktiv, ju lutemi përpiquni të kufizoni madhësinë e një grupi në një maksimum prej 10. Megjithatë, mos i përjashtoni fëmijët me aftësi të kufizuara që kanë shprehur gatishmërinë për të marrë pjesë në diskutim.
- Ju lutemi prezantoni veten me përsëritje të ngrohta, tregoni emrin tuaj, shpjegoni qëllimin e takimit dhe përdorimin e synuar të gjetjeve të studimit. Ju lutemi shpjegoni se pjesëmarrja në studim është absolutisht vullnetare dhe se ky diskutim nuk përfshin ndonjë ekzaminim biologjik/mjekësor. Ju lutemi shënoni emrin dhe adresat e pjesëmarrësve për qëllime të kontrollit të cilësisë.
- Ju lutemi lexoni dhe shpjegoni pyetjet në një gjuhë të thjeshtë që mund të kuptohet nga një fëmijë dhe jini të vëmendshëm për përbërjen e grupit (sipas moshës, gjinisë, llojeve të aftësisë së kufizuar etj.). Shpjegoni pyetjet nëse është e nevojshme, por shmanguni ndikimit/udhëheqjes së kahjes së përgjigjeve të pjesëmarrësve.
- Ju lutemi sigurohuni që fëmijët të mos pyeten apo të të hetohen me imtësi për të zbuluar ndonjë hollësi personale, konfidenciale ose intime rreth jetës së tyre dhe se të gjithë fëmijët të marrin pjesë në diskutim. Sidoqoftë, mos angazhoni në bisedë asnjë fëmijë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose mos e detyroni në përgjigje të sforcuar. Vëriteni re ata që nuk përgjigjen.
- Është e dëshirueshme që fëmijët me aftësi të kufizuara të marrin pjesë vetë në DFG. Megjithatë, ky kufizim mund të jetë i shlrë në disa raste (p.sh. dëmtimet e komunikimit, etj.) dhe një kujdestar/anëtar i familjes mund të lejohet të shoqërojë fëmijën.

### Pyetjet

1. **Ju lutem, a mund të përshkruani aktivitetet që zakonisht bëni gjatë ditës?** [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah shkallën e përfshirjes në lloje të ndryshme të aktiviteteve normale të përditshme, si shkuarja në shkollë, kryerja e detyrave të shtëpisë, pjesëmarrja në aktivitete sportive, ndihma në punët e ndryshme të shtëpisë, hobit dhe nëse janë të përfshirë në ndonjë "punë" të paguar ose të papaguar, etj.]
2. **Ju lutem, a mund të përshkruani personat me të cilët kaloni shumicën e kohës gjatë ditës? Cilat janë gjërat që bëni me ta? Çfarë tjetër do të dëshironit të bëni?** [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah llojin, rolin dhe shkallën e përfshirjes së kujdestarëve në jetën e përditshme të fëmijëve; hetoni për dallimet midis përgjigjeve të djemve dhe vajzave]
3. **Ju lutem, a mund të përshkruani ndonjë person tjetër (përveç kujdestarit kryesor) me të cilin kaloni kohë gjatë ditës ose nganjëherë? Cilat janë gjërat që bëni me të/ta? Çfarë tjetër do të dëshironit të bëni me të/ta?** [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah llojin, rolin dhe shkallën e përfshirjes së anëtarëve tjerë të familjes dhe jo të familjes në jetën e fëmijëve]

4. **Cila është gjëja që ju pëlqen të bëni më së shumti?** [p.sh. të kaloni kohë me anëtarët e familjes dhe miqtë, të luani lojëra me të tjerët, të ndiqni hobit tuaj, të vizitoni vende të ndryshme, të shkoni në ngjarje shoqërore ose kulturore etj.]
5. **Ju lutem, a mund të përshkruani se çfarë bëni në shkollën/institucionin ku shkoni dhe sa ju pëlqen?** [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah përvojën e fëmijëve në shkollë/institucion, pëlqimet e tyre dhe mospëlqimet për vendin, sjelljen dhe bashkëpunimin e pranuar - nga mësimdhënësit dhe/ose stafi, metodat e mësimdhënies/trajnitimit/kujdesit të përdorur, bashkëveprimet me fëmijët e tjerë, disponueshmërinë dhe lehtësinë e qasjes në infrastrukturë, pengesat në qasjen në shkollë/institucion dhe çdo praktikë tjetër të mirë apo diskriminuese që fëmijët ndjejnë në shkollë/institucion]
6. **Sa shpesh shkoni tek doktori/infermierja? Çfarë ju pëlqen kur shkoni aty? Çfarë do të dëshironit të ishte ndryshe?** [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah shpeshësinë e vizitave, llojin e shërbimit shëndetësor të pranuar, pëlqimet dhe mospëlqimet për vendin dhe shërbimet, lehtësinë e qasjes në infrastrukturë, sjelljen dhe bashkëpunimin e pranuar nga stafi/mjeku, ndonjë pengesë në qasjen në institucion dhe çdo praktikë tjetër të mirë ose diskriminuese që fëmijët ndjejnë në atë vend.]
7. **Ju lutem, a mund të përshkruani nëse merrni pjesë në aktivitetet e komunitetit me fëmijët tjerë dhe të rriturit?** (p.sh. sportet, lojrat, festat fetare, martesat, funeralet, etj.)? [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah arsyen përse duan të marrin pjesë, shkallën e pjesëmarrjes së tyre, nëse dikush nga komuniteti ose anëtarët e familjes i ndihmon ata në pjesëmarrje, reagimin e anëtarëve të komunitetit në lidhje me pjesëmarrjen e tyre, ndonjë pengesë në pjesëmarrje, nëse duan të marrin pjesë më shumë ose më pak, etj.]
8. **Sa prej jush kanë miq/shokë?** [Vëritë re ata që nuk kanë] **Çfarë mund të na thoni për miqtë tuaj?** [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah nëse fëmijët kanë ndonjë shok në lagjen dhe/ose në shkollë/institucion, nëse kanë ndonjë mik(mi)q pa aftësi të kufizuara, a luajnë me ta rregullisht, cilat lloje lojërash luajnë, si ndihen për miqtë e tyre, si ndihen kur shkojnë në shtëpinë e mikut, etj.]
9. **Ju lutem, a mund të përshkruani herën e fundit kur keni pasur frikë apo jeni frikësuar dhe pse?** [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah arsyen përse ata ndjehen të pasigurtë ose të frikësuar, ku ndihen më së shumti të pasigurt ose të frikësuar (në shtëpi, jashtë shtëpisë, në institucion, në institucionin shëndetësor, në komunitet ose në ngjarje shoqërore etj.).
10. **Ju lutem, a mund të përshkruani herën e fundit që dikush ju ka bërë të ndiheni të pikëlluar apo të mërzhitur?** [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah nëse ata kanë përjetuar ndodhi negative si tallja ose ngacmimi më shumë sesa fëmijët pa aftësi të kufizuara, çfarë bëjnë ata kur ndihen të pikëlluar, nëse dikush (kujdestar, mik, anëtar i komunitetit etj.) ndihmojnë në këtë drejtim etj.]
11. **Sa herë ju lejohet të bëni vetë zgjedhjet tuaja/vendimet tuaja?** [Diskutimi duhet të çojë në atë nëse ata mund të zgjedhin që të jetojnë në shtëpi me familjen e



tyre; shkollën ku ata shkojnë; mjekun/infermierin që e vizitojnë; aktivitetet që bëjnë me miqtë, familjen dhe të tjerët në komunitetin tuaj etj.]

12. **Çfarë dëshironi të bëni/të bëheni kur të rriteni?** [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah aspiratat e tyre, mënyrën se si ata mendojnë se mund të përmbushen, llojet e udhëzimeve ose ndihmës që duan nga familja, miqtë, pjesëtarët e komunitetit, mësuesit, qeveria dhe organizatat e tjera, etj.]

\*\*\*\*\*

**Pyetjet dytësore duhet të bëhen vetëm nëse këtë e lejon koha.**

13. **A keni marrë pjesë ndonjëherë në ndonjë proces vendimmarrës, shkruarjen e ndonjë ligj apo politike mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në shkollë ose në institucione të tjera?**

a. Nëse po: A mund të jepni një shembull se si keni kontribuar në këtë proces?

14. **Ju lutem, a mund të përshkruani nëse keni marrë ndonjë ndihmë/informacion nga një organizatë jashtë familjes ose shkollës suaj?**

- Prej atyre që thonë po, kërkoni ta përshkruajnë organizatën.

[Diskutimi duhet të nxjerrë në pah llojin, rolin dhe shkallën e përfshirjes së këtyre organizatave në jetën e fëmijëve. Shënim: Organizatat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si Organizata Joqeveritare, Organizata të Shoqërisë Civile, Organizata me bazë fetare, Organizata me bazë në komunitet, Organizata të personave me aftësi të kufizuara, Organizata që punojnë për personat me aftësi të kufizuara etj. Fëmijët mund ose mund të mos bëjnë dallimin në mes llojeve të ndryshme të organizatave si OJQ, OSHC, OPAK, etj. Koordinatorin e DFG-ve mund t'i shpjegojë këto koncepte në formën më të thjeshtë me shembuj, nëse kërkohet, për të lehtësuar diskutimin. **Ju lutemi sigurohuni që të mos pyetni për llojin e saktë të organizatës përveç nëse fëmijët janë të sigurt për të. Ju lutemi shënoni përgjigjen e fëmijëve saktësisht ashtu siç ato jipen.]**

## 2: Diskutimet e Fokus Grupeve me Fëmijët pa Aftësi të Kufizuara

### Udhëzime për Koordinatorët e DFG-së

- Në dobi të një diskutimi produktiv ju lutemi përpiquni të kufizoni madhësinë e një grupi në një maksimum prej 10. Megjithatë, mos i përjashtoni fëmijët që kanë shprehur gatishmërinë për të marrë pjesë në diskutim.
- Ju lutemi prezantoni veten me përshëndetje të ngrohta, tregoni emrin tuaj, shpjegoni qëllimin e takimit dhe përdorimin e synuar të gjetjeve të studimit. Ju lutemi shpjegoni se pjesëmarrja në studim është absolutisht vullnetare. Ju lutemi shënoni emrin dhe adresat e pjesëmarrësve për qëllime të kontrollit të cilësisë.
- Ju lutemi lexoni dhe shpjegoni pyetjet në një gjuhë të thjeshtë që mund të kuptohet nga një fëmijë dhe jini të vëmendshëm për përbërjen e grupit (sipas moshës, gjinisë, etj.). Shpjegoni pyetjet nëse është e nevojshme, por shmanguni ndikimit/udhëheqjes së kahjes së përgjigjeve të pjesëmarrësve.

- Ju lutemi sigurohuni që fëmijët të mos pyeten apo të të hetohen me imtësi për të zbuluar ndonjë hollësi personale, konfidenciale ose intime rreth jetës së tyre dhe që të gjithë fëmijët të marrin pjesë në diskutim. Sidoqoftë, mos angazhoni në bisedë asnjë fëmijë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose mos e detyroni në përgjigje të sforcuar. Vëri re ata që nuk përgjigjen.
- Është e dëshirueshme që fëmijët të marrin pjesë vetë në DFG. Nëse mbani DFG në një shkollë, lutni me mirësjellje çdo të rritur që të largohet nga dhoma.

## Pyetjet

- 1. Ju lutem, a mund të përshkruani aktivitetet që zakonisht bëni gjatë ditës?** *[Diskutimi duhet të nxjerrë në pah shkallën e përfshirjes në lloje të ndryshme të aktiviteteve normale të përditshme, si shkuarja në shkollë, kryerja e detyrave të shtëpisë, pjesëmarrja në aktivitete sportive, ndihma në punët e ndryshme të shtëpisë, hobit dhe nëse janë të përfshirë në ndonjë "punë" të paguar ose të papaguar, etj.]*
- 2. Ju lutem, a mund të përshkruani personat me të cilët kaloni shumicën e kohës gjatë ditës? Cilat janë gjërat që bëni me ta? Çfarë tjetër do të dëshironit të bëni?** *[Diskutimi duhet të nxjerrë në pah llojin, rolin dhe shkallën e përfshirjes së kujdestarëve në jetën e përditshme të fëmijëve dhe të hetojë për dallimet midis përgjigjeve të djemve dhe vajzave]*
- 3. Ju lutem, a mund të përshkruani ndonjë person tjetër (përveç kujdestarit kryesor) me të cilin kaloni kohë gjatë ditës ose nganjëherë? Cilat janë gjërat që bëni me të/ta? Çfarë tjetër do të dëshironit të bëni me të/ta?** *[Diskutimi duhet të nxjerrë në pah llojin, rolin dhe shkallën e përfshirjes së anëtarëve tjerë të familjes dhe jo të familjes në jetën e fëmijëve]*
- 4. Cila është gjëja që ju pëlqen të bëni më së shumti?** *[p.sh. të kaloni kohë me anëtarët e familjes dhe miqtë, të luani lojëra me të tjerët, të ndiqni hobit tuaj, të vizitoni vende të ndryshme, të shkoni në ngjarje shoqërore ose kulturore etj.]*
- 5. Ju lutem, a mund të përshkruani se çfarë bëni në shkollë/institucionin ku shkoni dhe sa ju pëlqen?** *[Diskutimi duhet të nxjerrë në pah përvojën e fëmijëve në shkollë/institucion, pëlqimet e tyre dhe mospëlqimet për vendin, sjelljen dhe bashkëpunimin e pranuar - nga mësimdhënësit dhe/ose stafi, metodat e mësimdhënies/trajnitimit/kujdesit të përdorur, bashkëveprimet me fëmijët e tjerë, disponueshmërinë dhe lehtësinë e qasjes në infrastrukturë, pengesat në qasjen në shkollë/institucion dhe çdo praktikë tjetër të mirë apo diskriminuese që fëmijët ndjejnë në shkollë/institucion]*
- 6. Sa shpesh shkoni tek doktori/infermierja? Çfarë ju pëlqen kur shkoni aty? Çfarë do të dëshironit të ishte ndryshe?** *[Diskutimi duhet të nxjerrë në pah shpeshësinë e vizitave, llojin e shërbimit shëndetësor të pranuar, pëlqimet dhe mospëlqimet për vendin dhe shërbimet, lehtësinë e qasjes në infrastrukturë, sjelljen dhe bashkëpunimin e pranuar nga stafi/mjeku, ndonjë pengesë në qasjen në institucion dhe çdo praktikë tjetër të mirë ose diskriminuese që fëmijët ndjejnë në atë vend.]*

7. **Ju lutem, a mund të përshkruani nëse merrni pjesë në aktivitetet e komunitetit me fëmijët tjerë dhe të rriturit?** (p.sh. sportet, lojrat, festat fetare, martesat, funeralet, etj.)? [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah arsyen përse duan të marrin pjesë, shkallën e pjesëmarrjes së tyre, nëse dikush nga komuniteti ose anëtarët e familjes i ndihmon ata në pjesëmarrje, reagimin e anëtarëve të komunitetit në lidhje me pjesëmarrjen e tyre, ndonjë pengesë në pjesëmarrje, nëse duan të marrin pjesë më shumë ose më pak, etj.]
8. **Sa prej jush kanë miq?** [Vini re ata që nuk kanë] **Çfarë mund të na thoni për miqtë tuaj?** [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah nëse fëmijët kanë ndonjë shok në lagjen dhe/ose në shkollë/institucion, nëse kanë ndonjë mik(mi)q pa aftësi të kufizuara, a luajnë me ta rregullisht, cilat lloje lojërash luajnë, si ndihen për miqtë e tyre, si ndihen kur shkojnë në shtëpinë e mikut, etj.]
9. **Ju lutem, a mund të përshkruani herën e fundit kur keni pasur frikë apo jeni frikësuar dhe pse?** [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah arsyen përse ata ndjehen të pasigurtë ose të frikësuar, ku ndihen më së shumti të pasigurt ose të frikësuar (në shtëpi, jashtë shtëpisë, në institucion, në institucionin shëndetësor, në komunitet ose në ngjarje shoqërore etj.).
10. **Ju lutem, a mund të përshkruani herën e fundit që dikush ju ka bërë të ndiheni të pikëlluar apo të mërzitur?** [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah nëse ata kanë përjetuar ndodhi negative, si tallja ose ngacmimi më shumë sesa fëmijët pa aftësi të kufizuara, çfarë bëjnë ata kur ndihen të pikëlluar, nëse dikush (kujdestar, mik, anëtar i komunitetit etj.) ndihmojnë në këtë drejtim etj.]
11. **Sa herë ju lejohet të bëni vetë zgjedhjet tuaja/vendimet tuaja?** [Diskutimi duhet të çojë në atë nëse ata mund të zgjedhin që të jetojnë në shtëpi me familjen e tyre; shkollën ku ata shkojnë; mjekun/infermierin që e vizitojnë; aktivitetet që bëjnë me miqtë, familjen dhe të tjerët në komunitetin tuaj etj.]
12. **Çfarë dëshironi të bëni/të bëheni kur të rriteni?** [Diskutimi duhet të nxjerrë në pah aspiratat e tyre, mënyrën se si ata mendojnë se mund të përmbushen, llojet e udhëzimeve ose ndihmës që duan nga familja, miqtë, pjesëtarët e komunitetit, mësuesit, qeveria dhe organizatat e tjera, etj.]

\*\*\*\*\*

**Pyetjet dytësore duhet të bëhen vetëm nëse këtë e lejon koha.**

13. **A keni marrë pjesë ndonjëherë në ndonjë proces vendimmarrës, shkruarjen e ndonjë ligj apo politike mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në shkollë ose në institucione të tjera?**
  - a. Nëse po: A mund të jepni një shembull se si keni kontribuar në këtë proces?
14. **Ju lutem, a mund të përshkruani nëse keni marrë ndonjë ndihmë/informacion nga një organizatë jashtë familjes ose shkollës suaj?**
  - Prej atyre që thonë po, kërkoni ta përshkruajnë organizatën.

*[Diskutimi duhet të nxjerrë në pah llojin, rolin dhe shkallën e përfshirjes së këtyre organizatave në jetën e fëmijëve. Shënim: Organizatat mund të jenë të llojeve të ndryshme si Organizata Joqeveritare, Organizata të Shoqërisë Civile, Organizata me bazë fetare, Organizata me bazë në komunitet, Organizata të personave me aftësi të kufizuara, Organizata që punojnë për personat me aftësi të kufizuara etj. Fëmijët mund ose mund të mos bëjnë dallimin në mes llojeve të ndryshme të organizatave si OJQ, OSHC, OPAK, etj. Koordinator i DFG-ve mund t'i shpjegojë këto koncepte në formën më të thjeshtë me shembuj, nëse kërkohet, për të lehtësuar diskutimin. **Ju lutemi sigurohuni që të mos pyetni për llojin e saktë të organizatës përveç nëse fëmijët janë të sigurt për të. Ju lutemi shënoni përgjigjen e fëmijëve saktësisht ashtu siç ato jipen.]***

### 3: Diskutimet e Fokus Grupeve me kujdestarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara

- Në dobi të një diskutimi produktiv, ju lutemi përpiquni të kufizoni madhësinë e një grupi në një maksimum prej 10. Megjithatë, ju lutemi mos i përjashtoni kujdestarët/prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë shprehur gatishmërinë për të marrë pjesë në diskutim.
- Ju lutemi prezantoni veten me përshëndetje të ngrohta, tregoni emrin tuaj, shpjegoni qëllimin e takimit dhe përdorimin e synuar të gjetjeve të studimit. Ju lutemi shpjegoni se pjesëmarrja në studim është absolutisht vullnetare dhe se ky diskutim nuk përfshin ndonjë ekzaminim biologjik/mjekësor. Ju lutemi shënoni emrin dhe adresat e pjesëmarrësve për qëllime të kontrollit të cilësisë.
- Ju lutemi lexoni dhe shpjegoni **pyetjet** në një gjuhë të thjeshtë dhe jini të vëmendshëm për përbërjen e grupit (sipas moshës, gjinisë, rural/urban, etj.). Shpjegoni pyetjet nëse është e nevojshme, por shmanguni ndikimit/udhëheqjes së kahjes së përgjigjeve të pjesëmarrësve.
- Ju lutemi sigurohuni që askush të mos pyetet apo të të hetohen me imtësi për të zbuluar ndonjë hollësi personale, konfidenciale ose intime rreth jetës së tyre apo të fëmijës.

#### Pyetjet e lidhura me aftësinë e kufizuar

1. Cila është marrëdhënia juaj me fëmijët me aftësi të kufizuara që përfaqësoni në këtë diskutim? (Ju lutemi shënoni nëse është nëna/babai ose kujdestari; në rastin e një kujdestari, shënoni llojin e marrëdhënies – vëlla/motër, teze/hallë, gjysh, punonjës social, menaxher i rastit, etj.). Sa fëmijë të tjerë keni? A është fëmija juaj me aftësi të kufizuara fëmija i parë, i fundit apo i mesëm?
2. Ju lutem, a mund të përshkruani fëmijët tuaj me aftësi të kufizuara me fjalët tuaja?
3. A kanë fëmijët tuaj certifikata të aftësisë së kufizuar? Cilat janë kategoritë ose llojet zyrtare të aftësisë së kufizuar? (shënoni përgjigjen saktësisht ashtu siç është dhënë)
4. Kur keni kuptuar për herë të parë se fëmijët tuaj kishin vështirësi specifike? Kush ju ndihmoi të diagnostikoni aftësitë e kufizuara? Sa vjeç ishin fëmijët tuaj në kohën e diagnozës?

## Pyetjet mbi rutinën e përditshme dhe kujdesin

5. **Ju lutem, a mund ta përshkruani një ditë të rregullt të fëmijës tuaj?** *[Ju lutem, hetoni për shkuarjen në shkollë, kryerjen e detyrave të shtëpisë, lojën, punën, etj. dhe pyesni për përfshirjen e tij/saj]. A i kryejnë të gjitha këto gjëra vetëm ose me ndihmesë?* *[hetoni për specifikat se kush, çfarë, sa shpesh, etj. është ndihmesa].*
6. **Çfarë u pëlqen fëmijëve tuaj të bëjnë më së shumti?** *[ose] Cilat janë hobit e tij/saj? Si dhe sa shpesh i bëjnë ato? A i inkurajoni zgjedhjet e tyre? A i ndihmoni ndonjëherë ata të bëjnë këto gjëra/të ndjekin hobit? Si?*
7. **A jeni ju personi që kalon shumicën e kohës me fëmijët tuaj në shtëpi dhe ofron kujdes?**
  - a. Nëse 'jo', kush kalon pjesën më të madhe të kohës me fëmijët tuaj dhe i ofron atij/asaj ndihmën e nevojshme? Cila është marrëdhënia midis personit dhe fëmijëve tuaj?

## Pyetjet mbi jetën shoqërore

8. **A e dini se kush janë shokët e fëmijës suaj? A i inkurajoni fëmijët tuaj të krijojnë shokë të rinj? Pse, pse jo?**
  - a. Nëse prindi i njeh disa shokë: **Si dhe sa shpesh bashkëveprojnë fëmijët tuaj me shokun (ët)? Çfarë bëjnë fëmijët tuaj me shokët e tij/saj? A janë shokët e tij/saj me dhe pa aftësi të kufizuara? A shkojnë fëmijët tuaj ndonjëherë në shtëpinë e shokut të tij/saj? A vijnë edhe shokët gjithashtu në shtëpinë tuaj?** *Ju lutem hetoni.*
  - b. Nëse 'jo': **pse mendoni se fëmijët tuaj nuk kanë shokë? A mendoni se ka ndonjë arsye specifike pse fëmijët tuaj nuk duan të bashkëveprojnë me fëmijët e tjerë dhe anasjelltas?**
9. **A marrin pjesë fëmijët tuaj rregullisht në jetën shoqërore ose të komunitetit?** *(p.sh. sporte, lojëra, festa, festa fetare, martesë, funerale etj.)*
  - a. Nëse 'po': **A ndihmojnë shokët e tij/saj ose ndonjë anëtar i komunitetit në pjesëmarrje? Si ndihmojnë ata? A merrni pjesë ju si familje në ngjarje shoqërore ose kulturore ose në komunitet së bashku me fëmijën? Sa shpesh? A e pengojnë miqtë, fqinjët apo udhëheqësit e komunitetit pjesëmarrjen e fëmijës suaj në jetën e komunitetit?** *Ju lutem, a mund ta shtjelloni përgjigjen tuaj?*

## Pyetjet mbi arsimin

10. **A ndjekin fëmijët tuaj ndonjë institucion arsimor?**
  - a. Nëse 'po': **cili është lloji i shkollës?** *(p.sh. Qendra e zhvillimit të hershëm të fëmijëve, shkolla e zakonshme, shkolla ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara, qendra e kujdesit ditor për personat me aftësi të kufizuara, qendra e aftësimin profesional, shkolla rezidenciale për fëmijët me aftësi të kufizuara etj.)*

b. Nëse fëmija ndjek një shkollë të zakonshme: Në cilën klasë janë duke mësuar fëmijët tuaj aktualisht? A kanë anashkaluar fëmijët tuaj ndonjë klasë?

i. Nëse 'po': pse? A kanë përsëritur fëmijët tuaj ndonjë klasë?

1. Nëse 'po': pse?

c. Nëse fëmija **NUK** është duke ndjekur ndonjë institucion arsimor aktualisht: A kanë ndjekur ndonjëherë fëmijët tuaj ndonjë parashkollë, shkollë apo institucion?

i. Nëse 'po': cili ishte lloji i institucionit? Cila ishte klasa e fundit e vijuar nga fëmija juaj? Pse fëmijët tuaj nuk janë duke shkuar aty për momentin? I kujt ishte vendimi për t'i larguar fëmijët tuaj nga shkolla? A dëshironi që fëmija juaj të vazhdojë arsimin e tij/saj?

11. Ju lutem, a mund të na tregoni se si fëmijët tuaj përshkruajnë përvojën e tij/saj në shkollë? [Ju lutem hetoni se si fëmija rrëfen përvojën e tij/saj në lidhje me sjelljen ose bashkëpunimin nga mësuesit, shokët, shokët e klasës etj.]
12. Deri në çfarë mase mendoni se shkolla/institucioni është duke përmbushur nevojat e të mësuarit të fëmijëve tuaj? Ju lutem përshkruani.

### Pyetjet mbi shëndetin

13. Sa shpesh fëmijët tuaj vizitojnë një institucion shëndetësor/mjek? Cilat janë arsyet kryesore pse dërgoni fëmijën tuaj në një institucion shëndetësor/mjek? [Ju lutem hetoni mbi kontrollin e rregullt shëndetësor të ndërlidhura me çështje të aftësisë së kufizuar dhe çështje të tjera shëndetësore, imunizimin, kujdesin emergjent etj.]
14. Ku i dërgoni zakonisht fëmijët tuaj për trajtim/kontroll shëndetësor? Ju lutem përshkruani llojin e institucionit/doktorit. Pse i dërgoni fëmijët tuaj tek ty institucion/doktor i veçantë? Ju lutem shpjegoni. A e shoqëroni gjithmonë fëmijën tuaj? Nëse 'jo' kush e dërgon fëmijën tuaj në këtë vend?
15. Nëse fëmijët tuaj nuk janë duke vizituar rregullisht ndonjë institucion/doktor, cilat janë arsyet? A mendoni se fëmijët tuaj duhet të kenë kontrole shëndetësore më shpesh? A jeni ballafaquar ndonjëherë me ndonjë sfidë apo vështirësi në qasjen në institucionet/shërbimet shëndetësore?

### Pyetjet mbi qetësinë dhe sigurinë

16. A e dini nëse fëmija juaj i është nënshtruar ndonjëherë talljes, ngacmimit ose abuzimit, nga të rriturit apo fëmijët e tjerë ?
- a. Nëse 'po': sa shpesh? Çfarë keni bërë në lidhje me këtë? [Vetëm për fëmijët vajza me aftësi të kufizuara] A ishin rastet e [talljes, ngacmimit ose abuzimit] direkt të lidhura me faktin se fëmijët tuaj janë vajza? Ju lutem shpjegoni.
17. A e dini se kujt [personi/organizate] duhet t'i drejtoheni për ndihmë nëse fëmija juaj është duke u abuzuar?



## Të drejtat, ëndrrat dhe aspiratat

18. Çfarë dëshiron të bëhet fëmija juaj kur të rritet?
19. Çfarë dëshironi që të bëhet fëmija juaj kur të rritet? Si mendoni se fëmija juaj mund ta arrijë këtë?
20. Kush e ka përgjegjësinë për të mbështetur fëmijën tuaj në përmbushjen e ëndrrës së tyre?
21. A mendoni se fëmija juaj ka më shumë, më pak ose të njëjtat të drejta si të gjithë fëmijët e tjerë? Pse?

\*\*\*\*\*

Pyetjet dytësore duhet të bëhen vetëm nëse këtë e lejon koha

22. A ka fëmija juaj përkrahjen e një asistenti në mënyrë që të plotësojë disa nga detyrat e tij/saj të përditshme, siç është shkuarja në shkollë?
  - a. Nëse po: kush paguan për këtë asistent? Si dhe sa shpesh raporton asistenti tek ju (prindi/ kujdestari)?
23. Cilat janë gjërat që ju/kujdestari bëni me fëmijët tuaj, në një ditë të zakonshme, që fëmija juaj nuk mund të bëjë vetëm? A mendoni se kaloni mjaft kohë me fëmijët tuaj? A ju shkëput kjo nga detyra të tjera, duke përfshirë kujdesin për fëmijët e tjerë? A kalojnë anëtarët e tjerë të familjes rregullisht kohë me fëmijët tuaj?
  - a. Nëse 'po': kush, sa dhe sa shpesh?
24. A janë fëmijët tuaj anëtarë të ndonjë klubi sportiv, të të rinjve apo ndonjë grupi të tillë të komunitetit?
  - a. Nëse 'po': a mund ta përshkruani këtë grup dhe pjesëmarrjen e tij/saj aty?
  - b. Nëse 'jo': cilat janë arsytet për mos marrjen pjesë rregullisht në jetën shoqërore apo të komunitetit? Ju lutem përshkruani.
25. A ka fëmija juaj një Plan të individualizuar arsimor?
  - a. Nëse po: A merrni pjesë në zhvillimin e planit të individualizuar arsimor në shkollë?
    - i. Nëse po: a mendoni se jeni partner i barabartë në krijimin e planit të individualizuar arsimor për fëmijën tuaj?
    - ii. Nëse jo: pse jo?
  - b. Nëse jo: a ka folur ndokush ndonjëherë me ju në lidhje me nevojat mësimore të fëmijës suaj?
26. A mendoni se fëmija juaj mund të qaset në të gjitha pjesët e shkollës pa ndihmë? (p.sh. ndërtesa, tualeti, klasa, etj.)? *[Intervistuesi, ju lutem të hetoni për disponueshmërinë e infrastrukturës si tualeti, rampa (pjerrina), etj., që është miqësore për personat me aftësi të kufizuara]*

27. Si arrijnë fëmijët tuaj deri në shkollë? A përballen fëmijët tuaj me ndonjë vështirësi për të arritur në shkollë? *Ju lutem përshkruani.*
28. Sipas këndvështrimit tuaj, a janë fëmijët tuaj të lumtur të ndjekin këtë shkollë? Si e dini këtë?
29. A ndiheni të kënaqur me shërbimet e marra nga ky institucion/mjek në përgjithësi? *Ju lutem hetoni çështjet e mëposhtme që përgjithësisht përcaktojnë kënaqshmërinë*
30. Sa larg ju duhet të udhëtoni për të shkuar atje?
31. Cila është gjendja e infrastrukturës? *(Ju lutem hetoni rreth disponueshmërisë së infrastrukturës miqësore për njerëzit me aftësi të kufizuara)*
32. A janë llojet e ndryshme të shërbimeve që nevojiten për fëmijët në dispozicion në institucion? *(p.sh. mjeku i përgjithshëm, pediatri, fizioterapia, etj.)*
33. Cila është cilësia e trajtimit mjekësor dhe këshillimit?
  - a. A jeni të kënaqur me cilësinë e trajtimit mjekësor dhe këshillimit të ofruar?
34. A i merrni nga aty të gjitha barnat e nevojshme/të përshkruara nga një mjek?
35. A mund të bëni testet mjekësore/laboratorike aty?
36. Sa ju duhet të shpenzoni (nga xhepi) në institucion, për të marrë shërbimet? A mendoni se është në rregull? *Ju lutem, a mund ta shtjelloni përgjigjen?*
37. A keni shqetësime në lidhje me sigurinë e fëmijëve tuaj? Cilat janë këto shqetësime? *Ju lutem shtjelloni.*
38. A keni marrë ndonjëherë ndonjë ndihmë nga ndonjë organizatë? A mund të përshkruani format e ndihmës? A keni marrë ndihmën falas apo keni pasur ndonjë shpenzim nga xhepi juaj? *[Hetoni nëse është fjala për Qeverinë, Organizata me bazë në komunitet, Shërbime të rehabilitimit me bazë në komunitet, Organizata joqeveritare, Organizata të shoqërisë civile, Organizata me bazë fetare, Organizata me bazë në komunitet]*
39. Sa dini për Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ose kuadrin ligjor vendor që siguron të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë?

#### 4: Diskutimet e Fokus Grupeve me ofruesit e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara

- Në dobi të një diskutimi produktiv, ju lutemi përpiquni të kufizoni madhësinë e një grupi në një maksimum prej 10. Megjithatë, ju lutemi mos i përjashtoni kujdestarët/prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë shprehur gatishmërinë për të marrë pjesë në diskutim.
- Ju lutemi prezantoni veten me përshëndetje të ngrohta, tregoni emrin tuaj, shpjegoni qëllimin e takimit dhe përdorimin e synuar të gjetjeve të studimit. Ju lutemi shpjegoni se pjesëmarrja në studim është absolutisht vullnetare dhe se ky diskutim nuk përfshin ndonjë ekzaminim biologjik/mjekësor. Ju lutemi shënoni emrin dhe adresat e pjesëmarrësve për qëllime të kontrollit të cilësisë.
- Ju lutemi lexoni dhe shpjegoni **pyetjet** në një gjuhë të thjeshtë dhe jini të vëmendshëm për përbërjen e grupit (sipas moshës, gjinisë, rural/urban, etj.). Shpjegoni pyetjet nëse është e nevojshme, por shmangiuni ndikimit/udhëheqjes së kahjes së përgjigjeve të pjesëmarrësve.
- Ju lutemi sigurohuni që askush të mos pyetet apo të të hetohen me imtësi për të zbuluar ndonjë hollësi personale, konfidenciale ose intime rreth jetës së tyre apo të fëmijës.

1. **Ju lutem, a mund të përshkruani llojin e shërbimit që ju ofroni për fëmijët me aftësi të kufizuara?** *Ju lutem mbledhni informacion për secilin veç e veç.*
2. **Cilat fëmijë me aftësi të kufizuara në përgjithësi vijnë për të marrë shërbimet tuaja?** *[Ju lutem hetoni për sfondin social dhe ekonomik të fëmijëve dhe kontrolloni nëse këta janë fëmijë me lloje të veçanta të aftësisë së kufizuar].*
3. **A udhëtojnë ata për të ardhur deri tek ju? Si? Nëse jo, A udhëtoni ju deri tek ata?**
4. **A është shërbimi juaj/ekspertiza juaj thelbësore në përcaktimin e shërbimeve specifike dhe/ose përfitimeve në para që marrin fëmijët me aftësi të kufizuara (ose familjet e tyre)?**
5. **Deri në çfarë mase mjedisi juaj i punës është miqësor ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara?** *[P.sh. rampa, tualet i qasshëm, terrene të sigurta etj.]*  
 Nëse është i tillë, **A mund të na jepni shembuj të iniciativave të marra për të bërë infrastrukturën më miqësore për fëmijët me aftësi të kufizuara? Si janë financuar ato apo si janë gjetur burimet?** *[hetoni për rolin e qeverisë, komunitetit, donacioneve private, projekteve të financuara nga ndonjë OJQ/OSHC/organizata të tjera, etj., në këtë drejtim]*
6. **Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqoheni në punën me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, dhe cilat janë masat e mundshme për t'i tejkaluar këto?** *Ju lutem, kërkonit shtjellim më në hollësi (lehtësuesi duhet të drejtojë diskutimin kah ajo se me çfarë lloji të pengesave ballafaqohen, siç janë: qasja ekonomike, shëndetësore, sociale, stigma, infrastruktura, numri i madh i fëmijëve në klasa, barriera kulturore etj.)*

7. **Në ç' masë jeni trajnuar ju dhe të tjerët në mjedisin tuaj të punës për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara?**  
Nëse përmendet trajnimi, **Ju lutem, a mund ta përshkruani trajnimin? Kush e ofroi trajnimin? Sa ishte efektiv?**
8. **Çfarë trajnimi specifik dhe/ose mbështetje tjetër specifike do të ju nevojitej që të përmirësoni punën tuaj me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe me familjet e tyre?**
9. **Deri në çfarë mase mendoni se fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre inkurajohen të kërkojnë shërbimet tuaja?**
10. **Cili është roli juaj në ngritjen e vetëdijes lidhur me të drejtat e fëmijëve për qasje në shërbimet ekzistuese?**
11. **A keni ndonjë bashkëpunim me ofruesit e tjerë të shërbimeve jashtë fushës suaj të ngushtë të ekspertizës? *Ju lutemi kërkonin që të përshkruhet dhe shtjellohet bashkëpunimi.***
12. **Deri në çfarë mase familjet paguajnë nga xhepi për të marrë disa/të gjitha llojet e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara?**
13. **Deri në çfarë mase ka alokime buxhetore për shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara këtë vit? A është i mjaftueshëm ky alokim? Cilat janë kategoritë e ndryshme buxhetore? *[P.sh. paga, infrastruktura, trajnimi, pajisjet, promovimi i ndërgjegjësimit, matja e performancës, M & V etj.]***  
Nëse 'jo', a mendoni se është i nevojshëm alokim i veçantë buxhetor? Pse ose pse jo?
14. **Për aq sa jeni në dijeni, a ka pasur raste të fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë përjetuar abuzim fizik dhe/ose emocional *[P.sh. tallje, abuzim fizik, frikësim/kërcënim, etj.]*?**  
Nëse 'po', nga kush? Cilat janë masat që **ju** merrni për të parandaluar abuzimin fizik dhe emocional të fëmijëve me aftësi të kufizuara?
15. **A ka ndonjë ofrues shërbimesh në komunitet që nuk mund të akomodojnë fëmijët me aftësi të kufizuara brenda ofrimit të shërbimit të tyre? *Ju lutem shtjelloni.***
16. **Si ofroni shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara në zonat e largëta? *Ju lutem përshkruani***
17. **Si do ta përshkruanit nivelin e ndërgjegjësimit dhe qëndrimin ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në përgjithësi?**
18. **Deri në çfarë mase përmbushen të drejtat e shëndetit, arsimit dhe mbrojtjes për fëmijët me aftësi të kufizuara në vendin ku jetoni?**

19. **A keni ndonjë procedurë për identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara duke përfshirë çdo shërbim të zbulimit të hershëm dhe parandalimit në nivel lokal?**  
Nëse 'po', a mund të përshkruani një procedurë të tillë?  
Nëse 'jo', deri në çfarë mase mendoni se një procedurë e tillë do të ishte e dobishme?
20. **A mund të na jepni ndonjë shembull të praktikës së mirë lidhur me ofrimin e shërbimeve tuaja për fëmijët me aftësi të kufizuara?**
21. **Sipas mendimit tuaj, a munden fëmijët me aftësi të kufizuara të përfshihen në shoqëri? Pse ose pse jo?**
22. **Deri në çfarë mase ju merrni ndonjë përkrahje në lidhje me shërbimet që u ofroni fëmijëve me aftësi të kufizuara nga zyrtarët lokalë në formën e udhëzimeve apo mjeteve të tjera? *Ju lutem shtjelloni me shembuj.***
23. **Sipas mendimit tuaj, çfarë lloj mbështetjeje (shtesë apo të re) ju nevojitet për ofrimin e shërbimeve të duhura për fëmijët me aftësi të kufizuara nga: (i) qeveria, (ii) organizatat joqeveritare dhe (iii) komunitetet?**

## Shtojca 4 - Lista e pjesëmarrësve në punëtorinë për rishikim dhe validim

Emri	Komuna	Organizata
Dr. Brandão Có, MD, MPH	Prishtinë	Shef i Zyrës - UNICEF Kosovë
James Mugaju	Prishtinë	Zëvendës Shef i Zyrës - UNICEF Kosovë
Arta Haliti	Prishtinë	Konsulente
Sami Uka	Prishtinë	NPO-OBSH
Afrim Maliqi	Prishtinë	Drejtor - HandiKOS
Durim Gashi	Prishtinë	Koordinatori i projektit- HandiKOS
Ardian Klaiqi	Prishtinë	Drejtësi për Fëmijët UNICEF
Afrim Ibrahimimi	Prishtinë	Zyrtar për MF UNICEF
Ibadete Krasniqi	Prishtinë	Drejtoreshë- OFAP
Burim Behluli	Prishtinë	Drejtor për Zhvillimin e Projekteve – SOS Fshati i Fëmijëve
Lulavere Behluli	Prishtinë	MASHT
Gazmend Tahiraj	Prishtinë	KAPIE (AKPAGJ)
Remzije Krasniqi	Prishtinë	Drejtoreshë- SOS kopshti
Saranda Bogujevci	Podujevë	Deputete në Kuvendin e Kosovës
Liridona Preniqi	Prishtinë	Zyrtare e DKA
Qazim Gashi	Prishtinë	MPMS
Luljeta Kabashi	Prishtinë	MASHT
Imrane Ramadani	Prishtinë	MASHT
Drita Dushi-Parduzi	Prishtinë	Olimpiada Speciale e Kosovës
Sahare Reçica	Prishtinë	IPK
Ivana Milosavljevic	Mitrovicë	UNICEF
Timur Ramiqi	Prishtinë	UNICEF
Igballe Rrahmani	Prishtinë	Zyra e Avokatit të Popullit
Ilirjana Geci	Prishtinë	FKAK
Mexhit Foniqi	Prishtinë	Sh.V.K
Hajrie Xhemali	Prishtinë	Sh.V.K
Feride Dashi	Prishtinë	UNICEF
Arijeta Sojeva	Prishtinë	ASK



Sanije Uka	Prishtinë	ASK
Dren Rexha	Prishtinë	UNICEF
Arjeta Gjokolli	Prishtinë	UNICEF
Adelina Shkodra	Prishtinë	UNICEF
Valmira Spahiu	Prishtinë	UNICEF
Milena Ilievska	Zvecan	-
Nenad Radivojevic	Mitrovicë	Caritas Kosova
Agron Gashi	Prishtinë	UNICEF
Ermira Shabani	Prishtinë	
Paula Hunt	Portugali	Konsulente ndërkombëtare e UNICEF
Vjollca Caka Belegu	Prishtinë	Konsulente vendore e UNICEF
Tamara Slavkovic	Mitrovica	UNICEF

## Shtojca 5 - Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara, sipas llojit të dëmtimit, që marrin shërbime arsimore në një Qendër Burimore

2006/07

Numri i fëmijëve/nxënësve sipas llojit të dëmtimit

Lloji i dëmtimit	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Intelektual	118	46	164
Dëgjim	65	33	98
Vizual	36	33	69
Fizik	1	1	2
Shumëfishtë	44	43	87
Gjithsej	264	156	420

2007/08

Numri i fëmijëve/nxënësve sipas llojit të dëmtimit

Lloji i dëmtimit	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Intelektual	78	36	114
Dëgjim	57	25	82
Vizual	34	21	55
Fizik	4	0	4
Shumëfishtë	76	53	129
Gjithsej	249	135	384

2008/09

Numri i fëmijëve/nxënësve sipas llojit të dëmtimit

Lloji i dëmtimit	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Intelektual	89	36	125
Dëgjim	55	27	82
Vizual	26	19	45
Fizik	1	0	1
Shumëfishtë	74	60	134
Gjithsej	245	142	387

2009/10

Numri i fëmijëve/nxënësve sipas llojit të dëmtimit

Lloji i dëmtimit	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Intelektual	127	81	208
Dëgjim	59	29	88
Vizual	25	15	40
Fizik	5	4	9
Shumëfishtë	52	24	76
Gjithsej	268	153	421

2010/11

Numri i fëmijëve/nxënësve sipas llojit të dëmtimit

Lloji i dëmtimit	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Intelektual	130	83	213
Dëgjim	58	31	89
Vizual	25	27	52
Fizik	3	2	5
Shumëfishtë	62	29	91
Gjithsej	278	172	450

2011/12

Numri i fëmijëve/nxënësve sipas llojit të dëmtimit

Lloji i dëmtimit	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Intelektual	115	79	194
Dëgjim	44	27	71
Vizual	24	18	42
Fizik	8	7	15
Shumëfishtë	90	42	132
Gjithsej	281	173	454

2012/13

Numri i fëmijëve/nxënësve sipas llojit të dëmtimit

Lloji i dëmtimit	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Intelektual	128	106	234
Dëgjim	40	21	61
Vizual	17	22	39
Fizik	3	5	8
Shumëfishtë	69	42	111
Gjithsej	257	196	453

2013/14

Numri i fëmijëve/nxënësve sipas llojit të dëmtimit

Lloji i dëmtimit	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Intelektual	124	82	206
Dëgjim	32	17	49
Vizual	28	23	51
Fizik	5	5	10
Shumëfishtë	68	41	109
Vështirësi në të folur, komunikim dhe gjuhë	2	4	6
Autizëm	17	9	26
Vështirësi/çrregullime në të mësuar	3	3	6
Gjithsej	279	184	463

2014/15

Numri i fëmijëve/nxënësve sipas llojit të dëmtimit

Lloji i dëmtimit	M	F	Gj
Intelektual	92	60	152
Dëgjim	25	15	40
Vizual	34	31	65
Fizik	0	2	2
Shumëfishtë	77	63	140
Vështirësi në të folur, komunikim dhe gjuhë	9	7	16
Autizëm	15	10	25
Çrregullime emocionale dhe të sjelljes	0	3	3
Vështirësi/çrregullime në të mësuar	0	2	2
Gjithsej	252	193	445

2015/16

Numri i fëmijëve/nxënësve sipas llojit të dëmtimit

Lloji i dëmtimit	M	F	Gj
Intelektual	80	57	137
Dëgjim	20	17	37
Vizual	15	16	31
Fizik	0	1	1
Shumëfishtë	54	39	93
Vështirësi në të folur; komunikim dhe gjuhë	4	3	7
Autizëm	11	13	24
Çrregullime emocionale dhe të sjelljes	4	3	7
Vështirësi/çrregullime në të mësuar	2	2	4
Sindroma Down	9	7	16
Gjithsej	199	158	357

## Shtojca 6 – Bibliografia (Burimet sekondare)

Kuvendi i Republikës së Kosovës (2012). Ligji NR. 04/L-110 mbi Ndërtimin. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/N. 18/03 Korrik 2012, Prishtinë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës (2015). Ligji N°. 05/L-020 mbi Barazinë Gjinore. Kosovë, Prishtinë.

Grupi për Qasje në Zgjedhje (2016). *Doracak për terminologjinë dhe qasjen e drejtë për personat me aftësi të kufizuara.*

Geci, I. & Xheladini, T. (2017). *Kuptimi i gjendjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë përmes zërit të tyre.*

KOMF (2014). *Më çu në shtëpi! - Analizë e shkurtër mbi avancimin e mbrojtjes së fëmijëve të braktisur në Kosovë (0-3 vjeç). Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve. Prishtinë.*

MDA (2016). Save the Children anketë bazë mbi shërbimet në dispozicion për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara në komunat e Gjakovës dhe Ferizajt.

Ministria e Shëndetësisë (n.d.). Vizitat në Shtëpi në Kujdesin Shëndetësor të Nënës dhe Fëmijës, Promovimi i Zhvillimit të Fëmijëve, Shëndeti dhe Mirëqenia - fletushkë. Ekipi i vizitave në shtëpi, Ministria e Shëndetësisë. Kosovë.

Republika e Kosovës. (2009). Strategjia për Shkollat Promovuese të Shëndetit në Kosovë 2009-2018. Qeveria e Kosovës. Prishtinë.

Republika e Kosovës. (2015). Rekomandim në lidhje me Strategjinë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të hartuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/ZKM. Institucioni i Avokatit të Popullit. Prishtinë.

Save the Children International (2015) *Krijimi i institucioneve parashkollore gjithëpërfshirëse. Praktika inovative 2015: Kosovë (91).*

SIDA (Nëntor 2014). *Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Ballkanin Perëndimor.* <http://www.sida.se/>

SOS Fshati Ndërkombëtar i Fëmijëve (2013). *Një fotografi e Arranzhimeve të Kujdesit Alternativ në Kosovë. (A Snapshot of Alternative Care Arrangements in Kosovo).*

Programi i binjakëzimit për të mbështetur zbatimin e Planit Strategjik të Sektorit të Arsimit në Kosovë 2011-2016 (Binjakëzimi Nr. KS 11 IB OT 02). *Udhërrëfyes për Diversitetin dhe Përfshirjen për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë.*

UNICEF Kosovo (2014) *Raporti Vjetor i Zyrës së Vendit*



UNICEF (2014). *Korniza Ligjore për të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë: Studim i përputhshmërisë së legjislacionit ekzistues me Konventën për të Drejtat e Fëmijës*. Prishtinë.

UNICEF Kosovo (2015) *Raporti Vjetor i Zyrës së Vendit*.

UNICEF (2015). UNICEF (2015). *Mirëqenia e fëmijëve në Kosovë – Varfëria dhe privimi në mesin e fëmijëve sipas Analizës së Privimeve të Shumëfishta (MODA)*. Prishtinë.

UNICEF (2016). *Vlerësimi i Sistemit të Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë (RKSKB 1244) 2009-2015 - Raporti i Vlerësimit*. Kosovë.

UNICEF (2016). *Rëndësia e Praktikave të Vizitave në Shtëpi për Fëmijët në Kosovë (RKSKB 1244): Rast studimor i komunës së Dragashit*. Kosovë

UNICEF & International Step by Step Association *Moduli 12: Fëmijët që zhvillohen ndryshe - Fëmijët me aftësi të kufizuara ose vështirësi në zhvillim*.

OBSH & UNICEF (n.d.) *Një përmbledhje e politikave Bazuar në Gjetjet e MICS 2014 - Ndërtimi i një ambienti mundësues për politikatat për përmirësimin e shëndetit të fëmijëve, zhvillimit dhe mirëqenies në Kosovë*.

## Fusnotat

1. UNICEF (ND) UNICEF Guidelines for Disability Situation Analysis retrieved from [https://www.unicef.org/disabilities/index\\_71769.html](https://www.unicef.org/disabilities/index_71769.html)
2. <http://ask.rks.gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/labor-force-survey-in-kosovo-q1-2017>
3. Banka Botërore në Kosovë\*, Country Program Snapshot, prill 2016, në [http://pubdocs.worldbank.org/en/419461462386476530/World-Bank-Kosovo\\*-Program-Snapshot-April-2016.pdf](http://pubdocs.worldbank.org/en/419461462386476530/World-Bank-Kosovo*-Program-Snapshot-April-2016.pdf)
4. Marrë nga UNDP më 9 janar 2017, <http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/countryinfo.html>
5. Programi i Kosovës Programi i Kosovës për bashkëpunim në mes të institucioneve të Kosovës dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) - Plani i Veprimit për Programin e Kosovës (KPAP) 2016-2020 (fq.2)
6. Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Raport i Raportuesit Special për të Drejtat e Njeriut të Personave të Zhvendosur Brenda vendit, Chaloka Beyani: Follow-up mission to Serbia, including Kosovo\*, 5 qershor 2014, në <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G14/042/17/PDF/G1404217.pdf?OpenElement>
7. Republika e Kosovës (2011) Sondazh i gjerë mbi personat me aftësi të kufizuara në Kosovë. Zyra për Qeverisje të Mirë, Prishtinë, Kosovë.
8. Komisioni Evropian (2013). Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit – raporti i Progresit i Kosovës për vitin 2013 që shoqëron dokumentin Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve - Strategjia e Zgjerimit të BE-së. f. 17
9. Komisioni Evropian (2014). Raporti i Progresit të Kosovës f. 19.
10. Komisioni Evropian (2015). Dokumenti i punës i stafit të Komisionit - Raporti i Progresit i Kosovës për Kosovën 2015 që shoqëron dokumentin Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2013-2014.
11. IBID, f. 12
12. IBID, f. 20
13. IBID, f. 24
14. Komisioni Evropian (2016). Dokumenti i punës i stafit të Komisionit - Raporti i Kosovës i vitit 2016 që shoqëron dokumentin Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve, 2016 Komunikimi mbi Politikën e Zgjerimit.
15. Raporti Vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015
16. IBID, faqe 59.
17. Raporti Vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016, faqe 44.
18. UNICEF (2017). Analiza e Situatës së Fëmijëve dhe Gruas në Kosovë (UNSCR1244).
19. Konferenca e KOMF për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, 3 dhjetor 2015
20. IBID, f. 113
21. për më shumë informacion, shih: [http://www.inclusive\\_education.org/sites/default/files/uploads/booklets/IE\\_Webinar\\_Booklet\\_2.pdf](http://www.inclusive_education.org/sites/default/files/uploads/booklets/IE_Webinar_Booklet_2.pdf)
22. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.
23. Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra e Qeverisjes së Mirë (2013) Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023
24. Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra e Qeverisjes së Mirë (2013) Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, f. 8
25. Agjencia e Statistikave të Kosovës (2011) Regjistrimi i popullsisë dhe banesave në Kosovë 2011 - Rezultatet përfundimtare. Fondi i Mirëbesimit Multi-Donatorë i Projektit të Regjistrimit. Prishtinë .
26. Agjencia e Statistikave të Kosovës (2011) Regjistrimi i popullsisë dhe banesave në Kosovë 2011 - Rezultatet përfundimtare. Fondi i Mirëbesimit Multi-Donatorë i Projektit të Regjistrimit. Prishtinë .
27. Agjencia e Statistikave të Kosovës (2011) Regjistrimi i popullsisë dhe banesave në Kosovë 2011 - Rezultatet përfundimtare. Fondi i Mirëbesimit Multi-Donatorë i Projektit të Regjistrimit. Prishtinë, Tabela 3.38, f. 106
28. Agjencia e Statistikave të Kosovës (2011) Regjistrimi i popullsisë dhe banesave në Kosovë 2011 - Rezultatet përfundimtare. Fondi i Mirëbesimit Multi-Donatorë i Projektit të Regjistrimit. Prishtinë, Tabela 3.38, f. 106
29. Agjencia e Statistikave të Kosovës (2011) Regjistrimi i popullsisë dhe banesave në Kosovë 2011 - Rezultatet përfundimtare. Fondi i Mirëbesimit Multi-Donatorë i Projektit të Regjistrimit. Prishtinë, Tabela 3.39, f. 108
30. UNICEF (2013) Raporti i Kosovës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara- dokument i brendshëm - Brian O'Toole

31. Intervistë, Zyra për Qeverisje të Mirë, 18 tetor 2016
32. Iniciativa për Monitorimin e Aftësisë së Kufizuar Evropa Juglindore (2013) Raporti: Pozita e personave me aftësi të kufizuara në komunitetin serb në Kosovë.
33. Iniciativa për Monitorimin e Aftësisë së Kufizuar Evropa Juglindore (2013) Raporti: Pozita e personave me aftësi të kufizuara në komunitetin serb në Kosovë. f. 6
34. Iniciativa për Monitorimin e Aftësisë së Kufizuar Evropa Juglindore (2013) Raporti: Pozita e personave me aftësi të kufizuara në komunitetin serb në Kosovë. f. 43
35. Intervistë, Zyra për Qeverisje të Mirë, 18 tetor 2016
36. Republika e Kosovës (2012) Ligji Nr. 04/092 për Personat e Verbër. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 20/18 korrik 2012, Prishtinë
37. Republika e Kosovës (2016) Ligji N° 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave paraplegjik dhe tetraplegjik. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 19/16 qershor 2016, Prishtinë.
38. Republika e Kosovës (2014) Rregullorja QRK Nr. 15/2014 për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në Republikën e Kosovës.
39. Komunikim personal me Arbena Beranin, Zyrtare e Lartë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
40. Republika e Kosovës (2008) Ligji Nr. 03/L-022 për Përkrahjen Materiale për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: Viti III/N.37/10 shtator 2008
41. Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë (2017). Raporti Vjetor 2016 n.16. Prishtinë. f. 60.
42. Komunikim personal, intervista me MSH, 8 dhjetor 2016
43. Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. (2017) Koncept Dokumenti për rregullimin e fushës së të drejtave të përfitimeve dhe shërbimeve për Personat me Aftësi të Kufizuara (në draft).
44. IBID, f. 17-19
45. Mattosovich, D. et al (2012). Using the ICF framework for collecting information on the barriers to inclusion in children in the Republic of Kosovo – design and preliminary results. Poster presented at the Meeting of the WHO Collaborating Centres for the Family of International Classifications, Brasilia (Brazil), 13-19 tetor 2012.
46. UNICEF (2013) Raporti i Kosovës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara – dokument i brendshëm – Brian O’Toole
47. UNICEF (2014) Korniza Ligjore për të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë - Një studim i përputhshmërisë së legjislacionit ekzistues me Konventën për të Drejtat e Fëmijës), 2014, f. 9
48. Kuvendi i Kosovës (2004), Ligji Nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit. Shkurt 2004.
49. Republika e Kosovës, Kuvendi (2015) Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore. Prishtinë, maj 2015.
50. Republika e Kosovës, Kuvendi (2015) Ligji Nr. 05/L-019 mbi Avokatin e Popullit. Prishtinë, maj 2015.
51. Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit (2009) Plani Kombëtar i Veprimit për Aftësinë e Kufizuar për Republikën e Kosovës 2009-2011, Prishtinë, maj 2009.
52. IBID, f.8
53. Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë (2013) Strategjia Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023
54. Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë (2013) Strategjia Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, f. 7
55. Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë (2013) Strategjia Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, f. 8
57. Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë (2013) Strategjia Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, f. 14 – nënvizimi nuk është në origjinal.
58. Republika e Kosovës (2015). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës (2013-2015) - Raporti i Progresit. Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë, f. 15
59. Instituti për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim të Rinisë - Kosovë, Raporti i Vendit i Kosovës për Kapacitetin Ligjor i PERSON qershor 2016
60. Republika e Kosovës (2013). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015) . Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë.
61. Republika e Kosovës (2013). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015) . Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë, f. 4
62. Republika e Kosovës (2013). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015) . Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë, f. 4

63. Republika e Kosovës (2013). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015) . Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë, f. 5
64. Republika e Kosovës (2015). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015)-Raporti i Progresit, Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë.
65. Republika e Kosovës (2015). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015)-Raporti i Progresit, Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë, f. 12.
66. Republika e Kosovës (2013). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015)-Raporti i Progresit. Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë, f. 10.
67. Republika e Kosovës (2013). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015)-Raporti i Progresit. Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë, f. 11.
68. Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (2005) Ligji Nr. 02/L-17 mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare. Kuvendi i Kosovës. Prishtinë.
69. Republika e Kosovës (2015). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015)-Raporti i Progresit. Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë, f. 13.
70. Republika e Kosovës (2013). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015). Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë, f. 14.
71. Republika e Kosovës (2013). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015)-Raporti i Progresit. Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë, f. 14-15.
72. Republika e Kosovës (2015). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015)-Raporti i Progresit. Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë, f. 14.
73. Republika e Kosovës (2013). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015). Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë, f. 28.
74. Republika e Kosovës (2015). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015)-Raporti i Progresit. Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë, f. 16.
75. Republika e Kosovës (2013). Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015). Zyra për Qeverisje të Mirë, Kosovë, f. 35.
76. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2015). Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/N.16/26 qershor 2015. Prishtinë.
77. Qeveria e Republikës së Kosovës (2017) Rregullorja QRK-N. 03/2017 për Mekanizmat Institucional për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit në Qeveri dhe Komuna.
78. Republika e Kosovës, Kuvendi (2012) Ligji N.04/L-017 për ndihmën juridike falas. Prishtinë. 2 shkurt, 2012
79. UNICEF (2013) Raporti i Kosovës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara - dokument i brendshëm – Brian O’Toole
80. UNICEF (2013) Raporti i Kosovës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara - dokument i brendshëm – Brian O’Toole
81. Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (2004). Ligji Nr. 2004/15 mbi Ndërtimin. Kuvendi i Kosovës. Prishtinë.
82. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2007). Udhëzimi Administrativ për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në Ndërtesat e Ndërtimit. Qeveria e Kosovës.
83. Basha, R. (2015). Disability and Public Space – Case Studies of Prishtina and Prizren. International Journal of Contemporary Architecture “The New ARCH”, vol. 2, N3.
84. Instituti për Qëndrueshmëri dhe Zhvillimi të Rinisë - Kosovë, Raporti i Vendit i Kosovës mbi Kapacitetin Ligjor i PERSON - qershor 2016, faqe 8
85. Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (2005) Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare. Kuvendi i Kosovës. Prishtinë.
86. Republika e Kosovës (2012). Ligji Nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare. Prishtinë.
87. Republika e Kosovës (2012). Ligji Nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare. Prishtinë.
88. UNICEF (2013) Raporti i Kosovës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara - dokument i brendshëm – Brian O’Toole
89. Hollows, A. (2014). Strategic Development of Social Work Education in Kosovo: Building a valued profession.
90. IBID, f. 4
91. IBID, f. 5
92. Republika e Kosovës (2014) Ligji nr. 4/L131 për skemat pensionale të financuara nga shteti. Prishtinë.

93. Kuvendi i Kosovës (2007). Ligji Nr. 2003/15 mbi Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë. Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë/Prishtinë: Viti II/N.15/01 gusht 2007
94. Republika e Kosovës (2008) Ligji Nr. 03/L-022 për Përkrahjen Materiale për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: Viti III/N.37/10 shtator 2008
95. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (2010). Plotësim i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2009 për Përcaktimin e Rregullores së Procedurave të Aplikimit për Realizimin e të Drejtës për Përkrahje Materiale për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme. Republika e Kosovës, Prishtinë.
96. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (2014). Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 06/2014 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.07/2010 për Rregullimin dhe Përcaktimin e Procedurave të Aplikimit për Ushtrimin e të Drejtës për Përkrahje Materiale për Familjet me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme. Republika e Kosovës, Prishtinë.
97. Republika e Kosovës (2012) Ligji nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 mbi Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/N.15/13 qershor 2012, Prishtinë.
98. UNICEF (2013) Raporti i Kosovës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara – dokument i brendshëm– Brian O’Toole
99. Dr. E. Tahiraj, A Future for Our Children: mapping social protection in Kosovo\* (Një e ardhme për fëmijët tanë: hartëzimi i mbrojtjes sociale në Kosovë), UNICEF, shkurt 2016
100. Agjencia e Statistikave të Kosovës, Publikimi i Statistikave të Mirëqenies Sociale 2015, 2016
101. Intervistë, UNICEF, 13 tetor 2016
102. HandiKOS (2013) Strategjia dhe Plani i Punës - HandiKOS, Shoqata e Paraplegjikëve dhe fëmijëve të paralizuar të Kosovës. Prishtina. F. 9.
103. UNICEF (2013) Raporti i Kosovës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara - dokument i brendshëm – Brian O’Toole
104. Agjencia e Statistikave të Kosovës, Publikimi i Statistikave të Mirëqenies Sociale 2015, 2016
105. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Statistikat e Arsimit 2015-2016, 2016
106. PEMA (2017) APEL URGENT: Mbështetni 4 qendrat e kujdesit ditor që të ruajmë jetën e qindra fëmijëve me aftësi të kufizuara: <http://pemakosova.org/>
107. PEMA (2017) APEL URGENT: Mbështetni 4 qendrat e kujdesit ditor që të ruajmë jetën e qindra fëmijëve me aftësi të kufizuara. <http://pemakosova.org/>
108. SHËNIM: Neni 123 i Kushtetutës së Kosovës thotë: “Qeveria vendore është e bazuar në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike duke pasur parasysh nevojat dhe interesat specifike të komuniteteve jo në shumicë dhe anëtarëve të tyre.”
109. Petrovic, M., Banic, M. & Ruzic, M. G. (nd) Analiza e Situatës së të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë (Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq, Zveçan).
110. World Vision International (2016) Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijëve - Kosovë
111. World Vision International (2016) Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijëve - Kosovë, f. 10
112. Shënim: Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijëve është një analizë pilot e të dhënave të përfshira në bazën e të dhënave të UNICEF TransMonee database, dhe bazohet në listat kontrolluese të Manualit Zbatues të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve për 8 shtete: Shqipëria, Armenia, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Gjeorgjia, Kosova \*, Rumania dhe Serbia. Indeksi mat pesë dimensionet (p.sh. politika dhe ligji, shërbimet, kapaciteti, koordinimi dhe llogaridhënia) e veprimeve të qeverisë për secilin nga nenet e KDF që i referohen mbrojtjes së fëmijëve. Indeksi përfshin 626 tregues të grumbulluar në 4 masa: 1) cenueshmëria e fëmijëve, 2) mjedisi i qeverisjes, 3) përpjekjet për t’i dhënë fund dhe parandaluar dhunën, kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve, dhe 4) kapacitetin e punës sociale. Brenda kësaj, “indeksi i cenueshmërisë së fëmijës” mat gjendjen e fëmijëve që jetojnë jashtë familjeve të tyre biologjike; personeli i sektorit publik në dispozicion për të avokuar në emër të fëmijëve të cenueshëm; dhe në fund, shumën e shpenzimeve të mirëqenies shtetërore si përqindje e BPV-së.
113. Shënim: Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijëve krahason të dhënat nga Shqipëria, Armenia, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Gjeorgjia, Kosova \*, Moldavia, Rumania dhe Serbia.
114. World Vision (2016) Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijëve
115. IBID, [www.childprotectionindex.org](http://www.childprotectionindex.org) f. 21
116. Republika e Kosovës (2009). Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve në Republikën e Kosovës 2009-2013. Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, qershor 2009.
117. IBID, f. 40
118. Coram Children’s Legal Centre (2015). Support to the Office for Good Governance/ Office of the Prime Minister for the Assessment of the Strategy and National Action Plan on Children’s Rights: 2009-2013 - Assessment Report. London, UK.

119. Coram Children's Legal Centre (2015). Support to the Office for Good Governance/ Office of the Prime Minister for the Assessment of the Strategy and National Action Plan on Children's Rights: 2009-2013 – Strategy Development Report. London, UK.
120. Terre des hommes (n.d.). Working Protocol: Inter-Sectorial Collaboration in Child Protection Cases.
121. IBID, f. 8
122. Faqe 57
123. Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (2005) Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare. Kuvendi i Kosovës. Prishtinë.
124. Agjencia e Statistikave të Kosovës (2011) Regjistrimi i popullsisë dhe banesave në Kosovë 2011 - Rezultatet përfundimtare. Fondi i Mirëbesimit i Projektit Multi-Donor të Regjistrimit. Prishtina, Tabela 3.52, f. 120
125. Intervistë, Qendra për Punë Sociale në Prishtinë , 18 tetor 2016
126. KOMF (2014). IsTax-Payers' Money Reaching the Children in Need? Brief Budget Analysis on Social Protection Policies for Children in Kosovo. f. 16
127. KOMF (2013). Who Speaks Out for Me? - KOMF Positions on Child Protection. Coalition of GOs for Child Protection. Prishtina.
128. IBID; f. 20
129. Amici de Bambini & Cooperazione Italiana allo Sviluppo (n.d.) Strengthening of Services in Favor of Minors Under the Responsibility of the Centre for Social Work Kosovo for family reasons.
130. UNICEF Kosovo "Strengthening family based care, strengthening social work- A situation analysis of foster care in Kosovo (UNSCR) 2015"
131. Amici de Bambini & Cooperazione Italiana allo Sviluppo (n.d.) Strengthening of Services in Favor of Minors Under the Responsibility of the Centre for Social Work Kosovo for family reasons. f. 4
132. Amici de Bambini & Cooperazione Italiana allo Sviluppo (n.d.) Strengthening of Services in Favor of Minors Under the Responsibility of the Centre for Social Work Kosovo for family reasons. f. 5
133. Republika e Kosovës (2010). Ligji Nr. 03/L-212 mbi Punën. Kuvendi i Kosovës. Prishtinë.
134. <http://www.institutigap.org/spendingsEng/#/~-/budget-of-kosovo---planning> qasur në shtator 15, 2017
135. Titulli i nenit 24 është ndryshuar nga "Arsimi" në "Arsim gjithëpërfshirës" me miratimin e Komitetit të Përgjithshëm #4 më 26 gusht 2016. Për tekstin e plotë shih [http://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/GC/4&Lang=en](http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/GC/4&Lang=en)
136. MASHT (2015) Plani strategjik për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016 - 2020. Prishtinë, f. 11.
137. Avokati i Popullit, Raporti Vjetor 2015, 2016, në [http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/English\\_Annual\\_Report\\_2015\\_351292.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/English_Annual_Report_2015_351292.pdf)
138. Komisioni Evropian (2013). Mbështetje për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore (SEN). Punësimi, Çështjet Sociale dhe Përfshirja.
139. UNICEF (n.d.) Early Childhood Development – A Statistical Snapshot – Building Better Brains and Sustainable Outcomes for Children. Kosovë.
140. UNICEF, Reaching every child: The promise of equity, 2016
141. MEST (n.d.) Udhëzues për ekipet e vlerësimit profesional për të vlerësuar nevojat arsimore të fëmijëve me nevoja të veçanta në komunë. Departamenti për Zhvillimin e Politikave të Divizionit të Arsimit Parauniversitar të Nevojave të Arsimit Special.
142. Matero, M. (2016). Report on the Functioning of Resource Centres in Kosovo - Twinning programme to support implementation of the Kosovo Education Sector Strategic Plan 2011 – 2016 - Twinning No. KS 11 IB OT 02.
143. Matero, M. (2016). Report on the Functioning of Resource Centres in Kosovo - Twinning programme to support implementation of the Kosovo Education Sector Strategic Plan 2011 – 2016 - Twinning No. KS 11 IB OT 02. Pg. 4
144. UNICEF (2016) Raporti Vjetor i Zyrës së Vendit, fq. 3
145. MASHT (n.d.). Udhëzimet e Projektimit për Normat dhe Standardet e Objekteve të Shkollave, Udhëzimet e Përgjithshme (Vëllimi 1) dhe Udhëzimet Specifike (Vëllimi 2).
146. UNICEF (2016) Raport mbi Zbatimin e Shërbimeve të Vizitave në Shtëpi për Përmirësimin e Mirëqenies së Nënës dhe Fëmijës në Gjashtë Komuna gjatë 2015 - 2016, Prishtinë, dhjetor 2016.
147. Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2014. 2013-2014 Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë të Kosovës. Prishtinë, Kosovë: Agjencia e Statistikave të Kosovës, në <http://ask.rks-gov.net/media/1878/monitoring-the-situation-of-children-and-women.pdf> MICS 2014
148. MSH 2016 – Raport mbi Situatën Perinatale në Kosovë - 2015



149. UNICEF (2016) Raporti Vjetor i Zyrës së Vendit, fq. 1
150. UNICEF (2013) Raporti i Kosovës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara - dokument i brendshëm - Brian O'Toole
151. Avokati i popullit, Raporti Vjetor i viteve 2015, 2016, në uebfaqen [http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/English\\_Annual\\_Report\\_2015\\_351292.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/English_Annual_Report_2015_351292.pdf)
152. KOMF (2014). Is Tax-Payers' Money Reaching the Children in Need? Brief Budget Analysis on Social Protection Policies for Children in Kosovo. Pg. 20
153. Intervistë, Asociacioni i Komunave, 18 Tetor 2016
154. Fondacioni One to One Children's, Kosovë: how do we do it? 10 maj 2015, në uebfaqen <https://www.onetoonechildrensfund.org/tag/charity/>
155. Intervistë, Asociacioni i Komunave, 18 Tetor 2016
156. Avokati i popullit, Raporti Vjetor i viteve 2015, 2016, në uebfaqen, [http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/English\\_Annual\\_Report\\_2015\\_351292.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/English_Annual_Report_2015_351292.pdf)
157. Raporti i UNICEF (2013) i Kosovës për fëmijët me aftësi të kufizuara - dokument i brendshëm - Brian O'Toole
158. Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar (n.d.) Deklarata mbi Fuqizimin e Forumit. Prishtinë, Kosovë.
159. Instituti për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim të Rinisë - Kosovë, Raporti për Kosovën për Kapacitetin Ligjor i PERSON - Qershor 2016, faqe 5
160. Republika e Kosovës (2013). Programi Kombëtar për ofrimin e shërbimeve për gjuhën e shenjave për personat e shurdhër në Republikën e Kosovës (2013-2016). Prishtinë.
161. Republika e Kosovës (2013). Programi Kombëtar për ofrimin e shërbimeve për gjuhën e shenjave për personat e shurdhër në Republikën e Kosovës (2013-2016). Prishtinë, faqe 7.
162. Shih, për shembull, <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC4624231/>
163. Qeveria e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës (2016), Strategjia për avancimin e të drejtave dhe statusit të personave me aftësi të kufizuara në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës (2016-2021), Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, f. 18 & Qeveria e Republikës Srpska (2017), Strategjia për përmirësimin e kushteve sociale të personave me aftësi të kufizuara në Republikën Srpska 2017-2026,, faqe 28
164. Qeveria e Republika Srpska (2017), Strategjia për përmirësimin e kushteve sociale të personave me aftësi të kufizuara në Republikën Srpska 2017-2026, faqe 35
165. Qeveria e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës (2016), Strategjia për avancimin e të drejtave dhe statusit të personave me aftësi të kufizuara në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës (2016-2021), Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, f. 29



European Union Office in Kosovo

Postal address:  
Kosova Street 1,  
P.O.Box 331, Pristina 10000  
Kosovo

Phone number:  
+383 38 5131 200

Email:  
[delegation-kosovo@eeas.europa.eu](mailto:delegation-kosovo@eeas.europa.eu)



European  
Union  
Kosovo

UNICEF Kosovo

"Behije Dashi", 7  
Prishtine/ Kosovo  
tel : + 381 38 249 230/231/232

e-mail: [prishtina@unicef.org](mailto:prishtina@unicef.org)  
web: [www.unicef.org/kosovoprogramme](http://www.unicef.org/kosovoprogramme)  
Facebook: UNICEF Kosovo Programme